



Komuna e Junikut


**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Programi i mbështetjes së planifikimit hapësinor komunal (MuSPP)

*Së bashku bëjmë qytete më të mira*



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



**PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I JUNIKUT  
2011 - 2023**

Junik  
Korrik, 2011

## JUNIKU 2011-2023



**Mirësevini në Kullat e Junikut!  
Freskohuni me ujin e Erenikut!  
Pushoni në Moronicë!  
Ngjituni në Gjeravicë!**

*(Punëtorja e Vizionimit, Ohër 2007)*

Ky dokument është përgatitur nga Komuna e Junikut, bartëse e të cilit është Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis në bashkëpunim me UN-HABITAT (Programin për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor (MuSPP2) dhe CHwB (Trashëgimia Kulturore pa Kufij), të dy keto organizata të financuar nga Sida suedeze. Procesi është përkrahur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) respektivisht Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH). Financimi i procesit të hartimit të këtij dokumenti është realizuar nga Komuna e Junikut, CHwB dhe UN-HABITATI.



*“Përmbajtja e planit jo-domosdoshmërisht reflekton qëndrimin e UN HABITAT-it, të Sida-s apo Qeverisë së Suedisë”.*

**Junik, Korik 2011**

## Fjala e kryetarit

*“Juniku është vend unik, prandaj besoj dhe ftoj të gjithë Junikasit të tregohen unik në realizimin e vizionit për zhvillimet e ardhshme në Junik”*

Komuna e Junikut është komunë e re, e formuar si Pilot-Komunë me 26 shtator 2005 dhe e certifikuar me 13 gusht të vitit 2008. Edhe pse komunë e re, me angazhimin e Qeverisë Lokale, banorëve të komunës dhe një numër të donatorëve, Juniku ka arritur të përpilojë dhe aprovojë dokumente të rëndësishme strategjike për komunën si: Planin Zhvillimor Urban (PZHU), Planin Rregullues Urban “Qendra”, Planin Zhvillimor për Konzervimin e Trashëgimisë Kulturore, Strategjinë e Zhvillimit Lokal si dhe tani përpilimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) si njërin nga dokumentet më të rëndësishme për zhvillimin hapësinor të Komunës.

Procesi i hartimit të Planit Zhvillimor të Junikut është bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor, Udhëzimet dhe parimet e përcaktuara nga ky Ligj.

Hartimi i këtij Plani e ka rëndësinë e madhe, sepse, është përpiluar nga stafi komunal që përfshinë ekspertë të fushave të ndryshme në kuadër të drejtorive komunale, të cilët kanë qenë të mbështetur nga ekspertë të Programit për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor i UN-HABITAT-it dhe Organizatës Joqeveritare “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” (CHWB) që të dyja të financuara nga Sida suedeze. Gjatë këtij procesi kishim edhe mbështetjen profesionale të Institutit për Planifikim Hapësinor (Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në përgjithësi). Duke hartuar këtë Plan me resurset tona njerëzore dhe me një kosto financiare shumë të vogël, Juniku ka treguar një mënyrë alternative të hartimit të këtyre dokumenteve nga praktikat e përdorura deri tani në komunat e Kosovës.

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) i Junikut, për ne është një dokument shumë me rëndësi, sepse, ai na ofron një vizion të qartë dhe përcakton orientimet e zhvillimit të ardhshëm ekonomik, shoqëror, fizik dhe hapësinor të komunës deri në vitin 2023+.

Me këtë Plan, vihen në pah shtyllat kryesore të zhvillimit të ardhshëm të komunës, si turizmi i bazuar në potencialin natyror dhe atë kulturor, bujqësia dhe agro-biznesi, hulumtimi i shfrytëzimit të potencialit pyjor dhe energjisë alternative.

Për të arritur vizionin tonë, ne duhet që të investojmë edhe në arsimimin dhe avancimin e kapaciteteve tona njerëzore në fushat e lartpërmendura dhe ato që ndërlidhen me to. Do të fokusohemi me theks të veçantë tek të rinjtë, duke pas parasysh popullatën shumë të re dhe entuziaste për punë. Prandaj, ne dëshirojmë që kësaj kategorie përmes realizimit të propozimeve dhe projekteve të dhëna në këtë plan, t’i ofrojmë mundësi punësimi. Në këtë mënyrë do të parandalojmë migrimin e tyre jashtë dhe në përgjithësi do të përmirësojmë mirëqenien sociale edhe për të gjithë banorët e Junikut, pa marrë parasysh moshën apo gjininë.

Në procesin e hartimit të këtij dokumenti, kemi dëshmuar përkushtim, përgjegjshmëri në punë, por, jemi treguar edhe shumë bashkëpunues në raport me partnerët tanë të përfshirë në këtë proces. Kemi qenë transparent ndaj qytetarëve, duke i përfshirë ata në fazat e ndryshme të hartimit të këtij dokumenti. Pikërisht për këtë, unë besoj që në zbatimin e këtij Plani të kemi përkrahjen para së gjithash të qytetarëve dhe të gjithë përfaqësuesve relevant qofshin ata qeveritarë, të sektorit publik apo privat dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Natyrisht, duke marrë parasysh buxhetin komunal shumë modest, komuna e Junikut do të tregohet e përkushtuar dhe e hapur për bashkëpunim edhe me donatorë në zbatimin e Projekteve të këtij Plani.

Junikasit kanë lënë gjurmë me zhvillime pozitive në historinë e Kosovës, këtë jemi të gatshëm ta bëjme edhe tani.

Prandaj, Juniku është vend unik, dhe unë besoj dhe ftoj të gjithë junikasit të tregohen unik, të bashkuar në realizimin e këtij vizioni për zhvillimet e ardhshme në Junik.

**Kryetari i Komunës së Junik  
Agron Kuqi**



### **EKIPI PUNUES:**

**Faik Tofaj**, *inxh. i dip. i makinerisë*; Komuna Junik - **Koordinator i Projektit**  
**Ferdone Tofaj**, *inxh. e dipl. e arkitekturës*; Komuna Junik - **Udhëheqëse e Projektit**  
**Lumnije Gashi**, *Inxh. e dip.e arkitekturës/MA Men. dhe Zhvillim Urban*; MuSPP2/UN-HABITAT - **Këshillëtare**  
**Teuta Jaha-Hoxha**, *inxh. dipl.ark.kand.MSc Ark.Planifikim Hap.&Mngt*; MuSPP2/UN-HABITAT - **Udhëheqëse e Projektit**  
**Dukagjin Bakia**, *Bsc/Dip TP/Msc Planifikim Urban*; MuSPP2/UN-HABITAT - **Udhëheqës i Projektit**  
**Enes Toska**, *inxh. i dipl. i arkitekturës*; CHwB - **Udhëheqës i Projektit**  
**Shkodran Gaxherri**, *inxh. i dipl. i bujqësisë*; Komuna Junik - **Anëtar i ekipit**  
**Flurije Shehu**, *gjeodete*; Komuna Junik - **Anëtar i ekipit**  
**Khavit Velijaj**, *inxh. i dip. i makinerisë*; Komuna Junik - **Anëtar i ekipit**  
**Xhemë Shehu**, *Gjeodet*; Komuna Junik - **Anëtar i ekipit**  
**Arten Hamza**, *Ekonomist i diplomuar*; Komuna Junik - **Anëtar i ekipit**

### **EKIPI PËRKRAHËS:**

**Arton Krasniqi**, *Arsimtar*; Komuna Junik  
**Ali Gacaferi**, *inxh. i dipl. i bujqësisë*; Komuna Junik  
**Shkelzen Shehu**, *Tek. i matematikës*; Komuna Junik  
**Xhavit Jasiqi**, *inxh. i dip. i ndërtimtarisë*; Komuna Junik  
**Avdyl Gjota**, *Ekonomist*, Komuna Junik  
**Visar Tofaj**, *Ekonomist*, Komuna Junik  
**Blerta Lokaj**, *Ekonomist*, Komuna Junik  
**Tor Erikson**, *ark/planer*; MuSPP2/UN-HABITAT  
**Rudina Qerimi**, *inxh. e dipl. e arkitekturës*; MuSPP2/UN-HABITAT  
**Joachim Bergerhoff**, *Planer transporti*; MuSPP2/UN-HABITAT  
**Gloriosa Hisari**, *Juriste e diplomuar*; MuSPP2/UN-HABITAT  
**Caroline Johansson**, *Arkitekt pejsazhi*, MuSPP2/UN-HABITAT  
**Arjeta Himaduna**, MuSPP2/UN-HABITAT  
**Ibrahim Kryeziu**, *Ekonomist i diplomuar*; EULOG  
**Bekim Gaxherri**, *Profesor*, Komuna Junik  
**Idriz Gacaferi**, *Jurist*, Komuna Junik  
**Halit Haxhiu**, *I.d i Ndertimtaris*, Komuna Junik  
**Zenun Shala**, *Ndermarja "Sigma"*, Komuna Junik  
**Haki Jasiqi**, *Ndermarja "Ardi-J" Market*, Komuna Junik

### **KONSULENTË TË JASHTËM:**

**Idriz Shala**, *Gjeograf*; GIS ekspert  
**Tush Markaj**, Ekspert mjedisi  
**Pëllumb Gjinolli**, *inxh. i mjedisit MSc*; Ekspert mjedisi

### **LEKTURA:**

**Faik Doda**, profesor

#### **Falënderimet:**

Falënderojmë në veçanti Institutin për Planifikim Hapësinor (Luan Nushi-Drejtor, Festa Nixha, Shpend Agaj dhe Ismail Gagica) për mbështetjen profesionale të ofruar në këtë dokument. Poashtu falënderojmë Departamentin e Planifikimit Hapësinor; Departamentin e Banimit dhe Ndërtimit; Departamentin e Mjedisit si dhe Agjencinë për Mbrojtje të Mjedisit; Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural; Agjencinë e Pyjeve të Kosovës; Ministrinë e Energjisë dhe Minierave; Institutin e Sizmologjisë; Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit; Ministrinë e Kulturës; Entin e Statistikave të Kosovës; OSBE-në; EULOG-un; Ndërmarrjet Publike që operojnë në Komunën e Junikut; Përfaqësuesit e Organizatave Joqeveritare; Qytetarët; Komunitetin e Biznesit dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e këtij Dokumenti.

## Tabela e përmbajtjeve

<b>Tabela e përmbajtjeve .....</b>	<b>5</b>
<b>SFONDI .....</b>	<b>9</b>
1.1. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RËNDËSIA E TIJ.....	9
1.2. QËLLIMET E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL të JUNIKUT .....	10
1.3. PROCESI I PLANIFIKIMIT DHE METODOLOGJIA .....	11
1.4. HISTORIKU I JUNIKUT.....	12
1.5. ADMINISTRATA, STRUKTURA KOMUNALE DHE QEVERISJA .....	13
1.7 DOKUMENTET REFERUESE PËR PZHK-në E JUNIKUT .....	14
1.8 PLANET HAPËSINORE NË KOMUNAT FQINJE .....	18
<b>2. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR NË KOMUNËN E JUNIKUT.....</b>	<b>19</b>
2.1 GJENDJA FIZIKO-GJEOGRAFIKE.....	19
2.1.1 Lokacioni – Pozita Gjeografike .....	19
2.1.2 Karakteristikat gjeografike.....	20
2.2 GJENDJA SOCIALE-EKONOMIKE .....	21
2.2.1. Profili demografik .....	21
2.2.2 Gjendja sociale .....	22
2.2.3 Infrastruktura dhe shërbimet sociale .....	23
2.2.4. Zhvillimi ekonomik .....	29
2.3 INFRASTRUKTURA RRUGORE & SHËRBIMET PUBLIKE.....	35
2.3.1 Infrastruktura rrugore.....	35
2.3.2 Shërbimet publike – Transporti publik .....	36
2.3.3 Shërbimet publike .....	40
2.4 SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI.....	44
2.4.1. Shfrytëzimi i tokës .....	44
2.4.2.Vendbanimet/struktura e tyre.....	47
2.4.3 Banimi dhe ndërtimet.....	48
2.5 MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA NDOTJA, DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA.....	51
2.5.1 Gjendja mjedisore: .....	51
2.6 TRASHËGIMIA KULTURORE .....	59
2.7 KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR.....	66
2.8 VLERËSIMI I GJENDJES NË KOMUNË .....	68
2.9 SFIDAT ZHVILLIMORE .....	71
2.10 VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTIVE.....	73
<b>3.VIZIONI, PARIMET DHE CAQET .....</b>	<b>75</b>
3.1 VIZIONI PËR TË ARDHMEN E KOMUNËS .....	75
3.2 PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM.....	77
3.3 CAQET ZHVILLIMORE AFATGJATA .....	78
3.4 PRIORITETET STRATEGJIKE.....	82
<b>4. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL .....</b>	<b>83</b>
4.1 KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR.....	83
4.1.1. Skenari i “trendit” apo “zero” .....	85
4.1.2. Skenari i “dëshiruar” .....	86
4.2 STRUKTURA DHE LOKACIONI HAPËSINOR PËR ZHVILLIMIN DHE ORGANIZIMIN E ARDHSHËM – ZONIMI .....	87
4.2.1 Popullsia, banimi dhe vendbanimet .....	87
4.2.2 Infrastruktura sociale.....	87

4.2.3 Zhvillimi ekonomik, rigjenerimi, përfshirë turizmin, rekreacionin, tregtinë etj. ....	88
4.2.4 Infrastruktura fizike, transporti, komunikimet dhe shërbimet publike .....	90
4.2.5 Mjedi përfshirë trashëgiminë natyrore dhe resurset, peizazhet, etj .....	90
4.2.6 Rreziqet natyrore, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera .....	90
4.2.7 Trashëgimia kulturore.....	90
4.3. SHËNIMI I ZONAVE URBANE EKSISTUESE DHE TË PROPOZUARA PËR TË ARDHMEN DHE NDËRTIMIN E ZONAVE JASHTË ZONAVE URBANE .....	91
4.4. SHËNIMI I NDËRTIMEVE TË RËNDËSISHME, PROJEKTEVE STRATEGJIKE OSE ZONËS SË VEÇANTË E CILA VEQ ËSHTË APROVUAR NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS OSE PLANET E ZONAVE TË VEÇANTA.....	91
4.5.VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK-MJEDISOR I KORNIZËS SË PROPOZUAR .....	92
<b>5. STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM .....</b>	<b>94</b>
5.1. STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT .....	94
5.2. VLERËSIMI I STRATEGJIVE .....	106
5.3. AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE DHE KORNIZA INSTITUCIONALE.....	106
5.4. AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE DHE KORNIZA INSTITUCIONALE.....	107
<b>6. DISPOZITAT PËR ZBATIM .....</b>	<b>118</b>
6.1. UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PZHK-së GJATË HARTIMIT TË PRrU-ve DHE PLANEVE TJERA.....	118
6.2. KUSHTET TË PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE PËR ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NË KOMUNË.....	118
6.2.1. Kushtet për rregullimin e hapësirës: .....	118
6.2.2. Kushtet për rregullimin e vendbanimeve .....	119
6.2.3. Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike .....	121
6.2.4. Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike .....	122
6.2.5. Kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve, sipërfaqeve komunikuese dhe sistemeve tjera të infrastrukturës .....	123
6.2.6. Masat për mbrojtjen e peisazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike .....	124
6.2.7. Mënyra e trajtimit të mbeturinave .....	127
6.2.8. Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis.....	128
6.2.9. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social .....	131
6.2.10. Masat për zbatimin e Planit .....	132
6.3. DISPOZITAT LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN .....	133
6.4. DISPOZITAT PËR RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E IMPLEMENTIMIT .....	133
6.5. ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM.....	134
6.6. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE .....	134

## LISTA E HARTAVE

Harta 1: Pozita gjeografike.....	26
Harta 2: Dendësia e popullsisë .....	27
Harta 3: Institucionet, hapësirat publike dhe objektet e kultit/religjionit .....	28
Harta 4: Objektet me veprimtari ekonomike.....	34
Harta 5: Rrjeti rrugor .....	39
Harta 6: Harta e shërbimeve publike .....	43
Harta 7: Shfrytëzimi i tokës.....	46
Harta 8: Vendbanimet dhe banimi .....	50
Harta 9: Mjedisi dhe degradimi .....	57
Harta 10: Trashëgimia natyrore.....	58
Harta 11: Trashëgimia kulturore.....	65
Harta 12: Korniza e zhvillimit hapësinor të Junikut 2011-2023+ .....	93
Harta 13 : Zhvillimet/veprimet e propozuara jashtë zonës urbane.....	116
Harta 14: Zhvillimet e propozuara në zonën urbane sipas PZHK dhe propozime të PZHU .....	117

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Popullsia e Junikut gjatë viteve, (Burimi: ESK,2009).....	21
Tabela 2: Popullsia sipas moshës dhe gjinisë nga analizat në terren (përfshirë popullsinë në diasporë).....	22
Tabela 3: Numri i të punësuarve në sektorin publik në komunën e Junikut sipas viteve, (Burimi: GAP 2009).....	22
Tabela 4: të ardhurat mesatare sipas anketimit në terren .....	23
Tabela 5: Numri nivelet e arsimit në procesin edukativo-arsimor .....	24
Tabela 6: Sipërfaqet e mbjelluara .....	29
Tabela 7: Klasifikimi i fermave në kategori sipas MBPZhR .....	30
Tabela 8: Kategoria e pyjeve.....	30
Tabela 9: Të dhëna për HC e lumit Erenik (Burimi: MEM (2006)) .....	32
Tabela 10: Rrjeti rrugor.....	35
Tabela 11: Lidhjet e transportit urban .....	37
Tabela 12: Kategorizimi i tokës bujqësore të kulturës arë:.....	45
Tabela 13: Objektet e trashëgimisë kulturore në zonën urbane (burimi Plani Zhvillimor Urban, 2007 .....	60
Tabela 14: Gjendja e trashëgimisë kulturore në komunën e Junikut në vitet e fundit. ....	61
Tabela 15: Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale (burimi: Korniza aftamesme buxhetore komunale).....	73
Tabela 16: Grantet e Qeverisë për komunën e Junikut .....	74
Tabela 17: Projektioni i të hyrave Buxhetore 2011/2013 të Komunës së Junikut .....	74
Tabela 18: Vlerësimet e hershme të buxhetit për vitin 2011 (burimi: Korniza aftamesme buxhetore komunale) .....	74
Tabela 19: Lokalitetet turistike dhe potenciali turistik dhe objektet e propozuara.....	89
Tabela 20: Zhvillimi i kulturave bujqësore sipas zonave:.....	89

## LISTA E GRAFIKONEVE

Grafiku 1. Korniza e punës e zhvilluar për procesin e hartimit të PZHK për Junikun: .....	11
Grafiku 2: Llojet e veprimtarive në Junik .....	33
Grafiku 3: Numri i objekteve të trashëgimisë kulturore jashtë zonës urbane (burimi: hulumtim në terren për nevojat e PZHK-së 2010)....	60

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Administrata Komunale e Junikut .....	13
Figura 2: Pozita gjeografike.....	19
Figura 3: Rritja urbane në vite .....	47
Figura 4: Vlerësimi i rreziqeve nga zjarret .....	53
Figura 5: Koncepti i zhvillimit hapësinor.....	84

## LISTA E KUTIVE

Kutia 1: Plani Hapësinor i Kosovës (2009-2020) .....	15
Kutia 2: Plani Zhvillimor Urban i miratuar nga Kuvendi Komunal i Junikut në qershor 2009.....	16
Kutia 3: Plani Rregullues Urban: Qendra e Junikut (2009).....	16
Kutia 4: Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Junikut (2007).....	16
Kutia 5: Dokumenti i Integruar i Vizionit.....	17
Kutia 6: Strategjia Zhvillimore Lokale 2009.....	17
Kutia 7: Projektet e identifikuar nga PZHK e Deçanit e që janë me interes të përbashkët edhe për Komunën e Junikut .....	18
Kutia 8: Projektet e identifikuar nga PZHK e Gjakovës e që janë me interes të përbashkët edhe për Komunën e Junikut .....	18
Kutia 9: Projektet e parapara me PZHU në Sektorin e Ekonomisë.....	31
Kutia 10: Statistikat e zjarreve në Komunën e Junikut gjatë viteve 2003-2007 .....	53
Kutia 11: Llojet e trashëgimisë kulturore (Burimi: Ligji për Trashëgimi Kulturor nr.02/L-88) .....	59
Kutia 12: Trashëgimia kulturore në Junik.....	59
Kutia 13: Deklaratat bazë për vizionin e integruar për Komunën e Junikut.....	75

## LISTA E AKRONIMEVE

PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimore Urban
PRRU	Plani Rregullues Urban
KK	Kuvendi Komunal
DSHP	Drejtoria për shërbime publike
DUKM	Drejtoria kadastër dhe mjedis
DAKRS	Drejtoria për arsim, kulturë, rini dhe sport
DZHE	Drejtoria për zhvillim ekonomik
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MASHT	Ministria e arsimit shkencës dhe teknologjisë
MKRS	Ministria e kulturës rinis dhe sportit
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MBPZHR	Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendëshme
MPMS	Ministria e punes dhe mireqenies sociale
APK	Agjensioni pyjor i Kosovës
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
HEC	Hidrocentralet
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
OJQ	Organizata jo qeveritare
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
Sida	Swedish International Development Agency
UN-HABITAT/United Nations Human Settlement Program	
UNDP	United Nations Development Program
CHwB	Cultural Heritage Without Borders

## SFONDI

### 1.1. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RËNDËSIA E TIJ

Planifikimi Hapësinor si disiplinë multisektoriale dhe proces i referohet hapësirës e cila na rrethon dhe në të cilën bashkëveprojmë duke i dhënë shprehje gjeografike politikave ekonomike, sociale, kulturore dhe atyre ekologjike/mjedisore/ të shoqërisë. Sipas Komunitetit Evropian (1997), planifikimi hapësinor i referohet metodave që përdoren nga sektori publik për të ndikuar në shpërndarjen e aktiviteteve në hapësirë.

Në Kosovë, korniza për zhvillim hapësinor është e përcaktuar me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe aktet përcjellëse që dalin nga ky Ligj. Me këtë legjislacion përcaktohen përgjegjësitë dhe kompetencat në fushën e planifikimit, parimet të cilat duhet respektuar gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit, procedurat e shqyrtimit publik dhe pjesëmarrjes e përfshirjes së pjesëmarrësve të ndryshëm në procesin e planifikimit. Kurse Plani Hapësinor i Kosovës jep orientimet dhe udhëzimet e ardhshme të zhvillimit hapësinor të Kosovës dhe udhëzimet për hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale.

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) i Junikut si Plan me karakter strategjik multisektorial përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të komunës dhe përfshin periudhën 15 vjeçare. Për shkak të harmonizimit të zhvillimeve hapësinore në nivel të Kosovës, ky Plan, duhet të jetë në përputhshmëri me Planin Hapësinor të Kosovës. Plani Zhvillimor i Komunës, duhet të kuptohet më shumë se sa vetëm shfrytëzim i tokës, meqë ai ka të bëjë më shumë me një strategji të integruar për rregullimin e ardhshëm të hapësirës, duke përcjellur një vizion të qartë për të cilin është arritur pajtueshmëri si dhe zotim të palëve me interes për të punuar drejt arritjes së qëllimeve dhe orientimeve strategjike që përcjellin atë vizion. Dhe duke qenë në rolin e harmonizuesit dhe udhëzuesit të zhvillimeve të ardhshme në komunë, në sferat e ndryshme i orientuar kah veprimi, PZHK ofron mundësi për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e hapësirës, përcaktimin e regjimit të mbrojtjes dhe zhvillimit të saj dhe vendosjes së veprimtarive ekonomiko-sociale e mjedisore në territorin e komunës së Junikut. Rëndësia e veçantë e PZHK-së për shkak të qasjes integrale gjatë hartimit të tij dhe karakterit multisektorial që ka, qëndron edhe në atë se ky Plan duhet të tentojë të minimizojë konfliktet ndërsektoriale dhe vë në pah përparësitë dhe potencialin zhvillimor të Junikut.

## 1.2. QËLLIMET E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL të JUNIKUT

Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) është të ofrojë vizion dhe synime të qarta për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të Komunës dhe të përcaktojë programet, politikat zhvillimore dhe veprimet për të arritur synimet e përcaktuara. Kah do të orientohet banimi; si të ruhen por edhe zhvillohen resurset natyrore dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në dobi të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale; si të lehtësohet qarkullimi i banorëve, por, të ofrohet edhe qasje më e lehtë për vizitorë, etj. janë disa nga çështjet për të cilat PZHK ofron zgjidhje. Komuna e Junikut është komunë e vogël shikuar nga aspekti demografik dhe territorial, por, me mundësi dhe potencial për zhvillim, falënderuar pozitës ndërkufitare dhe potencialit natyror që posedon, ruajtjes së traditave dhe trashëgimisë kulturore e mbi të gjitha popullatës së re dhe entuziaste për përparimin e komunës. PZHK synon që këtë potencial ta ruajë, zhvillojë në mënyrë të qëndrueshme e racionale dhe promovojë në interes të junikasve por edhe interes kombëtar.

Plani përcakton Projektet me prioritet, që do të kryhen për qëllime publike, andaj duhet t'i shërbejë si bazë komunës për negociata me palë të ndryshme, siç janë Ministrinë apo Investuesit privat për zbatimin e Projekteve Komunale në mënyrë strategjike.

Synim tjetër i procesit të hartimit të PZHK shikuar nga aspekti institucional është të kontribuojë edhe në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative në fushën e planifikimit strategjik hapësinor, marrë parasysh faktin që ky është Plani i parë hapësinor për komunën dhe komuna e Junikut është komunë e re.

### 1.3. PROCESI I PLANIFIKIMIT DHE METODOLOGJIA

Procesi i hartimit të Planit Zhvillimor të Junikut pikënisje ka Ligjin për Planifikimi Hapësinor i cili përcakton parimet e pjesëmarrjes dhe përfshirjes si dhe kornizën e procesit të hartimit të planit përfshirë edhe marrjen e vendimit nga Kuvendi Komunal me 27 Mars 2009 (Vendimi numër 001/14). Sipas Ligjit, qasja në planifikimin hapësinor dhe urban dhe procesi i hartimit të planeve duhet të jenë në përputhshmëri me parimet e pranuar ndërkombëtare për zhvillim urban dhe qeverisje të mirë duke vënë theks të veçantë në parimet si: transparencja, zhvillimi i qëndrueshëm, pjesëmarrja publike dhe gjithpërfshirja, ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë pa dallim moshe, gjinie, etniteti etj.


Për të garantuar pjesëmarrjen publike gjatë procesit të hartimit të Planit, komuna ka vendosur që përveç të qenit bartëse e këtij procesi të jetë në të njëjtën kohë edhe hartuese e Dokumentit. Në këtë proces Komuna është përkrahur nga Programi për Përkrahjen e Komunave në Planifikim Hapësinor në Kosovë i UN-HABITAT-it i financuar nga Sida, Organizata “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” si dhe Instituti për Planifikim Hapësinor nga MMPH. Ky bashkëpunim rezulton me dokumentin e përpiluar bashkarisht si dhe me përfshirjen e pjesëmarrësve të ndryshëm dhe palëve me interes në gjithë procesin e planifikimit. Esencialja në këtë proces është zhvillimi i sensit të pronësisë si dhe përgjegjësisë për vendimet dhe për krijimi i bazës për bashkëpunim dhe partneritet.

Për më shumë punimi mbi qasjen e Junikut në përpilimin e PZHK pranohet për t’u prezantuar në Konferencës Ndërkombëtare REAL CORP 2010 të mbajtur në Vienë (18-20 maj’10). Komuna prezantohet me punimin: *A është Juniku Unik? Përpilimi i dokumenteve përmes qasjes “E bërjes vet”*

E fundit por jo më pak e rëndësishme është se, qasja e hartimit të këtij dokumenti në mënyrën “të mësojmë duke punuar” do t’iu jap mundësinë të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces të ngrisin edhe më tej kapacitetet e tyre duke mësuar e punuar së bashku dhe shkëmbyer ide me njëri - tjetrin.

Etapat dhe përfshirja e pjesëmarrësve në periudha të caktuara gjatë hartimit të PZHK-së (shih më gjerësisht raportin e procesit të përfshirjes dhe pjesëmarrjes) është zhvilluar sipas kornizës së mëposhtme (shih grafiku 1).

Grafiku 1. Korniza e punës e zhvilluar për procesin e hartimit të PZHK për Junikut:



## 1.4. HISTORIKU I JUNIKUT

Sipas historisë, Juniku së pari ishte pjesë e Dardanisë Ilire, më pas e Perandorisë Romake, Bizantine e më vonë në kuadër të Perandorisë Osmane. Materialet arkeologjike të zbuluara me gjetje rasti ose kërkime të tërthorta të terrenit, vendbanimi antik "Gradina" i zbuluar në grykën e majës së Gjeravicës së bashku me materialin epigrafik të gjetur në këtë vendbanim, si dhe një mori vendbanimesh tjera të Junikut, mbetjet antike të gjetura në rrafshin aluvial të Erenikut, etj dëshmojnë se Juniku ka qenë një vendbanim ilir.

Të dhënat arkeologjike të shekujve VIII-X tregojnë se në ato vise ku nuk është vendosur kolonizimi sllav ka lulëzuar një kulturë thjeshtë shqiptare që është quajtur kultura e Komanit emër ky i një fshati në luginën e Rrafshit të Dukagjinit.

Gjatë kohës së feudalizmit të zhvilluar, Juniku sikurse Gjakova e rrethinat e saj si dhe tërë Kosova ishin përfshirë në shtetin feudal Serb. Në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë, shqiptarët ishin shumicë dërmuese e popullsisë në rrethinën e Junikut, por që është shoqëruar me migrime masive të popullsisë të shkaktuara nga ngjarjet historike, ekonomike, politike, etj.

Në fillim të sundimit osman, bazuar në defterët osmanë, përkatësisht në ata të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, Juniku ishte fshat shumë i madh dhe sikurse Gjakova ishte krijuar para ardhjes së këtij sundimi. Juniku deri më 26.IX.1462 qeverisej nga Leka i III-të Dukagjini. Në këtë kohë, Juniku edhe pse ishte fshat, përshkruhet si qendër pazari ashtu sikur Gjakova. Njihej me emrin Lunik dhe poashtu ishte edhe qendër e kazasë Alltun-Ilia me gjithsej 52 shtëpi.

Gjatë shekujve XV-XVI, kisha ortodokse serbe e cila pranoi vasalitetin e sulltanit, përpiqej në çdo mënyrë t'i serbizojë shqiptarët ortodoksë, dhe t'i ortodoksojë ata katolikë. Islamizimi i popullsisë së Junikut ishte një goditje e rëndë për pozitat e kishës ortodokse serbe, pasi popullsia e Junikut dhe rrethinat e saj ishin islamizuar, në këmbim të lejimit të ekzistencës së kishës së Deçanit. Kështu në vitin 1570-1571, në Junik ndërtohet xhamia e parë në lagjen Çoku e emërtuar sipas lagjes. Më vonë u ndërtua edhe Xhamia në lagjen Hoxhaj në qendër të fshatit. Islamizimin e përqaftuan edhe një pjesë e aristokracisë shqiptare për të ruajtur privilegjet e veta klasore. Nga fundi i shek. XVI, rrethina e Altun-ilu, Peja e Gjakova janë përfshirë në kufijtë e Sanxhakut të Dukagjinit. Kjo gjendje është ruajtur edhe gjatë shekullit XVII-të.

Gjatë viteve 1945-1960 Juniku ekziston si komunë. Ndryshimet politike të sistemit të atëhershëm rezultuan me suprimimin e komunës së Junikut në vazhden e ristrukturimit të qeverisjes lokale (eliminohen rrethet), me ç'rast Juniku inkorporohet brenda komunës së Deçanit.

Më 22 korrik 2005, nënshkruhet Urdhëresa Administrative të UNMIK-ut nr. 2005/11 për themelimin e pesë Pilot Njësive Komunale përfshirë Junikun. Sipas vendimit të UNMIKU nr. 2005/21, MAPL bën përcaktimin e përbërjes territoriale për secilën Pilot Njësi Komunale.

Kurse me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës (15 qershor 2008) dhe miratimin e ligjit për vetëqeverisjen lokale në komunat, Juniku certifikohet si Komunë (më datë 13 gusht 2008, sipas shkresës njoftuese nga MAPL me numër protokoll: 02-527) me të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si komunat tjera në Republikën e Kosovës, me zonat kadastrale Jasiq dhe Gjocaj.

*Burimi: të dhënat historike nga Komuna*

## 1.5. ADMINISTRATA, STRUKTURA KOMUNALE DHE QEVERISJA

Juniku është një nga komunitetet më të reja të Kosovës, e certifikuar si komunë në gusht 2008. Zgjedhjet e Nëntorit 2009, shënuan zgjedhjet e para lokale të mbajtura ndonjëherë në këtë komunë. Administrata aktuale komunale përbëhet nga zyra e kryetarit dhe shtatë drejtorive komunale me sektorët e tyre dhe drejtorët e emëruar nga kryetari (shih figurën 1).




Figura 1. Administrata Komunale e Junikut

## 1.6 BAZA LEGJORE PËR HARTIMIN E PZHK-së

Gjatë hartimit të këtij Dokumenti janë shfrytëzuar këto Ligje:

- Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor
- Ligji për Trashëgiminë Kulturore Nr.02/L-88
- Ligji për Ndërtim Nr.2004/15
- Ligji për Rrugët Nr.2003/11
- Ligji për Transportin Rrugor Nr.2004/11
- Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal Nr. 2008/03-L-041
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr.03/L-015
- Ligji për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera Nr.02/L-68
- Vendimet dhe Rregulloret e komunës së Junikut
- Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 2003/1 dhe Nr. 2009/03-L-025
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 2005/02-L-18
- Ligji për Zonat Ekonomike Nr. 2009/03-L-129
- Ligji për Mbeturina Nr. 2005/02-L-30
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 2004/24
- Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 02/L-26
- Ligji për Bletari Nr. 2007/02-L-111
- Ligji për Pyjet Nr.2003/3 dhe Nr.2004/29, etj

## 1.7 DOKUMENTET REFERUESE PËR PZHK-në E JUNIKUT


Dokumentet të cilat janë marrë për bazë gjatë hartimit të PZHK-së janë:

- Plani Hapësinor i Kosovës (2009-2020)
- Plani Zhvillimor Urban i Junikut (2009)
- Plani Rregullues Urban: Qendra e Junikut (2009)
- Raporte, Plane dhe Strategjitë sektoriale të Komunës dhe Ministrive
  - Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Junikut (2007)
  - Raportet Sektoriale të Drejtorive të Komunës
  - MTI (2008), Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare)
  - MMPH (2007), Raporti për gjendjen në natyrë
  - MPB (2007), Vlerësimi i rreziqeve
  - ESK (2009), Popullsia, ekonomitë familjare sipas vendbanimeve dhe organizimi territorial i Kosovës deri në vitin 2008
  - MEM (200), Projektet e mini-hidrocentraleve në Kosovë

Dokumente tjera në dispozicion:

- Dokumenti i Integruar I Vizionimit për Junikun (2008)
- Studimi i parafisibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla në Kosovë (MEM, '06)
- MMPH (2003), Studimi mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional
- Juniku, Ofertë Atraktive për Turizëm (2009)
- Elaborate kadastrale
- Instituti për Studime të Avancuara GAP (2009), Juniku-Raporti Komunal, etj.

**Kutia 1: Plani Hapësinor i Kosovës (2009-2020)**



Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) është dokument i cili jep orientimet dhe përcakton shtrirjen hapësinore të zhvillimeve në të ardhmen (deri 2020) në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. PHK shërben edhe si udhëzues në hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale.

Me qëllim të paraqitjes së kahjeve të zhvillimeve hapësinore, duke marrë parasysh edhe karakteristikat gjeografike, natyrore, veprimtaritë socio- ekonomike etj, PHK identifikon katër zona të cilave u janë dhënë ngjyrat dhe emrat në bazë të tipareve karakteristike të zonës.

\* **Thesari i Kosovës/zona e gjelbërt/** - zonë industriale, shërbyese tregtare, agroindustriale me qendër kryesore Mitrovicën.

\* **Porti i Kosovës/zona e kaltërt/** - zonë administrative, arsimore, shërbyese, tregtare, agroindustriale, turistike me qendër kryesore Prishtinën

\* **Kopshtet e Kosovës/zona e portokalltë/**- zonë kulturo-turistike, agroindustriale dhe shërbyese tregtare. Qendrat kryesore: Prizreni dhe Peja.

\* **Urat e Kosovës/zonat e verdha/**- zonë shërbyese, tregtare, agroindustriale e turistike me qendrat apo ura lidhëse me shtetet fqinje: Ferizaji, Gjilani dhe Gjakova.

Juniku në Planin Hapësinor të Kosovës përfshihet në Zonën e Verdhë, ajo e “Urave të Kosovës”. Kjo hapësirë zë pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe përbëhet nga komunitatet: Deçan, Rahovec, Malishevë dhe Gjakovën si qendër më e madhe Komunale. Kjo zonë karakterizohet me vlera të mëdha të trashëgimisë natyrore e kulturore, të cilat paraqesin potencial për zhvillimin e shërbimit tregtar, agroIndustrië, Industrisë së lehtë dhe turizmit rekreativ dhe atij kulturor.

**Vizioni për Zonën e Verdhë:** Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agro-industriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.

**Qëllimet e përgjithshme për Zonën e Verdhë relevante për Junikun:**

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brenda urbane, ndër-urbane me hapësirat e tjera dhe më gjerë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ,
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë,
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale, turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

**Juniku dhe zonat me interes për Kosovën:** Sipas PHK në “Hapësirën e Verdhë” si zona me interes të veçantë konsiderohen: Kullat e Dukagjinit; Kalimet kufitare (Prush e Qafë Morinë); Aeroporti i Gjakovës; Liqeni akumulues – Radoniqi; Çarshia e Madhe – Gjakovë; Manastiri i Deçanit etj.

## **Kutia 2: Plani Zhvillimor Urban i miratuar nga Kuvendi Komunal i Junikut në qershor 2009**

PZHU i Junikut i miratuar nga Kuvendi Komunal i Junikut më qershor 2009 paraqet dokumentin bazë për hartimin e PZHK-së. PZHU ofron informata rreth profilit të Komunës dhe analizë të gjendjes ekzistuese; **vizionin** (i referohet dokumentit të integruar të Vizionimit) dhe përcakton synimet afatgjata për zhvillimin e qytetit të Junikut si dhe kornizën zhvillimore dhe strategjike me Programet dhe Projektet konkrete për zbatim.

### **Synimet zhvillimore për të ardhmen e Junikut janë:**

- **Mbrojtja dhe evidentimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore:** Bazuar në vlerat e evidentuara të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore objektivi i kësaj strategjie është të evidentojë dhe të vendosë efikasitet në resurset ekzistuese, t'i përfshijë ato në procesin e planifikimit duke siguruar vazhdimësinë e konservimit dhe transmetimin e vlerave që ato bartin. Të promovojë këto pasuri dhe të japë direktiva për përdorimin e tyre në funksion të turizmit historiko-kulturor, turizmit natyror dhe agroturizmit.

- **Dendësimi i planifikuar dhe zhvillimi infrastrukturor:** Zhvillim i ambientit të ndërtuar drejtuar nga shfrytëzimi më efikas i territorit urban, brenda kufirit ekzistues të ndërtimeve me qëllim të dendësitimit. Dendësimi i qendrave të banuara ekzistuese duke respektuar strukturën shoqërore dhe identitetin e komunitetit banues.

Zhvillimi i infrastrukturës bazë: rrugë, ujësjellës, kanalizime, telekomunikacion, si përgjigje ndaj nevojave ekzistuese dhe zhvillimeve të parashikuara.

- **Zhvillimi i aktiviteteve dhe shërbimeve shoqërore:** Fuqizimi dhe promovimi i jetës në komunitet nëpërmjet ndërhyrjeve në strukturën e shërbimeve. Përforsimi i hapësirës publike dhe integrimi me funksionet komunale. Krijimi i poleve rekreative me influencë urbane, si elemente integrimi dhe shoqërimi ndërmjet komuniteteve.

- **Zhvillimi i ekonomisë:** Zhvillimi ekonomik synon fuqizimin e sektorit privat. Promovimi i aktivitetit tregtar, krijimi i organizmave të funksioneve si dhe pajisjeve ndihmëse që lidhen me to, është një nga elementet e rëndësishëm për ekzistencën e qendrës urbane. Ruajtja e strukturës së ekonomive të vogla familjare, krijimi i kushteve për zhvillimin e tyre janë në simbiozë me zhvillimet e tjera qytetare.

PZHU ep detaje të hollësishme mbi zbatimin dhe kushtet e përcaktuara nga Qeverisja Lokale për Rregullimin e hapësirës dhe objektet me rëndësi për Kosovën dhe Komunën; ndërtimin e objekteve të banimit; rregullimin e zonave dhe tërësive me vlera të veçanta; masat për mbrojtjen e peizazheve; vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historik; mënyrën e trajtimit të hedhurinave; masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis; parandalimin e ndikimit negativ social; rregullimin e ndërtesave destinimi i të cilave është në kundërshtim me destinimin e planifikuar.

Dokumenti i PZHU-së ofron mundësi për përmirësimin e hapësirës urbane të Junikut dhe hap dyert për hartimin e PRRU-ve.

## **Kutia 3: Plani Rregullues Urban: Qendra e Junikut (2009)**

Ky dokument ofron një analizë të detajzuar për qendrën e Junikut duke studiuar atributet fiziko-gjeografike; qasjen kulturore dhe peizazhin etj. PRRU është shkalla e tretë e planifikimit urban në komuna dhe shpreh detaje të hollësishme për rregullimin e hapësirës në përputhje me Planin Zhvillimor Urban (PZHU).

PRRU ep këto synime zhvillimore për qendrën e Junikut:

*Shfrytëzimi ekonomik dhe dendësimi i truallit urban; Krijimi i nukleve katalitike shumë-funksionale; Nxitja e përdorimit të përzier të truallit; Rikualifikimi i "perdeve" ndërtimore; Vënia në regjim, konservimi i tërësive hapësinore; Vënia në regjim, konservimi e trashëgimisë kulturore; Përforsimi i hapësirës publike; Krijimi i vendtakimeve dhe trajektore turistike; Rregullimi i trafikut të motorizuar dhe rritja e sigurisë në rrugë etj.*

## **Kutia 4: Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Junikut (2007)**

Ky dokument përfshin një analizë urbane dhe arkitektonike të Junikut duke konsideruar gjithë komponentët për zhvillim urban, duke u fokusuar në veçanti në vlerat kulturore dhe historike.

Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Junikut vazhdon me vlerësimin e potencialin të bjeshkëve; kanaleve me ujë natyral; fshatrave (Jasiq, Gjocaj) dhe ndan sugjerime për shfrytëzimin e hapësirave publike.

Hapat e ardhshëm në përmirësimin e hapësirave sipas Planit të Konservimit janë:

*Pastrimi i mbeturinave urbane - propozohet që të shpallet dita e pastrimit të Komunës me të cilin rast gjithë shoqëria aktivizohet në një ekip për pastrimin e mbeturinave;*


*Rigjenerimi i objekteve të rrënuara dhe shfrytëzimi i tyre – Komuna e Junikut ka shumë objekte të rrënuara dhe të pashfrytëzueshme.*

*Por, shumica e këtyre objekteve apo në disa raste mure me vlera kulturore kanë një potencial për ta bërë Junikun vend tërheqës, prandaj sugjerohet rindërtimi i objekteve të rrënuara apo pastrimi i atyre që nuk nevojiten;*

*Kompletimi i objekteve me fasadë – objekte të pakompletuara janë dukuri e shpeshtë në Junik prandaj sugjerohet të promovohen aktivitete gjithëpërfshirëse në fasadim apo lyrje dhe rregullimin e estetikës së qytetit.*

Në Përfundim, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit shpreh që Juniku do ta arrij një zhvillim të qëndrueshëm vetëm nëse konservon traditat e vjetra të ndërtimit dhe nëse ruhen vlerat rurale dhe urbane të regjionit.

#### Kutia 5: Dokumenti i Integruar i Vizionit



Dokumenti i Përbashkët i Vizionit doli nga rezultatet e 4 grupeve tematike të zhvilluara në Punëtorinë e mbajtur në Ohër në tetor 2007. Këto rezultate janë prezantuar publikisht para një publiku më të gjerë më 13 nëntor 2007 në Kullën e Ramë Zyberit në Junik. Ky dokument është miratuar pas një debati të thellë në mes të pjesëmarrësve nga Këshilli Joformal i Shoqërisë Civile dhe përfaqësuesve të komunës.

Deklarata e Vizionit për Junikun e përpiluar fillimisht nga grupet punuese në punëtori dhe zhvilluar më tej edhe me banorët e Junikut është: **“Juniku, vendthemi i traditës dhe odës si institucion,**

**“Park Etnografik” i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, ruajtja e së cilës do të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie për banorët e vet, me vend të merituar në ofertën turistike rajonale dhe integritet evropian.”**

Qëllimet strategjike të nxjerra nga procesi i Vizionimit dhe të transmetuara edhe nëpërmjet PZHU-së, janë:

- Juniku qytezë turistike;
- Mbrojtja dhe vënia në pah e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Dendësimi i planifikuar i qytezës dhe zhvillimi infrastrukturor;
- Zhvillimi i aktiviteteve dhe shërbimeve sociale;
- Zhvillimi i aktiviteteve ekonomike

Rezultatet e këtij dokumenti janë reflektuar në masë të madhe në hartimin e PZHU-së dhe PRRU-ve për Junikun.

#### Kutia 6: Strategjia Zhvillimore Lokale 2009

Ky dokument ka të bëjë me një analizë të përgjithshme mbi zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen viset rurale. Hartimi i kësaj strategjie ka të bëjë me bashkimin e sektorit publik dhe të atij privat, për të bërë analiza të përbashkëta për të zhvilluar së bashku veprimet praktike me pikëpamjet afatgjate.

Synimet strategjike për Junikun janë:

1. Aplikimi i teknologjive të reja në prodhimtarinë bujqësore,
2. Zhvillimi i turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore,
3. Menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit,
4. Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve bujqësore – pyjore,
5. Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës rurale,
6. Vëmendje më e madhe për të rinjtë.

Zbatimi i Strategjisë Zhvillimore Lokale, akterëve dhe institucioneve lokale u siguron përmirësimin e aftësive për të vlerësuar mjedisin e tyre që të marrin veprime të përbashkëta, lidhje midis sektorëve, shtimin maksimal të vlerës dhe se fundi lidhet me viset tjera në rajon dhe me tere botën.

## 1.8 PLANET HAPËSINORE NË KOMUNAT FQINJE

Pozita gjeografike e Junikut, karakteristikat topografike dhe veçoritë natyrore, përveç që e lidhin komunën e Junikut me ato fqinje, paraqesin njëherit edhe fusha me interes të përbashkët dhe mundësi për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar.

Duke marrë parasysh që komunat fqinje si ajo e Deçanit dhe Gjakovës, janë një hap më përpara në fushën e planifikimit hapësinor (komuna e Deçanit ka të miratuar PZHK dhe PZHU dhe ajo e Gjakovës është më e kompletuar sa i përket dokumenteve të planifikimit ka të miratuar PZHK-në, PZHU-në dhe 9 PRrU), komuna e Junikut në fillim të procesit të hartimit të PZHK-së ka konsultuar dokumentet e planifikimit hapësinor të këtyre dy komunave. Qëllimi i njohjes me këto dokumente, ka qenë që të identifikohen Projektet nga PZHK e Deçanit dhe Gjakovës të cilat kanë ndërlidhje apo dhe janë në interes të përbashkët me zhvillimin hapësinor të ardhshëm të komunës së Junikut.

### **Kutia 7: Projektet e identifikuar nga PZHK e Deçanit e që janë me interes të përbashkët edhe për Komunën e Junikut**

- Linja hekurudhore (e propozuar) Gjakovë – Deçan – Pejë
- Ndërtimi i shtigjeve të skijimit në bjeshkët e Belegut ( Projekt i përbashkët me Komunën e Deçanit)

### **Kutia 8: Projektet e identifikuar nga PZHK e Gjakovës e që janë me interes të përbashkët edhe për Komunën e Junikut**

- Linja hekurudhore (e propozuar) Gjakovë – Deçan – Pejë
- Linja hekurudhore (e propozuar) Gjakovë – Ponohec – Morinë - Shëngjin
- Universiteti i Gjakovës
- Aeroporti i Gjakovës

## 2. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR NË KOMUNËN E JUNIKUT

### 2.1 GJENDJA FIZIKO-GJEOGRAFIKE

#### 2.1.1 Lokacioni – Pozita Gjeografike

**Pozita:** Juniku ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës, pranë Alpeve Shqiptare. Ka territor me sipërfaqe prej 77.77 km<sup>2</sup> dhe shtrihet në gjerësi gjeografike prej 42° e 22' dhe gjatësi gjeografike prej 20°26'.

Ka pozitë të përshtatshme gjeografike sepse shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, përballë grykës së lumit Erenik, i cili buron nga Liqejtë e Gjeravicës dhe dredhon nëpër luginat e Alpeve Shqiptare.

Territori i komunës së Junikut shtrihet deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, dhe kufizohet me komunën e Deçanit, komunën e Gjakovës, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Malit të Zi.

Distanca Junik-Pejë është 25 km, Junik- Gjakovë është 20 km që kalon nëpërmjet fshatit Batushë, ndërsa distanca nga Juniku deri në Rastavicë (magjistranja Pejë-Gjakovë) është 5,5 km.




Figura 2: Pozita gjeografike

### 2.1.2 Karakteristikat gjeografike

**Topografia:** Komuna e Junikut ka pozitë të përshtatshme gjeografike para grykës pitoreske të lumit Erenik. Lartësia mbidetare e Junikut shkon nga 450 deri në 600 metra mbi nivelin e detit. Vet qyteza e Junikut, gjendet në lartësi mbidetare 593 m. Maja më e lartë është Gjeravica, me lartësi mbidetare 2656 m e cila është gjithashtu edhe pika më e lartë në Kosovë e Alpeve Shqiptare. Gjithashtu ekzistojnë dhe dy maja të larta në afërsi të Gjeravices, nga pjesa perendimore Maja e Gusanit me lartësi mbidetare 2539 m. ndërkaq nga pjesa veriperendimore Maja e Rrupës me lartësi mbidetare 2501 m.

**Veçoritë natyrore:** Juniku ka lloje të ndryshme peisazhesh, nga ai hidrografik (lumejtë Erenik dhe Travë), peisazhe fushore (fusha e Junikut) dhe peisazhe kodrinore apo malore (Gjeravica, Maja e Gusanit, Maja e Rupës, Rrasa e Zogut, Jedova, Moronica). Me datën 28.08.2008 Kuvendi Komunal i Junikut ka shpallur Moronicën “zonë të veçantë të komunës së Junikut”. Kjo zonë mendohet të jetë “parku i ardhshëm i qytezës(..) që do të jetë si urë lidhëse në mes të parkut etnografik dhe parkut nacional Bjeshkët e Nemuna”. Në tërësinë e tij, Juniku paraqitet si entitet që ka qenë, është dhe do të jetë i lidhur ngushtë me natyrën.

**Kushtet klimatike:** Juniku ka klimë kontinentale, por, me disa tipare mesdhetare. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Mesatarja e temperaturës është 21° C në verë dhe -11° C në dimër. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm<sup>3</sup>, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm<sup>3</sup>.

**Lumejtë dhe sipërfaqet ujore:** Lumi Erenik është më i madhi dhe më i rëndësishmi i rajonit, i cili shërben gjithashtu si burim uji edhe për ujitjen e fushës së Junikut. Ereniku buron nga Liqejtë e Gjeravicës. Ujërat që rrjedhin përkatësisht vijnë nga kurorat e maleve, nga Gropa e Erenikut dhe nga Alpet Shqiptare, formojnë rrjedhat sipërfaqësore të ujërave. Nëse menaxhohet mirë dhe nuk ka keqpërdorime të ujit, ka sasi të mjaftueshme edhe për ujitje dhe ujë të pijes.

**Përbërja e tokës:** Nga sipërfaqja prej 77.769,931 Ha, sa ka komuna e Junikut, afërsisht 4.439 Ha (57.08%) janë tokë bujqësore. Livadhet e kullotat zënë sipërfaqe prej rreth 2.000 Ha (45.05%) nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore si dhe pyjet që zënë mbi 3.029 Ha (38.95%) që paraqesin potencial për zhvillim. Në zonën urbane të Junikut dominon tokë relativisht e thellë e përshtatshme për prodhime bujqësore, ndërsa, në pjesët tjera jashtë zonës urbane dominon tokë e cekët e përshtatshme për kullosa dhe zhvillim të pylltarisë (shih më gjerësisht kapitullin 2.4.1 shfrytëzimi i tokës).

**Flora dhe fauna:** Afërsia me natyrën ka bërë të mundur që Juniku të jetë i pasur në planin e biodiversitetit. Biodiversiteti reflekton shumëllojshmërinë e genieve të gjalla varësisht se në cilën zonë zhvillohen. Ky koncept përmbledh gjithashtu laramaninë brenda llojit, ndërmjet llojeve dhe ndërmjet ekosistemeve (elaborim më i gjerë është bërë në kapitullin e biodiversitetit).

Përfundim: Juniku si komunë relativisht e vogël ka pozitë të volitshme ndërkufitare dhe lidhje të shkurtëra me qytetet përreth: Deçani, Peja dhe Gjakova . Pozita e volitshme gjeografike e Junikut paraqet një mundësi për zhvillim ekonomik të komunës dhe bashkëpunim ndërkufitar. Gjeomorfologjia e Junikut si dhe veçoritë natyrore të komunës së Junikut paraqesin vlera dhe potencial të madh për zhvillim.

## 2.2 GJENDJA SOCIALE-EKONOMIKE

*Shënim: Në mungesë të regjistrimit të përgjithshëm valid në Kosovë, gjatë hartimit të PZHK-së për komunën e Junikut të dhënat për numrin e banorëve janë bazuar në anketimin e bërë në terren<sup>1</sup>, të dhënat nga Enti i Statistikave të Kosovës, të dhënat nga Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) si dhe vlerësimet e bëra pas luftës së vitit 1999 nga organizata dhe institucione ndërkombëtare dhe vendore të cilat bazohen në anketime dhe hulumtime në terren. Regjistrimi i fundit valid në Kosovë, është ai i bërë në vitin 1981. Të dhënat statistikore të mbledhura dhe të publikuara nga ky Ent, deri në vitin 1988 konsiderohen të besueshme. Të dhënat për periudhën 1990-1999 janë të mangëta dhe në pjesë të madhe nuk pasqyrojnë realisht situatën në Kosovë gjatë kësaj periudhe, kështu që, si të tilla duhet të trajtohen me maturi meqë regjistrimi u bojkotua nga popullata shqiptare.*

### 2.2.1. Profili demografik

**Popullsia:** Sipas statistikave të vitit 1981 dhe disa shenimeve të pasluftës, kur Juniku u themelua si Pilot Njësi Komunale, numëronte rreth 12.500 banorë, përfshirë fshatrat: Gjocaj, Jasiq, Voksh, Sllup dhe Rastavicë. Ndërsa në vitin 2008 me miratimin e Kushtetutës dhe Ligjit për Kufijtë Administrativë Juniku bëhet komunë me dy zona kadastrale. Zona kadastrale e Junikut dhe zona kadastrale Gjocaj dhe Jasiq dhe vlerësohet të ketë 9.600 banorë me diasporën (sipas LFPL).

Tabela 1: Popullsia e Junikut gjatë viteve, (Burimi: ESK,2009)

Nr. rend.	Vendbanimet	Popullsia						Ekonomitë Familjare						2008
		1948	1953	1961	1971	1981	1991	1948	1953	1961	1971	1981	1991	
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Gjocaj	210	180	138	161	215	306	34	24	18	25	24	40	-
2	Jasiq	231	376	190	251	295	306	27	56	24	29	30	33	2
3	Junik	2,391	2,439	3,024	3,445	4553	5490	378	385	462	460	541	690	622
	<b>Juniku gjithsej</b>	<b>2832</b>	<b>2995</b>	<b>3,352</b>	<b>3857</b>	<b>5063</b>	<b>6102</b>	<b>439</b>	<b>465</b>	<b>504</b>	<b>514</b>	<b>595</b>	<b>763</b>	<b>624</b>

<sup>1</sup>Juniku komunë u zyrtarizua në fund të vitit 2008

Të dhënat e fundit zyrtare nga ESK (2009) nga anketimi "Popullsia, ekonomitë familjare sipas vendbanimeve dhe organizimi territorial i Kosovës deri në vitin 2008, tregojnë se Juniku si vendbanim ka 624 ekonomi familjare, 5423 anëtarë rezident, 1427 objekte ndërtimore, kurse fshatrat Jasiq- Gjocaj kanë 2 ekonomi familjare me gjithsej 7 anëtarë dhe 38 objekte ndërtimore. Nga ana tjetër, të dhënat e marra nga anketimi në terren për nevojat e PZHK-së, tregojnë se në Junik ka 741 ekonomi familjare me gjithsej 7138 banorë përfshi edhe diasporën. Mesatarja e ekonomive familjare është 6 anëtarë për familje.

<sup>1</sup> **shënim:** gjatë anketimit, është vërejtur se ka pasur raste kur dhënësi i shënimeve (familja) nuk ka ofruar të dhënat e sakta për familjen.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për popullsinë sipas moshës dhe gjinisë. Më se 50% e popullsisë janë nën moshën 26 vjeçare. Raporti gjinor është pothuasje i balancuar (F:M=50.26%: 49.74%). Popullsia i përket etnisë shqiptare.

**Tabela 2: Popullsia sipas moshës dhe gjinisë nga analizat në terren (përfshirë popullsinë në diasporë)**

Popullsia sipas moshës dhe gjinisë											
1-7		8-18		19-25		26-40		41-64		>65	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
7.06%	6.54%	9.92%	10.46%	8.48%	7.71%	12.70%	11.67%	8.60%	8.95%	2.98%	4.93%
13.60%		20.38%		16.19%		24.37%		17.55%		7.91%	

**Trendi dhe prognoza demografike:** Popullsia e Junikut paraqitet mjaft “delikate” ndaj ndryshimeve ekonomike sado të vogla qofshin ato, apo edhe nga faktorë të jashtëm të cilët influencojnë zhvillimet demografike dhe ekonomike në qytezë. Por, pavarësisht mungesës së informacioneve zyrtare, mund të themi se Juniku është vendbanim në zhvillim dhe me tendenca për t’u ndërtuar, prandaj është i domosdoshëm kontrolli dhe udhëzimi për këtë zhvillim. Parashikimi demografik është bazuar në llogaritjen e shkallës së shtimit të popullsisë në nivelin e Kosovës (e cila sipas statistikave të nxjerra nga Enti Statistikor është rreth 1.4%). Sipas këtij trendi, Juniku pritet që në vitin 2023+ ti ketë rreth 11.000 banorë (nëse mirret e dhëna zyrtare prej 9 600 banorëve përfshi diasporën). Duke ditur që të dhënat në terren dhe ato nga ESK tregojnë një situatë ndryshe, numri i banorëve rezident në Junik (sipas të dhënave të ESK) deri në 2023 pritet të jetë rreth 6 600 banorë (pra pa diasporën), respektivisht rreth 8 700 banorë me diasporën (llogaritur me të dhënat nga anketimi për PZHK-në).

## 2.2.2 Gjendja sociale

**Punësimi dhe papunësia:** Ashtu sikur në tërë Kosovën, shkalla e papunësisë edhe në komunën e Junikut është e lartë dhe paraqet një aspekt shqetësues. Nga të dhënat e marra në terren nga anketimi del se nga popullsia aktive për pune (të moshës 19-64 vjeç) vetëm 22.76% e tyre janë të punësuar respektivisht të papunë janë 77.24% e popullsisë aktive. Nga 22.76% e të punësuarve, 4.03% janë femra ndërsa 18.73% meshkuj që do të thotë se raporti i punësimit sipas gjinisë është gati F:M=1:5.

Deri sa ishin në funksion kapacitetet prodhuese, numri i të punësuarve ka qenë shumë më i madh e sidomos në Fabrikën e Konfeksionit në Junik ku kanë punuar më tepër se 230 punëtorë. Në mungesë të punësimit në këto kapacitete një numër i të punësuarve kanë gjetur mundësinë e punësimit në bizneset e vogla private. Përveç mosfunksionimit të kapaciteteve prodhuese, faktorë tjerë që kanë ndikuar më së shumti në rritjen e shkallës së papunësisë janë:

- Procesi i privatizimit (Pronat e Ndërmarrjes Shoqërore Ereniku)
- Kushtet e vështira gjeografike dhe ekonomike
- Mungesa e investimeve në infrastrukturë
- Mungesa e investimeve në sektorin e bujqësisë
- Mungesa e politikave të nivelit Qendror në krijimin e vendeve të reja të punës

**Tabela 3: Numri i të punësuarve në sektorin publik në komunën e Junikut sipas viteve, (Burimi: GAP 2009)**

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	141 ▲
2008	118 ▼
2007	119 ▲
2006	15 ▲

Të dhënat për vitin 2009 nga hulumtimi i GAP-it, tregojnë se numri i të punësuarve në sektorin publik është 141. Krahasuar me vitin 2008, numri i shërbyesve civil është rritur për 23 persona.

**Të ardhurat:** Të ardhurat kryesore vijnë nga përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale. Mirëpo duke pasur parasysh numrin e madh të junikasve që gjenden jashtë vendit (përgjithësisht në Zvicër dhe Gjermani), konsiderohet që ndihma ekonomike që vjen nga jashtë përbën gjithashtu një burim të ardhurash të rëndësishme për komunën. Sipas anketimit, rezultatet mbi të ardhurat mesatare familjare janë si vijon:

**Tabela 4: të ardhurat mesatare sipas anketimit në terren**

Të ardhurat	< 201 €	%	201 €	%	>201 €	%	S'ka përgjigje
Nr.familjeve	248	33.47%	175	23.61%	165	22.26%	20.64%

**Varfëria dhe asistenca sociale:** Sipas të dhënave nga Qendra për Punë Sociale e komunës së Junikut, gjithsej janë 685 individë apo 12.6% e popullsisë rezidente në Junik që jeton në varfëri . Kjo vlerë tregon se kemi të bëjmë me shkallë të mesme të varfërisë meqë % e popullsisë që marrin asistencë sociale është në vlerat 4-22%. Rritjes së shkallës së varfërisë i kanë kontribuar: shkalla e lartë e papunësisë, shkatërrimi masiv gjatë luftës sidomos për vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj, etj.

**Strehimi:** Komuna e Junikut nuk ka probleme të të pastrehëve dhe e gjithë popullata kanë strehim adekuat, duke marrë parasysh edhe atë se Lagjja „Agim Ramadani” është duke u shfrytëzuar në një formë si banim social dhe strehim për banorët e zhvendosur nga fshatrat Jasiq dhe Gjocaj.

**Migrimi:** Në mungesë të regjistrimit të popullsisë, nuk dihet numri i saktë zyrtar i familjeve që jetojnë në diasporë.Sipas anketimit të bërë në terren për nevojat e këtij plani del se 25% e popullsisë së Junikut jeton jashtë Kosovës dhe interesimi për të migruar jashtë në kërkim të kushteve më të mira për jetë dhe gjetjen e mundësive për punësim është ende prezent. Kjo sipas anketimit është shprehur në gati 12% të familjeve, të cilat kanë deklaruar se kanë të interesuar për të migruar jashtë vendit, e shprehur sidomos tek rinia mashkullore.

**Organizimi i shoqërisë civile:** Shoqëria civile në komunën e Junikut nuk është e organizuar dhe si e tillë nuk është edhe shumë aktive. Ndoshta një gjendje e tillë ndodh për shkak se Juniku është komunë e re dhe se deri më tani nuk ka pasur kapacitete të zhvillohet ky sektor me rëndësi për shoqërinë<sup>2</sup>.

### 2.2.3 Infrastruktura dhe shërbimet sociale

#### Gjendja në shëndetësi dhe shërbimet shëndetësore:

Shërbimet shëndetësore parësore ofrohen nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila gjendet në qytetin e Junikut dhe numëron gjithsej 22 punëtorë të sistemuar në dy turre punësimi. Nga ky numër, katër (4) janë mjekë, dy (2) stomatologë dhe pjesa tjetër staf i mesëm dhe staf ndihmës. QKMF ofron të gjitha shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor si dhe shërbime Oftalmologjike dhe Stomatologjike.

Qasja dhe gravitimi i banorëve deri tek QKMF është e lehtë, dhe madje shfrytëzohet edhe nga baorët e disa fshatrave të Deçanit dhe Gjakovës. Duke e marrë parasysh kriterin<sup>3</sup> se për 2000 banorë nevojitet 1 mjek dhe 2 motra medicinale, QKMF në Junik e plotëson këtë kriter.

Aktualisht hapësira ekzistuese në kuadër të QKMF nuk është e mjaftueshme, mirëpo me realizimin e projektit të QKMF së re (i cili pritet të realizohet më 2010), shërbimet shëndetësore do të përmirësohen dukshëm si dhe do të ketë kapacitete të mjaftueshme për ofrimin e këtyre shërbimeve. Kuadri aktual mjekësor i plotëson nevojat

<sup>2</sup> GAP (2009), Juniku - Raporti Komunal

<sup>3</sup> Organizata Botërore e Shëndetësisë, Strategjia e Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Projekt Plani Hapësinor I Kosovës

për shërbimet e nevojshme për dy ndërrime, mirëpo me ndërtimin e objektit të ri synohet të ketë 24 orë shërbim (varësisht nëse lejohet rritja e numrit të të punësuarve nga organi përgjegjës). Shërbimet dytësore ofrohen nga spitalet rajonale të Gjakovës dhe Pejës.

### Gjendja në arsim dhe shërbimet arsimore:

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Junikut zhvillohet në nivelet: parafillor përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, fillor (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (6-9) dhe arsimit i mesëm i lartë (shih tabelën 5).

**Tabela 5: Numri nivelet e arsimit në procesin edukativo-arsimor**

Nr.	Niveli shkollor	Nr. nxënësve	Mësimdhënës	Administrata	Pastrues-roje	Totali
1.	Parafillor	61	1			<b>1</b>
2.	Fillor dhe i mesëm i ulët	725	37	2	5	<b>44</b>
3.	Arsim i mesëm i lartë	251	13	1	3	<b>17</b>
4.	P.me nevoja të veçanta	6	1			<b>1</b>
	<b>Totali</b>	<b>1037</b>	<b>52</b>	<b>3</b>	<b>8</b>	<b>63</b>

Nëse shikohet kriteri i bankës botërore në shkollën fillore dhe të mesme të ulët ky kriter është respektuar dhe përkon me numrin e nxënësve dhe të punëtorëve të arsimit (21.3 nxënës 1 mësimdhënës, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë numri i punëtorëve të arsimit është më i madh). Ndërtimi i objektit të ri të shkollës së mesme me kapacitete të mjaftueshme dhe kushte bashkëkohore ka përmirësuar kushtet e mësimdhënies në shkollën fillore sepse janë liruar ambientet e shkollës fillore ekzistuese nga nxënësit e shkollës së mesme dhe ata mundën tani të zhvillojnë mësimin në dy ndërrime e jo tri siç ka qenë më parë. Megjithatë, këto shkolla ende nuk kanë salla sporti e kur dihet se komuna nuk ka edhe qendër sportive. Arritja në shkollë, për diku rreth 90% të nxënësve është deri diku e lehtë. Largësia më e madhe është në diametër prej 3 km dhe për këtë komuna nuk ka obligim ligjor të siguroj transport. Qasje pak më të vështirë kanë vetëm nxënësit e lagjes "Agim Ramadani" dhe ata që vijnë nga zonat rurale edhe nga fshatrat e komunave fqinje.

Juniku nuk ka institucione parashkollore të cilat sigurojnë shërbimet e çerdheve dhe kopshteve. Shërbimi i arsimit parashkollor është i organizuar në hapësirat e shkollës fillore, por kjo nuk do të thotë që komuna nuk ka nevojë për të pasur institucione të tilla (sidomos çerdhe/kopshte).

Mundësitë për edukimin e personave me nevoja të veçanta fizike ekzistojnë, mirëpo familjarët në shumicën e rasteve nuk i dërgojnë fëmijët në paralele për persona me nevoja të veçanta.

Shënime për nivelin e analfabetizimit nuk ka meqë nuk janë bërë ende statistika për shkallën e analfabetizimit.

**Objektet e religjionit:** Në Junik gjenden 12 objekte kulti, të cilat janë të shpërndara në gjithë territorin. Ndër to bëjnë pjesë edhe dy xhami, prej të cilave Xhamia më e vjetër është ajo që gjendet në lagjen Çoku e cila daton prej vitit 1570. Ndërsa Xhamia tjetër është "Xhamia e Qendrës". Aktualisht në Junik ekziston edhe një Teqe e sapo ndërtuar e cila u dedikohet besimtarëve halvetinj. Në përgjithësi, këto objekte plotësojnë nevojat e banorëve dhe poashtu paraqesin dhe objekte me vlera kulturo-historike.

**Objektet dhe hapësirat publike, si dhe hapësirat për sport, kulturë dhe zbavitje:** Në territorin e Junikut vërehet një mungesë e madhe e institucioneve për kulturë (muze, teatër, kinema, bibliotekë), institucioneve dhe hapësirave për sport e rekreacion, si dhe hapësirave publike (parqe, sheshe etj). Aktualisht nevojat e banorëve për sport dhe rekreacion i përmbush vetëm Hapësira për sport dhe rekreacion me 300 m<sup>2</sup> e cila gjendet në Miroc dhe një park i lodrave për fëmijë me 120 m<sup>2</sup>. Por kjo nuk mjafton kur dihet që as shkollat nuk kanë salla për edukatë fizike.

Në kuadër të PZHU-së dhe PRrU-së “Qendra” janë parapa Projekte të cilat do të mundësonin krijimin e hapësirave për zbavitje, sport e rekreacion e të cilat do të mund të shfrytëzoheshin edhe nga banorët e fshatrave si:

- Plotësimi i strukturave arsimore (shkollave) me mjedise me funksion rekreativ (lulishte, kënd lodrash, terrene sportive),
- Krijimi i një hapësire për rekreacion sportiv
- Krijimin e Sheshit Publik, Bibliotekës Komunale dhe Muzeut të Qytetit.

Nëse në një të ardhme të afërt projektet e tilla do të realizoheshin, kjo sadopak do të përmbush boshllëkun që ka komuna sa i përket mungesës së hapësirave publike dhe atyre për sport e rekreacion jo vetëm për banorët e saj, por, edhe për vizitorët të cilët do ta vizitonin Junikun meqë turizmi shihet si një potencial zhvillimi për komunën,

**Varrezat:** Çështja e varrezave është një çështje brengosëse e Komunës për arsye se ato janë të shpërndara gjithandej dhe nuk kanë një lokacion të dedikuar vetëm për to. PZHU ka trajtuar këtë problematikë dhe një Vendim është marrë nga Kuvendi Komunal për ndarjen e mjeteve për rregullimin e infrastrukturës së varrezave. Tani pritet përpilimi i projektit dhe shpresohet që në një të ardhme të afërt çështja e varrezave të zgjidhet.


**Mediat lokale:** Në Junik<sup>4</sup> nuk ka ndonjë radio apo televizion lokal e as edhe ndonjë korrespondent të gazetave të përditshme kosovare. Prandaj, qytetarët e Junikut kryesisht informohen nga televizionet apo radiot publike dhe ato private të komunave përreth.

Përfundim: Gjendja sociale në Junik në aspektin e varfërisë dhe strehimit sipas treguesve të dhënë është diç më e mirë krahasuar me trendin kosovar në përgjithësi, mirëpo, migrimi, punësimi i të rinjëve dhe shkalla e lartë e papunësisë dhe ofrimi i infrastrukturës papunësisë dhe ofrimi i infrastrukturës sociale dhe shërbimeve përkatëse më afër qytetarit mbetin ende një sfidë e veçantë për komunën e Junikut.


---

<sup>4</sup> GAP 2009, Juniku-Raport Komunal


Harta 1: Pozita gjeografike



Harta 2: Dendësia e popullsisë



Harta 3: Institucionet, hapësirat publike dhe objektet e kultit/religjionit



## 2.2.4. Zhvillimi ekonomik

### 2.2.4 (a). Bujqësia

**Bujqësia:** Është veprimtari e rëndësishme në komunën e Junikut. Juniku ka 4.439 Ha tokë bujqësore e cila paraqet 57.08% të sipërfaqes së përgjithshme. Ky është indeks relativisht i lartë krahasuar me mesataren në Kosovë që sillet prej 0.15-0.18 Ha tokë bujqësore për kokë banori (limiti kritik është 0.17 Ha) dhe atë në Europë (0.52 Ha/1b). Toka bujqësore pas luftës kultivohet me një shkallë më të ulët për shkak të konkurrencës joreale në treg dhe mos aplikimit i të mbjellurave profitabile nga fermerët. Aktivitetet bujqësore në Junik zhvillohen goftë në zonën urbane (për shkak të tipologjisë së banimit me oborre të mëdha) poashtu edhe atë rurale. Ndërsa kulturat më të zhvilluara bujqësore janë: gruri, misri, fasulja, thekra, pastaj perimet si: specat, domatet, lakrat dhe qepët. Në masë mesatare kultivohen kulturat e pemëtarisë si: molla, dardha, vishnja, dhe dredhëza, por, kohëve të fundit shihet tendenca e rritjes së mëtejshme të sipërfaqeve të pemishteve, me një favorizim të rritjes së kapacitetit të ujitjes. Duke iu falënderuar cilësisë së tokës dhe klimës, Juniku karakterizohet edhe me kulturat e bimëve me veti mjekuese si: lincuri, rrudhani dhe disa lloje të këpurdhave.

**Perimekultura/Lavërtaria:** Në komunën e Junikut nuk është ende aq e zhvilluar perime-kultura dhe lavërtaria. Kultivohen një numër i vogël bimëve lavërtare. Në sipërfaqe të vogla bimë foragjere dhe pemë. Mbi 45 Ha janë të mbjella në sektorin privat. Interesimi i ulët i fermerëve për kultivim ndodh edhe për arsyet e kostos së lartë të shpenzimeve. Ajo që vihet re është zhvillimi i pakët i kulturave intensive dhe industriale e sidomos kultivimi në ambiente të mbyllura – serra.

Tabela 6: Sipërfaqet e mbjellura

Sipërfaqet e mbjellura	Ha	%
Drithëra	1036	58.7
Perime	140	7.9
Foragjere	550	31.1
Pemë	40	2.3

*Burimi: Strategjia Zhvillimore Lokale, Junik (2009)*

**Qasja në tokat bujqësore:** Problematikë në vete paraqet qasja në tokat bujqësore. Kjo për arsye se në mungesë të rrugëve, pronarëve iu duhet të kalojnë nëpër pronat e tjetërkujt për të pasur qasje në tokën e vet. Ky problem është sidomos gjatë sezonit të të korrave. Poashtu pamundësia për plasimin e produkteve në tregun kosovar dhe atë rajonal paraqet një dobësi për sektorin e bujqësisë.

**Sistemi i ujitjes së tokave bujqësore:** Nën sistemin e ujitjes janë 960 Ha tokë punuese. Komuna në këtë aspekt është duke u ndihmuar nga Ministria e Bujqësisë me ndërtimin e pendës në lagjen Gacafer. Me këtë projekt priten të futen në sistemin e ujitjes, pjesë e madhe e tokave bujqësore. Realizimi i këtij projekti padyshim që do ta përmirësojë pak situatën, por, jo në tërësi. Ka nevojë për ngritjen e kanaleve që do ta dërgonin ujin në çdo pjesë të tokave bujqësore. Kështu fermerëve do t’iu lehtësohet puna për zënien e ujit nga lumi Erenik dhe futjen e ujit në sistemin e ujitjes. Ka vite që ujitja e tokave bujqësore bëhet nga ky lum meqë sasia e ujit është e mjaftueshme për ujitje. Nevojitet që kanalet kryesore dhe ato ndihmëse të rregullohen dhe mirëmbahen.

**Blegtoria:** Përkundër faktit që ajo pësoi dëme shumë të mëdha gjatë luftës (dëmet rezultuan me humbjen e rreth 90% të gjedheve, 85% të deleve, 100% të pulave dhe rreth 50% të dhive) blegtoria paraqet një drejtim tjetër strategjik të zhvillimit ekonomik të komunës së Junikut. Sipërfaqja e madhe me livadhe e kullota brenda territorit të komunës si dhe nga tradita e zhvillimit të kësaj lëmie janë faktorë favorizues për zhvillimin e blegtorisë (sidomos në kultivimin e gjedheve dhe dheneve). Sipas të dhënave nga Strategjia Zhvillimore Lokale (2009), në Junik ekzistojnë 200 ferma të vogla dhe dy ferma të mëdha të specializuara.

**Organizimi:** Në këtë drejtim është me rëndësi të shikohen edhe çështjet nga aspekti institucional dhe organizativ. Stimulimi i bujqëve dhe fermerëve nga ana e Ministrisë (MBPZHR) për rritjen e shfrytëzueshmërisë së tokës bujqësore respektivisht ngritjen e fermave duke respektuar standardet e BE, është i ulët.

**Tabela 7: Klasifikimi i fermave në kategori sipas MBPZHR**

Fermat	Krerë lopë
fermat e vogla	10 -20 krerë
fermat e mesme	20-50 krerë
ferma të mëdha	mbi 50 krerë

Kjo për arsye se Ministria përcjell standardet e BE, dhe këto standarde kërkojnë bashkëpunim më të madh të bujqve rreth komasacionit të tokave bujqësore (kjo bëhet edhe me qëllimin e mbrojtjes së tokës bujqësore nga fragmentimi). MBPZHR me politikën e saj stimulon fermerët të kategorisë së mesme dhe të lartë, gjë që nënkupton që fermerët e vegjël duhet të bashkojnë

fermat e tyre duke u organizuar në formë kooperativash. Sipas parametrave të MBPZHR, Juniku nuk ka nevojë për më shumë se dy ferma. Sipas informatave nga komuna e Junikut, mendohet se ekzistojnë rreth 800 dele të shpërndarë në 5 fermerë dhe diku 1100 lopë në rreth 90 fermerë të kësaj komune. Janë gjithsej pesë fermerë që kanë mbi 10 krerë lope qumështore të cilët kanë përfituar nga stimulimi i MBPZHR.

E rëndësishme të ceket është edhe mungesa e organizimit: në Junik ende nuk ka shoqatë të bujqve dhe fermerëve dhe fusha e bujqësisë mbulohet me vetëm një punëtor profesional në kuadër të komunës. Shqetësim paraqet edhe fakti që bujqësia nuk shihet si profesion profitabil nga të rinjtë.

### 2.2.4 (b).Pylltaria

Potenciali pyjor në nivel të Kosovës është 41.8% me rreth 455 000 Ha<sup>5</sup>. Pyjet (respektivisht kulturat pyjore ku përfshihen edhe masat drunore në tokat bujqësore), në komunën e Junikut zënë sipërfaqe prej 3197 Ha që i bie rreth 41% të territorit të komunës së Junikut)<sup>6</sup>. Në pronësi private janë rreth 22% e pyjeve. Rreth 50% e pyjeve janë të reja rreth moshës 30 vjeçare me lloje të drurit të ahut,

**Tabela 8: Kategoria e pyjeve**

	Kategoria e pyjeve	%
1	Pyje të larta	74.9
2	Pyje të ulëta	7.29
3	Pyje me kultura-plantacion	6.42
4	Shkurre	0.3
5	Tokë pyjore për pyllëzim	7.34
6	Tokë tjetër	3.83

**Burimi: Agjensioni Pyjor i Kosovës**

gështenjës, dushkut dhe verri. Llojet më të përhapura janë: Ahu (dominon në 79 % të sipërfaqes pyjore), halorët : Pisha e Zezë, Hormoqi, Bredhi, Arneni (rreth 20 % të sipërfaqes në pyjet publike). Gështenja, Dushku e Verri janë kryesisht në pronësi private, ndërsa Mështekna si dhe gjethor dhe halor të tjerë kryesisht në pronësi publike dhe në sipërfaqe të vogla.

Për të gjitha llojet ekzistojnë kushte optimale për rritje të drurëve të një kualiteti të lartë<sup>7</sup>. Rritje vjetore e masës drurore në

gjithë sipërfaqen pyjore është ~5.07 m<sup>3</sup>/Ha<sup>8</sup>. Potenciali i zhvillimit të pylltarisë në Junik në favor të zhvillimit të industrisë së drurit dhe përpunimit final ende nuk është hulumtuar. Aktualisht ato shfrytëzohen për prodhimin e drurit për djegie, meqë, tregu dhe organizimi i mirëfilltë që një sasi e konsiderueshme nga pyjet e ahut të shfrytëzohet për nevoja të industrisë së drurit mungon.

Nga ana tjetër vështirësitë në zhvillimin e këtij sektori, shihen edhe tek kompetencat në menaxhim të pyjeve që tash vonë janë deleguar tek komuna dhe deri tani kanë qenë kompetencë e nivelit qendror. Transferimi i kompetencave për mbrojtjen e pyjeve dhe shfrytëzimin jep mundësi për të krijuar një situatë të re sidomos në pyjet në pronësi publike. Është me se e nevojshme që rolet dhe përgjegjësitë për të gjitha palët e përfshira të sqarohen dhe kuptohen sepse menaxhimi i pyjeve ka nevojë për të adresuar si potencialin e zonës poashtu edhe nevojat e komunitetit për produktet pyjore dhe shërbimet për një menaxhim të qëndrueshëm. Modeli aktual i menaxhimit të pyjeve për tu aplikuar në këtë situatë të re me kompetencat e decentralizuara për pyjet akoma nuk është i sqaruar. Ngritja e kapaciteteve Komunale për menaxhim pyjesh është esenciale.

<sup>5</sup> Sipas të dhënave nga Projekt Plani Hapësinor i Kosovës, 2009

<sup>6</sup> Të dhënat sipas Elabortit Kadastral Komunal nga regjistrimi i vitit 1983. Situata në terren mund të jetë e ndryshueshme

<sup>7</sup> Të dhëna nga SNV 2011

<sup>8</sup> Sipas të dhënave nga Agjencia Kosovare e Pyjeve (2009)

Sektori i pyjeve private është dobët i organizuar dhe me institucionalizim të kufizuar që shpie tek një Sektor i pylltarisë që nuk siguron kuadër dhe shërbime të nevojshme optimale për sektorin privat. Shumica e pyjeve kanë menaxhim të pa qëndrueshëm dhe prerjet ilegale mbesin problem serioz. Në sektorin privat të pyjeve kjo ndodh për shkak që korniza ligjore e sektorit privat dhe e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve nuk është e rregulluar plotësisht. Ekziston një nivel i ulët i përfshirjes së akterëve vendor, siç janë komunat dhe komunitetet në sektorin e pylltarisë duke rezultuar në rregullim të limituar të menaxhimit të pyjeve lidhur me nevojat e këtyre akterëve dhe duke i kufizuar mundësitë për zhvillim ekonomik. Hapat e parë në zhvillimin e pylltarisë private janë hedhur me themelimin e Shoqatës së Pronarëve të Pyjeve me përkrahjen e projektit të SNV –SIDA, për forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Zhvillimi i sektorit privat dhe decentralizimi pyjeve i ep një mundësi të mirë zhvillimit ekonomik rural. Sidomos në zonat e largëta, sektori i pylltarisë është një ndër sektorët që siguron të ardhura dhe mundësi punësimi. Aktualisht, për shkak të kushteve të kufizuara, pyjet nuk përdoren dhe nuk menaxhohen në mënyrë të duhur (ka degradim dhe shërrim resursesh pyjore). Kushtet e duhura (institucionale, sociale dhe ekonomike) mund ta ndryshojnë këtë, ku pyjet private dhe të decentralizuara janë duke kontribuar në ekonominë rurale dhe duke i ruajtur shërbimet pyjore në dobi të shoqërisë duke kontribuar në mirëqenien sociale dhe ekonomike.

**Silvikultura:** Silvikultura është e zhvilluar në Junik. Në këtë territor funksionojnë dy fidanishte. Ndërmarrja “PTUJA” dhe “FIDANISHTJA” që kanë nga 0.50 deri në 0.60 Ha toke fidanishte të silvikulturës.

#### 2.2.4 (c). Industria dhe prodhimtaria

Në komunën e Junikut **industria** nuk është e zhvilluar. Ekziston një kompani e cila merret me përpunimin e asfaltit dhe zhavorit. Punësimi në këtë kompani bëhet në bazë të nevojave dhe është kryesisht sezonal. Siç u cek më lartë potencial për zhvillimin e industrisë së drurit ende nuk është hulumtuar. Nga ana tjetër nëse rritet fondi i blegtorisë ka mundësi për zhvillimin e industrisë së mishit në të ardhmen.

#### Kutia 9: Projektet e parapara me PZHU në Sektorin e Ekonomisë

- Krijimi i pikave me karakter grumbullimi, përpunimi dhe konservimi i pemëve, perimeve dhe frutave pyjore
- Ngritja e tregut rural ku do të përfshihen dhe aktivitete të magazinimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore-blegtorale si dhe një qendër shpërndarëse për rajonin
- Trajtime të fermerëve për përdorimin e mjeteve dhe metodave të avancuara në sektorin e agrobiznesit
- Kurse për artizanate për përmirësimin e cilësisë dhe të dizajnit të punimeve të dorës
- Institucionalizimi i grupeve të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve të prodhimeve bujqësoro-blegtorale

#### 2.2.4 (d). Sektori i energjisë elektrike dhe asaj alternative

Aktualisht ky Sektor nuk është i zhvilluar përkundër faktit që komuna e Junikut është e pasur me sipërfaqe ujore. Pasuria ujore ka tërhequr vëmendjen e specialistëve për të vlerësuar këtë jo vetëm si pasuri por edhe për shfrytëzim të saj. Duke iu referuar studimit të punuar nga MEM për parafisibiletin për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentralet e vogla në Kosovë (2006), Zona e Dukagjinit disponon me potencial hidroenergjetik që mund të përdoret. Studimi ofron shënime dhe vlerësime mbi vendet potenciale hidroenergjetike duke u bazuar në analiza të kapacitetit të tyre hidrik, prurjes dhe rënies së lumenjve, hidrologjinë, meteorologjinë, gjeologjinë, investimet, kërkesat dhe furnizimin me energji elektrike si dhe ndikimin e tyre në çështjet mjedisore. Lumi Erenik bën pjesë në zonën me interes nga i cili mund të përfitohet rreth 37 milionë kWh/vit ku mund të ndërtohen tri hidrocentrale: i Malit, Erenikut dhe Jasiqit (shih tabelën)

**Tabela 9: Të dhëna për HC e lumit Erenik (Burimi: MEM (2006))**

Hidrocentralet mbi lumit Erenik	Rënia (m)	Prurja llogaritëse (m <sup>3</sup> /sec)	Fuqia (kW)	Prodhim mesatar i energjisë (kWh/vit)	Investimet mil Euro		
					Ndërtim(orë)	pajisje	Shuma
HEC Malit	200	2.4	4000	18 milionë	2.4	1.7	4.1
HEC Erenikut	100	2.4	2000	9 milionë	1.6	0.7	2.3
HEC Jasiqit	90	2.6	1900	9.7 milionë	1.2	0.7	1.9

Shënim: Në investimet ndërtimore përfshihen edhe fondet për Studim dhe Projektim

Lokacionet sipas studimit të parafisibilitetit: Hidrocentrali i Malit mund të ndërtohet në zonën e Gradinës, Hidrocentrali i Erenikut mund të ndërtohet rreth 2.7 km në Veriperëndim të Junikut ndërsa ai i Jasiqit rreth 1.5 km në perëndim-veriperëndim të Junikut me ndërtesën e centralit tek restorant “Ereniku”. Për HEC Mali dhe Ereniku vrojtimet nuk kanë treguar probleme të rëndësishme gjeologo-inxhinierike, përderisa për shkak të terrenit tek HEC Jasiq parashikohen mjaft probleme, ndaj në këtë rast nevojiten studime të mëtejshme gjeologo-inxhinierike për të përcaktuar dhe zbatuar masat e nevojshme për sigurinë e kanalit të derivacionit. Për dallim, vendi i bazenit të presionit dhe ai ndërtesës së centralit nuk paraqesin probleme qëndrueshmërie.

Analiza nga studimi<sup>9</sup> poashtu tregon se që të gjithë centralet kanë kosto të vogël ekonomike se sa kostoja e mosfurnizimit të njësisë së energjisë elektrike dhe norma e brendshme ekonomike e fitimit është më e madhe se norma ekonomike e interesit. Konkluzioni kryesor i studimit është se ndërtimi i HEC të reja dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese është me shumë leverdi, meqenëse kemi një NPV pozitive dhe shumë të lartë, kemi një IRR më të lartë se norma e interesit prej 10%, një periudhë vetëshlyerjeje prej 3-9 vitesh shumë të lakmueshme në sektorin energjetik dhe një kosto njësi margjinale afatgjatë të gjenerimit 2.8-9.7 euro cent/kWh, e cila në disa raste është gati 1.5 herë më e ulët se çmimi i shitjes së energjisë elektrike. Nga aspekti mjedisor, është konkluduar se me ndërtimin e HEC do të bëhet i mundur zvogëlimi i gazrave që shkaktojnë shira acidike dhe efektin e smogut. Burimi: MEM (2006, 2009),

### 2.2.4 (e). Turizmi dhe hotelieria

Aktualisht turizmi nuk është sektor i zhvilluar në këtë komunë edhe pse potenciali natyror dhe ai kulturor ekziston. Potenciali turistik i komunës së Junikut është ngushtë i lidhur me pozitën gjeografike dhe vlerat kulturore e natyrore të komunës të cilat ofrojnë kushte për zhvillimin e turizmit malor/veror dhe dimëror, turizmit rekreativ dhe atij kulturor.

Shikuar në aspektin e zhvillimit turistik komuna e Junikut ndahet në tri zona me lokalitetet turistike: zona urbane: me potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor dhe atij rekreativ; Zona Gryka e Junikut me lokalitetet turistike: Liqejtë e Gjeravicës, Burimet e Erenikut, Lugu i Gjatë dhe Rrasa e Zogut, si dhe Zona e Zharres me lokalitetet: Gradina, Jedova, Zharra, Jasiq dhe Gjocaj (shih më gjerësisht kaptinën e potencialit natyror). Aktualisht komplekset/zonat më të vizituara nga turistët janë: Maja e Gjeravicës me dy liqejtë natyror; lumi Erenik, Moronica, Kullat, etj.

Sektori i turizmit është ngushtë i lidhur me zhvillimin e hotelierisë dhe gastronomisë (kuzhinës). Hotelet dhe objektet që ofrojnë shërbime hotelierike në Junik janë: Motel Restaurant Oda e Junikut; Motel Gjeravica dhe Konaku i Ramë Zymberit të cilat menaxhohen nga sektori privat. Kapaciteti i këtyre objekteve hoteliere është i kënaqshëm. Meqë turizmit i është dhënë prioritet si sektor i zhvillimit në të ardhmen, atëherë duhet marrë parasysh edhe ngritjen e kapaciteteve hoteliere. Përveç hotelierisë, faktorë tjerë të cilët gjithashtu ndikojnë në zhvillimin e turizmit janë: qasja (arritshmëria) deri te objektet/lokacionet turistike; konkurrenca; promovimi (marketingu); aktivitetet (ngjarjet kulturore, sportive, argëtuese etj) etj. Këto elemente mungojnë shumë në Junik ndaj ka nevojë për veprime të menjëhershme në këto fusha.

<sup>9</sup> MEM (2006), Studimi I parafisibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentralet e vogla në Kosovë


#### 2.2.4 (f). Zejtaria dhe artizanatet

Traditat e junikasve njihen në kultivimin e zejeve si për përpunimin e leshit, thurjes së rrobave tradicionale, qëndisjes, etj.. Me qëllim të ruajtjes së traditave por edhe përfitimit, shërbimeve dhe kultivimit të produkteve të zejtarisë duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë. Zhvillimi i tij duhet të shihet i ndërlidhur me zhvillimin e turizmit.



#### 2.2.4 (g). Tregtia dhe bizneset

Sektori i tregtisë është pak i zhvilluar përkundër faktit që pas luftës së vitit 1999, në Junik ka pasur një rritje të regjistrimit të bizneseve private. Aktualisht në Junik gjithsej janë të evidentuara 80 biznese që ushtrojnë veprimtaritë e tyre. Shumica nga këto, janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, të paregjistruara janë 18. Prej tyre shumica e ndërmarrjeve janë biznese familjare kryesisht si ndërmarrje tregtare dhe me gjithsejtë 140 të punësuar në sektorin privat. Komuna e Junikut ka përgatitur edhe Strategjinë për Zhvillim Lokal e cila i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit dhe përkrahjes së biznesit.




Grafiku 2: Llojet e veprimtarive në Junik

#### 2.2.4 (h). Shërbimet financiare

Këto shërbime në Junik kryhen përmes dy filialeve: Bankës ProCredit dhe Banka Ekonomike. Ekziston edhe Western Union që ofron pagesat dhe transferet si dhe dy institucione mikrofinanciare "Agjensioni për Financim në Kosovë"(AFK) dhe "Kreditimi Rural i Kosovës"(KRR) të cilat ofrojnë kredi në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, kredi biznesi, konsumi dhe rinovime shtëpiake. Këto institucione i ofrojnë sektorit privat kredi dhe këshilla për kredi. Megjithatë, niveli i lartë i interesit për kredi nuk i favorizon banorët apo zhvillimin e biznesit.

Përfundim: Sipërfaqet e mëdha me pyje, livadhe e kullosa paraqesin faktorë favorizues të zhvillimit të blegtorisë përcjellur me mundësinë e zhvillimit të industrisë ushqimore. Juniku ka pasur traditë në zhvillimin e sektorit të blegtorisë ndaj dhe kjo traditë duhet të fuqizohet edhe më tutje. Potenciali pyjor paraqet një mundësi për zhvillimin e industrisë së drurit dhe biomasës mirëpo, ka nevojë për hulumtim dhe studim më të detajuar se si të arrihet kjo. Në anën tjetër, edhe pse ajo po zhvillohet në masë të vogël sidomos pas luftës, bujqësia mbetet një sektor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik nëse rritet interesimi për kultivimin e kulturave intensive dhe industriale sidomos kultivimi në sera dhe krahas kësaj fuqizimi i sektorit privat për t'i kushtuar rëndësi më të madhe zhvillimit të agro-biznesit. Në këtë aspekt një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes dhe parandalimit të humbjes së tokës bujqësore nga zhvillimet aktuale. Përparësi për zhvillim në këtë sektor paraqet pemëtaria e cila ka treguar një trend të rritjes së kultivimit. Turizmi i bazuar në natyrë dhe ai kulturor është i dukshëm dhe paraqitet si një ndër potencialet më të fuqishme për zhvillim ekonomik, por, që vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe zhvillimit të infrastrukturës turistike dhe të sektorëve tjerë përcjellës të tij si: hotelerisë, artizanateve, kulturës, sportit e rekreacionit etj. Pasuritë ujore, sidomos lumi Erenik paraqet një potencial të madh në të ardhmen në zhvillimin e sektorit të energjisë së ripërtërishme/alternative.

Harta 4: Objektet me veprimtari ekonomike



## 2.3 INFRASTRUKTURA RRUGORE & SHËRBIMET PUBLIKE

### 2.3.1 Infrastruktura rrugore

Korridorët dominuesë rrugore në komunën e Junikut janë rrugët regjionale të cilat lidhin Junikun me qendrat më të afërta si Deçani, Peja dhe Gjakova. Gjendja fizike e këtyre akseve është relativisht e mirë, dhe përmes tyre përballohet ngarkesa e trafikut të shkallës së mesme.

Tabela 10: Rrjeti rrugor

Kategoria e rrugës	Nr	Rrugët	M	Gjendja fizike	Trafiku
<b>Rrugë regjionale:</b> (pë mirëmbajtjen e të cilave është përgjegjëse MI)	3	1) Junik-Voksh-Deçan e cila bën lidhjen me rrugën regjionale Pejë-Gjakovë që çon në Deçan dhe Pejë 2) Junik-Rastavicë lidhet përsëri me rrugën Pejë-Gjakovë nga ana e Gjakovës 3) Junik-Batushë- Ponoshec bën lidhjen me fshatrat malore në jug-perëndim të tij dhe me qytetet e Shqipërisë së Veriut dhe Gjakovë	9558	1)Relativisht e mirë 2)Relativisht e mirë 3)Relativisht e mirë	1)Relativisht i ngarkuar 2)Trafik i mesëm 3)Trafik i lehtë
<b>Rrugë kryesore komunale:</b> (janë rrugë që lidhin qendrat e bashkësive lokale me sub-qendrat më të afërta)	1	1) Rruga Junik-Dobrosh-Gjakovë që lidh qendrën me fshatrat e pjesës juglindore duke vazhduar për në Gjakovë.	3596	Relativisht e mirë	Trafik i lehtë
<b>Rrugë lokale:</b> (rrugë që lidhin hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të komunës)	25	1) Rrugët që lidhin lagjet 2) Rruga Gjocaj dhe Jasiq duke kaluar nëpër lagjet Gacafer dhe Pepsh.	22000	Jo e mirë/të pa kategorizuara	Trafik rural
<b>Rrugë e karakterit rural</b>		Rruga që shpie në Bjeshkë (Gjocaj, Jasiq & Lugu i Gjatë)		E pa kategorizuara	Trafik rural / sezonal
<b>Rrugët sezonale</b>		Rrugët që përdoren gjatë sezonit veror për qasjen në tokat bujqësore			

#### 2.3.1 (a) Lidhjet e brendshme:

PZHU i ka trajtuar të gjitha rrugët përbrenda Zonës Urbane. Të gjitha kategoritë e rrugëve dhe shtigjeve kontribuojnë në sigurimin e lëvizjes së brendshme. Shumica e rrugëve që nuk sigurojnë edhe lidhjet e jashtme janë në gjendje të keqe dhe karakterizohen me:

- zhavor jo të mjaftueshëm apo të degraduar, gur apo mbulojë asfalti
- paqëndrueshmëri (rrugë pa dalje, ose të tërthorta)
- dimensione të papërshtatshme (gradientë, diametra të lakuar, distanca prej objekteve)
- mungesë e sigurisë, mbrojtje dhe komoditet për këmbësorë dhe çiklistë (rrjeti i kanalizimit, mirëmbajtja, hapësirat e rezervuara (trotuaret/shtigjet për çiklistë), menaxhimi i parkimit, ndriçimit, të mirëmbajtjes)
- mungesë e shenjëzimit (hartave, tabelave orientuese)

Çështjet që duhet të adresohen janë:

- Rrugët në pyje dhe zona malore janë të shumta. Shumica e tyre janë të paklasifikuara dhe mund të përdoren vetëm me kuaj dhe traktorë apo ndoshta nëpërmjet automjeteve 4x4 për terren. Asnjë prej tyre nuk është e përshtatshme për biçikleta të zakonshme, vetura, kamionë ose autobusë, duke përfshirë rrugën "kryesore" drejt luginës së Erenikut dhe më tej në Liqejtë e Gjeravicës. Për këtë arsye ka vështirësi të qasjes në zonën pyjore dhe malore për çfarëdo veprimi rutinor lidhur me zhvillimin e turizmit apo menaxhimit të pasurive pyjore.

- Të gjitha lidhjet e jashtme takohen në qendër të rrethqarkullimit të Junikut. Si rezultat, të gjitha automjetet e rënda për transport mallrash, që vijnë nga pylli ose gurthyesi (deri në disa kamionë / orë) nëpërmjet rrugës së tranzitit të qytetit të Junikut shkaktojnë shqetësime të rregullta të rënda, sidomos në lidhjet Junik-Voksh dhe Junik-Rastavicë.
- Lëvizja ndërmjet lagjeve të vendbanimeve kryesore në Junik realizohet kryesisht me anë të mjeteve jo-motorike, ecje dhe çiklizëm. Në shumë raste, infrastruktura ekzistuese nuk iu është përshtatur kërkesave në rritje për lëvizje të shpejtë dhe të sigurtë, si dhe motorizimit në rritje.
- Nuk ekzistojnë shtigje të përshtatura për ecje, (alpinizëm), çiklizëm, kalërim dhe skijim nordik.

### **2.3.1 (b). Lidhjet e jashtme (ndërkomunale):**

Qasja në Junik arrihet nëpërmjet këtyre katër rrugëve kryesore:

- lidhja me rrugën regjionale Pejë-Gjakovë, rrugë regjionale 5,5 km (deri në udhëkryqin e Rastavicës)
- lidhja me Gjakovë/Shqipëri nëpër Ponošec, 2,3 km në territor të Junikut (deri te Batusha)
- lidhja me Gjakovë nëpër Dobrosh, rrugë komunale, 3,5 km në territor të Junikut
- lidhja me Deçan nëpër Voksh, rrugë regjionale, 2 km në territor të Junikut)

Të gjitha lidhjet janë rinovuar rishtas (mbulojë e re asfalti në të gjitha lidhjet dhe disa rikonstruksione të kryera në lidhjen e Deçanit) dhe janë në gjendje të mirë dhe shërbejnë për nevojat e transportit aktual.

Megjithatë disa prej çështjeve që duhet të drejtohen janë:

- Lidhja me magjistralen Pejë-Gjakovë është e orientuar në drejtim të Deçanit. Si karakteristikë e saj është një shpat i pjerrët që kalon nëpër lagjen Gaxherr. Një lidhje tjetër duke përdorur rrugën/shtegun komunal që lidh Hotelin Oda e Junikut me rrugën regjionale do të jetë i favorshëm për transport mallrash me shpate më të buta. Kjo gjithashtu do të sigurojë një lidhje të shkurtër për në Gjakovë (kjo lidhje do të shtrihet pjesërisht në territorin e Deçanit, e cila është gjithashtu dhe kryesisht me rëndësi strategjike për Junikun).
- Lidhja me Deçanin përmes Vokshit që kalon afër fshatit Dranoc. Rruga që lidh është praktike për të gjitha automjetet e terrenit. Dranoci është një zonë e rëndësishme e trashëgimisë dhe ka nevojë të jetë i lidhur në funksion të zhvillimit të një qasje ndërkomunale të trashëgimisë dhe të turizmit natyror (lidhja do të shtrihet në territorin e Deçanit e cila është gjithashtu me rëndësi strategjike për Junikun).
- Lidhja direkte me Shqipërinë nëpërmjet rrugëve malore duke shfrytëzuar ish bazën ushtarake e cila ekziston. Është praktike për të gjitha automjetet e terrenit përtej sektorëve të gjata. Ajo mund të zhvillohet si pjesë e programit të qasjes pyjore/malore dhe të bashkëpunimit ndër-kufitar.
- Ekzistojnë gjithashtu edhe rrugët sezonale, të cilat shfrytëzohen për bujqësi dhe meqë këto rrugë ndodhen në pronësi private kjo paraqet një problem në zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

### **2.3.2 Shërbimet publike – Transporti publik**

#### **2.3.2(a). Transporti me autobus:**

Në komunën e Junikut transporti publik i brendshëm nuk funksionon. Por, këtë komunë e përshkon linja e autobusëve ndërkomunalë dhe për arsye të mungesës së stacionit të autobusëve ata stacionohen në qendër. Përmes këtyre autobusëve udhëtarët lëvizin në drejtime të ndryshme si të fshatrave për rreth ashtu edhe në qytetet tjera. Pra ka linja të rregullta udhëtimi për Deçan, Gjakovë, Pejë e Prishtinë.

**Tabela 11: Lidhjet e transportit urban**

Lidhja	Numri i nisjeve	Distanca km	Koha e udhëtimit (minuta)	Çmimi (€)
Junik-Deçan-Pejë-Prishtinë	13	110	20 / 35 / 120	0.8 / 1.5 / 4
Junik-Deçan-Pejë	9	12,5 / 28,0	20 / 35	1 / 1.5
Junik-Batushë-Gjakovë	9	2 / 25,5	20 / 40	0.5 / 1.5
Junik-Rastavicë-Gjakovë	3	5.5 / 22,5	15 / 45	0.5 / 1.5
Junik-Gjakovë nëpërmjet shërbimeve të Deçanit dhe lidhjes në linjën kryesore rrugore	22	23	40	1.5

Lidhje të drejtpërdrejta dhe të shpejta janë të orientuara drejt Deçanit e Pejës. Gjakova mund të arrihet më shpesh duke pasur parasysh që shërbimet për në Deçan edhe më tutje veprojnë përmes rrugës magjistrale ku udhëtarët mund të lidhen me shërbimet e rregullta që udhëtojnë në drejtimin mes Pejës dhe Gjakovës.

### 2.3.2 (b) Transporti hekurudhor

Në territorin e komunës së Junikut nuk kalon linja hekurudhore. Kjo linjë nuk kalon as pranë këtij territori. Stacioni më i afërt i trenit ndodhet në qytetin e Pejës dhe të Klinës. PZHK i Gjakovës parasheh lidhjen hekurudhore me Deçanin dhe Pejën, e cila do të kalojë paralel me rrugën regjionale Gjakovë-Deçan-Pejë dhe kjo paraqet një mundësi për Junikut të kqyçet në linjat hekurudhore në të ardhmen.

### 2.3.2 (c) Qasja nga ajri

Lidhja e Lokalitetit të Junikut përmes rrugëve ajrore kryhet zakonisht përmes Aeroportit të Prishtinës. Gjatësia e rrugës prej Junikut deri në Aeroport është 100 km, e cila kalohet përmes Gjakovës apo Pejës, ku distanca përafërsisht është e njëjtë. Lidhje tjetër alternative është edhe Aeroporti i Shkupit (Maqedoni), ku rruga prej Junikut është e gjatë rreth 250 km. Si alternativë tjetër për lidhje ajrore mund të jetë edhe Aeroporti i Kukësit (Shqipëri), i cili është në ndërtim e sipër. Në këtë aeroport mund të shkohet më shpejt edhe se në Prishtinë sepse është më afër. Gjatësia e rrugës është rreth 80 km. Gjithashtu, në të ardhmen mund të konsiderohet mundësia a aktivizimit të aeroportit të Gjakovës, e paraparë gjithashtu me PZHK-në e Gjakovës, me c' rast lidhja e Junikut nga ajri mund të përmirësohet dukshëm.

### 2.3.2 (d). Infrastruktura e shtigjeve për këmbësorë

Në nivel ndërkomunal rrugët e vogla komunale, rrugët e joklasifikuara dhe rrugët e thjeshta bujqësore ose këmbësorike, kanë kontribut të rëndësishëm në infrastrukturën e transportit intern (ecja apo ngasja e biçikletës nëpër qytezë) dhe si atraksion turistik. Nga vrojtimi dhe diskutimi me grupin punues dhe nga vizita në vendbanim, shihet qartë se lëvizshmëria interne është e lartë dhe e shpejtë me orare. Investimet tërësore në këtë fushë janë të mirëseardhura përdërisa ecja në mal (hiking) dhe çiklizmi malor si zhvillim turistik mund të shihet vetëm si një strategji afatgjate që do të zhvillohet hap pas hapi.


Komuna e Junikut ka punuar një segment të shtegut për biçikleta dhe pritet të fillojë punimet në zbatimin e projektit për shtigje të çiklistëve të përcjellura edhe me trotuare aty ku infrastruktura dhe çështja e pronësisë ka lejuar një gjë të tillë. Mirëpo kjo iniciativë pozitive nuk mund të ketë efekt nëse nuk zgjidhet edhe çështja e mirëmbajtjes (shtegu i biçikletave nuk duhet të pushtohet nga veturat që kalojnë, pasi që akumulon pluhur dhe copëza, gjë që e bëjnë të papërshtatshme për ngasje).

### 2.3.2 (e). Shërbimet Taxi

Në Junik janë të regjistruar 8 vetura taksi. Çmimet nuk janë të rregulluara. Nuk ekzistojnë të dhëna mbi numrin e taksive jozyrtare dhe shërbimeve me minibus. Këto shërbime ekzistojnë, por, nuk janë në konkurrencë të hapur/agresive me taksitë e autorizuar dhe të transportit publik.

Përfundim: Sfida më komplekse për pjesën e infrastrukturës së PZHK-së do të jetë përcaktimi i rrugës për lidhje anësore me rrugën e Rrafshit dhe atë të Junikut për në rrugë të Deçanit drejt rrugës regjionale Deçan-Gjakovë, duke përdorur pjesë të lidhjes ekzistuese dhe mundësisht rrugës së zhavoruar e ndërtuar për qëllim të bartjes së zhavorit në qendrën e shpërndarjes. Mungesa e rrugës tranzit e cila do të shërbente për transport të rëndë, rrjeti i brendshëm i rrugëve ende i pakompletuar (shumë rrugë të lagjeve janë ende të paasfaltuara), qasja deri në Bjeshkë e vështirë, mungesa e infrastrukturës së nevojshme për transport publik (stacionit të autobusëve), ofrimi i kushteve më të mira për lëvizshmërinë e banorëve (shtigjet e këmbësorëve, trotualet, sinjalizimet etj) por edhe turistëve janë poashtu një sfidë e veçantë për tu ballafaquar. Meqë turizmi shihet si një potencial i ardhshëm për zhvillim, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet edhe infrastrukturës përcjellëse që e ndihmon zhvillimin e këtij sektori (rregullimi i vijave të ecjes deri në zonat turistike, vendkampingjet, etj).

Harta 5: Rrjeti rrugor



### 2.3.3 Shërbimet publike

#### 2.3.3 (a) Rrjeti i ujësjellësit dhe furnizimi me ujë

Rrjeti i ujësjellësit është në gjendje mesatarisht të mirë. Ka mjaft burime të pastërta ujore të cilat momentalisht shfrytëzohen dhe 97% e banorëve furnizohet me ujë të pijes<sup>10</sup> nga ujësjellësi. Në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj rrjeti i ujësjellësit nuk është i organizuar, por, ato furnizohen me ujin nga burimet natyrore që vjen me rënie të lirë. Rrjeti ka afërsisht 15 km tuba të ujit në gjendje të mirë dhe 1.4 km në gjendje më të dobët. Aktualisht ujësjellësi i Junikut menaxhohet nga KUR "Hidrodrini" nga Peja, nëpërmjet Njësisë Operative në Junik. Furnizimi me ujë të pijes është i mirë me përjashtim të muajit gusht dhe shtator ku ka edhe reduktime të ujit. Ka edhe mjaft burime tjera të ujit për pije por në mungesë të donacioneve kanë mbetur të pa shfrytëzuara. Cilësia e ujit që përdoret në Junik është jashtëzakonisht e mirë (ku edhe është vërtetuar me analizat e bëra të ujit).

Qyteza e Junikut furnizohet me ujë të pijes prej tri burimeve:

- Nga Burimi i quajtur "Vrella e Goçit" (gati tërë qyteza furnizohet prej këtij burimi dhe ku cilësia e ujit është më e mira, furnizimi bëhet me 30 l/sec. Në sezon të verës kur ka reduktime niveli i ujit bie, furnizimi bëhet me 14 l/sec. ndërsa depoja e rezervoarit ka kapacitet prej 600 m<sup>3</sup> ujë. Burimi i "Vrelës së Goçit" gjendet në lartësinë mbidetare 1200 m.
- Nga burimi i quajtur "Lipovica" (furnizohet një pjesë e Lagjes Gacafer, 7 shtëpi). Është njeri nga burimet me të vjetra, gjegjësisht 40 vjet i vjetër. Ky burim ka kapacitet të furnizimit 6-16 l/sec. Nga ky burim nuk ka reduktime të furnizimit me ujë.
- Nga burimi në Shkozë (furnizohet e tërë Lagja "Agim Ramadani" dhe një pjesë e Lagjes së Shalajve, Gaxherr dhe "Dëshmorët e Kombit", rreth 1500 banorë).

Burimi Vrella e Goçit është burimi më aktiv, përderisa dy burimet tjera janë të vjetra dhe kanë kapacitet më të vogël furnizimi. Nevoja elementare për kokë banori në Junik është 200 l/ditë. Në të ardhmen e afërt, parashihet që të rritet sasia e furnizimit me ujë edhe nga burimet tjera ekzistuese të cilat tash nuk shfrytëzohen. Burim tjetër që do të mund të shfrytëzohet në të ardhmen është Vrella e Livadhit të Madh e cila ka kapacitet për të mbuluar edhe fshatrat Jasiq dhe Gjocaj.

#### 2.3.3 (b). Rrjeti i kanalizimit fekal dhe atmosferik

Rrjeti i ujërave të zeza është në ndërtim e sipër dhe ka filluar të funksionojë pjesërisht. Ky rrjet nuk e mbulon gjithë territorin e banuar të komunës. Deri më tani është ndërtuar njëri krah i kanalizimit që përfshinë mesatarisht gjysmën e qytezës kurse krahu tjetër që përfshin edhe pjesën tjetër të qytezës pritet të përfundojë në vitet në vijim duke përfshirë këtu edhe rrjetin e kanalizimit në lagjet tjera. Pasi të përfundojë edhe kjo pjesë e kanalizimit, atëherë, Qyteza e Junikut do të ketë tërë rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza. Ky projekt është i pari në Kosovë që mundëson filtrimin primar të ujërave të zeza me standarde evropiane dhe uji nga trajtimi i ujërave të zeza mund të shfrytëzohet për ujitjen e tokave. Në kuadër të këtij projekti është paraparë edhe ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza, për realizimin e të cilit pritet ndihmë nga Komisioni European. Rrjeti i kanalizimit në fshatra nuk ekziston dhe derdhja e ujërave të zeza nga 7 familjet që jetojnë atje bëhet në natyrë. Në të ardhmen duhet të mendohet për zgjidhjen e këtij problemi.

---

<sup>10</sup> Burimi: Strategjia e Zhvillimit Lokal (2009)

### **2.3.3 (c). Sistemi i ngrohjes**

Ngrohja në Junik nuk kryhet me një sistem qendror, por, operon në baza individuale dhe kryhet në masë të madhe me lëndë drurore dhe energji elektrike. Kjo natyrisht që ka pasoja në humbjen e masës drurore në pyjet e Junikut dhe ndotjen e mjedisit.

### **2.3.3 (d). Menaxhimi i mbeturinave**

Në komunën e Junikut, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave urbane dhe i pastrimit të rrugëve kryesore kryhet nga ndërmarrja publike "Higjiena" nga Deçani, e cila nuk e ka shtrirë aktivitetin e saj në të gjitha vendbanimet. Ky shërbim kryhet në masë të caktuar, pra, jo të plotë dhe ofrohet kundrejt një detyrimi financiar. Ky fakt, ka bërë që pjesa tjetër që nuk e ka këtë shërbim t'i hedhë mbeturinat buzë lumit apo në vende të tjera të ngjashme (përfshirë edhe tokën bujqësore) ku krijohet një ambient i papastër. Tash për tash grumbullimi i mbeturinave bëhet në disa kontejner që janë të vendosur në disa vende të caktuara, ku dy herë në muaj bëhet pastrimi i tyre nga ndërmarrja e cekur më lartë. Deponimi i mbeturinave bëhet në deponinë qendrore rajonale në fshatin Sferkë/Klinë. Juniku tani ka një deponi të mbeturinave inerte në të cilën nuk bëhet riciklimi i mbeturinave dhe deponinë joformale në afërsi të lagjes,, Agim Ramadani" ku bëhet hudhja e mbeturinave.

Një gjendje e tillë, ka ardhur si pasojë e menaxhimit të dobët të mbeturinave nga ndërmarrja publike, mungesa e lokacionit adekuat për deponi. Në të ardhmen, pritet që me kalimin e këtij shërbimi në kompetenca të komunës së Junikut, situata në këtë shërbim të përmirësohet. Komuna planifikon pasi të jetë e lejuar me ligj, të formojë Ndërmarrjen Komunale për pastrimin e qytezës me rrethinë.

### **2.3.3 (e). Furnizimi me energji dhe rrjeti energjetik**

Furnizimi me energji elektrike në komunën e Junikut është i dobët dhe natyrisht këtë e vështirëson edhe rrjeti i vjetruar energjetik. Shërbimi i furnizimit me rrymë kryhet nga Korporata Elektroenergjitike e Kosovës (KEK). Sipas një informacioni të marrë nga KEK, Divizioni i Rrjetit, Distrikti Pejë, dalja 10 kV e Junikut për momentin furnizohet nga linja TS 35/10 kV që vjen nga Lluka e Epërme në Deçan e cila furnizon 12 njësi të kësaj zone përfshirë qytezën e Junikut, Gjocajt dhe Jasiqin. Në aspektin energjetik kjo dalje 10 kV bën pjesë në daljet më të mbi ngarkuara dhe gjendja teknike e saj është e paqëndrueshme. Si rrjedhojë e kësaj në realizim e sipër është projekti për shkarkimin e kësaj daljeje.


Infrastruktura e rrjetit elektrik të nivelit të TU 0.4 kV është tërësisht në gjendje jo të mirë teknike duke përfshirë edhe vetë qendrën e Junikut. E tëra është linjë ajrore me shtylla të drurit dhe shumë të vjetruara sikurse edhe trafostacionet e mbingarkuara të cilat nuk i kënaqin kërkesat e konsumatorëve. Situata me furnizim do të përmirësohet me përmirësimin e rrjetit dhe trafove ekzistuese si dhe ndërtimin e trafos së re ne lagjen Qok (projekt në realizim e sipër). Meqenëse, ky lokalitet është në rritje dhe në ndërtim e sipër është e nevojshme që këto rrjete elektrike ekzistuese të zëvendësohen me rrjete të reja kabllore nëntokësore me një infrastrukturë të harmonizuar sipas standardeve më të reja për të evituar rreziqet e mundshme dhe ofruar furnizim kualitativ. Nëse në të ardhmen e afërt do të realizoheshin edhe projektet e ndërtimit të hidrocentraleve (shih kaptinën 2.5 zhvillimi ekonomik: sektori i energjisë), kjo do të ndikonte në furnizim më të mirë me energji, krijonte lehtësi në ngarkesën e rrjetit si dhe kursim të energjisë.

### 2.3.3 (f). Rrjeti i telekomunikimit dhe internetit

Rrjeti i radio televizionit ekziston dhe funksionon, por jo dhe ai kabllovik. Rrjeti i telefonisë dhe internetit funksionon dhe operohet nga operatorët PTK dhe IPKO. Nga të dhënat e PTK dhe IPKO, aktualisht në komunën e Junikut ka 420 kyçje në rrjetin e telefonisë dhe internetit. Duke marrë parasysh aspiratat për zhvillimin e turizmit, padyshim që teknologjia informative dhe krijimi i një shoqërie informative ka rëndësi të madhe, ndaj investimet në zgjerimin e shtrirjes së rrjetit të telekomunikimit janë të nevojshme.

Përfundim: Përkundër investimeve të bëra në përmirësimin e shërbimeve publike, në Junik ende ka nevojë për investime të mëdha për të arritur mbulueshmëri më të mirë. Rrjeti i ujësjellësit është në gjendje mesatarisht të mirë (97% e banorëve furnizohet me ujë të pijes). Në Jasiq dhe Gjocaj rrjeti nuk është i organizuar (banorët furnizohen me ujë nga burimet natyrore). Rrjeti ende i pakompletuar i kanalizimit, mungesa e ofrimit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave dhe funksionimit të këtij shërbimi në tërësi, intervenimet e nevojshme për përmirësimin e rrjetit të vjetër furnizues me energji elektrike dhe shfrytëzimin e potencialit për zhvillim të energjisë alternative si dhe zhvillimin dhe rritjen e shfrytëzueshmërisë së teknologjisë informative si komponentë e rëndësishme në zhvillimin e turizmit janë sfida të kësaj fushe.

Harta 6: Harta e shërbimeve publike



## 2.4 SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI

### 2.4.1. Shfrytëzimi i tokës

Nga sipërfaqja prej 7777 Ha, sa ka komuna e Junikut, afërsisht 3197 Ha (41%) janë pyje dhe 4277 Ha (55%) janë tokë bujqësore (këtu përfshihen 653 Ha arë, 648 Ha livadh, 253 Ha pemishte, 2667 Ha kullosa dhe 56 Ha vreshta) ndërsa 4% janë të tjera (rrugë, përrenj, lumenj, objekte ndërtimi, varreza etj)<sup>11</sup>. Juniku ka tokë bujqësore të konsiderueshme për kokë banori. Kalkulimet në nivel të Kosovës tregojnë se çdo vit humbet rreth 5000 Ha tokë bujqësore (kjo e dhënë nuk dihet saktë në komunën e Junikut). Evidente janë vetëm faktet vizuale që tregojnë se toka bujqësore në Zonën Urbane po humbet nga fragmentimi i parcelave (oborreve të shtëpive), ndërtimet, ndotjet e ndryshme etj.

Shikuar nga aspekti morfologjik, sipërfaqja e komunës së Junikut përbëhet nga disa njësi funksionale me karakteristika të ndryshme (shih hartën 6).

1. Njësia Urbane /e Banimit /
2. Njësia Fushë
3. Njësia Pyje
4. Njësia Bjeshkë

**1. Njësia Urbane /e Banimit/ dhe funksioneve administrative-shërbyese:** Ndodhet në lartësi mbidetare prej 450-600 m dhe përfshinë Zonën Urbane me 520 Ha. Është zonë administrative, arsimore, banuese, e shërbimeve sociale dhe atyre ekonomike-tregtare. Të dhënat nga PZHU tregojnë se pjesa më e madhe e sipërfaqes së kësaj njësie është zonë e gjelbërt dhe banimi (rreth 504 Ha) kurse pjesën tjetër e zënë funksionet ekonomike-tregtare, shërbimet sociale dhe të servisimit. Tipi i objekteve të banimit është individual me oborre të mëdha brenda së cilave zhvillohen edhe aktivitete tjera bujqësore, depozitimit të materialeve, etj (shih më gjerësisht kaptinën e banimit). Aktualisht struktura e prodhimit bujqësor në këtë zonë dominohet nga kultura e misrit dhe e grurit që së bashku zënë rreth 40% të sipërfaqes së tokës së punueshme ,kurse, pjesa tjetër është livadh.

**Analiza e pronësisë:** Pronësia: private, shoqërore (nën menaxhimin e AKP-së) dhe komunale.

Numri i konsiderueshëm i pronave komunale (Juniku ka 159 324 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja urbane<sup>12</sup>) është parë si një potencial i mundshëm për të investuar në krijimin e hapësirave publike.

Pjesa më e madhe e pronave në këtë njësi është në pronësi private (S=5 059 085 m<sup>2</sup>) dhe karakterizohet me forma të çrregullta me parcela të formave dhe madhësive nga më të ndryshmet. Brenda territorit të qendrës mund të dallojmë parcela minimale 200-300 m<sup>2</sup> dhe maksimale 6000-7000 m<sup>2</sup>.

Pronat nën AKP (S=227 571 m<sup>2</sup>) janë ish- pronat e ndërmarrjeve shoqërore në proces ndërrimi të pronësisë. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht përgjatë lumit Erenik dhe në pjesën veriore të qendrës. Për vetë statusin transitor që përfaqëson ky tip pronësie, mund të paraqesin potencial për përdorim për shërbime dhe hapësira publike.

**2. Njësia Fushë:** Kjo zonë përfshinë parcelat në jug-lindje të Junikut dhe ndodhet në lartësi mbidetare prej 450-600 m. Prania e peisazheve hidrografike të lumejve Erenik dhe Travë si dhe ato fushore paraqesin një mundësi të shfrytëzimit të kësaj zone për sport e rekreacion, hapësira publike, turizëm, zhvillimin e aktiviteteve ekonomike-tregtare etj. Për shkak të plleshmërisë së tokës, poashtu kjo zonë ofron potencial për kultivimin e kulturave bujqësore si dhe për kullosa.

**Analiza e pronësisë:** Pronësia në këtë zonë është kryesisht private.

<sup>11</sup> Sipas Elaboratit Kadastral të Komunës (1983)

<sup>12</sup> Burimi: PZHU i Junikut

**3. Njësia Pyje:** Zona e pyjeve përfshin një territor përafërsisht prej 3400 Ha. Në kuadër të kësaj zone ndodhen dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj që aktualisht janë gati të depopulluara. Për shkak të karakteristikave morfologjike, kjo zonë shfrytëzohet për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale, pemëtarisë, bujqësisë dhe poashtu paraqet potencial për zhvillimin e turizmit e sidomos atij rural.

Analiza e pronësisë: Pronësia në këtë zonë është e përzier (shoqërore dhe private)

**4. Njësia Bjeshkë:** Kjo zonë përfshin një sipërfaqe të madhe (rreth 4.000 Ha) dhe shtrihet në lartësi mbidetare mbi 2500 m. Është zonë e zhveshur ndaj edhe nuk ka mundësi për kultivimin e kulturave vegjetative. Ajo që e bën karakteristike këtë zonë është pika më e lartë e Gjeravicës. Duke marrë parasysh këto karakteristika, kjo zonë mund të shfrytëzohet për kullosa dhe zhvillimin e turizmit malor (sidomos alpinizmit).

Analiza e pronësisë: Kryesisht shoqërore

#### **2.4.2 Kategorizimi i tokës bujqësore të kulturës arë <sup>13</sup>:**


Toka bujqësore e kulturës arë (gjithsej 653 Ha) është e klasifikuar si vijon:

**Tabela 12: Kategorizimi i tokës bujqësore të kulturës arë:**

Kategoria	Ha
Kategoria I	32
Kategoria II	116
Kategoria III	181
Kategoria IV	40
Kategoria V	265
Kategoria VI	14
Kategoria VII	5
Total	653

<sup>13</sup> të dhënat kadastrale komunale


Harta 7: Shfrytëzimi i tokës



### 2.4.2.Vendbanimet/struktura e tyre

Komuna e Junikut ka tri vendbanime: qytezën e Junikut dhe dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj. Zona urbane e Junikut ka sipërfaqe prej 520 Ha dhe ndodhet në terren me pjerrësi të vogël e cila ndërpritet nga përrenj të vegjël (jaze) që sjellin ujin nga lartësitë dhe e shpërndajnë në fushë. Si elemente identifikuese të zonës urbane janë lumi i Erenikut dhe Travës . Nga ana jug-lindore ky element vjen dhe zgjerohet në formën e një hinke, formë të cilën e thekson edhe më shumë relievi kodrinor i përbërë nga kodrat periferike të Moronicës dhe Rogopecit. Me të drejtë qyteza e Junikut konsiderohet “qytezë e mbështjellë nga natyra”. Rritja urbane është vërejtur të ndodhë përrreth disa bërthamave, që aktualisht janë edhe qendrat e lagjeve të sotme me origjinë fisnore. Qyteza e Junikut ka gjithsej 12 njësi urbane nga të cilat 10 njësi janë të banuara ndërsa 2 prej tyre janë zona natyrore dhe bujqësore (informacione më të hollësishme për tipologjinë, strukturën dhe funksionet e këtyre njësive urbane ofrohen në PZHU). Kjo bën që Juniku të konsiderohet si *vendbanim policentrik (shih figurën 2)*. Mund të përjashtohet vetëm

njësia Gacafer, e cila ka një shtrirje lineare të orientuar kah lumi i Erenikut. Me kalimin e viteve shtrirja e këtyre njësive tenton në një bashkim të tyre, por, që akoma nuk është bërë i mundur për shkak të hapësirave të gjelbërta që ekzistojnë mes tyre të cilat edhe sot përdoren për kullota apo prodhime bujqësore.



njësia Gacafer, e cila ka një shtrirje lineare të orientuar kah lumi i Erenikut. Me kalimin e viteve shtrirja e këtyre njësive tenton në një bashkim të tyre, por, që akoma nuk është bërë i mundur për shkak të hapësirave të gjelbërta që ekzistojnë mes tyre të cilat edhe sot përdoren për kullota apo prodhime bujqësore.

Fshatrat Jasiq dhe Gjocaj të shtrira në sipërfaqe prej 308 Ha ,janë gati plotësisht të zbrazëta nga popullata me vetëm 7 shtëpi të banueshme<sup>14</sup>. Vendosja e popullatës nga këto dy vendbanime është bërë kryesisht në lagjen “Agim Ramadani”. Arsytet pse banorët e këtyre dy fshatrave janë larguar plotësisht duke lënë këto vendbanime me gjithsej disa shtëpi të shfrytëzuara shpjegohen me zhvendosjen nga lufta e fundit; mungesën e infrastrukturës fizike dhe sociale në këto vendbanime; kërkimin e kushteve më të mira të jetesës në qytet; dhe më problematikja është që në këto vendbanime ende ekziston rreziku i minave. Kjo bën që pjesa e madhe e popullatës së komunës së Junikut (rreth 79%) jetojnë në zonën urbane të Junikut.

**Vendbanimet joformale:** Ligjit për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor (2008) neni 2, vendbanimet joformale (VJF) nënkuptojnë ato vendbanime të cilat karakterizohen me:

1. Zotërim joformal të pronësisë,
2. Qasje joadekuate ose privim në shërbimet elementare
3. Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje dhe
4. Rrezikueshmërinë e lartë për banorët që jetojnë në atë vendbanim

<sup>14</sup> Sipas të dhënave nga ESK (2009)

Rregullimi i vendbanimeve joformale është poashtu edhe një çështje prioritare sipas Planit të Veprimit 2008 për implementimin e partneritetit Evropian për Kosovën.

Në kontekstin e Junikut, komuna ka të miratuar PZHU-në si dhe Planin Rregullues Urban “Qendra e Junikut”. Projektet e parapara për realizim që rrjedhin nga këto plane, e që një pjesë e tyre është realizuar apo dhe janë në realizim e sipër tentojnë të sigurojnë kushte më të mira për jetesë për banorë dhe pjesëmarrje në qeverisje; sigurimin e pronës dhe përmirësimin dhe ofrimin e një qasje të mirëfilltë në infrastrukturë edhe pse me një pjesë të këtyre shërbimeve komuna e Junikut është në pozicion më favorizues krahasuar me komunt tjera në Kosovë.

Për t’i sqaruar më mirë dilemat rreth identifikimit të vendbanimeve joformale, është mbajtur një takim konsultativ me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Duke marrë në konsideratë karakteristikat e mësipërme në kontekstin e Junikut është vërejtur se vendbanimi i ashtuquajtur Lagja “Agim Ramadani”, mund të konsiderohet si Vendbanim Joformal meqë ka të bëjë me zotërim joformal të pronësisë. Kjo lagje zë një sipërfaqe diku rreth 14,13 Ha me gjithsejtë 142 objekte ndërtimore të cilat zënë sipërfaqe prej 13 290 m<sup>2</sup> dhe rreth 720 banorë. Objektet janë pronësi shoqërore dhe aktualisht menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) dhe janë kryesisht objekte banimi me etazhitet P+1. Lagja ka infrastrukturë teknike (ujësjellës, kanalizim, telefoni fikse) dhe qasje në infrastrukturën sociale (shkolla, QMF etj.) në parametra të pranueshëm. Për këtë vendbanim, komuna do të fillojë trajtimin ashtu siç është paraparë me udhëzimet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Trajtimi i këtij VJF lidhet ngushtë me aspektin e sigurisë dhe rindërtimit të shtëpive të dëmtuara gjatë luftës në vendbanimet e tyre origjinale. Kjo për arsyen se ende këto vendbanime nuk janë pastruar plotësisht nga minat dhe për këtë shtëpitë e banorëve atje ende kanë mbetur të pa rindërtuara.

### **2.4.3 Banimi dhe ndërtimet**

Komuna e Junikut, sipas të dhënave të Entit Statistikor<sup>15</sup>, ka gjithsej 1.427 objekte ndërtimi në Zonën Urbane dhe 38 objekte në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj. Të dhënat më të hollësishme në lidhje me banimin në Zonën Urbane ofrohen nga PZHU, sipas të cilit zona e banimit në zonën urbane zë sipërfaqe prej 121,99 Ha apo 23% të sipërfaqes urbane. Përderisa në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj sipas të dhënave të regjistrimit 1981, banimi zë sipërfaqe prej rreth 36 Ha.

**Lloji dhe tipologjia e objekteve të banimit:** Objektet e banimit që dominojnë në Junik janë ato të tipit individual dhe të rrethuara me oborr përkatës i cili ka hapësirën e mjaftueshme për të organizuar brenda tij edhe funksione tjera përveç atij të banimit si p.sh bujqësisë dhe blegtorisë, parkimit, depozitimit të produkteve etj.

Në kuadër të objekteve të banimit, komuna e Junikut ka edhe numër të konsiderueshëm të objekteve që prezantojnë vlera të trashëgimisë kulturore (sidomos kullat dhe shtëpitë e gurit- të elaboruara më gjerësisht në pjesën e trashëgimisë kulturore). Gjendja aktuale e tyre nuk është e mirë për shkak të intervenimeve që janë bërë në to me qëllim të përmirësimit të kushteve të banimit por edhe nga shkatërrimet gjatë luftës me ç’rast është humbur krejtësisht edhe një pjesë e tyre. Prandaj ruajtja dhe mbajtja e tyre në funksion të banimit, paraqet një aspekt sfidues.

**Etazhiteti:** Etazhiteti në 96% të objekteve sillet prej 1-3 etazhe (prej kësaj 58% janë shtëpi njëkatëshe, 33% shtëpi dy-katëshe dhe 9% shtëpi tre-katëshe). Komuna e Junikut aktualisht nuk disponon me banesa të tipit kolektiv. Kjo për arsye se komuna ka ende sipërfaqe të lira brenda parcelave të banimit si dhe për arsye se ende zhvillohet mënyra e jetës tradicionale në familje të mëdha. Marrë parasysh që trendet aktuale po tregojnë tendenca të zvogëlimit të ekonomive familjare dhe nga ana tjetër sipas trendit të rritjes së popullsisë në nivel të Kosovës prej 1.4% (Juniku në vitin 2023+ pritet të ketë popullsi me rreth 8700 banorë (përfshi diasporën)

---

<sup>15</sup> ESK (2009), Rifreskimi I të dhënave në terren tetor 2008-Prill 2009

respektivisht popullsi rezidente rreth 6600 banorë), kjo nënkupton se ka nevojë për rritjen e fondit të banimit. Analizat e bëra nga PZHU, rekomandojnë dendësim të banimit në kuadër të sipërfaqeve ekzistuese të lagjeve (nuk rekomandohet ndërtim i lartë). Dendësimi parashihet kryesisht në zonën qendrore të Junikut, me një koeficient të banimit dhe ndërtimit prej 45%, që mundësohet jo me rritjen e etazhitetit (sepse ai duhet të mbetet jo më shumë se 3 kate), por arrihet me shfrytëzimin e hapësirave të pashfrytëzuara në kuadër të parcelës apo të përdorura për funksione tjera shërbimi. Kjo poashtu nënkupton se pjesa e banimit (sidomos përdhesa) do të mund të shfrytëzohet për aktivitete ekonomike. Në zonat periferike nga qendra urbane, PZHU propozon një dendësim të lehtë me koeficient ndërtimi prej 35% pra për 5% më i lartë se ai ekzistues.

**Ndërtimet pa leje:** Sikurse në gjithë Kosovën, edhe në Junik fenomeni i ndërtimeve pa leje është prezent sidomos në zonën urbane. PZHU (paragrafi 5.2.11) sugjeron zhvillimin e një vlerësimi mbi ndërtimet pa leje, krijimin e bazës së të dhënave me informatat për secilën ngastër në lidhje me statusin formal të ndërtimit apo posedimit të lejes dhe tutje përcaktimin e kriterëve për legalizim apo mos-legalizim. PZHU poashtu propozon hartimin urgjent të PRRU me prioritet në zonat ku ka rritje dhe ndërtim të pakontrolluar.

**Depopullimi:** Një problematikë në vete paraqet boshatisja e shtëpive në dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj dhe zhvendosja e popullsisë në zonën urbane (lagjen “Agim Ramadani”). Aktualisht, në këto dy fshatra jetojnë vetëm 7 familje. Kthimi i popullsisë në këto dy vendbanime është i lidhur ngushtë edhe me investimet në infrastrukturën fizike dhe sociale si dhe eliminimin e rrezikut të minave i cili është ende prezent në këtë zonë.

Përfundim: Gjendja e Junikut sa i përket banimit është relativisht e mirë. Kërkesa për sipërfaqe të reja të banimit nuk është dhe aq e madhe meqenëse ka mundësi të rritjes së dendësisë së banimit në kuadër të zonës urbane duke plotësuar hapësirat boshe në zonat e ndërtuara ekzistuese (ashtu siq është paraparë me PZHU). Shtimi i fondit të banimit duke pasur kujdes në mos-humbjen e fondit të tokës bujqësore (sidomos asaj të kategorisë I-IV që mbrohet me ligj) si dhe duke tentuar që tipologjitë ekzistuese tradicionale të banimit e që janë karakteristike për Junikut të ruhen është një aspekt sfidues.

Dihet që Komuna e Junikut posedon një fond të konsiderueshëm të objekteve të banimit me veçori të trashëgimisë kulturore, me kullat si objekte banimi ekzistenciale tipike shqiptare (shih më gjerësisht kaptinën trashëgimia kulturore), prandaj ruajtja, shfrytëzimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre është poashtu sfidë në vete.

Depopullimi i vendbanimeve Jasiq dhe Gjocaj paraqet një sfidë, zgjidhja e së cilës është mjaft komplekse, meqë ndërthet në vete gërshetimin e shumë aspekteve të zhvillimit atij social, ekonomik, infrastrukturor dhe atë të sigurisë (për shkak të prezencës së minave). Ofrimi i kushteve më të mira për jetesë, banorëve në këto vendbanime në mënyrë që t’u mundësohet kthimi i tyre në shtëpi (pronat e veta do të duhej të jenë një ndër synimet dhe prioritetet strategjike të Komunës).



## 2.5 MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA NDOTJA, DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

*Shënim: Në mungesë të të dhënave dhe parametrave të saktë mbi monitorimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës (meqë në Junik nuk ka stacion për monitorim të ndotjes) për bazë janë marrë informatat e komunës bazuar në raportet dhe njohuritë lokale.*

### 2.5.1 Gjendja mjedisore:

Gjendja e mjedisit në komunën e Junikut, sa i përket ndotjes mund të thuhet në përgjithësi se është relativisht e mirë. Aktivitete ndotëse industriale nuk ka.

**Ndotja e ajrit:** vjen kryesisht nga qarkullimi i automjeteve dhe pluhuri për shkak të rrugëve të pa asfaltuara.

**Ndotja e ujit:** vjen si pasojë e hudhjes së mbeturinave në lumin Erenik si dhe përgjatë bregut të tij por edhe te lumi Trava ku ka depozitim të mbeturinave në afërsi të lagjes “Agim Ramadani” (shih hartën 7). Ujërat e kanalizimit nga ekonomitë familjare derdhen në ujëra sipërfaqësore ose nëntokësore pa trajtim adekuat. Në përgjithësi, këto shkarkime shkaktojnë degradim të mjedisit në resurset ujore.

**Ndotja e dheut:** vjen kryesisht si pasojë e derdhjes së ujërave të zeza në natyrë, lumenj e jaze. Me përfundimin e sistemit të rrjetit të kanalizimit që është në ndërtim e sipër, situata pritet të përmirësohet.

### 2.5.2 Zonat e rrezikuara nga degradimi i mjedisit, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Sikurse edhe në gjithë Kosovën, edhe në Junik vërehen dukuri negative si dhe prezencë e fatkeqësive natyrore që përfundojnë me pasoja ekologjike, ekonomike dhe sociale.

**Prerja e pyjeve:** Në pyjet e Junikut dukuria e prerjes së drunjeve është prezente sidomos e shprehur tek pyjet në sektorin publik (në lokacionet Stanishtë e Goqit, Zharrë, Gradinë). Pasojat nga kjo, përveç humbjes së masës drurore, paraqiten edhe në çrregullimin e ekosistemit, prishjen e peisazhit, paraqitjen e erozionit në këto zona etj. Komuna nuk posedon të dhëna se sa janë humbjet e masës drurore nga prerja e pyjeve, meqë me pyjet aktualisht menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës. Një brengë tjetër që ka të bëjë me shkatërrimin e pyjeve është edhe prezencja e insekteve të rrezikshme dhe epidemisë që ka prekur drurin e gështenjës (40% e gështenjave janë të sulmuara nga i ashtuquajturi kancer i



gështenjës). Shpresohet se tani me kalimin e kompetencave në menaxhimin e pyjeve tek institucionet lokale situata në terren të menaxhohet më mirë dhe të pengohet degradimi i pyjeve.

**Erozioni:** Zonat erozive ku intensiteti është më i madh e të cilat duhet të kenë trajtim të veçantë janë ato zona ku ka prerje të pyjeve ilegale të drunjve (sipas informatave të *Burimi:MMPH/AKMM,2007: Raport mbi gjendjen e natyrës* komunës prerja ilegale nuk bëhet nga banorët e komunës se Junikut por nga banorët e komunave të tjera përreth që kufizohen me Junikun). Rreziku nga erozioni është prezent edhe në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj ku ka rrëshqitje të dheut (informata këto nga banorët se nuk ka studime të bëra për këtë zonë) si dhe në sipërfaqet afër brigjeve të lumejve (shih hartën 7). Një shkaktar i erozionit në tokat e zhveshura dhe të pjerrëta janë reshjet e vjeshtës nënkuptohet kur ato janë të furishme. Zonat erozive ku intensiteti është më i madh duhet të kenë trajtim të veçantë. Parandalimi i aktiviteteve erozive kërkon marrjen e masave konkrete si: ndalimi i prerjes së pyjeve, zëvendësimi i drunjve të prerë me mbjelljen e fidaneve të reja, ndalimi i shfrytëzimit të materialeve inerte që shkaktojnë erozion, etj.

**Vërshimet:** Lumi Erenik është lumë shumë i shpejtë dhe paraqet rrezik të vërshimit. Sasia e ujit në lumin Erenik rritet sidomos në muajt mars, prill, maj nga shkrirja e borës, kurse në muajt tetor dhe nëntor nga reshjet e shiut dhe kjo paraqet mundësinë e daljes së lumit nga shtrati. Vërshimi i fundit me përmasa të mëdha ka qenë në vitin 1979 si dhe këto të fundit të vitit 2010.

Faktor tjetër që shkakton vërshim janë edhe aktivitetet e nxitura nga njeriu sidomos nxjerrja e rërës nga lumejtë. Nxjerrja e rërës nga lumi Erenik bëhet në vendin e quajtur te Prita e Katundit.

Fatmirësisht, në komunën e Junikut nuk ka dhe shumë ndërtime afër shtratit të lumit, megjithatë kjo nuk nënkupton mosmarrjen e masave për parandalimin e vërshimit dhe mbrojtjen nga ai në rast rreziku. Në të ardhmen kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet rregullimit të shtratit të lumejve me qëllim parandalimi të daljes së tyre nga shtrati.

**Tërmetet:** Nga pikëpamja sizmike, pjesa më e madhe e territorit të Kosovës konsiderohet si zonë me rrezik sizmik mesatar ( $0.0g < PGA^{16} < 0.24g$ )<sup>17</sup>. Sipas të dhënave probabiliteti i tërmeteve në Kosovë është një dridhje prej 5-8 shkallë të Rihterit që ndodh pas një periudhe të caktuar përafërsisht 50-80 vite. Juniku, bën pjesë në rajonin me aktivitet sizmik prej 6-7 shkallë të Merkalis parametër ky që tregon se duhet marrë me seriozitet marrjen e masave mbrojtëse ndaj tërmeteve (në ndërtimet e reja). Tërmeti i fundit në komunën e Junikut ishte ai i vitit 1985.

**Zjarret:** Në Kosovë zjarret janë dukuri e shpeshtë. Në periudhën prej vitit 2000-2008, në Kosovë kanë ndodhur përafërsisht 15.077 zjarre që kanë djegur përafërsisht 7 632 Ha në sipërfaqe malore dhe fushore. Shumica e tyre kanë pasur intensitet të madh. Zonat e përfshira nga zjarret në Kosovë, përfshirë edhe Junikun janë paraqitur në ilustrimin 4, të dhëna këto nga Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave i Ministrisë së Punëve të Brendshme (2007). Në Junik<sup>18</sup>, në dhjetëvjeçarin e fundit ndodhja e zjarreve është shtuar si në numër e po ashtu edhe në sipërfaqen e prekur (shih kutinë 3-Statistikat e zjarreve) duke shkaktuar dëme në njerëz dhe të mira materiale. Numri më i madh i zjarreve është në pyje, fusha e ngastra bujqësore.

Shkaqet e zjarreve janë në radhë të parë me karakter: Antropogjenik (pakujdesia e njerëzve), djegia për kullota; vënia e zjarreve me qëllim e interesa personale dhe si dhe shkaqet natyrore (kushtet klimatike p.sh. temperaturat e larta etj). Duke marrë parasysh dhe faktin që viteve të fundit një numër i konsiderueshëm i banorëve të zonave afër pyjeve dalin në stane me bagëti gjithashtu edhe një pjesë e popullatës dalin për

<sup>16</sup> PGA-Nxitimi Horizontal Maksimal i Truallit

<sup>17</sup> MEM, Departamenti i Minierave, Divizioni i Sizmologjisë

<sup>18</sup> Komuna e Junikut (2009), Projekt Plani i Mbrojtjes nga Zjarri

rekreacion dhe pushime, kjo shton edhe rrezikun për shëndetin publik të banorëve nga zjarri si dhe dëme ekonomike e mjedisore, gjithashtu, muajt: mars, prill dhe korrik, gusht janë muajt që paraqesin muajt me rreziqe më të mëdha ndaj zjarrit.

**Kutia 10: Statistikat e zjarreve në Komunën e Junikut gjatë viteve 2003-2007**

**Numri i përgjithshëm i zjarreve të raportuara gjatë periudhës 2003**

**– 2007 është 40. Nga këto:**


- Zjarre në objektet e banimit familjar = 5 raste
- Zjarre në trafostacionet për shpërndarjen e rrymës elektrike dhe në ormanët e rrymës elektrike = 4 raste
- Zjarre në automjete të udhëtarëve = 2 raste
- Zjarre në deponitë e mbeturinave = 7 raste
- Zjarre në pyje, fusha, ngastra bujqësore, ushqim i thatë kafshëve = 22 raste

**Pasojat në viktimat njerëzore:**

- Viktima nga zjarret janë shënuar 2 raste
- Të plagosur nga zjarret janë shënuar 3 raste

*Burimi: Projekt Plani për Mbrojtjen nga Zjarri për Komunën e Junikut, 2009*

**Figura 4: Vlerësimi i rreziqeve nga zjarret**



Komuna e Junikut në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike ka themeluar: Njësinë e Zjarrfikjes që operon me një zyrtar për shpëtim dhe tre zjarrfikës. Detyra kryesore e kësaj strukture është kontrolli i zbatimit të ligjit dhe rregulloreve për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri. Duke iu referuar edhe obligimeve që dalin nga Legjislacioni, komuna e Junikut është në proces të hartimit të Planit të Mbrojtjes nga Zjarri i cili është pjesë përbërëse e Planit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit të komunës, dokument ky që pritet të hartohet sipas udhëzuesit të dhënë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

**Ndryshimet klimatike:** Edhe pse, nuk ka studime dhe analiza në këtë problematikë efektet e ndryshimeve klimatike janë të dukshme. Gjatë 2 dekadave të fundit në gjithë globin janë vënë re ndryshime të motit me rritje të temperaturave, pakësimin të reshjeve dhe përmbytje nga uji apo edhe thatësira. Parashikimet globale<sup>19</sup>, shprehin se reshjet e shiut në verë do të pakësohen me 10% (deri në 2020) dhe me 20% (deri në 2050), ndërsa temperaturat pritet të ngriten prej 1,4 deri 5,8 °C deri në vitin 2100. Të gjitha këto janë shenja të ndryshimeve klimatike të përshpejtuara ose siç quhet ndryshe, të ngrohjes globale. Padyshim që as Kosova, dhe në këtë rast komuna e Junikut, nuk i shpëton prekjes nga ky fenomen me ndikim direkt mbi gjithë sektorët e zhvillimit, e sidomos në bujqësi, turizëm dhe prodhim të energjisë, dhe si rezultat edhe mbi jetën e banorëve. Efektet e ndryshimeve klimatike janë të dukshme. Shfrytëzimi i veturave, prerja e drunjve për djegie më tepër se sa që mbillen janë dukuri gjatë të cilave shkaktohet tepriçë e karbon dioksidit në ajër. Një prej arsyeve se pse shfrytëzohen më shumë drunjtë për nxemje është se nuk ekziston sistemi i ngrohjes qendrore në Junik. Problemi tjetër është furnizimi i dobët me energji elektrike në Junik dhe rrjeti i vjetër elektrik, që më tepër ka ndërprerje të rrymës dhe që rezulton në shfrytëzimin e dizel gjeneratorëve dhe drunjve për ngrohje.

Juniku ka potencial të pa përdorur në krijimin e energjisë alternative dhe burimeve të tjera natyrore, të cilat mund të ndryshojnë për të mirë dhe minimizojnë efektet nga ndryshimet klimatike. Ministria e Energjisë dhe

<sup>19</sup> (Burimi: The Intergovernmental Panel on Climate Change, cituar ne [www.bbc.co.uk](http://www.bbc.co.uk), hapur me 26/01/10).

Minierave (MEM) ka hartuar një studim parafizibiliteti mbi identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla në Kosovë (2006), ku tre prej këtyre hidrocentraleve gjenden në komunën e Junikut.<sup>20</sup>

Nga ana tjetër, zvogëlimi i këtyre efekteve lidhet drejtpërdrejt edhe me ndërgjegjësimin dhe mënyrën e sjelljes së Qeverisë, sektorit privat dhe vetë qytetarëve ndaj shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe ngritjen e efijencës së energjisë.

**Minat:** Një problematikë e shprehur në komunën e Junikut dhe me ndikim edhe në zhvendosjen e popullatës nga vendbanimet është prania ende e minave në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj. Përkundër faktit që këtu janë zhvilluar shumë aktivitete deminuese, kjo zonë mbetet ende e rrezikshme për kthim të sigurtë të banorëve. Në hartë janë paraqitur zonat e minuara në Junik (të dhëna këto nga viti 2000, me vërejtjen se në hartë janë të paraqitur vetëm lokacionet e raportuara si të minuara dhe theksuar që minat mund të ndodhen edhe në lokacione të pashënuara si të minuara).

### 2.5.3 Peisazhet, resurset natyrore dhe biodiversiteti

Pozita gjeografike, relievi, malet e larta, grykat, lumenjtë, peisazhet dhe kullosat së bashku me florën dhe faunën që zhvillohet në to, paraqesin një bazë të mirë të zhvillimit të trashëgimisë natyrore për t'i mundësuar kështu komunës së Junikut të bëhet një vend atraktiv për t'u vizituar dhe zhvilluar në të ardhmen. Vet qyteza e Junikut konsiderohet si një "qytezë e mbështjellë nga natyra" për shkak se natyra depërton në pjesë të konsiderueshme të saj. Zonat që paraqiten si hapësira me vlerë të rëndësishme natyrore dhe potencial zhvillimi të turizmit janë:

**2.5.3 (a) Peisazhet:** Peisazhet hidrografike (lumenjtë Erenik dhe Travë, Jazet), peisazhet fushore (fusha e Junikut) dhe ato kodrinore apo malore (Gjeravica, Maja e Gusanit, Maja e Rupës, Rrasa e Zogut, Jedova, Moronica) paraqesin vlera të rëndësishme natyrore dhe potencial për zhvillimin e turizmit.

**Bjeshkët e Junikut** janë pjesë përbërëse e Alpeve Shqiptare (duke iu referuar raportit të MMPH mbi gjendjen në natyrë, Bjeshkët e Nemuna janë propozuar për mbrojtje<sup>21</sup> në nivel kombëtar).

Në vitin 2003, MMPH, respektivisht Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës në Prishtinë punoi "Studimin mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional" pasuar me përgatitjen edhe të projekt-ligjit për të. Pritet shumë shpejt që kjo zonë të shpallet Park Nacional. Sipërfaqja e propozuar për këtë park është afro 500 km<sup>2</sup> mirëpo deri në përkufizimin ekzakt të territorit të tij, në këtë stad të PZHK ende nuk mund të japim saktë se sa sipërfaqe e Bjeshkëve të Junikut mund të përfshihen në të. Gjendja momentale në këtë zonë, nuk është e lakmueshme për shkak të prezencës së dukurive negative (prerja e pyjeve, ndërtimi i objekteve të banimit dhe atyre hoteliere etj) të cilat po dëmtojnë peisazhin dhe biodiversitetin përrreth, ndaj dhe shpallja e kësaj zone Park Nacional, do ti kontribuonte ndalimit të këtyre dukurive negative.

**2.5.3 (b) Biodiversiteti:** Në zonën e Junikut ka lloje relikte të faunës dhe florës përfshirë edhe lloje endemike barishtore autoktone me vlera të larta shkencore dhe farmaceutike. Për shkak të faunës së zhvilluar e sidomos të shumë llojeve të shpendëve prezent, Alpet Shqiptare në kuadër të cilave përfshihen edhe Bjeshkët e Junikut, janë evidentuar në listat ndërkombëtare si l

*Burimi: Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare), MTI (2008)*

<sup>20</sup> Shoqata Shqiptare për energji të qëndrueshme dhe mjedis , Studimi i parafizibilitetit mbi identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla, MEM, Maj 2006, Kosovë

<sup>21</sup> Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Zonë e Mbrojtur e natyrës është zona e shpallur me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peisazheve, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe për ofrimin e menaxhimit efekti përmes mjeteve juridike dhe mjeteve tjera.

<sup>22</sup> MMPH (2003), studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park nacional

**Llojet e florës:** Studimet në këtë zonë kanë evidentuar këto lloje të florës të cilat janë dhe/apo duhet të përfshihen në listat ndërkombëtare për t'u mbrojtur.

Vlen të theksohen:

- Llojet autoktone të drunjve pyjor:
  - pyjet e ahut dhe bredhit (që rriten në lartësinë mbidetare 1300-1500 m)
  - Bredhi, *Arneni i Bardhë* që është endem dhe relik (rritet në Gjeravicë)
  - *Pinetum Mugo (kërleka)* që luan rol me rëndësi në ruajtjen e tokës nga erozioni rritet në lartësinë mbidetare deri 2000 m
  - në pyjet e dushkut në lartësinë



Pamja e Junikut nga Jasiqi



Biodiverzitet i pasur në Bjeshkët e Junikut



Uji i akullit dhe i kristaltë i rrjedhës së epërme të Erenikut



Gërshetim i tri stinëve

- në pyjet e dushkut në lartësinë 300-900 m dominojnë *Çarri, Shpardhi, Bunguta, Bungu, Gështenja*. Të pranishëm janë edhe *Acer Intermedium (pafti i Hirkanisë), Acer Tataricum (Ulëza), Ostrya Carpinifolia (Mëllezë)* si dhe lloje tjera si *Panja e Malit, Dardha e Egër, Qershia, Lajthia, Thana, Murrizi Njëthelbor, si dhe shumë bimë barishtore*.

Të propozuara për t'u përfshirë në Librin e Kuq të Kosovës i cili do të hartohet janë: *Gështenja, Kërleka, Arneni, Bunguta, Draba e Korabit, Gentiana Lutea (Sanëza), Zambaku Shqiptar, Cerasti Dinarik, Burgulli Maqedonas* etj.

- **Në mbrotje rigoroze** duhet të jenë: *Arneni, Kërleka, Pafti i Hirkanisë, Bangëbuta, Sanza*, etj.
- **Në kontroll të shfrytëzimit:** Në përgjithësi e gjithë flora dhe vegjetacioni i Alpeve Shqiptare është në rrezik nga shkatërrimi dhe zhdukja, prandaj komuna duhet të marr masa në parandalimin e dukurive negative të shkaktuara nga faktori antropogjen. Ndalja e prerjes ilegale të pyjeve, parandalimi i djegieve aksidentale, janë disa masa. Komuna duhet që në suaza të kompetencave të saj të ketë një kontroll të shfrytëzimit të bimësisë dhe vegjetacionit.

Llojet endemike barishtore të Ballkanit me vlera shkencore dhe farmaceutike, që gjenden në Gjeravicë janë *Draba Karabensis (Draba e Korabit) /në rrezik të zhdukjes/; Cerastinum Dinaricum (Cerasti Dinarik) /në rrezik të zhdukjes së plotë/; Sempervivum Macedonicum (Burgulli Maqedonas); Liliium Albanicum (Zambaku Shqiptar), Rumex Balcanicus (Lëpjeta e Ballkanit), Gentiana Lutea (Sanza)* etj. Burgulli Maqedonas gjendet në listën e Kuqë Evropiane, UNESCO (1991) /për shkak të rrezikut nga zhdukja/.

**Llojet e faunës** karakteristike për Alpet Shqiptare ku përfshihen edhe Bjeshkët e Junikut janë: *Iloje të Ujë tokësorëve, Zvarranikëve, Shpendëve, Gjitarët*. I regjistruar në Librin e Kuq, është *Gjeli i Egër i Madh (Tetrao Urogallus)*, që është i rralluar meqë është shumë i ndieshëm ndaj zhurmës dhe pranisë së njeriut dhe jeton në Gjeravicë. Pastaj *Bonasa Nonasia* prezente në Bjeshkët e Junikut; *Familja Accipitridae-* shpend grabitqar me disa lloje të saj por e vecuar me *Shqiponjën e Malit (Ilojin Aquila Chrysetos)* e cila ka trup të fuqishëm dhe fluturim elegant dhe një madhësi prej 76-89 cm, që jeton në malet e larta dhe shkëmbinjte e thepisur në Bjeshkët e Junikut. Në territorin e Alpeve Shqiptare, jetojnë edhe gjitarët *Ariu i Murrme* të cilit i kanoset rreziku i ekzistencës (është i ndieshëm në zhurmën e sharrave, praninë e njeriut, prerja e pyjeve, etj). Rreziku i zhdukjes i kanoset edhe *Rrëqebullit (Lynx lynx L)* sepse ajo është e ndieshme në zhurmë dhe praninë e njeriut. Në zvogëlim e sipër janë *Kaprolli dhe Dhia e Egër, Macja e Egër* etj.

Për fat të keq, menaxhimi i dobët i këtij resursi natyror shkakton probleme të mëdha në tërë habitatin e saj dhe rrezikon degradimin e mëtutjeshëm. Shpallja e Alpeve shqiptare Park Kombëtar do të krijojë kushte për ruajtjen dhe mbrojtjen e llojlojshmërisë së pasur të faunës së kësaj zone.

**2.5.3 (c) Zonat me potencial zhvillimi të turizmit natyror:** Shpatijet e përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore dhe rekrejuese (ngjitje në bjeshkë), Liqejtë e bukura të Gjeravicës, burime e rrjedha lumejsh, gryka, pyje të larta dhe një faunë e shumëllojshme e bëjnë Junikun zonë atraktive me mundësi të zhvillimit të turizmit gjatë gjithë vitit. Sipas konceptit të punuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë<sup>23</sup>, lokalitetet me potencial të rëndësishëm të zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë natyrore janë:

- Hapësira urbane me trashëgiminë kulturore (kullat, mullitë, vajavicat)
- Lokalitetin Moronica që paraqet potencial të mirë për pushim dhe rekreacion. Fauna e pasur e kësaj zone ofron mundësi për ndërtimin e një kopshti zoologjik.
- Lokaliteti Lugu i Erenikut që ofron mundësi të mira për ngritjen e një qendre për sport e rekreacion dhe në veçanti zhvillimin e sporteve ujore
- Lokaliteti i Gradinës paraqet potencial për sport e rekreacion (sport ujqor, peshkim, gjueti),
- Lokaliteti Jedova- potencial për zhvillimin e turizmit alpin, turizmit rekreativo-kurativ, gjueti etj.
- Lokaliteti Gropa e Erenikut dhe Rrasa e Zogut për shkak të pozitës gjeografike paraqet një lokalitet me vlera të larta turistike si dhe mundësi për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar mes Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Gjithashtu ka mundësi për zhvillimin e ekoturizmit. Sipas raportit të lartpërmendur, dhe duke iu referuar studimeve ndërkombëtare të bëra në vitet '70, në rajonin turistik të Junikut Rrasa e Zogut paraqet një vend me mundësi për ngritjen e një qendre turistike.
- Lokaliteti Burimi i Erenikut dhe Liqejtë e Gjeravicës ofrojnë mundësi për zhvillimin e ekoturizmit, turizmit alpin për shkak të Majës së Gjeravicës si dhe aplikimin e gjuetisë dhe bashkëpunim ndërkufitar.
- Lokaliteti Gjocaj dhe Jasiq janë lokalitete të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural dhe ekoturizmit, zhvillimin e gjuetisë dhe turizëm konferencial.
- Lokaliteti Zharra për shkak të karakteristikave gjeo-morfologjike, paraqet potencial për zhvillimin e turizmit rural dhe ekoturizmit, turizmit konferencial, si dhe mundësi për ngritjen e një Qendre rekreative-rehabilituese


**Përfundim:** Përkundër faktit që gjendja mjedisore është relativisht e mirë në Junik, sidomos krahasuar me gjendjen në komunat tjera, kjo nuk nënkupton se nuk duhet marrë veprime për mbrojtje dhe parandalim të ndotjes dhe degradimit të tij.

Parandalimi dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore (tërmeti, vërshimet, rrëshqitja e dheut, zjarret etj) dhe dukuritë që shkatërrojnë vlerat natyrore dhe shkaktojnë ndotje në mjedis si: prerja e pakontrolluar e pyjeve, mbeturinat dhe derdhjet e ujërave të zeza në ambiente të hapura dhe lumej, ndotja nga gazrat e automjeteve, etj paraqesin një aspekt sfidues për komunën e Junikut në përmirësimin e situatës mjedisore.


Menaxhimi i matur i vlerave natyrore, ruajtja e biodiversitetit dhe shfrytëzimi i tyre në favor të zhvillimit të turizmit janë sfida me të cilat Komuna e Junikut do të ballafaqohet në të ardhmen.

<sup>23</sup> MTI, "Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare), dhjetor 2008

Harta 9: Mjedisi dhe degradimi



Harta 10: Trashëgimia natyrore



## 2.6 TRASHËGIMIA KULTURORE

Sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore në kuadër të trashëgimisë kulturore përfshihen: trashëgimia arkitekturale, arkeologjike, peisazhet kulturore si dhe trashëgimia shpirtërore (shih kutinë 11):

### Kutia 11: Llojet e trashëgimisë kulturore (Burimi: Ligji për Trashëgimi Kulturore nr.02/L-88)

- Trashëgimia arkitekturale (monumentet; ansamblet ose tërësia e ndërtesave; hapësirat arkitekturale konservuese të cilat dallohen për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, me interes shoqëror ose teknik)
- Trashëgimia arkeologjike (ndërtimet, strukturat dhe grupet e ndërtesave, vendbanimet e zhvilluara, objektet e luajshme, monumentet e llojeve të ndryshme dhe përbërjeve të tyre, të gjetura në tokë ose nën ujë.
- Peisazhet kulturore nënkuptojnë një fushë, ashtu siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilës është rezultat i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë; një komponentë esenciale e ambientit të njerëzve, një shprehje e diversitetit të trashëgimisë së përbashkët të tyre kulturore e natyrore, dhe një krijues i identitetit të tyre.
- Trashëgimia shpirtërore e cila përfshin format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.

Juniku edhe pse komunë relativisht e vogël me territor, karakterizohet me vlera të shumta të trashëgimisë kulturore dhe asaj shpirtërore. Llojet e trashëgimisë që mund të hasen në Junik janë: trashëgimia arkitekturale, arkeologjike si dhe ajo shpirtërore. Trashëgimia kulturore e Junikut lidhet shumë me zhvillimin historik të tij.

Në kaptinën e historikut u cek se Juniku paraqet një vendbanim të lashtë ilir. Dëshmi të kësaj janë materialet arkeologjike të zbuluara tek vendbanimi ilir i quajtur “Gradina”, vendbanim ky që ndodhet në grykën e majës së Gjeravicës gjurmët e të cilit ekzistojnë edhe sot.

Në periudhën e feudalizmit, Juniku paraqitet si një qendër e rëndësishme e pazarit. Në atë periudhë edhe ndërtohet Xhamia e Qokut dhe Xhamia në Qendër të Junikut, që edhe sot paraqesin objekte me vlera të rëndësishme kulturo-historike.

Trashëgimia me të cilën Juniku spikatet janë: kullat 9banesa të fortifikuara familjare, tipike për rrafshin e Dukagjinit), pasuar me shtëpitë e gurit, objektet tradicionale për shërbime dhe mullinjët.

### Kutia 12: Trashëgimia kulturore në Junik

**Kullat**- janë objekte tradicionale me bazë katrore dhe elemente përcjellëse arkitektonike sikurse dysheklëku, shkallët e jashtme etj. Në Junik kullat më të vjetra janë ato të lagjes së Hoxhajve, që datojnë nga fundi i shekullit të XVIII-të. Kullat përveç interesit arkitektonik, kanë luajtur edhe një rol të rëndësishëm shoqëror. P.sh. Kulla “Oda e Junikut” ishte njëkohësisht institucion juridik, shoqëror dhe politik. Aty u mbajtën tubime të ndryshme me rëndësi jo vetëm për Junkun, por edhe për tërë Kosovën. Kulla si banesë e fortifikuar është i vetmi tip arkitekturor banesë të shqiptarët që përfaqësohet në treva të caktuara në të gjitha shtresat popullore dhe pikërisht për këtë kulla edhe quhet banesë e të gjitha shtresave shqiptare.

**Shtëpi guri**- janë objekte tradicionale me bazë kryesisht drejtkëndëshe dhe e ndërtuar gjithmonë afër kullës si nevojë e zgjerimit të kapacitetit për banim ku rrallë hasen elemente arkitektonike të kullave. Paraqiten zakonisht më e thjeshtë se kulla.

**Pozllom (objekte tradicionale për shërbime)**- janë struktura fizike brenda oborreve të shtëpive që shërbejnë për nevoja ekonomike. Një nga karakteristikat kryesore të hapësirave për banim është prania e funksionit prodhimtra me karakter bujqësor/blegtoral. Për këtë arsye në pothuajse çdo oborr, brenda mureve rrethuese gjenden edhe objekte që u dedikohen strehimit të kafshëve, apo magazinimit të produkteve e materialeve të lidhura me aktivitetin bujqësor/blegtoral. Kështu, në kategorinë e objekteve tradicionale për shërbime mund të renditen pozllomet, koshet dhe hambaret të cilat janë të lidhura ngushtë me funksionin rezidencial duke qenë se ata janë pjesë e sistemit të prodhimit për vet-konsumim.

**Mullinjët**- janë objekte ekonomike tradicionale që shërbejnë për bluarje të grurit. Mullinjët kanë qenë përgjatë shekujve objekte karakteristike për Junikun. Sot kanë mbetur tre të tillë në gjendje relativisht të mirë. Ata gjenden në lagjet Gacafer, Krasniq dhe Berishë. Dy nga mullinjët janë akoma në gjendje pune dhe gjithashtu ata funksiononin edhe gjatë luftës. Këto objekte duhen konservuar duke pasur parasysh moshën e tyre të hershme: mullinjët në lagjet Berishë dhe Gacafer kanë përkatësisht rreth 950 dhe 580 vjet që ekzistojnë. Përpos vlerave historike, ata mbartin gjithashtu vlera të identitetit por edhe ekonomike duke qenë se ata strehojnë aktivitete prodhimtare. Përveç mullinjve si objekte tradicionale me karakter ekonomik janë edhe vajavicat dhe sharrat me ujë.

Burimi: PZHU (2009)

Përgjegjësia kryesore për inventarizimin, dokumentimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturor është kompetencë qendrore, gjegjësisht e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor si organ i Kuvendit të Kosovës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) me institucionet e saja gjegjëse që, në rastin e Junikut mbulohet nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Pejë (QRTK-PE). Të dhënat zyrtare në lidhje me objektet e trashëgimisë kulturore në Junik janë ato të QRTK-PE dhe deri sot vetem 4 kulla janë nën mbrojtje ligjore. Sipas listës së inventarizimit të vitit 2002/2003 të QRTK-PE, Juniku paraqitet me një mori objektiv dhe kompleksesh me vlera të trashëgimisë kulturore.

Duke parë që situata në terren që nga viti 2003 kur edhe është bërë inventarizimi ka ndryshuar, është parë e nevojshme që ajo listë të rishikohet. Për nevojat e PZHU në vitin 2009, është bërë hulumtim në terren nga hartuesit e planit me ç’rast krijohet evidenca për trashëgiminë kulturore për zonën urbane, me gjithsej 193 objekte të tilla (shih tabelën 13).

**Tabela 13: Objektet e trashëgimisë kulturore në zonën urbane (burimi Plani Zhvillimor Urban, 2007**

Numri i objekteve	Shtëpi guri	Kullë	Objekte tradicionale për shërbime	Mullinj, vajavica, sharra me ujë
<b>Në zonën urbane</b>	91	32	63	7

Kurse për nevojat e Planit Zhvillimor Komunal është zhvilluar edhe një hulumtim në terren nga ekipet e hartuesve të Planit, për të krijuar edhe evidencën për numrin dhe gjendjen aktuale të tyre apo dhe shkallën e dëmtimit jashtë zonës urbane (shih grafikoni e mëposhtëm me tabelën përcjellëse).

Nga evidentimi i përgjithshëm i objekteve jashtë zonës urbane (166) janë gjithsej 30 sosh që kanë vlera të trashëgimisë (kulla-5, shtëpi guri-18, pozllom tradicional-6, hambar-1). Gjendja aktuale e tyre është si vijon:

- Tri nga 5 kullat janë të shkatërruara kurse dy të tjerat kanë dëmtim të lartë;
- 14 shtëpi guri nga 18 të evidentuara janë të shkatërruara, 2 shtëpi guri kanë dëmtim të lartë, njëra ka dëmtim mesatar kurse vetëm një shtëpi guri është e padëmtuar. Hambari i vetem jashtë zonës urbane është në gjendje me dëmtim të ulët
- 93% e këtyre objekteve janë të pashfrytëzueshme, kurse funksioni kryesor i tyre është banim

**Grafiku 3: Numri i objekteve të trashëgimisë kulturore jashtë zonës urbane (burimi: hulumtim në terren për nevojat e PZH-së 2010)**




Tabela 14: Gjendja e trashëgimisë kulturore në komunën e Junikut në vitet e fundit.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË KOMUNËN E JUNIKUT						
Nr.	GJENDJA 2002 / 03 Inventarizimi (QRTK Pejë)	Emërtimi alternativ (nëse egziston)	Parcela	GJENDJA 2007 Plani i Mbrojtjes dhe Zhvillimit, (Komuna e Junikut, CHwB)	GJENDJA 2009 Plani Zhvillimor Urban (PZHU), (Komuna e Junikut, CHwB, Metropolis)	GJENDJA 2010 Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) (Komuna e Junikut, UN-Habitat, CHwB)
1	Gradina e vogël			egziston / e pyllëzuar, e mbuluar	egziston / e pyllëzuar, e mbuluar	egziston / e pyllëzuar, e mbuluar
2	Kroni i Priftit			egziston	egziston	egziston
3	Kroni i Hoxhajve			egziston	egziston	egziston
4	Vorrezat në Qendër të fshatit		341,1245,2219, 2220,3060,3059	egziston	egziston	egziston
5	Vorrezat e Lagjës së Bajraktarve		1246	egziston	egziston	egziston
6	Vorrezat e Lagjës së Berishës		2311	egziston	egziston	egziston
7	Vorrezat e Lagjës Gacafer		157,515,631,549	egziston	egziston	egziston
8	Vorrezat e Lagjës Pepshe		104,910,501,052	egziston	egziston	egziston
9	Vorrezat e Lagjës Gagjerr		3213, 554	egziston	egziston	egziston
10	Vorrezat e Goqajve		2867	egziston	egziston	egziston
11	Xhamia e Qokut		764-0	egziston	egziston	egziston
12	Xhamia e Hoxhajve	Xhamia e Junikut	2103-0	egziston	egziston	egziston
13	Kulla e Ibrahim Hoxhës	Kulla e Avdyll Hoxhës	1421-0	egziston	egziston	egziston
14	Kulla e Regjep Malokut			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
15	Kulla e Adem Makës	Kulla e Rexhep Makës	1463-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
16	Kulla e Ali Musliu			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
17	Kulla e Dervish Kasumit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
18	Kulla e familjes Maka	Kulla e Canë Makës	1464-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
19	Kulla e Hazir Kasumit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
20	Kulla e Ismajl Metes			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
21	Kulla e Pajazit Toftës			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
22	Kulla e Ramë Selmanit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
23	Kulla e Remzi Gagjerrit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
24	Kulla e Regjep Malokut			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
25	Kulla e Rrustem Hasanit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
26	Kulla e Sadik Elez Hoxhës			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
27	Kulla e Sadik Ramës			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
28	Kulla e Sadridinëve	Kulla e Qazim Jahës	1478-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
29	Kulla e Sali Hoxhës		1408-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
30	Kulla e Shaban Ahmetit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
31	Kulla e Shefqet Selimit			shkatërruar / themelet	shkatërruar / themelet	shkatërruar / themelet
32	Kulla e Smajl Regjepit			është shtëpi guri	është shtëpi guri	është shtëpi guri
33	Kulla e Taf Hoxhës		1411-0	egziston	egziston	egziston
34	Kulla e Xhemë Sadrië			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
35	Kulla e Ymer Hasanit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
36	Kulla e Zenun Ramë Aruqit	Kulla e Zenun Bajrushit	1621-0	egziston	egziston	egziston
37	Kulla e Zeq Bilalit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
38	Kulla e Zeq Lah Toftaj			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
39	Kulla e Miftar Hoxhës	Kulla e Ali Hoxhës	1423-0	egziston	egziston	egziston
40	Kulla e Beqë Hajdarit			egziston	egziston / fasadë e re e shtuar	egziston / fasadë e re e shtuar
41	Kulla e Jah Hebibit		1399-0	egziston	egziston	egziston
42	Kulla e Sadik Shehut	Kulla e Hysen Sadikut	2140-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
43	Kulla e Isuf Toftës			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
44	Kulla e Qallakut			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
45	Kulla e Selim Hoxhës		2137-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
46	Kulla e Llullunëve	Kulla e Faik Llullunit	1262-0	egziston	egziston	egziston
47	Kulla e Ali Bajraktarit	Kulla e Osman Sylës	1268-0	egziston	egziston	egziston
48	Kulla e Sali Bajraktarit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
49	Kulla e Kukajve			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
50	Kulla e Rrust Zeqirit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
51	Mulliri i Isuf Sadris	Mulliri i Nimon Toftajt		egziston	egziston	egziston
52	Mulliri i Haxhi Zhubit	Nuk Egziston, por ekziston mulliri i Sadri Sallajt	2040	egziston	egziston	egziston
53	Mulliri i Mushak Lushit		1633/1	egziston	egziston	egziston
54	Mulliri i Shaban Ahmetit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
55	Mulliri i Sylë Mehmetit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
56	Shtëpia e Nezir Hasanit			nuk egziston	nuk egziston	nuk egziston
57	Koshi i Haxhi Avdyllit			egziston	egziston	egziston
58	Koshi i Isuf Toftaj					
59	Koshi i Regjep Malokut					
60	Varri i Eltonit dhe Premetit	Rruga Gacafer te Makajt, vetem vendi por jo edhe vorrezat				
Nr.	GJENDJA 2002 / 03 Inventarizimi (QRTK Pejë)	Emërtimi alternativ (nëse egziston)	Parcela	GJENDJA 2007 Plani i Mbrojtjes dhe Zhvillimit, (Komuna e Junikut, CHwB)	GJENDJA 2009 Plani Zhvillimor Urban (PZHU), (Komuna e Junikut, CHwB, Metropolis)	GJENDJA 2010 Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) (Komuna e Junikut, UN-Habitat, CHwB)
<b>Objektet e paevidentuara nga QRTK Pejë</b>						
61	Teqja Sheh Xhaferrit		1173-0	egziston	egziston	egziston
62	Tyrbja Sheh Osmani		1247-0	egziston	egziston	egziston
63	Tyrbja e Dervish Elezit		2068-0	egziston	egziston	egziston
64	Tyrbja e Hate Sallajt		2311-0	egziston	egziston	egziston

Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011-2023

65	Tyrbja e Ali Krasniqit		3800-0	egziston	egziston	egziston
66	Kulla e Nezir Pepsit	<i>Kulla e Rrucojt</i>	1150-0	egziston	egziston	egziston
67	Kulla e Beqë Knushit		1230-0	egziston	egziston	egziston
68	Kulla e Avdyll Ramë Krasniqi		1315-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
69	Kulla e Qerim Imer Pepsit		1544-0	egziston	egziston	egziston
70	Kulla e Hamëz Gacaferri		1616-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
71	Kulla e Gëzim Zenun Kuqit		2047-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
72	Kulla e Mehmet Salihut		2077-0	shkatërruar / muret perimetrike	nuk egziston	nuk egziston
73	Kulla e Vehbi Ukës		2092-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
74	Kulla e Riza Hoxhës		2136-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
75	Kulla e Hazir Qollakut		2149-0	egziston	shkatërruar / muret perimetrike	nuk egziston
76	Kulla e Sali Islam Krasniqit	<i>Kulla e Luan Krasniqit</i>	2162-0	egziston	egziston	egziston
77	Kulla e Ramë Zyberit		2163-0	egziston	egziston	egziston
78	Kulla e Qerim Cenës	<i>Kulla e Cyme Hykasmani Sadiku</i>	2382-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
79	Kulla e Ali Musli Krasniqit		3064-0	shkatërruar / muret perimetrike	nuk egziston	nuk egziston
80	Kulla e Lulëzim Krasniqit	<i>Kulla e Idriz Sadik Krasniqit</i>	3139-0	egziston	egziston	egziston
81	Kulla e Ibrahim Sadikut	<i>Kulla e Beqë Krrakit</i>	3155-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
82	Kulla e Nurë Shalës		3223-0	egziston	egziston	egziston
83	Kulla e Qamil Mirocit	<i>Kulla e Isuf Mirocit</i>	3467-0	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike	shkatërruar / muret perimetrike
84	Kulla e Sadri Gocit		2481-0			egziston
85	Kulla e Zog Isuf Gocit		2492-0			egziston
86	Hambani i Avdullah Lushit	<i>Hambani i Xhafer Tafajt</i>	3877-0			egziston

FSHATI JASIQ

Nr.	GJENDJA 2002 / 03 Inventarizimi (IMM Pejë)	Emërtimi alternativ (nëse egziston)	Parcela	GJENDJA 2007 Plani i Mbrojtjes dhe Zhvillimit, (Komuna e Junikut, CHWB)	GJENDJA 2009 Plani Zhvillimor Urban (PZHU), (Komuna e Junikut, CHWB, Metropolis)	GJENDJA 2010 Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) (Komuna e Junikut, UN-Habitat, CHWB)
87	Kulla e Ibrahim Jasiqit	<i>Kulla e Ibish Jasiqit</i>	192-0			shkatërruar / muret perimetrike
88	Kulla e Lulëzim Jasiqit					nuk egziston
89	Kulla e Osman Jasiqit					nuk egziston
90	Kulla e Ramë Jasiqit					nuk egziston
91	Kulla e Regjep Jasiqit					është shtëpi guri
92	Kulla e Rrust Jasiqit		152-0			shkatërruar / muret perimetrike
93	Kulla e Rrustem Jasiqit					është shtëpi guri
94	Kulla e Sali Jasiqit					nuk egziston
95	Kulla e Skender Jasiqit		157-0 ?			shkatërruar / muret perimetrike
96	Kulla e Smail Jasiqit					nuk egziston
97	Kulla e Taf Jasiqit					nuk egziston
99	Kulla e Xhavit Jasiqit					nuk egziston

FSHATI GJOCAJ

Nr.	GJENDJA 2002 / 03 Inventarizimi (IMM Pejë)	Emërtimi alternativ (nëse egziston)	Parcela	GJENDJA 2007 Plani i Mbrojtjes dhe Zhvillimit, (Komuna e Junikut, CHWB)	GJENDJA 2009 Plani Zhvillimor Urban (PZHU), (Komuna e Junikut, CHWB, Metropolis)	GJENDJA 2010 Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) (Komuna e Junikut, UN-Habitat, CHWB)
100	Kulla e Avdyll Gjocit					nuk egziston
101	Kulla e Demë Gjocit	<i>Kulla e Damush Sadik Gjocit</i>				është shtëpi guri
102	Kulla e Halil Malokut					nuk egziston
103	Kulla e Musë Ganijan	<i>Kulla e Teutë Musë Ganijan</i>				është shtëpi guri
104	Kulla e Demë Ganijaj					nuk egziston
105	Kulla e Rrustem malokut					nuk egziston
106	Kulla e Ukë Malokut					nuk egziston

Gjendja aktuale në Junik tregon se nuk mund të flitet më për një kompleks kullash meqë një numër i madh kullash janë degraduar ose janë zhdukur plotësisht. Shkaqet kryesore të rrënimit të kullave në Junik përfshijnë:

- Luftërat sidomos kjo e fundit, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i konsiderueshëm kullash me qëllim zhdukjen e trashëgimisë së kulturës shqiptare.
- Pronarët e kullave të cilët kanë transformuar kullat për t'iu përshtatur nevojave të jetesës bashkëkohore. Në këtë mënyrë shumë kulla kanë humbur elementet karakteristike ndërtimore dhe arkitektonike. Këto veprime vijnë edhe si pasojë e mos interesimit shoqëror dhe institucional ndaj kullave si objekte me vlerë kulturore dhe historike për shqiptarët.
- Faktori kohë ka ndikuar poashtu në degradimin e kompleksit të kullave. Sot në Junik ekzistojnë shumë rrënoja kullash nga të cilat mund të ketë mbetur vetëm ndonjë mur ose ndonjë grumbull gurësh. Ndërkaq ndodh shpesh që në oborret ku ndodhen këto rrënoja jeta ka vazhduar dhe janë ngritur shtëpi me dy apo tri kate.



1

1. Shenjëzimi i trashëgimise natyrore dhe kulturore nëJunik dhe Gjoçaj

2. Kullë e restauruar

3. Pamja e qytezës së Junikut nga dy vendbanimet e saja të boshatisura Jasiq dhe Gjoçaj



2



3

4. Momente pune nga punëtoria për trashëgimi dhe turizëm

5. Trashegimia kulturore e shkatërruar

6. Pamje nga fshatrat e boshatisura Jasiq dhe Gjoçaj



4



5



6

**Përfundim:** Prezenca ende e disa vlerave të trashëgimisë kulturore (me theks të vecantë kullave) është mundësi e mirë për Junikun për të zhvilluar turizmin kulturor dhe ofruar mundësi për tu ranguar në një vend të veçantë në ofertën turistike në Kosovë dhe rajon.

Sa i përket zones urbane vërehet se lista e inventarizuar (krahasimet nga tabela 14) ka pësuar ndryshime të theksuara ku gjysma e tyre sot nuk ekzistojnë fare. Alarmante paraqitet edhe gjendja ku prej vitit 2007 kur është bërë edhe përditësimi i parë i informatave nga lëmia e trashëgimisë kulturore e deri në vitin 2010 në Junik plotësisht zhduken 3 kulla të tjera. Kjo tregon një trend ku komuna bashkë me institucionet relevante qendrore duhet të jetë më vigjilente sa i përket gjendjes dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore.


Kjo merr përmasa më të mëdha sepse Komuna parasheh që nëpërmjet këtyre asetëve kulturore të synojë stimulimin e zhvillimit lokal.

Sa i përket zonave jashtë zonës urbane, në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj vërehet një shkatërrim i madh i bërë kryesisht gjatë luftës së fundit. Edhe pse shkatërrimet janë të mëdha dhe këto vendbanime janë gati të shpopulluara këto zona paraqesin potencial të madh të zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Përkundër gjithë kësaj, sot ende ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i këtyre vlerave që tentojnë t'i rrezistojnë kohës dhe zhvillimeve që sjell ajo.

Ruajtja e këtyre vlerave nga degradimet, shfrytëzimi i tyre në favor të zhvillimit ekonomik të komunës dhe promovimi i tyre paraqet një sfidë të veçantë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të Junikut.

Harta 11: Trashëgimia kulturore



## 2.7 KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Meqenëse komuna e Junikut është komunë e re dhe personeli i saj është kryesisht personel i ri dhe i pa përvojë ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative është e domosdoshme dhe më se e nevojshme.

Me çështjet e Planifikimit Hapësinor dhe Urban në Junik mirret Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis. Kjo Drejtori aktualisht numëron 6 punëtorë, përfshirë drejtorin. Fusha e planifikimit si dhe ajo e banimit dhe ndërtimit mbulohet me dy zyrtarë (një inxhinier të arkitekturës dhe një të ndërtimtarisë). Kjo d.m.th që këta zyrtar duhet të merren me planifikim por edhe të lëshojnë dokumente ndërtimi si dhe kryejnë punë të tjera mbikëqyrje të Projekteve Investive etj.. Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor obligon Komunitat të themelojnë Njësinë e Planifikimit. Kjo Njësi duhet të merret ekskluzivisht vetëm me çështjet e planifikimit. Themelimi i Njesisë kërkon diskutim, analizë të kapaciteteve njerëzore si dhe gjetjes së modaliteteve të organizimit dhe funksionimit të tij nga aspekti profesional, organizativ dhe buxhetor.

Nga ana tjetër, kjo Drejtori ende nuk ka staf të punësuar për çështjet mjedisore. Andaj plotësimi i Drejtorisë me kuadër profesionist, ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të tyre për t'i përballuar sfidat e planifikimit hapësinor si dhe riorganizimi i Drejtorisë për Planifikim, Kadastër dhe Mjedis janë veprime të domosdoshme.

Organet inspektuese janë të ndara nga Drejtoria e Urbanizmit dhe në rastin e Junikut veprojnë në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike. Një funksionim i tillë i Inspektionit kërkon koordinim më të madh mes Drejtorive në kryerjen e punëve të inspektionit, zbatimit të dispozitave të planit dhe monitorimin e zhvillimeve në hapësirë. Mekanizmat për zbatim të Planeve dhe kontrollimin e zhvillimeve në komunë duhet të fuqizohen si nga aspekti profesional poashtu edhe vendimmarrës.

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, përveç punëve të tjera merret edhe me lëshimin e dokumentacionit të ndërtimit. Praktikantët botërore sidomos në vendet e zhvilluara janë të orientuara rreth lehtësisë të procedurave të dhënies së lejeve gjë që kontribuon pengimin e zhvillimeve të pakontrolluara dhe ndërtimeve pa leje. Prandaj thjeshtësimi i procedurave dhe dokumenteve të ndërtimit si dhe informimi i popullsisë, janë aspekte që duhet synuar.

Ligji për Planifikim Hapësinor (neni 6) obligon komunitat të themelojnë Këshillin e Ekspertëve të Planifikimit, Këshill ky që ka për detyrë të ofrojë këshilla profesionale në procesin e hartimit të Planeve dhe zbatimit të tyre. Në Junik në vitin 2008, për nevojat e PZHU-së, një Këshill i tillë është formuar dhe ka një përbërje prej 7 ekspertëve të fushave të ndryshme: ekonomist, biolog, arkitekt, ekspert i bujqësisë, historian, ndërtimtar dhe ekspert për turizëm. Ky Këshill duhet të angazhohet dhe funksionojë çdo herë kur paraqitet nevoja për këshilla profesionale, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinor, shqyrtojë dhe propozojë zgjidhje përkatëse në rastet e joharmonizimit të strategjive zhvillimore, përcjellë dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor të cilat miratohen nga Kuvendi i Komunës sipas Ligjit për planifikim hapësinor si dhe kryej edhe punë të tjera të cilat dalin nga fusha e planifikimit hapësinor.

Me Ligjin për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Komunitat poashtu obligohen të themelojnë dhe mirëmbajnë bazën e të dhënave të planit hapësinor të Komunës i cili duhet të jetë i lidhur dhe në harmoni me sistemin e të dhënave në vend. Për nevojat e hartimit të PZHK-së, Juniku ka arritur të krijojë bazën e të dhënave hapësinore dhe ka trajnuar një pjesë të stafit në përdorimin e GIS-t për përpilimin e hartave. Mirëpo për nevojat e ardhshme të zbatimit të dispozitave të ligjit hapësinor dhe tutje të monitorimit të gjendjes në terren dhe revidimit të planeve në çdo pesë vite, ka nevojë në vazhdimësi për trajnime në nivele më të avancuara të stafit të Drejtorisë (sidomos sektorit të Kadastrit) në këtë fushë.

Fusha e Planifikimit Hapësinor është një disiplinë shpesh edhe e paqartë për një pjesë të madhe të popullsisë. Gjendja aktuale e zhvillimeve të pakontrolluara në hapësirë, është rezultat përveç tjerash edhe i vetëdijes jo fort të lartë të popullsisë për rëndësinë e planifikimit hapësinor. Prandaj PZHK ngrit në pah edhe nevojën për ngritjen e vetëdijes së popullsisë për rëndësinë e planifikimit hapësinor.

**Përfundim:** Si komunë e re dhe me personel të ri, Juniku ka nevojë për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të kuadrit të saj profesionist në fushën e planifikimit. Investimet në ngritjen e kuadrove në njërin anë duhet parë si domosdoshmëri për të arritur zhvillimet e synuara me Planet Zhvillimore. Poashtu shihet e nevojshme riorganizimi i Drejtorisë me synim gjetjen e modaliteteve për institucionalizimin e Njesisë së Planifikimit ndaras nga njësia/sektori për dhënien e dokumenteve të ndërtimit/. Ekzistimi i Sektorit për Kadastër në kuadër të Drejtorisë është përparësi dhe si i tillë ky Sektor duhet të përkrahët në zhvillimin e mëtutjeshëm për krijimin e bazës së të dhënave hapësinore dhe harmonizimit me ato të nivelit qendror. Mekanizmat për kontroll të zhvillimeve (inspekcioni) dhe monitorim duhet fuqizuar dhe organizuar në mënyrën e cila i mundëson qasje më praktike për operim dhe vendimmarrje.

## 2.8 VLERËSIMI I GJENDJES NË KOMUNË

**Shënim:** Vlerësimi i gjendjes në komunë është bërë gjatë një takimi punues një ditor me gjithë ekipin punues komunal. Vlerësimi është bërë sipas fushave tematike të përcaktuara në profil. Teknika e përdorur është SWOT. Në vijim po paraqesim vlerësimin sipas fushave tematike, pasuar me vlerësimin e përgjithshëm.

Përparësitë	STRENGTHS
<p><u>Gjendja fiziko-gjeografike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pozita e mirë gjeografike me potencial natyror ende të pashfrytëzuar</li> <li>Prania e peisazheve ujore, fushore dhe malore (lumit Erenik, maja Gjevica, kullosat)</li> <li>Flora dhe fauna te pasur</li> </ul> <p><u>Gjendja socio-ekonomike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillimi social/demografia                     <ul style="list-style-type: none"> <li>Karakteri vital dhe i paepur i popullsisë Junikase (populli e re dhe e aftë për punë)</li> <li>Nivel i lartë i sigurisë dhe respektit të ndërsjellë shoqëror</li> <li>Diasporë e fortë dhe përkrahëse e fuqishme e zhvillimeve</li> <li>Qasje e lehtë në shërbimet e shëndetësisë dhe arsimin                             <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillimi ekonomik</li> </ul> </li> </ul> </li> <li>potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe agro-biznesit</li> <li>Potenciali pyjor</li> <li>Vetëdijësimi për zhvillim e bujqësisë dhe agro-biznesit</li> <li>Afërsia me zonat ku zhvillohet turizmi malor, historik kulturor</li> <li>Interesimi i madh i popullsisë për zhvillimin e turizmit</li> <li>Tradita në kultivimin e zejeve tradicionale (përpunimin e leshit, thurjes së rrobave tradicionale, qëndisjes)</li> <li>Nivel i kënaqshëm i bashkëpunimit mes sektorit publik-privat</li> </ul> <p><u>Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qasje e lehtë në infrastrukturën rrugore</li> <li>Lidhjet e jashte rrugore (në rrugë regjionale) në gjendje relativisht të mirë</li> <li>Burime të mjaftueshme të ujit dhe furnizimi i mirë me ujë të pijes</li> </ul> <p><u>Shfrytëzimi i tokës/vendbanimet dhe banimi</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dendësia relativisht e ulët e ndërtimit në zonën urbane</li> <li>Shtrirje policentrike të lagjeve (sipas PZHU)</li> <li>Hapësira ende të lira për zhvillim të ardhshëm</li> </ul> <p><u>Mjedisi, peisazhet dhe zonat e rrezikuara nga ndotja, degradimi dhe fatkeqësitë natyrore</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Jo shumë ndërtime pranë shtratit të lumit</li> <li>Nuk ka aktivitete ndotëse industriale</li> <li>Prezencë e peisazheve lumore, malore, fushore</li> <li>Lloje relikte të florës dhe faunës me vlera shkencore dhe farmaceutike</li> <li>Resurse natyrore me potencial zhvillimi turistik</li> </ul> <p><u>Trashëgimia kulturore</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Interesim i lartë i qeverisë dhe banorëve për zhvillimin dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore</li> <li>Lokacion i njohur për trashëgimi kulturore- kullat, mullinjët, vajavicat</li> <li>Vend historik-Kuvendi i Junikut</li> </ul> <p><u>Sistemi i planifikimit hapësinor (aspekti organizativ)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Staf i ri dhe i motivuar për njohuri të reja dhe avancim</li> <li>Përkrahje politike për të zhvilluar këtë sektor</li> </ul>	


### Mundësitë

#### Gjendja fiziko-gjeografike

- Ndërlidhja me shtetet fqinje

#### Gjendja socio-ekonomike

- zhvillimi social/demografia
  - Burimet njerëzore, moshë e re e popullsisë dhe aktive në punë
  - Projektet në realizim e sipër mundësi për të përmirësuar shërbimet në arsim dhe shëndetësi
  - Përkushtimi i qeverisjes vendore në të gjitha nivelet për të prodhuar programe zhvillimi për Junikun dhe promovimin e tij në rajon e më gjerë
- zhvillimi ekonomik
  - Potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit si dhe ndërmarrjeve agro-ç
  - Mundësi për ngritjen e pemishteve intensive
  - Sipërfaqet e punueshme dhe potenciali i mjaftueshëm ujor për ujitjen e tokave
  - Potencial për zhvillim të pylltarisë dhe blegtorisë
  - Potencial për zhvillimin e energjisë alternative (hidrocentralet, biomasa, etj)
  - Resurset natyrore dhe kulturore e historike potencial për zhvillimin e turizmit dhe hotelierisë



#### Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike

- Mundësi për kycjen në rrugë regjionale dhe atyre me lidhje tejkufitare
- Mundësi e përfitimt nga projektet mbi bashkëpunimin ndërkomunal me Gjakovën e Deçanin
- Zhvillimi i infrastrukturës së këmbësorëve brenda dhe jashtë zonës urbane (ajo jashtë zonës urbane mund të shfrytëzohet edhe për sport, rekreacion për banorët, turistët vendor dhe ndërkombëtar)
- Mundësi e qasjes në transportin hekurudhor poqese zhvillohet linja hekurudhore Gjakovë-Klinë
- Mundësi komunikimi të shpejta përmes linjave ajrore poqese realizohet projekti i Aeroportit te Kukesit apo dhe ai i Gjakovës
- Mundësi e përmirësimit të furzinimit me ujë meqë ka burime ujore me potencial zhvillimit
- Mundësitë e shfrytëzimit të fondeve të donatorëve për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit
- Mundësi e shfrytëzimit të fondeve për zhvillimin e studimeve për energji alternative
- Zgjerimi i rrjetit të telekomunikimit dhe internetit do të mundësojë komunikim më të shpejtë dhe qasje më të lehtë në informata
- Menaxhim më i mirë i mbeturinave me marrjen përsipër të kompetencave nga komuna për kryerjen e këtij shërbimi (sidomos të grumbullimit)

#### Shfrytëzimi i tokës/vendbanimet dhe banimi

- Trajtimi i vendbanimeve të depopuluara, vendbanimit joformal dhe banimit mundësi e mirë për të përmirësuar jetën e qytetarëve të Junikut

#### Mjedisi, peisazhet dhe zonat e rrezikuara nga ndotja, degradimi dhe fatkeqësitë natyrore

- Fuqizimi i kapaciteteve komunale për menaxhim të resurseve natyrore dhe rreziqeve nga fatkeqësitë
- Shfrytëzimi i programeve të ndryshme të donatorëve për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit

#### Trashëgimia kulturore

- Ngritja e kapaciteteve humane dhe organizative komunale
- Bashkëpunim me donatorë rreth hartimit të planeve dhe projekteve të trashëgimisë
- Bashkëpunim ndërkomunal rreth zhvillimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore (inicimi i hartimit të planit hapësinor për Kullat e Dukagjinit)

#### Sistemi i planifikimit hapësinor (aspekti organizativ)

- Fuqizimi i sektorit të planifikimit hapësinor dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të stafit

**Mangësitë**

Gjendja fiziko-geografike

- Pozita ndërkufitare dhe të resurset natyrore nuk janë të shfrytëzuara në favor të zhvillimit të gjithmbarshëm

Gjendja socio-ekonomike

- zhvillimi social/demografia
- Mungesa e të dhënave zyrtare për demografi
- Shkallë e lartë e papunësisë dhe numër i konsiderueshëm i familjeve të varfëra
- Migrimi i të rinjve
- Mungesa e institucioneve arsimore parashkollore (çerdheve/kopshtet për fëmijë)
- Mungesa e hapësirave publike dhe të funksioneve të rekreacionit
  - zhvillimi ekonomik
- Buxheti i komunal është i vogël dhe nuk mbulon kërkesat e mëdha për investime në sektorin e ekonomisë. Komuna është komunë e re dhe ende në konsolidim e sipër
- Moskultivimi i tokës bujqësore; qasja në tokat bujqësore ende e vështirë
- Kultivim i ulët i kulturave intensive dhe industriale
- Mungesa e organizimit në sektorin e bujqësisë (ende nuk ka shoqatë të fermerëve, sektori i bujqësisë mbulohet vetëm me një zyrtar komunal)
- Konkurenca jolojale e tregut dhe kosto e lartë e shpenzimeve të fermerëve
- Mungesa e politikave të qeverisë për stimulimin e fermerëve me subvencione
- Setori i pylltarisë ende i centralizuar; komuna nuk ka kompetenca në menaxhimin e pyjeve
- Potenciali i pylltarisë ende i pahulumtuar
- Potenciali i energjisë alternative ende i pafshrytëzuar
- Mungesë kapacitësh dhe njohurish në ofrimin e shërbimeve në sektorin e turizmit dhe hotelerisë
- Mospromovimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe artizanateve
- Niveli i lartë i interesit për kredi jofavorizues për sektorin privat dhe banorët

Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike

- Infrastruktura fizike
- Kërkesat për investime në ifrastrukturën rrugore janë të mëdha; buxheti i limituar;
- Qasja deri në Bjeshkë e vështirë dhe pamundëson edhe zhvillimin e turizmit
- Mosmirëmbajtja e rrugëve
- Mungon infrastruktura përcjellëse e rrjetit infrastrukturor (stacioni i autobusëve, shërbimet e transportit publik e, infrastruktura ekëmbësorëve sidomos për qasje në Bjeshkë etj)
- Shërbimet publike
- Komuna ka kompetenca të limituara në ofrimin e disa shërbimeve komunale
- Komuna nuk ka mbulueshmëri të plotë për qytetarët me shërbimet publike (ujësjellës, kanalizim, grumbullim të mbeturinave, etj)

Shfrytëzimi i tokës/vendbanimet dhe banimi

- Ka prezencë të Vendbanimeve joformale (VJF)
- Vendbanimet Gjocaj dhe Jasiq janë gati të depopulluara
- Ka ende prezencë të minave në vendbanimet rurale

Mjedisi, peisazhet dhe zonat e rrezikuara nga ndotja, degradimi dhe fatkeqësitë natyrore

- Ndotja e ujit të lumenjve dhe dheut nga mbeturinat dhe derdhja e ujërave të zeza
- Prerja e pyjeve me pasoja rreziku në paraqitjen e erozionit dhe humbjen e biodiversitetit
- Zjarret në pyje-dukuri e shkaktuar kryesisht nga pakujdesia

Trashëgimia kulturore

- shkatërrimi i kullave gjatë dhe pas luftës
- mungesa e fondeve për restaurim e trashëgimisë
- Mungesë e kapaciteteve komunale për të trajtuar trashëgiminë kulturore

Sistemi i planifikimit hapësinor (aspekti organizativ)

- Juniku si komunë e re ka nevojë për konsolidim të sistemit të planifikimit dhe ngrijtjen e kapaciteteve



WĒEAKNESSES

**Kërcënimet / Problemet**

Gjendja fiziko-geografike

- Mospërkrahja e realizimit të projekteve që mundësojnë bashkëpunim ndërkufitar dhe tejkuftar

Gjendja socio-ekonomike

- zhvillimi social/demografia
- shkallë e lartë e papunësisë
- Emigracion dhe largim i kapaciteteve intelektuale
  - zhvillimi ekonomik
- Humbja e tokës bujqësore
- Pamundësia e plasimit të produkteve të Junikut
- Humbja e madhe e fondit blegtoral gjatë luftës

Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike

- Mospërkrahja e zhvillimit të projekteve të infrastrukturorë
- Mos-ofrimi i shërbimeve publike adekuatë për qytetarët ka pasoja në kualitetin e jetës dhe kjo mund të rezultojë edhe me rritjen e migrimit të popullsisë në kërkim të kushteve më të mira jetësore si dhe mos-ofrimin e kushteve optimale për zhvillim të turizmit

Shfrytëzimi i tokës/vendbanimet dhe banimi

- Mosrespektim i rregullave të urbane në procedurat e ndërtimit
- Vendbanimet ende të minuara-rrezik permanent për kthim të sigurtë të popullsisë
- Probleme në regjistrimin e pasurive të paluajtshme

Mjedisi, peisazhet dhe zonat e rrezikuara nga ndotja, degradimi, fatkeqësitë natyrore dhe të tjera


- Degradim i brezit të lumit Ereniku dhe ndotja me mbeturina inerte ose organike
- Prerja e pakontrolluar e pyjeve-rrezik i humbjes së këtij resursi
- Mungesa e kompetencave lokale për menaxhim të pyjeve
- rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (vërshimet, erozioni, tërmetet, zjarret në pyje) janë rrezik për jetën e banorëve dhe mund të dëmtojnë në masë të madhe esurset natyrore dhe biodiversitetin që zhvillohet në to

Trashëgimia kulturore

- Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore
- Mungesa e investimeve në trashëgimi kulturore

Sistemi i planifikimit hapësinor (aspekti organizativ)

- Mos-vendosja e një sistemi të mirëfilltë të planifikimit hapësinor, do të ketë pasoja në zhvillimin e qëndrueshëm të gjithmbarshëm të Junikut



THREATS

### Vlerësim i përgjithshëm:

Analiza e situatës nxjerr këto përfundime duke vënë në pah çështjet prioritare të cilat duhet adresuar për periudhën për të cilën hartohet Plani.

1. Pozita gjeografike, resurset natyrore që spikatin Junikun (sidomos maja më e lartë Gjeravica) si dhe potenciali kulturor duhet shfrytëzuar në favor të zhvillimit ekonomik.
2. Popullsia junikase karakterizohet me një shkallë të mesme të varfërisë dhe sikurse e gjithë popullsia e Kosovës, nivel shumë të lartë të papunësisë. Popullsia është shumë e re dhe aktive për punë. Nëse nuk krijohen kushte për zhvillim ekonomik dhe mundësi punësimi, situata e tillë do të keqësohet edhe më tej dhe kjo do të rriste edhe më tej dëshirën e të rinjve për të migruar në kërkim të kushteve më të mira për jetesë dhe në skenarion më të keq edhe paraqitjen e dukurive negative të shoqërisë. Zhvillimi ekonomik është në shkallë të ulët. Kjo nga njëra anë mund të arsyetohet se Juniku tash së voni është shpallur komunë, megjithatë pavarësisht kësaj junikasit kanë patur traditë të zhvillimit të disa sektorëve të caktuar të ekonomisë (bujqësisë, blegtorisë etj) në të kaluarën. Analiza e gjendjes së zhvillimit të këtij sektori ka vënë në pah katër shtylla mbi të cilat mund të bazohet zhvillimi ekonomik: Turizimi i bazuar në natyrë dhe ai kulturor; bujqësia përfshirë blegtorinë; pylltaria dhe energjia alternative. Ky zhvillim kryesisht bazohet në potencialin dhe resurset natyrore, por pavarësisht kësaj vlerëson edhe zhvillimin e sektorëve tjerë shërbyes dhe infrastrukturës përcjellëse që mbështesin këta sektorë.
3. Marrë parasysh që Juniku ishte një vendbanim rural, natyrisht që edhe infrastruktura fizike dhe qasja në shërbimet publike i përkasin karakterit rural dhe janë ende të pakompletuara. Me ndryshimin e statusit dhe shpalljen e Junikut komunë, kjo infrastrukturë si dhe shërbimet publike kanë nevojë për përmirësim. Është vlerësuar si e rëndësishme sigurimi i qasjes në bjeshkë dhe ngritja e infrastrukturës së këmbësorëve në këtë zonë. Kjo për arsye se vlerësohet se nuk mund të ketë një zhvillim të mirëfilltë të turizmit poqese nuk trajtohet edhe problemi i arritshmërisë së lehtë në këtë zonë i turistëve (vendorë apo ndërkombëtarë) apo edhe shfrytëzuesve të cilët shfrytëzojnë potencialin sportiv e rekreativ të zonës.
4. Analiza ka vlerësuar se është me rëndësi që vendbanimet të kenë një trajtim adekuat. Trajtimi i vendbanimit joformal duhet të lidhet ngusht me trajtimin e vendbanimeve Jasiq dhe Gjocaj të cilat janë në depopullim e sipër. Kësaj problematike i shtohet edhe aspekti i sigurisë për shkak të prezencës së minave. Çështja e banimit dhe ndërtimeve është elaboruar detajisht në PZHU ndaj vlerësohet se PZHK duhet t'i referohet zhvillimeve të PZHU-së në këtë lëmi.
5. Ndotja e ujit dhe e tokës nga mbeturinat dhe derdhja e ujërave të zeza janë çështje brengosëse ashtu siç është edhe prezenca e dukurive negative (prerja e pyjeve, zjarret, nxjerrja e zhavorit, veprimet e gurthyesve) dhe fatkeqësive natyrore (tërmetet, vërshimet, ...) të cilat sjellin pasoja për jetën e banorëve dhe rrezikimin e biodiversitetit. Nga ana tjetër, vlerësohet se ekzistojnë mundësi të shumta përfshirë edhe programe të ndryshme donatorësh, për të përmirësuar gjendjen mjedisore, ruajtjen e resurseve dhe biodiversitetit.
6. Është evidentuar që trashëgimia kulturore po shkatërrohet nga viti në vit. Veprimet për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtij resursi kërkojnë buxhet shumë të madh. Buxheti i komunës nuk mund t'i përballojë kostot e mëdha të restaurimit ndaj dhe si mundësi pothuajse e vetme shihet bashkëpunimi me donatorë që ofrojnë programe dhe projekte investive në fushën e trashëgimisë.
7. Një Plan nuk është strategjik, poqese nuk adreson edhe aspektin institucional. Si Komunë e re dhe në konsolidim e sipër, ka nevojë për zhvillimin e mirëfilltë të Sektorit për Planifikim Hapësinor (i cili do të jetë bartësi kryesor i zbatimit të Planit) duke adresuar vazhdimisht nevojën për ngritjen e kapaciteteve sidomos atyre humane në këtë lëmi.

## 2.9 SFIDAT ZHVILLIMORE

### **Sfidat:**

**S1:** Juniku ka pozitë të mirë gjeografike dhe ndërkufitare dhe një potencial natyror dhe kulturor por të cilat nuk janë të shfrytëzuara. Ekonomia e Junikut nuk është e zhvilluar sa duhet përkundër që turizmi, bujqësia përfshirë blegtorinë, pylltaria dhe energji alternative paraqesin potenciale për zhvillim ekonomik. *Si të shfrytëzohet kjo pozitë dhe vlerat natyrore-kulturore në favor të zhvillimit ekonomik ?dhe bashkëpunimit me Komunitat dhe shtetet fqinje? Si mund të shfrytëzohen këto potenciale dhe përfitohet nga to?*

### **Sfidat:**

**S2:** Popullsia e Junikut është shumë e re dhe aktive për punë; në anën tjetër niveli i papunësisë është i lartë.

*Si mundet PZHK ti kontribuojë ngritjes së mirëqenies sociale dhe krijimit të vendeve të reja të punës?*

**S3:** Migrimi i të rinjve dhe humbja e trurit (intelektualëve) një sfidë e vecantë.

*Cfarë kushtesh duhet t'i ofrohen kësaj kategorie që ata të qëndrojnë dhe t'i kontribuojnë vendlindjes së tyre?*

**S4:** Mungesa e institucioneve publike dhe hapësirave publike, atyre për kulturë, sport e rekreacion është e evidente.

*Si të plotësohet mungesa e këtyre hapësirave; për cfarë lloj institucionesh, hapësirash të rinjtë Junikas kanë nevojë më shumë?*

### **Sfidat:**

**S5:** Mbulueshmëria me rrjetin rrugor është relativisht e mirë, por cilësia e rrugëve është e dobët dhe ka shumë rrugë të pa asfaltuara. Nuk ka rrugë tranzit për transport të rëndë dhe qasje në bjeshkë.

*Ku duhet të intervenohet urgjentisht në kompletimin/përmirësimin e rrjetit rrugor për të lehtësuar lëvizshmërinë për banorët e tij dhe vizitorë? Si duhet të përmirësohet qasja në bjeshkë?*

**S6:** Transporti publik jo i organizuar; mungesë e infrastrukturës përcjellëse të tij si dhe asaj për këmbësorë.

*Si të përmirësohet transporti publik dhe shërbimet e tij në mënyrë që banorët e Junikut të kenë qasje të lehtë në të dhe shërbime më të mira? Si të përmirësohet infrastruktura për këmbësorë sidomos ajo turistike?*

**S7:** Shërbimet publike (ujësjellësi, kanalizimi, telekomunikimi, furnizimi me rrymë etj) nuk mbulojnë gjithë territorin e Komunës së Junikut, në kuptimin që jo të gjitha familjet në Junik kanë qasje në këto shërbime.

*Si të përmirësohen këto shërbime dhe ku ka nevojë për intervenim?*

**Sfidat:**

**S8:** Toka bujqësore është një resurs i rëndësishëm por që po humbet nga zhvillimet aktuale.  
*Si të ruhet toka bujqësore dhe parandalohet humbja e saj nga zhvillimet e tanishme?  
Si dhe kah duhet të orientohet banimi në mënyrë që të mos ndikojë në humbjen e tokës bujqësore, por edhe të ruajë tipologjinë tradicionale?*

**S9:** Vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj janë pothuajse të depopulluara. Popullsia e saj është e zhvendosur në qytet konkretisht në lagjen "Agim Ramadani" e cila edhe konsiderohet si vendbanim joformal.  
*Si duhet trajtuar këto dy vendbanime? Cfarë kushtesh duhet t'i ofrohen popullsisë së fshatrave Jasiq dhe Gjocaj në mënyrë që ata të kthehen në vendbanimet e tyre?*

**Sfidat:**

**S10:** Mjedisi relativisht i pastër, megjithatë prezente ndotja e ujit dhe tokës për shkak të hudhjes së mbeturinave në lumenj dhe brigjet e tyre si dhe derdhja e pakontrolluar e ujërave të zeza  
*Si të përmirësohet kjo situatë? Ku duhet të intervenohet urgjentisht?*

**S11:** Degradimi i vlerave natyrore (prerja e pyjeve) dhe fatkeqësitë natyrore (vërshimet, tërmetet, shembja e dheut etj.) mund të nxisin rreziqe dhe kenë pasoja katastrofale.  
*Si të ndalohen dhe parandalohen këto dukuri? Në cilat prej tyre duhet intervenuar urgjentisht?*

**Sfidat:**

**S12:** Juniku ka vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore.  
*Si të ruhen dhe shfrytëzohen këto vlera në favor të zhvillimit ekonomik? Cilat prej tyre meritojnë vëmendje të veçantë dhe uraiente për intervenim?*

**Sfidat:**

**S13:** Juniku si Komunë e re që është, nuk ka arritur ende të konsolidojë një sistem të mirëfilltë të Planifikimit Hapësinor. Poashtu i mungon përvoja dhe njohuritë e reja në fushën e Planifikimit.  
*Si të zhvillohet sistem funksional i Planifikimit, kuptohet rëndësia e Planifikimit Hapësinor dhe njëkohësisht edhe ngriten kapacitetet e Komunës në këtë lëmi?*

## 2.10 VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTIVE

Vlerësimi i kapaciteteve investive është një mjet me të cilën vlerësohet potenciali i financimit të Projekteve për Investime Kapitale Publike dhe Private. Komuna e Junikut e ka të përpiluar Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB) e cila është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore nga MEF-i. Me kornizën afatmesme buxhetore synohen të arrihen këto objektiva:

- Zhvillohet, promovohet dhe rigjenerohet infrastruktura lokale;
- Ngritet cilësia e mjedisit jetësor;
- Përmirësohet siguria dhe shëndeti i komunitetit;
- Zhvillohet shëndetësia, arsimiti, kultura dhe sporti;
- Ofrohen mjete për nevojtarët dhe të dëmtuarit;
- Përkrahen dhe zhvillohen biznesi dhe aftësitë individuale të talentëve etj.

**Parashikimi i të hyrave komunale:** Të hyrat komunale të komunës së Junikut realizohen në bazë të Rregullores për Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores për Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasojë siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale. Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë, të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale, në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Tabela 15: Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale (burimi: Korniza aftamesme buxhetore komunale)

	Burimet e të hyrave	2010 Buxheti	2011	2012	2013
			Projeksioni		
<b>1</b>	<b>Gjithsej grantet nderqeveritare</b>	<b>957,806</b>	<b>1,083.0</b>	<b>1,115.6</b>	<b>1,149.1</b>
<b>2</b>	<b>Gjithsej te hyrat vetanake te komunes</b>	<b>43,1</b>	<b>50.7</b>	<b>52.2</b>	<b>53.6</b>
1	Të hyrat nga bizneset	5.0	5.2	5.3	5.4
2	Të hyrat nga gjobat në trafik	1.5	1.6	1.7	1.8
3	Të hyrat nga shërbimet kadastrale	1.5	1.6	1.7	1.8
4	Të hyrat nga urbanizmi	0.8	1.6	1.7	1.8
5	Të hyrat nga administrata	3.6	4.7	4.9	5.1
6	Të hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	1.5	1.6	1.7	1.8
7	Të hyrat nga tatimi në pronë	18.5	19.5	20.0	20.5
8	Regjistrimi i Automjeteve	6.1	6.1	6.2	6.3
9	Të hyrat nga shëndetësia	3.6	4.2	4.3	4.4
10	Të hyrat tjera	1.0	1.1	1.2	1.3
11	Dënimet e gjykatave		0.5	0.5	0.5
12	Agjensioni Pyjor		3.0	3.0	3.0
	<b>TOTALI</b>	<b>1,000</b>	<b>1,133.7</b>	<b>1,167.8</b>	<b>1,202.7</b>

**Projeksionet e shpenzimeve të Buxhetit Komunal:** Më datën 05.05.2010 kanë arritur Limitet e para buxhetore për Komunat për periudhën 2011/2013. Granti fillestar i Qeverisë për komunën Junik, pastaj ka pasuar edhe qarkorja e dytë buxhetore 2011/12 në të cilën janë përcaktuar grantet dhe limitet e financimit të kategorive ekonomike.

**Parashikimi i granteve të Qeverisë** për komunën e Junikut janë si vijon:

**Tabela 16: Grantet e Qeverisë për komunën e Junikut**

Limiti fillestar	Granti i Arsimit	Granti i Shëndetësisë + 5% Performanca	Granti i Përgjithshëm	Sh. sociale	Gjithsej granti Komunal
2011-Kufijtë e financimit	330,175	146,462	599,472	6,981	1,083,090
2012-Parashikimet	340,080	150,855	617,456	7,190	1,115,583
2013-Parashikimet	350,282	155,381	635,979	7,406	1,149,050

Është vlerësuar se komuniteti i bizneseve ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e projekteve të mundshme qoftë të atyre si investime kapitale, poashtu, edhe të aktiviteteve që i kontribuojnë promovimit të vlerave të Junikut.

Buxheti i komunës së Junikut është ende i vogël dhe shumë i varfër krahas projekteve dhe investimeve kapitale për të cilat komuna ka nevojë. Përkrahja me Projekte apo dhe programe të ndryshme të donatorëve është e domosdoshme. Komuna ka arritur të krijojë raporte të mira bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm, dhe ka përfituar nga Projekte të ndryshme të donatorëve. Komuna është e interesuar të fuqizojë bashkëpunimin me donatorë për të realizuar Projekte edhe më madhore në të ardhmen.

Shoqatat joqeveritare, edhe pse të pakta në Junik janë deklaruar se janë të gatshme të ndihmojnë. Projektet e komunës, sidomos ato të cilat kanë të bëjnë me aktivitete ndërgjegjësimi, në organizimin e aktiviteteve që promovojnë produktet e Junikut, etj.

**Projeksioni i të hyrave buxhetore:** Tabela e mëposhtme tregon projeksionin e të hyrave buxhetore të Komunës përfshirë të hyrat vetanake si dhe ato nga Qeveria në formë të granteve.

**Tabela 17: Projeksioni i të hyrave Buxhetore 2011/2013 të Komunës së Junikut**

Komuna e Junikut	Buxheti - 2011	Buxheti – 2012	Buxheti – 2013
Të hyrat nga granti qeveritar	1,083,090	1,115,583	1,149,050
Të hyrat vetanake	50,650	52,200	53,600
<b>TOTALI</b>	<b>1,133,740</b>	<b>1,167,783</b>	<b>1,202,650</b>

**Shpërndarja e buxhetit në vitet 2011-2013:** Sipas parashikimeve të Kornizës Afatmesme Buxhetore pritet që në vitet e ardhshme buxheti i Komunës të ketë një rritje solide qoftë nga të hyrat vetanake poashtu edhe nga Grantet Qeveritare.

**Tabela 18: Vlerësimet e hershme të buxhetit për vitin 2011 (burimi: Korniza aftamesme buxhetore komunale)**

Buxheti komunal	2010 (000 euro)	2011 (000 euro)	2012 (000 euro)	2013 (000 euro)
	<b>1 001</b>	<b>1 134</b>	<b>1 167</b>	<b>1 202</b>

**Programi Komunal i Investimeve Publike (PIP):** Komuna ka paraparë Projektet Kapitale me Buxhetin e vitit 2010, me financim nga të hyrat e fondit të ndarë për komunën e Junikut, si dhe Listën e Projekteve për vitet 2011/2013 të parapara me financim nga të hyrat vetanake dhe nga donatorët. Kjo Listë mund të modifikohet me propozime të reja që do të vijnë nga drejtoritë dhe strukturat tjera udhëheqëse dhe organet relevante Komunale për hartimin e politikave zhvillimore të Komunës (kjo vlen edhe për projektet e parapara me Planin Zhvillimor Komunal) të cilat duhet të rishikohen dhe harmonizohen me planin buxhetor.

## 3.VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

### 3.1 VIZIONI PËR TË ARDHMEN E KOMUNËS

#### DEKLARATA E VIZIONIT

*“Juniku, Park etnografik, vend i traditës, që ruan, zhvillon dhe promovon vlerat e tij njerëzore, kulturore, historike dhe natyrore; me arsimim cilësor dhe mirëqenie sociale; me turizëm, bujqësi (agroindustri) dhe infrastrukturë të zhvilluar; mjedis të pastër, të qëndrueshëm dhe të sigurtë për të gjithë”*

Deklarata e Vizionit për komunën e Junikut është zhvilluar gjatë një punëtorie dhe paraqet një verzion të integruar të deklaratave të vizionit të zhvilluara më herët për komunën e Junikut duke marrë për bazë:

1. Dokumentin e Integruar të Vizionimit, i cili paraqet deklaratën e vizionit dhe përmbledh shënime dhe konkludimet e ndryshme të krijuara gjatë punëtorisë së suksesshme të vizionimit të mbajtur në vitin 2007 dhe pranuar nga opinioni i gjerë junikas,
2. Strategjinë Zhvillimore Lokale të Komunës së Junikut, hartuar në vitin 2009,
3. Planin Hapësinor të Kosovës, respektivisht vizionin për Zonën e Verdhë ku bën pjesë komuna e Junikut,
4. Hartimin dhe ilustrimet e fëmijëve Junikas të zhvilluara gjatë shënimit të Ditës Botërore të Habitat-it (tetor, 2009), në temën; “Si e shihni Junikun pas 15 vitesh?”.

#### **Kutia 13: Deklaratat bazë për vizionin e integruar për Komunën e Junikut**

*“Juniku, vend-themel i traditës dhe odës si institucion, “Park Etnografik” i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, ruajtja e së cilës do të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie për banorët e vet, me vend të merituar në ofertën turistike rajonale dhe integrimi evropiane”. Deklarata e vizionit si rezultat nga punëtorja e vizionimit, Ohër 2007*


*Juniku, me trashëgiminë kulturore dhe bukuritë e saja natyrore, do të jetë një vend atraktiv me bujqësi, infrastrukturë dhe turizëm të zhvilluar, mjedis të pastër, arsimim cilësor dhe rini të shëndoshë. Deklarata e vizionit nga strategjia e zhvillimit lokal (SZHL) të Junikut si rezultat i punëtorive të SZHL, 2009*

*“Hapësirë e cila prin në arritjen e objektivave zhvillimore të Mileniumit, ngritjen e kualitetit të jetës dhe zhvillimit ekonomik lokal, përmes qeverive lokale të decentralizuara e me përkrahje nga sektori privat, biznesi, shoqëria civile dhe qytetarët si partnerë në realizimin e objektivave, duke shfrytëzuar resurset natyrore, humane dhe kapacitetet infrastrukturorë. Zhvillimet sociale, ekonomike dhe kulturore të arrihen përmes modernizimit të ekonomisë me teknologji të reja, TIK, njohurive të reja, për një zhvillim të qëndrueshëm. Projekt Planit Hapësinor i Kosovës; Vizioni për zonën e verdhë në të cilën bën pjesë edhe Juniku (2009)*



*Punimi fitues në temën "Si e shihni Junikun pas 15 viteve?"*

JUNIKU SOT



JUNIKU PAS 15 VITEVE



ORIGINAL: Arbacia Lolluni - Junik '09

### 3.2 PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM

Parimet janë vlera të propozuara dhe të dakorduara të cilat duhet respektuar në të ardhmen. Parimet të cilat Plani Zhvillimor i komunës së Junikut i ka përcaktuar si më të rëndësishme për t'u marrë parasysh gjatë hartimit por edhe pas miratimit të Planit janë:

- PZHK mbështet parimin e qasjes së integruar, duke përfshirë elementet e infrastrukturës dhe transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për Komunën;
- PZHK promovon interesat e përbashkëta të banorëve të Junikut me qëllim të ngritjes së kualitetit të jetës dhe mirëqenies sociale;
- Plani bazohet në parimin e ofrimit të qasjes për të gjithë banorët në shërbimet e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve tjera sociale;
- Promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm duke treguar maturi në shfrytëzimin racional të vlerave natyrore, historike e kulturore për zhvillim (që këto vlera të promovohen por edhe të ruhen për t'u përcjellë edhe tek gjeneratat e ardhshme);
- Promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të vlerave të Junikut;
- Promovimi i ekonomisë stabile e cila do të krijojë mundësi për gjenerimin e vendeve të reja të punës për banorët e Junikut me të drejta të barabarta për të gjithë;
- Qeverisja e mirë urbane e cila promovon pjesëmarrjen publike dhe gjithpërfshirjen në procesin e hartimit të Planit Zhvillimor të komunës duke përfshirë grupe të ndryshme të interesetit dhe duke mos përjashtuar grupet me nevoja të veçanta në këtë proces (promovimin e transparencës në planifikim dhe barazisë duke marrë parasysh aspektet e barazisë gjinore si dhe duke adresuar kërkesat e personave me nevoja të veçanta, rinjve, grave, fëmijëve, moshuarve etj);
- Parimi i subsidiaritetit sipas së cilit plani duhet të fokusohet në çështjet lokale, mirëpo nuk duhet të jetë kontradiktor me çështjet e nivelit të lartë. Komuna merr përgjegjësi lidhur me vendimet e nivelit qendror por edhe të merr vendime që mund të zbatohen në mënyrë efikase në nivelin lokal të qeverisjes-delegim të mëtejme të përgjegjësive lokale në instanca më të ulëta;
- PZHK i Junikut theks të veçantë i ep parimit të zhvillimit kompakt sidomos të zonës urbane me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të hapësirës por edhe duke insistuar në një shpërndarje të barabartë të funksioneve themelore të zhvillimit edhe në zonat rurale në mënyrë që të eliminohen disparitetet mes zonës urbane dhe asaj rurale;
- PZHK i Junikut mbështetet poashtu në parimin e partneritit dhe bashkëpunimit ndërkomunal dhe më gjerë me qëllim të mbrojtjes, shfrytëzimit racional të vlerave të përbashkëta dhe përfitimit nga projektet e përbashkëta. Poashtu, PZHK mbështet zhvillimet e ardhshme të cilat krijojnë një partneritet urban-rural sipas të cilit funksionet e qytetit dhe ato të fshatrave e plotësojnë njëra tjetrën e asesi të konkurojnë njëra-tjetrën.

### 3.3 CAQET ZHVILLIMORE AFATGJATA

Pjesa e definimit të caqeve zhvillimore (përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave) paraqet një vazhdimësi të vizionit. Bazuar në përparësitë dhe mangësitë si dhe duke marrë parasysh mundësitë dhe potencialin zhvillimor dhe sfidat zhvillimore, Plani Zhvillimor Komunal për periudhën për të cilën hartohet ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat sipas fushave tematike të përcaktuara.

PZHK ka marrë në konsideratë edhe rekomandimet e definuara nga Plani Hapësinor i Kosovës për Zonën e Verdhë në kuadër të së cilës gjendet edhe Juniku e që në fokus kanë :

- zhvillimin e turizmit kulturor, rekreativ, tradicional fshatar me ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore e kulturore,
- ruajtjen e tokës bujqësore dhe parandalimi i shtrirjes së vendbanimeve në tokën bujqësore,
- mbrojtja e lumenjve dhe pyjeve nga degradimi.

Kurse orientimet afatgjata për zhvillimin e zonës urbane sipas Planit Zhvillimor Urban 2009-2023+ në fokus kanë mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, zhvillimin e saj në funksion të turizmit historiko-kulturor, turizmit natyror dhe agroturizmit si dhe promovimin e saj në këtë zonë; dendësimin e qendrave të banuara ekzistuese duke respektuar strukturën shoqërore dhe identitetin e komunitetit banues; zhvillimin e infrastrukturës bazë: rrugë, ujësjellës, kanalizime, telekomunikacion, si përgjigje ndaj nevojave ekzistuese dhe zhvillimeve të parashikuara; zhvillimin e aktiviteteve dhe shërbimeve shoqërore si dhe zhvillimin e ekonomisë me synim fuqizimin e sektorit privat, ruajtjen e strukturës së ekonomive të vogla familjare etj.

Dokumenti i strategjisë së zhvillimit lokal 2009, rëndësi i jep zhvillimit të bujqësisë, rregullimit dhe zhvillimit të infrastrukturës rurale përfshirë edhe shërbimet, menaxhimin më të mirë të mjedisit dhe resurseve natyrore, sistemit të ujitjes, menaxhimit të tokës, bashkëpunimit brenda dhe jashtë Kosovës si dhe zhvillimit të resurseve njerëzore përfshirë arsimimin, aftësimin etj.

Qëllimet dhe objektivat e përcaktuara me PZHK përmes një procesi konsultativ gjithëpërfshirës, paraqesin një përfshirje të synimeve të përcaktuara nga dokumentet e lartpërmendura dhe kanë një radhitje sipas fushave tematike të: zhvillimit social dhe infrastrukturës sociale, zhvillimit ekonomik, infrastrukturës fizike, transportit dhe shërbimeve publike, shfrytëzimit të tokës, vendbanimeve dhe banimit, mjedisit dhe resurseve natyrore, trashëgimisë kulturore si dhe aspektin e ngritjes së kapaciteteve në planifikim hapësinor.

#### **A: ZHVILLIMI SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE**

*Juniku ka popullsi shumë të re dhe vitale, por e cila në mungesë të ofrimit të mundësive për punësim dhe rekreim në Junik, ka synim migrimin jashtë vendit. Mungesa e hapësirave dhe institucioneve publike dhe atyre për sport e rekreim e zbavitje veç sa e keqëson këtë situatë edhe më shumë. Qëllimet dhe objektivat që synojnë përmirësimin e kësaj gjendjeje janë:*

##### **AQ1: Përmirësimi i gjendjes sociale dhe ekonomike**

- O1:** Ulja e shkallës së papunësisë
- O2:** Ulja e nivelit të migrimit
- O3:** Ngritja e kapaciteteve profesionale
- O4:** Sigurimi i punës sezonale

##### **AQ2: Përmirësimi i kualitetit të jetës përmes ngritjes së hapësirave dhe objekteve publike**

- O1:** Ofrimi i kushteve më të mira arsimore, kulturore dhe sportive si dhe hapësirave rekreativo-kulturo-arsimore (bibliotekë, qendër rinore, teatër, salla dhe hapësira sportive etj)
- O2:** Ngritja e kualitetit të hapësirave publike (sheshe, fushëlojëra, etj)

**AQ3: Zhvillimi i shoqërisë informative të organizuar dhe pjesëmarrëse në vendimmarrje**

- O1:** Ofrimi i qasjes më të lehtë në informata
- O2:** krijimi i të dhënave bazike socio-ekonomike
- O3:** Përkrahja e organizimit të shoqërisë në formë shoqatash, organizatash joqeveritare apo komunitare të grupeve të caktuara të cilat promovojnë zhvillim
- O4:** avancimi i rolit të gruas për të qenë kontribuuese në zhvillimin ekonomi dhe punësim

**B: ZHVILLIMI EKONOMIK**

*Juniku ka pozitë të mirë gjeografike dhe ndërkufitare me resurse natyrore dhe kushte të favorshme që ofrojnë mundësi për zhvillim ekonomik dhe bashkëpunim me komunat dhe shtetet fqinje. Synimet janë që ky sektor të ketë një ngritje në zhvillim në të gjithë sektorët ekonomik, por në veçanti në atë të turizmit, bujqësisë përfshi blegtorinë me theks të veçantë në bletari; zhvillimin e agro-biznesit dhe agro-industrisë, pasuar me pylltarinë dhe sektorin e energjisë alternative.*

**BQ1: zhvillim i qëndrueshëm ekonomik në të gjitha sferat por në veçanti bujqësi, turizëm, pylltari, energji alternative**

- O1:** Avancimi i sektorit të bujqësisë dhe agrobiznesit /fuqizimi edhe i sektorit privat në këtë fushëveprimtari/
- O2:** Zgjerimi dhe shtrirja e sistemit të ujitjes në tokat bujqësore
- O3:** Qasje më e lehtë në tokat bujqësore
- O4:** Promovimi i produkteve bujqësore të Junikut duke ofruar qasje në tregjet lokale dhe rajonale
- O5:** Rritja e sektorit të blegtorisë së imët (në veçanti bletarisë)
- O6:** Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve duke fuqizuar kapacitetet komunale dhe strukturat tjera
- O7:** Zhvillimi i energjisë alternative (hidro-energjëtika, biomasa)
- O8:** Zhvillimi i sektorit të turizmit dhe shërbimeve turistike
- O9:** Ndikimi në organizim dhe vetëdijësim

**BQ2: Rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar**

**C: INFRASTRUKTURA FIZIKE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE**

*Rrjeti infrastrukturor: Duke marrë parasysh faktin se komuna e Junikut ka një mbulueshmëri me rrjetin rrugor relativisht të mirë, por e cila ka nevojë për t'u kompletuar dhe përmirësuar, si dhe krijimin e hapjeve të reja, në mënyrë që të krijohen lehtësi në qarkullim të automjeteve dhe banorëve e vizitorëve, PZHK ka përcaktuar këto qëllime dhe objektiva:*

**CQ1: Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës fizike sipas kushteve teknike bashkëkohore në tërë territorin e Komunës dhe më gjerë**

- O1:** Qasje e lehtë në Bjeshkët e Junikut
- O2:** Krijimi i lidhjeve me dy shtetet fqinje
- O3:** Përmirësimi i qarkullimit rrugor përmes hapjes së rrugës tranzit "Bajraktar-Gaxherr" deri në vitin 2011 në gjatësi 3 km

*Transporti publik: Në Junik transporti publik funksionon por nuk është i organizuar si duhet dhe poashtu ka edhe mungesë të infrastrukturës përcjellëse të tij. Edhe pse PZHU trajton më gjerësisht këtë pjesë, në suaza të hartimit të PZHK-së është parë e arsyeshme që të ritheksohen qëllimet/objektivat të përcaktuara:*

**CQ2: Përmirësimi gjegjësisht shtrirja e transportit publik urban dhe ndërrurban me shërbime dhe elemente përcjellëse si dhe infrastrukturës adekuate për këmbësorë**

- O1:** Lëvizshmëri më e mirë përmes hapjes së vijave urbane
- O2:** Në periudhën 10 vjeçare të bëhet hapja e vijave të reja ndër-urbane me komunat tjera
- O3:** Brenda 5 viteve të përmirësohen shërbimet e transportit publik dhe taksive duke ofruar një vendlokacion të përshtatshëm për stacion të autobusëve dhe vendqëndrim për taxi

**O4:** Lehtësim i qarkullimit për këmbësorë dhe persona me nevoja të veçanta përmes ngritjes së sigurisë në trafik (shenjëzimi horizontal, vertikal, punimi i trotuareve....)

**Shërbimet publike:** Në sferën e shërbimeve publike, shtrirja e këtyre shërbimeve në zonat ku mungon, paraqet sfidë, ndaj dhe qëllimet dhe objektivat e PZHK-së në lidhje me këtë aspekt janë:

**CQ3: Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimeve publike konform standardeve bashkëkohore në gjithë territorin e Komunës së Junikut**

- O1:** Mbulimi i zonës urbane me rrjet primar të kanalizimit në një periudhë afatshkurtë
- O2:** Në periudhë afatshkurtë edhe 5% e mbetur e familjeve të kyçet në rrjetin e ujësjellësit
- O3:** Ngritja e kapaciteteve me energji elektrike me një trafostacion 10 kW në periudhë afatshkurtë
- O4:** Zvogëlimi i ngarkesës në trafot ekzistuese (vendosja e trafostacionit të ri në 5 vitet e ardhshme)
- O5:** Ngritja e kapaciteteve me energji alternative me hidrocentrale në periudhë afatgjatë
- O6:** Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave përmes themelimit të një ndërmarrjeje komunale
- O7:** Promovimi i shfrytëzimit të energjisë alternative për sistemin e ngrohjes dhe shtrirjen e tij

#### **D: SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI**

Zhvillimet aktuale në relacion me shfrytëzueshmërinë e tokës nuk janë edhe aq favorizuese për një zhvillim të mirëfilltë hapësinor në Junik. Ndërtimet e reja në tokë bujqësore, fragmentimi i parcelave në njërën anë dhe depopullimi i dy vendbanimeve me zhvendosjen e popullatës dhe uzurpimin e pronave të banimit në lagjen “Agim Ramadani” duke krijuar kështu vendbanim joformal paraqesin një aspekt sfidues për trajtim. Në këtë kontekst, PZHK përcakton këto qëllime (objektiva):

**DQ1: Mbrojtja dhe shfrytëzim racional i tokës bujqësore**

- O1:** Mbrojtja e tokës bujqësore (sidomos asaj të kategorisë I-IV) nga zhvillimet aktuale
- O2:** Rritja e shfrytëzueshmërisë së tokës bujqësore
- O3:** Ngritja e vetëdijësitimit për mbrojtjen e këtij resursi dhe zhvillimin e tij

**DQ2: Trajtimi i vendbanimeve**

- O1:** Trajtimi i vendbanimit joformal - lagjes “Agim Ramadani”
- O2:** Krijimi i kushteve për kthimin e popullsisë në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj

**DQ3: Trajtimi i banimi dhe ndërtimeve**

- O1:** Trajtimi i hapësirave ekzistuese dhe atyre të reja të banimit dhe ndërtimit

#### **E: MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA NDOTJA, DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË**

Sfida kryesore në fushën e mjedisit ka të bëjë deri në një masë me mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e parasëgjithash me pengimin e degradimit të tij si dhe parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu.

Qëllimet/objektivat e përcaktuara me PZHK janë:

**EQ1: Mbrojtja dhe zhvillim i qëndrueshëm mjedisor**

- O1:** Zvogëlimi i ndotjes së lumenjve dhe tokës nga mbeturinat dhe ujërat e zeza
- O2:** Mbrojtja e pyjeve nga degradimi i vazhdueshëm dhe prerjet ilegale duke fuqizuar strukturat komunale dhe komunitetin për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve

**EQ2: Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera**

- O3:** Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera me theks të veçantë mbrojtja nga zjarri dhe erozioni por dhe nga vërshimet e termetet
- O4:** Ngritja e çështjes së deminimit si një problem ende aktual
- O5:** Shfrytëzimi i resurseve mjedisore të ripërtërishme dhe alternative për zhvillim lokal
- O6:** Mbrojtja nga ndryshimet klimatike

**EQ2: Ruajtja e peisazheve dhe biodiversitetit**

**EQ3: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërshtetëror**

## **F: TRASHËGIMIA KULTURORE**

*Ruajta dhe shfrytëzimi i vlerave të trashëgimisë kulturore në favor të zhvillimit ekonomik është sfida e identifikuar në Plan. Si Komunë e re, Juniku poashtu ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve organizative e humane për të zhvilluar këtë sektor dhe zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.*

Ndaj dhe qëllimet/objektivat e përcaktuara për fushën e trashëgimisë janë:

### **FQ1: Mbrojtja dhe funksionalizimi i trashëgimisë kulturore**

- O1:** Ngritja e kapaciteteve komunale (humane/organizative) për mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë
- O2:** Data baza dhe inventarizimi i gjithë fondit të trashëgimisë kulturore të komunës
- O3:** Mbrojtja, jetësimi (funksionalizimi) i vlerave të trashëgimisë kulturore
- O4:** Vetëdijësimi, promovimi dhe marketingu i vlerave kulturore-historike të Junikut

## **G: KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

*Një Plan nuk mund të jetë strategjik, nëse nuk adreson edhe aspektin e zhvillimit institucional i nevojshëm për të realizuar objektivat e Planit. Konsolidimi i një strukture të Planifikimit e cila do të jetë në gjendje t'i përmbush kërkesat ligjore të Planifikimit Hapësinor dhe ligjeve përkatëse është poashtu njëra ndër sfidat zhvillimore të Planit.*

Qëllimet/objektivat e përcaktuara për të tejkaluar këtë sfidë janë:

### **GQ1: Konsolidimi i strukturave të Planifikimit Hapësinor në Komunë**

- O1:** Zhvillimi i kapaciteteve komunale njerëzore dhe organizative në fushën e planifikimit hapësinor dhe kontrollin e zhvillimeve
- O2:** Zhvillimi i bazës së të dhënave për planifikim hapësinor
- O3:** Ndërgjegjësimi i popullsisë për fushën e planifikimit hapësinor
- O4:** Zhvillimi i metodave që thjeshtojnë procedurat e marrjes së lejeve urbanistike dhe ndërtimit

### 3.4 PRIORITETET STRATEGJIKE

Prioritetet strategjike të përcaktuara nga ana e komunës, Shoqërisë Civile, Komunitetit të Biznesit etj janë:

1. Prioritet shumë i lartë:

- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik është fusha më prioritare të cilës PZHK duhet t'i kushtojë rëndësi. Pa zhvillim ekonomik, nuk mund të mendohet as për zhvillimin e fushave tjera. Fushat kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë: turizmi natyror dhe kulturor, bujqësia, pasuar me sektorët tjerë me potencial zhvillimi si pylltaria dhe sektori i energjisë alternative.

2. Prioritet i lartë:

Prioritete strategjike poashtu të larta për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës së Junikut janë:

- Ofrimi i infrastrukturës fizike e cila do ta bënte Junikun më lehtë të qasshëm për banorët e saj si dhe vizitorët;
- Mbrojtja e tokës bujqësore dhe shfrytëzim racional i saj;
- Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimeve publike në gjithë territorin e komunës;
- Përmirësimi i gjendjes sociale-ekonomike me theks të veçantë në punësim;
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit;
- Rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar; etj.

3. Prioritet i mesëm:

- Zhvillimi i hapësirave publike si dhe ngritja e objekteve publike do t'iu ofronin banorëve të Junikut mundësi më të mirë për jetesë dhe rekreacion duke ndikuar kështu në përmirësimin e kualitetit të jetës.
- Përmirësimi i transportit publik ndërurban/urban përcjellur me ngritjen e shërbimeve përcjellëse të tij por edhe elementeve tjera përcjellëse do të ofronin mundësi për junikasit që të kenë një qarkullim më të lehtë brenda dhe jashtë Junikut. Kjo, poashtu, do të ketë ndikim në zvogëlimin e nevojës për përdorim të veturave gjë kjo që do të kontribuonte në lehtësimin e qarkullimit të këmbësorëve si dhe të personave me nevoja të veçanta.
- Duke e menduar Junikun në të ardhmen si një vend prezent në agjendën turistike të Kosovës si dhe një komunë e cila synon të jetë e hapur edhe për qytetarët e saj, padyshim që informimi dhe qasja më e lehtë në informata është parë si prioritet strategjik i një rëndësie të veçantë.

## 4. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

Korniza e zhvillimit hapësinor shpreh parashikimin e dëshiruar hapësinor për territorin e komunës dhe përcakton kontekstin hapësinor të strategjive për implementim, planeve të veprimit dhe të vendimmarrjes.<sup>24</sup>

### 4.1 KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor të Junikut është bazuar kryesisht në zonat funksionale që ekzistojnë në komunën e Junikut e të cilat dallohen për nga karakteristikat e zhvillimit, karakteristikat gjeografike dhe përmbajtjesore (shih figuren 5). Ky koncept është bazuar në konceptin e mbrojtjes së zonave me vlera natyrore por me mundësinë e krijimit të lidhjeve të reja infrastrukturore, zhvillimit hapësinor më kompakt dhe të koncentrimet të urbanizimit dhe infrastrukturës në zonën e banimit ku edhe zhvillohen më shumë aktivitetet ekonomike. Ky koncept mundëson një zhvillim më dinamik të qytetës së Junikut dhe i kthen vitalitetin dy fshatrave. Fuqizimi i lidhjes mes zonës urbane dhe rurale do të mundësojë një partneritet urban-rural i cili do të ndihmojë zhvillimin ekonomik të Junikut bazuar në turizmin kulturor dhe natyror, zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe energjisë alternative.

Sipas këtij koncepti, Juniku ndahet në katër zona. Zonat 1 dhe 2 janë zonat ku është më së shumti i shprehur potenciali i trashëgimisë natyrore (Bjeshkët (1) dhe pyjet (2)). Zona 3 paraqet zonën ku është i koncentruar banimi në tri venbanimet - qytetën e Junikut dhe dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj. Në kuadër të kësaj zone kemi edhe koncentrimin e zhvillimit të aktiviteteve ekonomike si dhe potencialet e trashëgimisë kulturore. Kurse zona 4 është karakteristike për potencialin për zhvillim të bujqësisë.

Koncepti është testuar përmes dy skenarëve: Skenarit të trendit i cili analizon përparësitë dhe mangësitë e konceptit nën hipotezën se çka ndodh me zhvillimet në hapësirë nëse do të përcjellim zhvillimet e trandit aktual (që i përgjegjen një zhvillimi të shpërndarë) dhe skenarit të “dëshiruar” i cili i përgjigjet një forme më kompakte të zhvillimit. Përparësitë, mangësitë, konfliktet dhe sinergjitë mes sektorëve të ndryshëm janë analizuar për të dy skenarët.


Punimi i skenarëve është zhvilluar gjatë dy punëtorive intensive dhe është rezultat i një procesi me një përfshirje të profesionistëve në fusha të ndryshme të zhvillimit hapësinor. Gjatë punëtorive është punuar fillimisht në fusha tematike veç e veç pasuar me punëtorinë për integrimin e skenarëve për të identifikuar konfliktet dhe sinergjitë në mes te fushave.

*Momente pune të pjesëmarrësve në punëtoritë për punimin e konceptit të zhvillimit hapësinor*



<sup>24</sup> Ligji për Planifikim Hapësinor

Figura 5: Koncepti i zhvillimit hapësinor




#### 4.1.1. Skenari i "trendit" apo "zero"

Ky skenar, pas analizës nga pjesëmarrësit rezulton si variant i papëlqyer i zhvillimit hapësinor të Junikut në të ardhmen. Me përjashtim të pak përparësive, ky skenar tregon një mori mangësish. Aktivitetet ekonomike, infrastruktura fizike dhe shërbimet publike janë të koncentruara kryesisht në zonën urbane. Kjo bën që dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj të braktisen krejtësisht dhe shtrirja e banimit të shkojë në drejtim të zonës 3 e cila paraqet njëherit zonën me tokë bujqësore. Toka bujqësore si një resurs i rëndësishëm do të vazhdojë të humbet. Degradimi i mjedisit (ndotja e lumenjve dhe tokës, prerja e pyjeve, etj) mund të sjell pasoja të rënda ekologjike (erozionit dhe humbjen e biodiversitetit). Trashëgimia kulturore do të vazhdojë të shkatërrohet dhe kjo do të ketë pasoja të rënda meqë Juniku mëton të jetë një vend i rëndësishëm i zhvillimit të trashëgimisë kulturore (kullave me theks të veçantë), përfshirë këtu edhe trashëgiminë shpirtërore që lidhet me ruajtjen dhe vazhdimin e traditave dhe zakoneve të trevës. Kjo më tej do të sjell limite në mundësinë e zhvillimit të turizmit kulturor. Lëvizja e banorëve të Junikut do të mbetet e vështirësuar dhe Juniku në përgjithësi nuk do të jetë lehtë i qasshëm edhe për vizitorë.

**Sinergjitë dhe konfliktet e skenarit të "trendit":** Skenari i trendit paraqet më shumë konflikte se sa sinergji. Sinergjitë paraqiten kryesisht mes sektorit të mjedisit dhe konservimit të potencialit ekzistues natyror (kullotat, peisazhet, burimet ujore). Koncentrimi i aktiviteteve ekonomike në zonën urbane nuk implikon kosto të lartë në ofrimin e infrastrukturës fizike dhe sociale.

Nga ana tjetër, nëse zhvillimet në komunën e Junikut vazhdojnë sipas trendit aktual, konfliktet paraqiten në mes banimit dhe ruajtjes së tokës bujqësore dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë si dhe në përgjithësi shfrytëzimit racional të hapësirës. Ky trend do të favorizojë edhe më tej depopullimin total të fshatrave Jasiq dhe Gjocaj. Sipas këtij skenari, sektorët e ndryshëm do të vazhdojnë të zhvillohen në vete pa ndonjë harmonizim dhe nuk do ta ndihmojnë zhvillimin e sektorëve tjerë. Zhvillimet do të jenë të koncentruara në zonën urbane duke mos ofruar mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe duke krijuar dallime të mëdha në zhvillim mes qytetit dhe fshatrave. Investimet në infrastrukturë fizike do të jetë të orientuara më shumë në aspektin intern (asfaltimit të rrugëve brenda komunës) se sa krijimit të mundësive për lidhje të reja. Në njëfarë mënyre ky trend i zhvillimit do ta mbaj Junikun në izolim duke mos ofruar mundësi hapjeje sidomos ndaj rajonit dhe duke mos i dhënë mundësinë që përparësitë e tij krahasuese të vijnë në shprehje ndaj dhe si i tillë nuk është një skenar i pëlqyer për zhvillimin e ardhshëm hapësinor.



#### Përparësitë e skenarit të "trendit" apo skenarit "0"

- Bashkëpunim komunal në nivel të kënaqshëm
- Kullotat do të mbeten të njëjta
- Burimet natyrore/ujit nuk do të dëmtohen
- Bukuritë e Gjeravicës nuk do të dëmtohen
- Koncentrimi i aktiviteteve ekonomike në zonën urbane nuk implikon ofrimin e infrastrukturës fizike dhe sociale

#### Mangësitë e skenarit të "trendit" apo skenarit "0"

- Zgjerimi i ndërtimit në tokën bujqësore
- Shfrytëzim jo i mjaftueshëm i tokës bujqësore
- Fshatrat Jasiq dhe Gjocaj të depopulluara
- Mungesa e një qendre informative
- Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Degradim i vazhdueshëm i lumenjve në komunë (ndotja e lumenjve, nxjerrja e inerteve në lumin Erenik)
- Hudhja e mbeturinave në mënyrë ilegale përgjatë rrugës Junik-Rastavicë
- Mungesa e infrastrukturës adekuate për zhvillim të llojeve të turizmit veror/dimëror/alpin etj
- Shfrytëzim joracional i resurseve natyrore
- Mungesa e qasjes së komunës në projektet mjedisore ndërshtetërore
- Zhvillimi ekonomik i paqëndrueshëm dhe jo premtues për rritje ekonomike dhe gjenerim të vendeve të reja të punës
- Potenciali i pyjeve nuk do të shfrytëzohet dhe menaxhohet nga komuna
- Prodhimtaria bujqësore do të zvogëlohet; do të vazhdojë ndërrimi i destinimit të tokës
- Blegtoria dhe bletaria do të vazhdojnë trendin e zvogëlimit
- Nuk ofron mundësi për zhvillimin e turizmit dhe përcaktimin e hapësirave turistike sidomos Bjeshkëve-turizmi malor
- Nuk do të shfrytëzohet potenciali ujqor për prodhimin e energjisë alternative
- Koncentrimi i aktiviteteve ek.vetëm në zonën urbane
- Qasje e vështirë në Bjeshkët e Junikut
- Lëvizje e vështirësuar për qytetarë/vizitorë
- Qytetarët nuk do të kenë shërbime publike të mjaftueshme
- Vështirësi e lëvizjes në transport publik urban/ndërrurban (nr. i veturave do të rritet; do të vështirësohet lëvizja e banorëve brenda e jashtë Junikut

### 4.1.2. Skenari i "dëshiruar"

Ky skenar parasheh një zhvillim të qytetit si promotor i zhvillimit por nuk lë anash as zhvillimin e dy fshatrave Jasiq dhe Gjocaj. Sipas këtij skenari ato paraqiten si vende atraktive për zhvillim si fshatra turistike dhe si zona atraktive për orientimin e banimit në të ardhmen në këtë pjesë. Pra sipas këtij skenari qyteti dhe fshatrat e plotësojnë njëra tjetrën duke krijuar partneritet e jo konkurrencë e njëra tjetrës. Ky skenar parasheh shtrirjen e infrastrukturës fizike si dhe shërbimeve publike në zonat ku kjo mungon. Potenciali natyror mund të shfrytëzohet më racionalisht duke penguar kështu degradimin e tij. Kalimi i disa kompetencave si dhe disa ndërmarrjeve publike tek komuna do të kenë ndikim shumë pozitiv në përmirësimin e gjendjes mjedisore. Ky skenar pengon shtrirjen e banimit në tokë bujqësore duke lënë mundësi, jo vetëm të ruajtjes së tokës bujqësore por zhvillimit të këtij sektori. Zonat përgjatë lumenjve, Liqejtë e Gjeravicës si dhe bukuritë e rralla natyrore të Bjeshkëve të Junikut paraqiten si pika atraktive për turizëm. Hapja e Junikut dhe paraqitja e tij edhe në ofertat e ndryshme turistike në Kosovë, rajon dhe më gjerë është e rëndësishme andaj ky skenar propozon që ndërtimi i një qendre apo dhe zyre informimi dhe funksionalizimi i saj do të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e Junikut si vend meritor për t'u vizituar. Ky skenar duke u përputhur edhe me deklaratën e vizionit, e parasheh Junikun me mundësi të zhvillimit të turizmit kulturor dhe natyror. Mangësitë dhe kërkesat e këtij skenari janë adresuar, duke theksuar sidomos nevojën për zbatim të ligjeve dhe rregulloreve, nevojën për resurse financiare marrë parasysh buxhetin e limituar të komunës, nevojën për resurse njerëzore dhe avancimin e kapaciteteve të tyre për t'u përgjigjur zhvillimeve të ardhshme të komunës në fushat e caktuara si prioritare, nevojën për bashkëpunim dhe bashkërendim të zhvillimeve mes niveleve të ndryshme qeveritare dhe më gjerë.


**Sinergjitë dhe konfliktet e skenarit të "dëshiruar":** Ky skenar i zhvillimit ka më shumë sinergji se sa konflikte në mes sektorëve të ndryshëm andaj është edhe skenari i parapëlqyer për zhvillimin e mëtutjeshëm hapësinor. Megjithatë gjatë zhvillimit të mëtejshëm të tij duhet tentuar që edhe ato konflikte të minimizohen nëse s'ka mundësi të eliminohen plotësisht. Kështu p.sh. zhvillimi i turizmit, nëse nuk bëhet në masë të kontrolluar, bie ndesh me ruajtjen e pasurive natyrore dhe trashëgiminë kulturore; zhvillimi i sektorit të energjisë së ripërtërishe me ruajtjen e peisazheve lumore; shpallja e mundshme e Parkut Nacional të Bjeshkëve të Nemuna me zhvillimin e turizmit dhe sektorit të pylltarisë.

Kurse sinergjitë e këtij skenari paraqiten me strategjinë për ruajtjen e tokës bujqësore; strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal; menaxhim më të mirë të pyjeve kur kompetencat të kalohen në nivel lokal; ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, banimin.

#### Zonat me interes-

Interes kombëtar: Bjeshkët e Junikut si pjesë e propozuar e Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna përfshi edhe Majën Gjeravica, Maja e Gusanit, Maja e Rupës, Rrasa e Zogut, Jedova, Lumi Erenik, Pika kufitare në trekëndëshin Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi & Kullat e Junikut si pjesë integrale e kullave të Dukagjinit

Interes komunal dhe ndërkomunal: Parku Moronica & Toka bujqësore



#### Përparësitë e skenarit të "dëshiruar"

- Mbrojtja të tokave bujqësore
- Orientimi i zhvillimit të zonës urbane përgjatë aksit rrugor Junik-Voksh dhe kah zona kodrinore si dhe fshatrat Jasiq dhe Gjocaj
- Rritja e shfrytëzueshmërisë së tokës bujqësore nga 50% në 75%
- Krijimi i potencialeve turistike në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj
- Krijimi i një qendre informative për bazën e të dhënave për komunë e Junikut
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Identifikimi, mbrojtja dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore rezulton me integrimin e tyre në një koncept të përbashkët të quajtur "Juniku-Park Etnografik dhe natyror"
- Mbrojtja nga degradimi i mëtutjeshëm i lumenjve në komunë
- Menaxhim më i mirë i mbeturinave
- Krijimi i infrastrukturës funksionale të turizmit në përgjithësi (shtigjet e ecjes, teleferikët, shtigjet e skijimit, shenjëzimi, orientimi i turistëve)
- Promovimi i resurseve natyrore përmes turizmit
- Inicimi i bashkëpunimit ndërshtetëror për politikat mjedisore
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal
- zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik
  - Shfrytëzim të kontrolluar të pyjeve, të menaxhuara nga komuna
  - Rritje të prodhimit të tokës bujqësore: kontrollohet destinimi i tokës bujqësore
  - Rritje e shpejtë e bletorisë dhe bletarisë
  - Shfrytëzim i potencialit ujor (energji alternative)
  - Ofrimi i mundësive për shfrytëzim të potencialit kult-natyror në favor të zhvillimit të turizmit
- Ngritje e zhvillimit ekonomik në zonën urbane (krijimi i zonës industriale); ndërlidhje me aktivitetet ekonomike jashtë zonës urbane (zonën urbane dhe rurale plotësojnë njëra tjetrën)
- Qyteti i Junikut do të jetë promotor i zhvillimit ekonomik
- Ofrohen mundësi punësimi
- Rritje të bashkëpunimit ndërkufitar (përmirësim i bashkëpunimit me Shqipërinë; krijohet mundësi ndërlidhjeje me Malin e Zi- Parku i Paqes; Fuqizohet bashkëpunimi ndërkomunal)
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike do të mundësojë qasje të lehtë në Junik dhe Bjeshkë
- Standard më të lartë të shërbimeve publike
- Përmirësim të transportit publik dhe shërbimit të tij; përparësi do t'i jipet këmbësorëve duke krijuar zgjidhje alternative për vetura (tranziti); zvogëlohet nevoja për përdorim të veturave sidomos brenda territorit të komunës

#### Mangësitë e skenarit të "dëshiruar" dhe kërkesat

##### Mangësitë:

- Turizmi masiv/ i pakontrolluar mund të ndikojë negativisht në shkatërrimin e bukurive natyrore
- Mungesa e pronës publike ku parashihet zhvillimi i aktiviteteve ekonomike dhe infrastrukturës fizike (mund të ketë probleme shpronësimi)

##### Kërkesat:

- kërkesë e madhe për resurse humane e financiare
- kërkesë e madhe për vetëdijësim
- kërkesë e madhe për zbatimin e ligjeve
- kërkesë e madhe për bashkëpunim dhe bashkërendim mes niveleve të ndryshme

## 4.2 STRUKTURA DHE LOKACIONI HAPËSINOR PËR ZHVILLIMIN DHE ORGANIZIMIN E ARDHSHËM – ZONIMI

### 4.2.1 Popullsia, banimi dhe vendbanimet

Juniku duke u bazuar në numrin e banorëve (9600) për të cilët ndahet buxheti i komunës nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave duke marrë parasysh trendin kosovar të shtimit vjetor prej 1.4% për periudhën për të cilën hartohet ky Plan pritet të ketë rreth 11 000 banorë (përfshirë edhe diasporën). Realisht, nëse merret e dhëna e ESK-së për numrin e banorëve rezident në Junik deri në 2023 pritet që në Junik të ketë rreth 6600 banorë (pra pa diasporën), respektivisht rreth 8 700 banorë me diasporën (llogaritur me të dhënat nga anketimi për PZHK-në).

Kjo do të thotë se zonat e vendbanimit në 15 vitet e ardhshme duhet të pranojnë edhe rreth 1200 banorë rezident, respektivisht 3270 banorë përfshirë diasporën. Aktualisht indeksi i shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës është shumë i madh në krahasim me numrin e popullsisë (~11 b/ha në zonën urbane dhe gjithsej vetëm 7 banorë në dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj) që do të thotë se nevoja për zgjerimin e sipërfaqes së ndërtimit nuk është edhe aq e madhe. Analizat nga Plani Zhvillimor Urban propozojnë zhvillimin e vendbanimit të qytetit bazuar në densifikimin e zonës së ndërtuar urbane duke ruajtur poashtu edhe tipologjinë e ndërtimeve dhe nuk propozohet ndërtim i lartë banesor. Korniza e zhvillimit hapësinor e Junikut mundëson shfrytëzim racional të hapësirës, zvogëlon koston e infrastrukturës fizike dhe mundëson shfrytëzimin e infrastrukturës sociale ekzistuese që është në parametrat e pranueshëm. Trendet e zhvillimit janë duke treguar tendenca të shtrirjes së banimit në zonën me tokë bujqësore. Kjo dukuri duhet penguar. Për këtë arsye korniza e zhvillimit hapësinor të Junikut propozon mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet dhe propozon zona të reja ndërtimi në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj të cilat i parasheh të zhvillohen si fshatra turistike. Rivitalizimi i fshatrave Jasiq dhe Gjocaj në një rënë anë, lidhet ngushtë me kthimin e familjeve respektivisht me trajtimin e vendbanimit joformal Lagja “Agim Ramadani” por me parakushtin e krijimit të kushteve për kthim meqë në këto dy fshatra ka ende prezencë të minave. Gjithashtu ka nevojë edhe për investime në ofrimin e infrastrukturës fizike.

### 4.2.2 Infrastruktura sociale

Marrë parasysh prognozën demografike, korniza e zhvillimit hapësinor parasheh këto zhvillime sa i përket ofrimit të infrastrukturës sociale:

- **Arsimi:**

- Institucionet parashkollore: Juniku ka nevojë për një çerdhe të fëmijëve meqenëse kjo mungon dhe ka kërkesa për këtë shërbim. Arsimi parashkollor zhvillohet në paralelet në kuadër të shkollës fillore. Me ndërtimin e objektit parashkollor, çerdhja dhe paralelet për arsim parashkollor mund të planifikohen në një objekt.
- Institucionet për arsim fillor: Analizat në profil kanë treguar përparësi sa i përket objekteve dhe arritjes (afërsisë) së tyre në parametrat e pranueshëm. Duke u bazuar në standardet për shkolla fillore, në Junik (për popullsinë e parashkuar) nuk ka nevojë për shkolla të reja fillore.
- Institucione për arsim të mesëm: Nëse nisemi nga kriteri një shkollë e mesme për 18 000 banorë, nevojat për arsim të mesëm plotësohen me hapësirat e shkollës ekzistuese. Pra nuk ka nevojë për shkollë të re për arsim të mesëm për periudhën e planifikuar me PZHK.
- Institucionet për arsimim profesional: rekomandohet krijimi i kushteve për shkolla profesionale në fushën e turizmit, artizanateve, gastronomisë, agrikulturës, energjisë alternative etj.

- **Objektet shëndetësore:**
  - Objekti i QKMF-së mbulon me shërbime gjithë territorin e Junikut. Shikuar kriterin 1 QKMF për 100 000 banorë, një QMF për 10 000 banorë dhe ambulanca në fshatra/lagje me më shumë se 2000 banorë nënkuptohet se nuk ka nevojë për objekte të reja të shëndetësisë në Junik.
- **Objektet e religjionit:**
  - Analizat nga profili kanë treguar se objektet ekzistuese të religjionit kanë kapacitet të mjaftueshëm dhe plotësojnë nevojat aktuale të banorëve.
- **Objektet për kulturë, sport dhe rekreacion:**
  - Mungesa e këtyre hapësirave është adresuar si çështje e cila në mënyrë indirekte ka ndikim edhe në rritjen e migrimit të rinjëve. Koncepti i zhvillimit hapësinor parasheh ofrimin e këtyre hapësirave. Trendet e reja të projektimit të këtyre hapësirave, tregojnë tendenca të shfrytëzimit maksimal dhe propozojnë ndërtimin e objekteve multifunksionale të cilat mund të shfrytëzohen për muze, shtëpi kulture, bibliotekë, ofrimin e qendrave rinore apo edhe atyre të komunitetit etj. Juniku nuk ka mjaft hapësirë në pronësi publike prandaj parim themelor i planifikimit të këtyre hapësirave duhet të jetë ai i shfrytëzimit maksimal të hapësirës duke përkrahur projektimin e objekteve multifunksionale. Koncepti propozon sigurimin e hapësirave për sport dhe rekreacion dhe përkrah propozimet e dala nga PZHU. Hapësirat shkollore poashtu mund të sigurojnë hapësira për sport e rekreacion me shfrytëzim të organizuar jashtë orarit mësimor.
- **Objektet për çështje sociale dhe punësim:**
  - Juniku është Komunë e re dhe ende në konsolidim e sipër dhe ka nevojë për ngritjen e objekteve që adresojnë çështjet sociale përfshirë edhe ato për punësim. Analizat nga anketimi në terren të bëra për nevojat e PZHK-së, kanë treguar gjithashtu edhe për prezencën e të moshuarve që jetojnë vetëm duke adresuar kështu nevojën për përkujdesje ndaj tyre. Për plotësimin e nevojave të kësaj kategorie, është e nevojshme të sigurohet si fillim një zyre me personel i cili do të ofronte shërbim përkujdesjeje ndaj pleqve, kurse më vonë pas ndonjë analize detaje rreth kësaj problematike mund të paraqitet ndoshta edhe nevoja për ndërtimin e shtëpisë së pleqve.

#### ***4.2.3 Zhvillimi ekonomik, rigjenerimi, përfshirë turizmin, rekreacionin, tregtinë etj.***

Fusha e zhvillimit ekonomik në të gjitha sferat e në veçanti në turizëm dhe veprimtaritë përcjellëse të kësaj fushe, bujqësi përfshirë blegtorinë, pylltari dhe energji alternative si potenciale për zhvillim, është parë si prioriteti më i lartë për komunën e Junikut. Koncepti i zhvillimit hapësinor parasheh zhvillime në hapësirë në fushat e lartpërmendura.

- **Turizmi:**

Juniku ka potencial të llojllojshëm për zhvillim të turizmit kulturor dhe atij natyror (rekreativ, kurativ, eko-turizmit, ndërkufitar, turizmit alpin, rural dhe atij konferencial). Koncepti i zhvillimit hapësinor vë në pah lokalitetet me potencial turistik si: Moronica, Lugina e Erenikut, Gradina, Jedova, Gropa e Erenikut, Rrasat e Zogut, Burimi i Lumit Erenik dhe Liqejtë e Gjeravicës, Maja e Gjeravicës, Zharra, etj. Zhvillimi i turizmit kulturor lidhet ngushtë me trashëgiminë arkitektonike (prezencën e kullave tradicionale) dhe atë shpirtërore (ruajtja e dokeve, zakoneve, riteve etj). Zhvillimi i kësaj fushe natyrisht lidhet edhe me elemente tjera që i japin drejtimin turizmit. Këto elemente janë: qasja dhe mundësia e ardhjes në këto lokalitete turistike, gjë që lidhet kryesisht edhe me informacionet që iu jipen turistëve për të vizituar këto treva, transportin; pastaj elementi përmbajtësor turistik që kryesisht lidhet me resursin turistik por edhe aktivitetet që turistët mund të zhvillojnë aty si dhe elementi i infrastrukturës përcjellëse turistike si akomodimi, shërbimet hotelierike, ushqimi etj.

**Tabela 19: Lokalitetet turistike dhe potenciali turistik dhe objektet e propozuara**

Zona e Junikut			Zona Gryka e Junikut						Zona Gryka e Zharres	
Moronica	Hapsira urbane	Lugina e Erenikut	Gradina	Jedova	Gropa e Erenikut	Rrasat e Zogut	Burimi i lumit Erenik	Liqejtë e Gjeravicës	Fshatrat Gjocaj, Jasiq	Zharra
Turizmi i lokalitetit;	Turizëm kulturor	Turizëm rekreativ -sportet ujore	Turizëm rekreativ -sportet ujore - gjuetia	Turizëm rekreativ-kurativ -gjuetia -alpinizmi -çka me kurativ	Eko-turizmi Turizëm malor Turizëm ndërkufitar -ecja, shëtitja; -kampimi; - Kalërimi; - skijimi		Eko-turizëm, turizëm alpin (Maja e Gjeravicë), turizmi ndërkufitar -sportet malore (ngjitja në bjeshkë)		Turizmi rural, Eko-turizëm; Turizmi.konferencial Turizmi kulturor Turizmi rekreativ-gjuetia	Turizmi rural, Turizmi konferencial rekreativ-rehabilitues; eko-turizëm;
-Kopsht Zoologjik, -Kopsht botanik -Muze; -Kullat, mullinjte -Qendër rekreative			Qendër Turistike						Qendër rekreativ-rehabilituese Qendër konferenciale	

**Bujqësia dhe agroindustria:**

**Kultivimi i drithërave:** Bujqësia paraqet një veprimtari të rëndësishme dhe potencial zhvillimor në Junik por fatkeqësisht shënon kultivim të ulët të rendimenteve bujqësore. Konkurrenca joreale në treg, qasja e vështirë në tokat bujqësore, mos-organizimi i fermerëve, kreditë jo të favorshme, kapacitete të pamjaftueshme njerëzore në komunë në këtë fushë, mosinteresi i të rinjve për t'u marrë me këtë profesion etj., janë disa arsye të ngecjes së zhvillimit të bujqësisë. Koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor i komunës, e vendos mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë si prioritet të larta të zhvillimit të ardhshëm.

**Kultivimi i frutave:** Kultivimi, grumbullimi i frutave me theks të veçantë atyre pyjore (gështenjat, boronicat) dhe plasimi i tyre në tregjet e jashtme si dhe bimëve më veti shëruese është një mundësi zhvillimi.

**Agro-industria:** Krahas ruajtjes së këtij resursi, korniza e zhvillimit hapësinor rëndësi i kushton edhe zhvillimit të agroindustrisë në lokacionin e përcaktuar si zonë për prodhimtari në PZHU si dhe tregut të gjelbërt gjithashtu. Fuqizimi i sektorit të bujqësisë në kuadër të komunës, ngritja e kapaciteteve organizative të fermerëve, fushata vetëdijesimi etj., janë disa aspekte tjera zhvillimore të bujqësisë.

**Blegtoria:** Nga fusha e blegtorisë, bletaria është parë si veprimtari më shpresdhënëse dhe potencial për zhvillim pasuar me prodhimin e mjaltës. Zhvillimi i kësaj veprimtarie lidhet ngushtë me prodhimtarinë e pemëtarisë.

**Tabela 20: Zhvillimi i kulturave bujqësore sipas zonave:**

Zona 1: Bjeshkët	Zona 2: Pyjet	Zona 3: Vendbanimet, banimi, funksionet administrativo-shërbyese	Zona 4: Bujqësia
Bimët mjekësore;	Blegtoria (Bletaria); Pemëtaria; Bimët mjekësore;	Perimekultura; Pemëtaria;	Drithëra; Perimekultura; Kullosat;

- Pylltaria:** Potenciali i shfrytëzimit të drunjve në favor edhe të zhvillimit të industrisë së drurit dhe përpunimit final nuk është hulumtuar ende. Aktualisht ky potencial shfrytëzohet për nevoja të ngrohjes dhe menaxhohet nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës. Korniza e zhvillimit hapësinor, në zhvillimin e kësaj fushe ekonomike, fokusin e ka në menaxhimin e këtij resursi nga Komuna dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve, pyllëzim dhe ripyllëzim të zonave të zhveshura si dhe hulumtimin për zhvillimin e industrisë së drurit dhe përpunimit final. Për të arritur këto duhet të aplikohen praktikat që përfshijnë shumë palë në interes në modalitetet e shumë llojshme të menaxhimit të pyjeve si dhe të aplikohet menaxhimi i sektorit privat dhe decentralizimi i përgjegjësisë që kanë të bëjnë me pyjet.
- Energjia alternative:** Shtylla e katërt e zhvillimit ekonomik në Junik, bazohet në zhvillimin e energjisë alternative fillimisht me fokusin në ndërtimin e tri hidrocentraleve të vogla pasuar edhe me hulumtimin për mundësi të tjera të shfrytëzimit të energjisë alternative (energjisë së erës, diellit, prodhimit të biomasës, etj.)

#### ***4.2.4 Infrastruktura fizike, transporti, komunikimet dhe shërbimet publike***

Infrastruktura rrugore përbrenda kufijve urban, është trajtuar në PZHU. Fokusi kryesor në PZHK i është dhënë rrugës tranzit, hapjes së re të rrugës lokale "Te Udhë e Kuqe" e cila siguron dalje në rrugën regjionale si dhe infrastrukturës rrugore dhe asaj për këmbësorë për qasje në Bjeshkë. Korniza e zhvillimit hapësinor poashtu merr parasysh edhe propozimet nga PZHK-të e Komunave fqinje dhe Planit Hapësinor të Kosovës në lidhje me infrastrukturën dhe transportin rrugor, hekurudhor (lidhja hekurudhore e propozuar Gjakovë-Deçan-Pejë); dhe atë ajror (aeroporti i propozuar civil i Gjakovës). PZHK rithekson propozimet e dala nga PZHU në lidhje me transportin publik dhe infrastrukturën e këmbësorëve.

Prioritet i lartë i jepet edhe përmirësimit dhe shtrirjes së shërbimeve publike në gjithë territorin e komunës së Junikut me theks të veçantë kompletimit të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza dhe menaxhimit më të mirë të mbeturinave me marrjen e këtij shërbimi në kompetencë të komunës dhe themelimin e ndërmarrjes komunale për këtë shërbim. Në lidhje me rrjetin e telekomunikimit përfshirë telefoninë, televizionin, internetin si dhe rrjetin energjetik, korniza e zhvillimit hapësinor propozon kryesisht përforcim dhe përmirësime të këtyre shërbimeve.

#### ***4.2.5 Mjedis i përfshirë trashëgiminë natyrore dhe resurset, peizazhet, etj***

Resurset natyrore (Bjeshkët e Junikut, Maja e Gjeravicës, Liqejtë e Gjeravicës, lumenjtë) dhe peizazhet (lumore, fushore, bujqësore) mund të shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve sportive, rekreative madje edhe rehabilituese. Lokalitetet me potencial për zhvillimin e turizmit natyror dhe aktiviteteve që mund të zhvillohen aty janë cekur më lart në pjesën e turizmit. Është me rëndësi të potencohet se zhvillimet e ardhshme në turizëm duhet të mos shkatërrojnë këto resurse dhe biodiversitetin që ndodhet në Junik. Shpallja e Alpeve Shqiptare Park Nacional do t'i kontribuonte shumë ruajtjes së vlerave natyrore të zonës dhe zhvillimeve të ardhshme. Rregullimi i shtretërve të lumenjve me intervenime me materiale natyrore të lokalitetit e jo të betonit, mbrojtja e peisazheve bujqësore, ruajtja e livadheve dhe mirëmbajtje e rregullt e tyre (mbjellja e barit, kositja etj), mbrojtja e pyjeve nga prerja e pakontrolluar e drunjve duke penguar kështu erozionin, aktivitetet e pyllëzimit dhe ripyllëzimit etj janë vetëm disa propozime të propozuara në koncept.

#### ***4.2.6 Rreziqet natyrore, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera***

Në profilin e zhvillimit hapësinor të Junikut zonat e rrezikuara nga vërshimet, erozioni, zjarret, minat dhe tërmetet janë identifikuar dhe lokalizuar. Korniza e zhvillimit hapësinor i deklaronte këto si zona në të cilat duhet ndërmarrë veprime të menjëhershme për të arritur siguri dhe lëvizshmëri të banorëve. Veprimet dhe masat për parandalimin e fatkeqësive dhe rreziqeve natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu janë të përshkruara më detajisht në kapitullin e strategjive të veprimit dhe dispozitat për zbatim.

#### ***4.2.7 Trashëgimia kulturore***

Korniza e zhvillimit të ardhshëm hapësinor e Junikut në fushën e trashëgimisë kulturore vë më shumë në pah nevojën për të pasur zhvillime që ndërlidhen me aspektin e institucionalizimit të trashëgimisë dhe vendosjen e një sistemi funksional për mbrojtjen e saj po nuk lë anash as propozimet për restaurim, promovim, marketing, rëndësinë e krijimit të databazës si dhe përkrahjen e projekteve që promovojnë vlerat e trashëgimisë kulturore përfshirë trashëgiminë shpirtërore (zakonet, doket, ritet, vallet, muzika dhe shprehjet artizanale dhe artistike të Junikut) si dhe ato projekte që ndërlidhen me kultivimin e gastronomisë.

#### 4.3. SHËNIMI I ZONAVE URBANE EKSISTUESE DHE TË PROPOZUARA PËR TË ARDHMEN DHE NDËRTIMIN E ZONAVE JASHTË ZONAVE URBANE

Ky Plan për periudhën që hartohet nuk propozon zgjerim të zonës urbane, pra zona urbane mbetet në kufijtë e përcaktuar me PZHU. Për popullsinë e parashikuar, zonat e vendbanimit në 15 vitet e ardhshme duhet të pranojnë rreth 1200 banorë, respektivisht 3270 nëse llogaritet edhe diaspora. Korniza e zhvillimit hapësinor të Junikut propozon dy rezerva kapacitetesh në lidhje me ndërtimet e reja: ato në zonën ekzistuese dhe zonën e re ndërtimore të propozuar për banim dhe ndërtim.

1. Ndërtimet në kuadër të **zonës ekzistuese** urbane - ku ka mundësi dendësi në hapësirat e zbrazëta (sipas rekomandimeve të PZHU-së dhe PRRU "Qendra". Kjo zonë veç ka infrastrukturë ekzistuese dhe qasje në shërbimet publike

2. **Zona e re** e ndërtimit jashtë zonës urbane janë dy sosh:

i. Zona e re e ndërtimit **në funksion të banimit** në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj - e cila mund të akomodojë një pjesë të konsiderueshme të njërive të banimit. Zhvillimi i kësaj zone për banim nga njëra anë lidhet ngushtë me konfiguracionin gjeografik, kushtet e përshtatshme nga aspekti sizmik dhe pedologjik e nga ana tjetër me mundësitë për zhvillim ekonomik me fokus në potencialin turistik (mundësi të zhvillimit të turizmit rural, ekoturizmit, turizmit konferencial dhe atij rekreativ) dhe atë blegtoral. Zhvillimi i kësaj zone për banim do t'i kontribuojë ruajtjes së tokës bujqësore andaj hartimi i PRRU për këto vendbanime me qëllim të zhvillimit të investimeve imediate në këtë zonë duhet parë si prioritet;

ii. Zona të reja të ndërtimeve **në funksion të zhvillimit të turizmit dhe rekrejimit** (eko-turizmit, turizmit alpin, sportivo-rekreativ dhe atij kurativ (Kopshti zoologjik në Moronicë, qendra rekreativo-rehabilituese në lokalitetin Zharra, qendër konferenciale etj). Planifikimi i këtyre zonave përmes hartimit të PRRU-ve në harmoni me dispozitat për zbatim të këtij Plani është poashtu prioritet.

Zhvillimet të cilat ndodhin jashtë zonës urbane duhet të ndjekin procedurën e posaçme bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor. Kushtet për rregullimin e këtyre hapësirave janë dhënë më detajisht në pjesën e dispozitave për zbatim (në veçanti paragrafin 5.2.2).

#### 4.4. SHËNIMI I NDËRTIMEVE TË RËNDËSISHME, PROJEKTEVE STRATEGJIKE OSE ZONËS SË VEÇANTË E CILA VEÇ ËSHTË APROVUAR NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS OSE PLANET E ZONAVE TË VEÇANTA

Plani Hapësinor i Kosovës për zonën në të cilën ndodhet Juniku ka përcaktuar "Kullat e Dukagjinit" dhe Parkun Nacional "Bjeshkët e Nemuna" si zona me interes të veçantë për të cilat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të hartojë Planet Hapësinore për Zonat e Veçanta.

Projekte respektivisht veprime të parapara me Projekt Planin Hapësinor të Kosovës të rëndësishme për Junikun janë:

- reduktimi i ndotjes së lumit Erenik i cili pritet të ketë në fazën e parë trajtim primar (2013-2015) dhe trajtim terciar (2018-2019)- shih PHK fq 166
- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në 7 qendrat regjionale, në rastin konkret të Junikut me rëndësi është ai i Gjakovës (ndikim indirekt-PHK fq 166)
- Hapja e vendkalimit të ri kufitar në Kozhnjer: Ndërtimi i rrugës Deçan-Kozhnjer-Mal i Zi (projekt me ndikim indirekt për Junikun- PHK fq.176)
- avancimi i Aeroportit të Gjakovës në aeroport civil (projekt me ndikim indirekt në Junikun- PHK fq 176)

#### 4.5.VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK-MJEDISOR I KORNIZËS SË PROPOZUAR

*Shënim:* Kjo pjesë e Planit së bashku me vlerësimin e strategjive dhe projekteve është elaboruar më gjerësisht në raportin e bashkangjitur në Plan. Një studim i tillë është nxitur pjesërisht nga kërkesat ligjore dhe më tepër nga dëshira për të vlerësuar më detajisht ndikimet e kornizës dhe propozimeve të Planit në mjedis, ekonomi, shoqëri. Në anën tjetër, Ligji i miratuar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor –VSM (Nr.03/L-015) deklaron se hartimi i raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) është i detyrueshëm për të gjitha Planet dhe Programet, të cilat ka të ngjarë të kenë efekte të rëndësishme mjedisore (neni 4.1). Përveç kësaj, Ligji mbi VSM aktualisht është duke u ndryshuar<sup>25</sup> dhe ka mungesë të udhëzimeve të mëtutjeshme që e ndihmojnë zbatimin e saj. Në fund, sipas udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor<sup>26</sup>, është marrë një vendim mbi hartimin e raportit “Vlerësimi i ndikimeve” (VN), që bën vlerësimin e ndikimeve socio-ekonomike dhe mjedisore të PZHK-së. Si rezultat i kësaj, Komuna e Junikut përfiton një studim që do t’u ndihmojë atyre në procesin e vendimmarrjes në të ardhmen, dhe e cila do t’i dedikohet përmirësimit socio-ekonomik dhe performancës mjedisore në rritjen e vetëdijes në sektorët e zhvillimit, si dhe fton dhe udhëzon ndryshime në qëndrimet vendimmarrëse.

Përfundimi i përgjithshëm i argumentuar në këtë raport është se korniza e propozuar e zhvillimit hapësinor për Junikun 2011-2023+, do të ndikojë pozitivisht dhe përmirësojë kushtet socio-ekonomike dhe mjedisore në Komunë. Megjithatë, është tepër e rëndësishme që vendim-marrësit komunal të ndjekin rekomandimet që janë të paraqitura në këtë Dokument, në mënyrë që të shtohen në maksimum avantazhet e supozuara.


Shih gjerësisht raportin “Vlerësimi i ndikimeve socio-ekonomike, mjedisore të PZHK-së” në aneks.

---

<sup>25</sup> Në kohën kur është hartuar ky raport, Ligji për VSM ka qenë në procedurë të amendamentimit.

<sup>26</sup> Takimi me zyrtarët e MAPH, qershor 2010

Harta 12: Korniza e zhvillimit hapësinor të Junikut 2011-2023+



## 5. STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

Kjo kaptinë formulon pakon e strategjive dhe veprimeve për të arritur qëllimet dhe objektivat e zhvillimit hapësinor në Junik.

### 5.1. STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT

#### A: STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZHVILLIMIN SOCIAL DHE INFRASTRUKTURËN SOCIALE

Nga aspekti i gjendjes sociale sfida më e madhe për komunën e Junikut është niveli i lartë i papunësisë (77.24% e popullsisë aktive për punë) dhe migrimi, krahas përparësive që popullsia është mjaft e re me rreth 51% nën moshën 25 vjeçare dhe 58% e popullsisë aktive për punë. Niveli i punësimit shënon shifrën me vetëm 22.76% të popullsisë aktive të punësuar dhe një raport të ulët 1:5 punësimi të femrave ndaj meshkujve. Sfida tjetër, ka të bëjë me mungesën e infrastrukturës sociale, sidomos hapësirave që ndërliken me kulturë, sport e rekreacion. Deklarata e vizionit e shpreh këtë aspekt të zhvillimit. Parimet që PZHK promovon janë barazi sociale, kualitet jetësor më të lartë dhe mirëqenie sociale, zhvillim të qëndrueshëm, qasje të integruar në planifikim dhe transparencë ndaj dhe propozon strategjitë për të ofruar zgjidhje në sfidat e lartpërmendura:

#### STRATEGJIA A1: PËRMIRËSIMI I GJENDJES SOCIALE DHE EKONOMIKE

Ulja e shkallës së papunësisë dhe migrimit; Ngritja e kapaciteteve profesionale; Sigurimi i punës sezonale janë objektivat që për synim kanë përmirësimin e gjendjes sociale dhe ekonomike për banorët e Junikut. Në lidhje me këtë strategji propozon që:

- Përmes planifikimit hapësinor të krijohen mundësi për zhvillimin ekonomik sidomos në disa sektorë të caktuar (shih më gjerësisht strategjinë 4 dhe projektet që do të zhvillohen në këta sektorë), zhvillim ky që do të ndihmonte ngritjen e mirëqenies sociale dhe krijonte mundësi punësimi dhe vet-punësim.
- Një mundësi tjetër për punësim është edhe shikimi i mundësive për punësim sezonal. Aktivitetet që duhet ndërmarrë përfshirë lobimin më intensiv prej institucionit Komunal që të sigurohet rritje e numrit të të punësuarve prej komunës së Junikut.
- Zhvillimi i bujqësisë dhe turizmit në veçanti që paraqesin potencialet e ardhshme për zhvillim kërkojnë edhe njohuri të reja në këtë fushë dhe fushat që ndërliken me to si marketingu, promovimi si dhe veprimtaritë shërbyese/hoteliere. Prandaj është e domosdoshme të punohet në ngritjen e kapaciteteve humane për t'u përballur me zhvillimet e reja të mundshme dhe krijimit të mundësive për punësim.
- Strategjia gjithashtu propozon veprime që kanë të bëjnë me aspektin e organizimit, sidomos ato që i kontribuojnë avancimit të gruas për të qenë kontribuuese në zhvillim ekonomik dhe punësim. Organizimi i gruas në formë shoqate apo tjetër, është ngritur si domosdoshmëri dhe nevojë për t'i hapur asaj rrugë dhe mundësi punësimi.<sup>27</sup>

#### STRATEGJIA A2: PËRMIRËSIMI I KUALITETIT TË JETËS PËRMES NGRITJES SË HAPËSIRAVE DHE OBJEKTEVE PUBLIKE

Ofrimi i kushteve më të mira arsimore, kulturore dhe sportive si dhe hapësirave të tyre (bibliotekë, qendër rinore, teatër, salla dhe hapësira sportive etj); Ngritja e kualitetit të hapësirave publike (sheshe, fushëlojëra, etj) do të mundësojnë përmirësimin e kualitetit të jetës dhe kushteve të hapësirave më të mira sidomos për të rinjtë junikas dhe sado pak do të zvogëlonin dëshirën e të rinjëve për migrim. Strategjia propozon projektet si:

- Ndërtimi e çerdhes së fëmijëve

<sup>27</sup> Gjate procesit të hartimit të PZHK-es në Junik janë themeluar dy shoqata të grave (OJQ "Rrenja" dhe OJQ "Qershiza") të cilat kanë qenë pjesëmarrëse aktive në tubimet e prezentimit të planit.

- Ndërtimi i objektit shumëqëllimor- biblioteka, shtëpia e kulturës, qendra rinore
- Ndërtimi i sallës së sporteve dhe terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura (shfrytëzim max.i terreneve ekzistuese përfshirë terrenet sportive shkollore)
- Ndërtimi i Muzeut të Qytetit
- Projekte që promovojnë/masivizojnë aktivitetet kulturo-sportive
- Formimi i një zyre/qendre që ofron kujdes ndaj pleqve

### **STRATEGJIA A3: ZHVILLIMI I SHOQËRISË INFORMATIVE, MË TË ORGANIZUAR DHE PJESËMARRËSE NË VENDIMARRJE**

Në ditët e sotme kur shoqëria duke iu falënderuar teknologjisë moderne dhe sistemit informativ është duke u transformuar në shoqëri informuese (information society) dhe më të organizuar, padyshim që ofrimi i qasjes më të lehtë në informata dhe komunikim, krijimi i bazës së të dhënave përmes një sistemi informativ që do të mundësojë azhurnimin më të lehtë të të dhënave paraqesin një domosdoshmëri më shumë se sa nevojë për t'i kontribuar komunës të jetë e prezantuar në vend, rajon e më gjerë me vlerat dhe asetet e saj karakteristike. Projektet dhe veprimet që strategjia propozon për të arritur këtë synim janë:

- Hapja e zyrës publike për informim dhe këshilla për qytetarë përfshirë punësimin e stafit dhe ngritjen e kapaciteteve të kuadrit punues të zyrës
- Përkrahja e projekteve të shoqatave, organizatave joqeveritare apo komunitare të cilat promovojnë vlera të mirëfillta dhe zhvillim të shoqërisë
- Publikimi i rregullt i Buletinit të Komunës

## **B: STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK**

Siç është potencuar në analizën e gjendjes, Juniku nuk ka ekonomi të zhvilluar sa duhet. Por pozita ndërkufitare që ka, pasuritë natyrore dhe vlerat e trashëgimisë kulturore, janë mundësi e mirë për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të bazuar kryesisht në turizëm, bujqësi përfshirë blegtorinë, pylltari dhe energji alternative (hidro-energjetika, prodhimi i biomasës). Sfida kryesore është si të përfitohet nga asetet natyrore dhe kulturore dhe të shfrytëzohet pozita ndërkufitare në favor të zhvillimit ekonomik por duke edhe mos dëmtuar vlerat dhe mjedisin ku ndodhen ato. Vizioni i zhvillimit të ardhshëm e shpreh qartë këtë aspekt, ndaj dhe synimet kryesore janë që zhvillimi ekonomik të ketë një ngritje në veçanti në sektorët e lartpërmendur. Strategjitë për të arritur këto synime janë:

### **STRATEGJIA B1: ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK NË VEÇANTI NË SEKTORËT BUJQËSI, TURIZËM, PASUAR ME PYLLTARI DHE ENERGJI ALTERNATIVE**

Zhvillimi i sektorit të turizmit dhe shërbimeve përcjellëse turistike, avancimi i sektorit të bujqësisë dhe zhvillimi i agrobiznesit, rritja e shfrytëzueshmërisë së tokës bujqësore duke parandaluar edhe humbjen e saj, shtrirja dhe përmirësimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore dhe qasje më e lehtë në to, promovimi i produkteve bujqësore, fuqizimi i sektorit privat në zhvillimin e agro-biznesit, rritja e sektorit të blegtorisë, menaxhim i plotë i pyjeve nga komuna, përfshirë ngritjen e kapaciteteve organizative dhe zhvillimi i sektorit të energjisë alternative, janë objektivat e përcaktuara të PZHK në fushën e zhvillimit ekonomik. Projektet dhe veprimet që strategjia propozon për arritjen e objektivave në fushat kryesore zhvilluese për Junikun janë:

#### **Bujqësia dhe agrobiznesi:**

- Zhvillimi i agro-biznesit në zonën ekonomike të përcaktuar me lokacion sipas PZHU-së. Në këtë zonë mund të ndërtohet Parku i agro-biznesit, depoja për deponim dhe ruajtje të agro-produkteve, frutave pyjore dhe atyre me veti mjekuese. Strategjia propozon një studim fizibiliteti për këtë zonë për të hulumtuar se çfarë kulturash mund të kultivohen, si do të funksiononte kjo zonë, çfarë janë mundësitë e

ngritjes së një parkut-qendre të agro-biznesit me funksione edhe të hulumtimit dhe zhvillimit, mundësitë e punësimit etj. Komuna harton PRRU për këtë zonë.

- Strategjia propozon zhvillimin e projektit për rritjen e sipërfaqeve me pemë për 5 Ha në zonat rurale. Ky projekt do të mundësonte shfrytëzim më të mirë të tokës, krijonte mundësi punësimi dhe zvogëlonte nevojën për import të këtyre produkteve.
- Sektori privat në Junik duhet përkrahur për t'u zhvilluar dhe fuqizuar më tepër. Për të arritur këtë strategjia propozon masa stimulimi dhe lehtësi të cilat nevojiten të diskutohen dhe harmonizohen me bizneset. Aktualisht si biznes i tillë në Junik vepron vetëm Sigma biznesi i cili planifikon investime në zhvillimin e projektit të ashtuquajtur "Qershiza-Boronica e Junikut", Projekt ky që nënkupton edhe përpunim ekologjik të boronicës.
- Në lidhje me **shtrirjen dhe përmirësimin e sistemit të ujitjes së tokave bujqësore**, strategjia propozon:
  - Ndërtimi i pendës për ujitje tek Prita e Katundit si dhe riparimi pendave në Jaruha
  - Ndërtimin e kanaleve primare të ujitjes
- Projektet e ndërtimit të rrugëve të poshtëpërmendura, shihen si mundësi e mirë për zgjidhjen e problemit për **qasje më të lehtë në tokat bujqësore**.
  - Trasimi i rrugës së Tyrbisë
  - Shtrimi me zhavor i rrugës Miroc - Ulëza
  - Asfaltimi i rrugës Shafrane - Hybe
  - Shtrimi me zhavor i rrugës së arave te Prita e Katundit
- Në lidhje me **promovimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale** duke ofruar qasje në tregjet lokale dhe regjionale, strategjia duke u përputhur edhe me rekomandimin nga PZHU dhe strategjia e zhvillimit lokal, propozon:
  - Ngritjen e tregut për shitjen e produkteve ku do të përfshijë edhe aktivitetet e magazinimit dhe përpunimit të produkteve bujqësoro-blegtorale si dhe një qendër shpërndarëse ndoshta edhe për rajonin
- **Rritja e sektorit të blegtorisë:** parashihen projekte për shtimin e fondit të blegtorisë së imët, fushata vetëdijesimi për veterinarë dhe blegtorë për praktikatat moderne dhe frytdhënëse në blegtori, si psh. praktikatat që rezultojnë në përmirësimin e racës së kafshëve, vetëdijesimin mbi metodat e ngritjes dhe mirëmbajtjes së sektorit të blegtorisë nga profesionistë.
- **Ndikimi në organizim:** Organizimi i bujqve dhe fermerët në formë shoqate apo tjetër është me rëndësi. Kjo do ta bënte më të lehtë edhe komunikimin me Ministrinë gjegjëse dhe donatorë dhe ofronte mundësi për përfitimin nga subvencionet në këtë sektor. Aktualisht MBPZHR e përkrahur nga FAO është duke zhvilluar një projekt i cili trajton edhe aspektin e organizimit të fermerëve dhe bujqve. Në anën tjetër në komunën e Junikut ekziston edhe problematika e mungesës së Drejtorisë përkatëse pra të bujqësisë e cila do të vepronte si një urë lidhëse komunikimi me Ministrinë dhe fermerëve dhe bujqit lokal në zbatimin e politikave bujqësore dhe çështjeve tjera. Ministria e Bujqësisë përcjell standardet e BE në lidhje me shfrytëzueshmërinë e tokës bujqësore dhe këto standarde kërkojnë bashkëpunim më të madh të bujqëve rreth komasacionit të tokave bujqësore. Kjo më pas sjell lehtësi për bujqit të subvencionohen nga Ministria. Poashtu është e nevojshme të punohet edhe në vetëdijesimin e popullsisë për rëndësinë e kultivimit të tokës bujqësore, sepse aktualisht bujqësia nuk shihet nga të rinjtë si një profesion profitabil. Së këndejmi, projektet e mundshme që mund të ndikojnë në përmirësimin e kësaj gjendjeje janë:
  - Formimi i shoqatave të bujqve, fermerëve, përpunuesve dhe shitësve të prodhimeve bujqësoro-blegtorale
  - Themelimi i Njesisë apo Drejtorisë së Bujqësisë në kuadër të strukturës organizative të komunës
  - Aktivitete vetëdijesimi i popullsisë sidomos të rinjtë për beneficionet e Bujqësisë
  - Organizimi i trajnimeve në fushën e bujqësisë

### Pylltaria:

- **Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve duke fuqizuar kapacitetet komunale dhe strukturat tjera.**

Bartja e kompetencave nga Agjencia Kosovare e Pyjeve tek niveli komunal ka përfunduar. Transferimi i kompetencave për mbrojtjen e pyjeve dhe shfrytëzimin jep mundësi për të krijuar një situatë të re sidomos në pyjet në pronësi publike por në të njëjtën kohë edhe kërkon resurse njerëzore të përgatitura për marrjen e përgjegjesive. Modeli aktual i menaxhimit të pyjeve për t'u aplikuar në këtë situatë të re me kompetencat e decentralizuara për pyjet akoma nuk është i sqaruar. Veprimet që strategjia parashih në lidhje me hapat që duhet të ndërmerren në lidhje me këtë përfshijnë:

- Ngritja e kapaciteteve komunale për menaxhim të pylltarisë;
- Edukimi i gjeneratave të reja me njohuri elementare për menaxhim të pyjeve;
- Zhvillimin e fushatave ndërgjegjësimit për menaxhim dhe mbrojtjen e resurseve pyjore. Në projekte të tilla organizatat joqeveritare mund të sigurojnë shërbime të duhura, siç janë informacionet, vetëdijësimi, trajnimi, marketingu dhe shërbimet e praktikave të pylltarisë etj.
- Hartimi i planit të veprimit për menaxhimin e pyjeve. Gjatë hartimit të këtij plani është me rëndësi pjesëmarrja e të gjithë akterëve të rëndësishëm. Plani duhet të adresojë edhe aspektin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve si dhe aplikimi i praktikave të pyllit të fermerit duke përfshirë edhe certifikimin. Ai duhet përfshijë një mode bazë të të dhënave për pyjet dhe kullotat në nivel menaxhimi të komunës, si pjesë e kadastrës komunale. Të gjitha komunitetet dhe përdoruesit do të identifikohen brenda planit të menaxhimit të pyjeve.
- Studim fizibiliteti i shfrytëzimit të potencialit pyjor për zhvillim të mundshëm industrial, përpunim final dhe plasim të mëtejshëm. Veç tjerash ky studim duhet të përfshijë edhe aspektin e marketingut (funksionimit të tregut vendas, shtimin e vlerës, marrëdhëniet tregtare, fuqizimin e pozitës së pronarëve të pyjeve privat në treg), mundësitë për prodhimtari të dyta (bio-energji, bio-masë-prodhim dhe çipsave të drurit për ngrohje etj).

### Turizmi dhe shërbimet turistike

Duke pasur parasysh mos-shpalljen ende të Parkut Nacional të Bjeshkëve të Nemuna, për të cilin mandej Ministria e Mjedisit është e obliguar të hartojë Planin Hapësinor për atë zonë, Plan i cili do të jepte orientimet e duhura të zhvillimit të zonës që përbën një pjesë të konsiderueshme të territorit të Junikut, strategjia e PZHK-së së Junikut në mungesë të këtij Plani merr për bazë konceptin e zhvillimit të turizmit punuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me komunën dhe propozon projektet dhe veprimet e poshtëshënuara për zhvillim të turizmit. Projektet tjera që ndërlidhen me zhvillimin e turizmit përfshijnë:

- Hartimi i PRrU për lokalitetin Moronica dhe Luginën e Erenikut i cili duhet të përfshijë edhe rregullimin e shtigjeve, sinjalizimit dhe ndriçimit, vendosjen e ulëseve, ngritjen e një kopshti zoologjik, zhvillimin e produktit turistik të lokalitetit etj. Gjithashtu Plani duhet të ofroj zhvillimin e sporteve ujore dhe aktiviteteve për rekreacion (PZHU)
- Hartimi i PRrU-ve për lokalitetet Gradinë, Jedovë si dhe Burimi i Erenikut, Liqejtë e Gjeravicës dhe Rrasa e Zogut si zona ku mund të zhvillohet turizmi rekreativ (sportet ujore, gjyëtia, etj), eko-turizmi, turizmi ndërkufitar, turizëm alpin (Maja e Gjeravicës)
- Hartimi i PRrU-së për Zonën ku përfshihen lokalitet Gjocaj, Jasiq e Zharre me mundësi zhvillimit e ekoturizmit, turizmit konferencial, turizmi rural, përfshirë edhe ngritjen e një qendre rekreative-rehabilituese
- Ngritja e Qendrës Informuese për Turizëm dhe Marketing
- Përkrahja e projekteve që stimulimojnë zhvillimin e veprimtarisë artizanale
- Mbështetja e projekteve në kultivimin e gastronomisë tradicionale
- Mbështetja e zhvillimit të resurseve humane në fushën e turizmit

- Publikimi i hartave dhe guidave turistike
- Mbështetja për investime me partneritetit publiko-privat në turizëm
- Organizimi i manifestimeve të ndryshme që lidhen me promovimin e vlerave turistike në Junik
  - Dita e shënimit të Pavarësisë me aktivitetin “Vrapimi për Pavarësi”
  - Shënimi i Ditëve të Gjeravicës kombinuar me projektin për sinjalizimin turistik
  - Dita e Kullave
- Mbështetja e zhvillimit të resurseve humane në sektorin e turizmit me caktimin e një zyrtari komunal për turizëm dhe trashëgimi. Ky projekt nënkupton në vazhdimësi avancimin e tij/saj përmes trajnimeve dhe kurseve.
- Krijimi i lehtësirave dhe mundësive për investime në turizëm. p.sh për investimet në hotelieri do të kishte mundësi të shfrytëzohej Partneritetin publiko privat (PPP) në formën e dhënies me koncesion të tokës për ndërtimet e reja hotelierike apo edhe të qendrave turistike /stanet do të mund të epen me qira për shfrytëzim etj/

### Energjia alternative

Studimi i parafizibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentralet e vogla në Kosovë (2006), punuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave e më pas zhvilluar në dokumentin e strategjisë dhe projektet e hidrocentraleve të vogla në Kosovë (2009) propozon tri projekte të ndërtimit të hidrocentraleve të vogla në lumin Erenik, që kalon në komunën e Junikut.

- Projekti i hidrocentralit të Malit
- Projekti i hidrocentralit të Erenikut
- Projekti i hidrocentralit të Jasiqit

Strategjia poashtu propozon edhe:

- Hartimin e studimit të fizibilitetit për shfrytëzimin e energjisë alternative qoftë për përdorim në sektorin e ngrohjes qendrore, energjetikës (energja solare, energjia e erës), prodhimtarisë (biomasës) etj.

### STRATEGJIA B2: BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL DHE NDËRKUFITAR

Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar është një synim të cilin komuna parasheh ta arrijë në periudhën për të cilën hartohet ky Plan. Komuna do të shikojë mundësitë për të ngritur infrastrukturën ndërlidhëse me komunat dhe shtetet fqinje, mundësitë e bashkëpunimit për qasjen në fonde të jashtme dhe mbështetje në iniciativat/ projektet për bashkëpunim. Veprimet që ndërlidhen me zhvillimet në këtë fushë, para së gjithash, kanë të bëjnë me bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve me institucionet vendore, institucionet e vendeve fqinje dhe atyre ndërkombëtare që veprojnë përbrenda dhe jashtë Kosovës. Projektet/veprimet e mundshme për bashkëpunim përfshijnë:

- Zhvillimi i projektit Parku i Paqes që përfshin tri shtetet kufitare: Shqipëri-Kosovë-Mal i Zi
- Bashkëpunimi me Agjensionin për Zhvillim Regjional (AZHR) të Pejës në hartimin e projekteve të karakterit ndërkomunal-ndërkufitar
- Bashkëpunimi me komunat fqinje në projektet me interes të përbashkët (me theks të veçantë në fushën e ruajtjes së trashëgimisë, zhvillimit ekonomik, menaxhimit të pyjeve, ujërave, zhvillimit të turizmit etj.

### C: STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURË FIZIKE, TRANSPORT DHE SHËRBIME PUBLIKE

Analiza e gjendjes në komunën e Junikut, në lidhje me fushën e infrastrukturës fizike vë në pah nevojën e përmirësimit të lidhjeve ekzistuese me infrastrukturë rrugore mes Junikut me Pejën-Gjakovën (përmes rrugëve regjionale) dhe Deçanin përmes fshatit Voksh si dhe krijimin e lidhjes së re me Shqipërinë dhe Malin e Zi, përmes rrugëve malore. Nga aspekti i rrjetit të brendshëm, kjo çështje është trajtuar më detajisht me PZHU, duke vënë në pah nevojën për kompletimin e rrjetit të brendshëm rrugor, meqë ka ende shumë rrugë lagjeje të

paasfaltuara. Shërbimet e transportit publik në Junik ekzistojnë por siç potencohet edhe në PZHU mungon një terminal/stacion që do t'u mundësonte autobusëve dhe taksive të operojnë në mënyrë të sigurtë dhe ofrojnë informacion, vend-pritje për udhëtarë dhe autobusë, vendparkim, etj. Juniku nuk ka rrugë tranziti, kështu që, të gjitha automjetet e rënda për transportin e mallrave, shfrytëzojnë rrugën nëpër qendër të rrethqarkullimit të Junikut. Sfidë është mungesa e infrastrukturës së këmbësorëve, sinjalistikës si dhe infrastrukturës për transport jo-motorik. Në fushën e shërbimeve publike sfida kryesore ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve në zonat ku ato mungojnë si dhe përmirësimin e atyre që nuk ofrojnë shërbime kualitative. Një ndër parimet në të cilat PZHK bazohet është edhe promovimi i interesave të përbashkëta të banorëve të Junikut, me qëllim të ngritjes së kualitetit të jetës, ndaj dhe strategjitë e propozuara në vijim duhet të jenë konform këtij parimi dhe të orientuara drejt zgjidhjes së çështjeve të lartpërmendura.

### **STRATEGJIA C1: PËRMIRËSIMI DHE ZGJERIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE SIPAS KUSHTEVE TEKNIKE BASHKËKOHORE NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS DHE MË GJERË**

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore përmes hapjes së rrugës unazore (tranzitit); Ofrimi i qasjes më të lehtë në Bjeshkët e Junikut, krijimi i lidhjes rrugore me dy shtetet fqinje janë objektivat e përcaktuara me PZHK dhe për arritjen e tyre strategjia propozon këto projektet/veprime:

- Ndërtimi i rrugës tranzit për t'u përdorur për transport të rëndë dhe aktivitete industriale: aksi "Bajraktar-Gaxherr"
- Ndërtimi i segmentit rrugor që mundëson qasje të re në rrugën regjionale (rruga tek 'Udha e Kuqe')
- Asfaltimi i rrugës Junik-Nivokaz
- Ndërtimi i rrugës që shkon deri në Bjeshkë
- Hartimi i studimit të fizibilitetit për hapje të re të rrugës prej Bjeshkës deri në trekëndëshin Shqipëri-Kosovë-Mal i Zi. Hapja e kësaj rruge është çështje strategjike dhe për shkak të vendimeve politike dhe kostos financiare si dhe kompetencave (meqë rrugët e nivelit të tillë janë edhe kompetencë e Qeverisë) ky projekt kërkon edhe aprovim dhe mbështetje edhe nga Qeveria.
- Në zonën urbane, strategjia parasheh projekte për ndërtimit e rrugëve të përcaktuara me PZHU si dhe mirëmbajtjen e tyre

### **STRATEGJIA C2: PËRMIRËSIMI DHE SHTRIRJA E TRANSPORTIT PUBLIK URBAN DHE NDËRURBAN ME SHËRBIME DHE ELEMENTE PËRCJELLËSE SI DHE INFRASTRUKTURËS ADEKUATE PËR KËMBËSORË**

Arritja e lëvizshmërisë më të mirë përmes përmirësimit të shërbimeve të transportit publik dhe taksive që mund të kenë efekte në zvogëlimin e përdorimit të veturave, si dhe lehtësimi i qarkullimit për këmbësorë dhe personave me nevoja të veçanta, përmes ngritjes së sigurisë në trafik, janë objektivat e përcaktuara me këtë PZHK, por, edhe më detajisht me PZHU. Andaj, projektet dhe veprimet, disa prej tyre të cekura edhe në PZHU përfshijnë:

- Ndërtimi i stacionit të autobusëve në lokacionin e paraparë sipas PZHU
- Punimi i planit për qarkullimin e transportit publik dhe infrastrukturën e këmbësorëve
- Ngritja e infrastrukturës së këmbësorëve në zonën urbane e përcaktuar sipas PZHU
- Krijimi i infrastrukturës së këmbësorëve për zhvillimin e sportit dhe rekreacionit jashtë zonës urbane (rregullimi i shtigjeve për ecje-ngjitje në bjeshkë, çiklizëm, rregullimin e shtigjeve për kalërim, rregullimi i shtigjeve për zhvillimin e sporteve ekstreme p.sh ngjitjes me motorë, shenjzimi i pikave vrojtuese/soditëse dhe atyre me vlera kulturore) etj.

### **STRATEGJIA C3: OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE MË CILËSORE PËR BANORËT TË CILAT I KONTRIBUOJNË NGRITJES SË KUALITETIT TË JETËS**

Ofrimi i rrjetit primar të kanalizimit në gjithë komunën, kyçja edhe e 5% të familjeve në rrjetin e ujësjellësit, ngritja e kapaciteteve me energji elektrike dhe atyre me energji alternative si dhe zvogëlimi i ngarkesës në trafot ekzistuese, përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave si dhe promovimi i shfrytëzimit të energjisë alternative për

sistemin e ngrohjes dhe shtrirjen e tij, janë objektivat e përcaktuara për zhvillimet e ardhshme në këtë fushë. Programet, projektet dhe veprimet që strategjia propozon për arritjen e tyre janë:

- Kompletimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit
- Ndërtimi i rezervuarit për ujë: Gaxherr-Bajraktar
- Ndërtimi i dy trafostacioneve të reja që do të zvogëlonte ngarkesën në trafot ekzistuese
- Ndërtimi i hidrocentraleve (shih projektet e përmendura në paragrafin energjia )
- Themelimi i ndërmarrjes për menaxhimin e mbeturinave
- Hartimi i planit lokal për menaxhimin e mbeturinave (në referencë të ligjit për mbeturina nr.02/L-30) i cili do të shqyrtojë programet për mënyrat e grumbullimit, largimit, selektimit të mbeturinave, mundësinë e riciklimit si dhe çështjen e deponisë së mbeturinave përfshirë edhe programet për vetëdijesim
- Hartimi i programit për trajtimin e ujërave të zeza dhe atyre atmosferik
- Studim fizibiliteti për shtrirjen e sistemit të ngrohjes qendrore duke shqyrtuar edhe mundësitë e shfrytëzimit të materialeve me ndikim të vogël ekologjik në mjedis (biomasës, ...)

#### **D. STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR SHFRYTËZIM TË TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMIN**

##### **STRATEGJIA D1: MBROJTJA DHE SHFRYTËZIMI RACIONAL I TOKËS BUJQËSORE**

Profili i zhvillimit hapësinor të komunës së Junikut për këtë fushë, e vë në pah çështjen e humbjes së tokës bujqësore nga zhvillimet aktuale si nga fragmentimi i parcelave, ndërtimet e ndryshme, ndotja etj. Korniza e zhvillimit hapësinor ka përcaktuar zonën me tokë bujqësore si zonë ku, nuk do të lejohen ndërtimet që kanë qëllim banimi, por, vetëm ato të përcaktuara me ligjin e Ndërtimit. Informatat nga Instituti Seizmik, poashtu, tregojnë të dhëna se kjo zonë është zonë seismike në parametrat seizmik. Deklarata e vizionit e prezanton Junikun si një vend që ruan, zhvillon dhe promovon vlerat natyrore (në këtë rast tokën bujqësore si një resurs të rëndësishëm natyror) ndaj dhe qëllimet dhe objektivat e përcaktuara janë të orientuara kah mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i këtij resursi.

- Strategjia propozon mirëmbajtjen dhe evidentimin e tokës bujqësore në GIS si një mjet që në vazhdimësi do të përcjell gjendjen në terren dhe ofron informata në lidhje me humbjen apo edhe shfrytëzueshmërinë e tokës bujqësore dhe kulturave që zhvillohen në to. Kjo më tej do të rezultojë me hartimin e raporteve vjetore për gjendjen dhe shfrytëzueshmërinë e tokës bujqësore.
- Zhvillimi i projektit për Rregullimin e tokës bujqësore si mundësi (në referencë të ligjit për tokën bujqësore neni-24) i cili ka për qëllim bashkimin e ngastrave (komasacionit) të shkapërderdhura me qëllim të krijimit të ngastrave më të mëdha; përmirësimin e tokës përmes zbatimit të masave, agroteknike, agromeloriuese dhe hidromeloriuese; çasjes në infrastrukturën publike; krijimin e ngastrave në formë të rregullt gjeometrike; rregullimi i marrëdhënieve pronëso-ro-juridike, matjet e reja të tokës, krijimi i kadastrit të ri etj.
- Të rëndësishme të veçantë janë edhe aktivitetet dhe projektet që kanë të bëjnë me vetëdijesimin për ruajtjen dhe zhvillimin e këtij resursi.

Masat e propozuara:

- Zbatimi i Ligjit për Tokën Bujqësore dhe atij për Planifikim Hapësinor, të cilët ndalojnë ndërtimet në tokën bujqësore të kategorisë I-IV, kërkon monitorim dhe raportim të rregullt të gjendjes. Inspektimi në terren i ndërtimeve, për të parandaluar ndërtimet e mundshme dhe marrja e masave për zbatimin e ligjit, janë parakushte esenciale në parandalimin e humbjes së tokës bujqësore.

##### **STRATEGJIA D2: TRAJTIMI VENDBANIMEVE PËRFSHIRË EDHE VENDBANIMIN JOFORMAL**

Një ndër sfidat kryesore të identifikuar me Plan, është edhe aspekti i depopullimit, gati tërësisht i vendbanimeve Jasiq dhe Gjocaj, popullsia e së cilës është zhvendosur kryesisht në lagjen "Agim Ramadani" e cila edhe është identifikuar si vendbanim joformal. Siç është cekur në pjesën e profilit, arsyet e zhvendosjes së

banorëve të këtyre dy fshatrave lidhen edhe me shkatërrimin e zonës nga lufta dhe prezencën ende të minave në këtë zonë, mungesën e infrastrukturës fizike dhe sociale në këto vendbanime, kërkimin e kushteve më të mira të jetesës në qytet. Vizioni i komunës, shpreh edhe aspektin e ofrimit të një mjedisi të sigurtë dhe mirëqenien sociale dhe parimet mbi promovimin e interesave të përbashkëta të banorëve me qëllim të ngritjes së kualitetit të jetës dhe zhvillimit të qëndrueshëm, elemente këto që e mbështesin këtë vizion. Nga ana tjetër, trajtimi i vendbanimeve joformale është një obligim ligjor i Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Planit të veprimit për Partneritet Europian. Së këndejmi, strategjia propozon këto veprime:

- Hartimi i Planit Rregullues për të dy vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj të bazuara në konceptin e zhvillimit si zona banimi të kompletuara me infrastrukturë fizike dhe sociale por edhe si vendbanime me funksionin e zhvillimit të turizmit rural dhe aktiviteteve bujqësore.
- Strategjia propozon hartimin e programit për rregullimin e vendbanimit joformal “Agim Ramadani”, program ky që në fokus ka rregullimin e çështjeve pronëso- juridike, shikimin e mundësive për kthim të sigurtë të banorëve në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj duke krijuar parakushtet e nevojshme për kthim (deminimi i zonës, ndërtimin e shtëpive të shkatërruara gjatë luftës, ofrimi i infrastrukturës fizike (rrugë, ujësjellës, kanalizim) dhe qasje më të lehtë në infrastrukturën sociale).

### **STRATEGJIA D3: BANIMI DHE NDËRTIMET**

Siç është cekur në pjesën e profilit, gjendja e Junikut sa i përket banimit është relativisht e mirë. Kërkesa për sipërfaqe të reja të banimit nuk është dhe aq e madhe meqenëse ka mundësi të rritjes së dendësisë së banimit në kuadër të zonës urbane duke plotësuar hapësirat boshe në zonat e ndërtuara ekzistuese (ashtu siç është paraparë me PZHU). Korniza e zhvillimit hapësinor, parasheh shtrirjen e banimit në të ardhmen në zonën 3 (e cila përfshin qytetin e Junikut dhe vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj), dhe rekomandon pengimin e shtrirjes së banimit në zonën 4 e definuar si zonë bujqësore në të cilën mund të ndërtohen vetëm objektet me karakter bujqësor (shih më gjerësisht kapitullin e dispozitave për zbatim).

Strategjia përkrah veprimet e dala nga PZHU në lidhje me trajtimin e hapësirave të banimit dhe ndërtimet në kuadër të zonës urbane (shih më gjerësisht PZHU dhe PRrU për Qendrën) që parasheh dendësim të banimit duke shfrytëzuar hapësira të pashfrytëzuara apo ato të përdorura për funksione të tjera shërbyese e jo arritjen e dendësisë duke u zhvilluar në lartësi (lartësia maksimale e propozuar është 3 kate). Ndërsa, për banimin dhe ndërtimet jashtë zonës urbane, siç u përmend më lart, fshatrat Jasiq dhe Gjocaj në të ardhmen janë paraparë për banim ndaj dhe është propozuar hartimi i PRrU për këto dy fshatra. PRrU do të përcaktojë në detaje specifikat e banimit, tipologjinë e objekteve etj. mirëpo deri në hartimin e Planit Rregullues, komuna do të shfrytëzojë dispozitat për zbatim, të dhëna në pjesën e dispozitave për zbatim të PZHK-së, ku përshkruhen kushtet për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e komunës dhe kushtet për rregullimin e hapësirës (shih paragrafët 5.2.2.b në zonat ndërtimore për vendbanime dhe 5.2.2.c. Strukturat e ndërtuara jashtë vendbanimeve).

Nga ana tjetër, strategjia merr parasysh edhe zbatimin e ligjeve të kësaj fushe dhe kërkesave që dalin nga ato. Duke u ndërlidhur me këtë strategjia propozon:

- Trajtimin e hapësirave të banimit në zonën urbane sipas dispozitave të parapara me PZHU
- Hartimin e programeve komunale të banimit dhe planit të veprimit
- Hartimin e Rregullores dhe programit për rregullimin e ndërtimeve pa leje

### **E: STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR MJEDIS, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË**

Të dhënat në profilin e gjendjes tregojnë se, pavarësisht që gjendja mjedisore në Junik konsiderohet si relativisht e mirë, duhet ende të punohet në përmirësimin e saj. Dukuritë që më së shumti paraqesin rrezik mjedisor janë: fatkeqësitë natyrore (tërmeti, vërshimet, rrëshqitja e dheut, zjarret me theks të veçantë në pyje etj) si dhe aktivitetet njerëzore përmes të cilave shkatërrohen vlerat natyrore si: prerja e pakontrolluar e pyjeve,

mbeturinat dhe derdhjet e ujërave të zeza në ambiente të hapura dhe lumenj etj. Nga ana tjetër, Juniku ka resurse dhe vlera të shumta natyrore ndaj dhe ruajtja, zhvillimi i matur dhe përfitimi nga trashëgimia natyrore sidomos në sferën e turizmit, është gjithashtu sfidë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor. Juniku, sipas deklaratës së vizionit, mëton të jetë një vend i cili ruan, zhvillon dhe promovon vlerat e tij natyrore dhe të ketë një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm, ndaj dhe qëllimet/objektivat e përcaktuara synojnë këtë drejtim të zhvillimit. PZHK i Junikut mbështetet në parimin e promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili, i referohet shfrytëzimit me maturi të resurseve të ndryshme me qëllim që, ato të ruhen dhe përcillen tek gjeneratat e ardhshme. Së këtejmi strategjitë dhe veprimet e propozuara në vijim, duhet të jenë konform këtij parimi dhe të orientuara drejt zgjidhjes së sfidave të lartpërmendura.

### **STRATEGJIA E1: MBROJTJE DHE ZHVILLIM I QËNDRUESHËM MJEDISOR**

Kjo strategji ngërthen në vete objektivat si: zvogëlimi i ndotjes së lumenjve dhe tokës nga mbeturinat, mbrojtjen e pyjeve nga degradimi i vazhdueshëm dhe prerjet ilegale, mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (theks të vecantë mbrojtja nga zjarri dhe erozioni), shfrytëzimin e resurseve mjedisore të ripërtërishe dhe alternative për zhvillim lokal (energji e ujit, biomasës etj), zgjidhja e çështjes së deminimit, adresimi i problemeve të ndryshmeve klimatike etj. Veprimet e propozuara për arritjen e këtyre objektivave janë:

#### **Mbrojtja e mjedisit nga ndotja:**

- Themelimi i ndërmarrjes për menaxhimin e mbeturinave (projekti i njëjtë i propozuar tek fusha tematike mbi shërbimet publike)
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për fushën e mjedisit
- Hartimi i planit lokal të veprimit për mbrojtjen e mjedisit
- Aktivitete pastrimi dhe sensibilizim opinionit për mbrojtjen e mjedisit
- Përkrahja e projekteve të OJQ mjedisore
- Hartimi i planit lokal për administrim të mbeturinave në harmoni me planin strategjik (MMPH)

#### **Mbrojtja e pyjeve:**

- Hartimi i planit operacional për menaxhimin e pyjeve
- Projekte për ripyllëzimin e zonave të zhveshura dhe pyllëzimin e zonave të reja
- Zhvillimi i fushatave për ndërgjegjësimin ndaj mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve
- Ngritja e qendrës për pyllëzim/ripyllëzim e cila do të mirret me kultivimin e fidaneve që mund të shfrytëzohen për pyllëzim/ripyllëzim
- Caktimi i një pike për vëzhgim, informim, monitorim dhe mbajtjen e bazës së të dhënave

### **STRATEGJIA E2: MBROJTJA NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE ATO TË SHKAKTUARA NGA NJERIU**

**Mbrojtja nga zjarret:** Komuna ka një studim për mbrojtjen nga zjarri, nga i cili sygjerohen veprimet për mbrojtje dhe shpëtim. Veprimet tjera përfshijnë:

- Hartimi i planit për mbrojtje dhe shpëtim për gjithë komunën (në referencë të ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë).
- Fushatë e ndërgjegjësimit (seminare, leksione në shkollë, botimet (broshura, postera), debate televizive për mbrojtjen nga zjarret dhe parandalimin nga zjarri

Masat: Aplikimi i masave mbrojtëse kundër zjarrit sipas udhëzimit administrativ

**Mbrojtja nga erozioni:** Projektet për të parandaluar ose për tu mbrojtur nga erozioni përfshijnë:

- Projekte për pyllëzimin e zonave të zhveshura (njëjtë si projekti 4 në paragrafin mbrojtja e pyjeve)
- Vendosjen e rrjetave për mbrojtjen nga rrëshqitja e tokës (përgjatë rrugës në vendin Gurthi dhe ODA)

#### **Mbrojtja nga vërshimet:**

- Rregullimi i shtratit të lumit Erenik dhe vendosja e prioritetëve për zonat më të rrezikshme
- Hartimi i analizës për trajtimin e çështjes së përmytjeve në lagjen Tofaj dhe Prita e Katundit
- Riparimi i digës ekzistuese në lumin Trava

Masat: Marrja e vendimit për ndalimin e shfrytëzimit të rërës nga lumi nga Prita e Katundit deri në Tofaj

### **Mbrojtja nga termetet:**

- Përgatitjen e planit për mbrojtje dhe shpëtim për gjithë komunën (i njëjtë me projektin e lartëpërmendur).

Masat: Ndërmarrja e veprimeve për përforsim të ndërtesave ekzistuese në fushat me ndikim të lartë sizmik dhe rrëshqitjetoke, aplikimi i normave të stabilitetit në ndërtimet e reja, hartimi i mikrozonimit (i cili përcakton shkallën e sigurisë ndaj temeteve) gjatë fazës së projektimit për objektet banesore, komerciale, industriale; Inspektimi i rregullt në punimet e ndërtimit

### **Deminimi:**

- Aktivitete deminimi në bashkëpunim me qeverisjen qendrore, Forca e Sigurisë e Kosovës, Policinë, KFOR-in
- Fushatë ndërgjegjësimi për rreziqet nga minat dhe mënyrën e informimit

Strategjia poashtu propozon veprime që ndikojnë në mbrojtjen nga ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e biodiversitetit.

**Ndryshime klimatike:** Shumica e veprimeve në këtë fushë ndërlidhen me veprimet e propozuara më lartë dhe janë të listuara si vijon:

- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura
- Pyllëzimin e zonave të reja
- Vetëdijesimi dhe fushatat e sensibilizimit për mbrojtjen e pyjeve dhe zhvillimin e tyre
- Rregullimi i shtratit të lumit
- Fushatë ndërgjegjësimi për mbrojtjen nga zjarri dhe masat parandaluese kundër zjarrit
- Duke iu referuar projekteve për energjinë alternative: Ndërtimi i tre mini-hidrocentraleve për prodhimin e energjisë alternative
- Fushata e ndërgjegjësimit mbi efikasitetin e energjisë dhe ndikimin në ndryshimet klimatike
- Mbështetje e iniciativave për përdorimin e energjisë alternative dhe efikasitetit të energjisë (p.sh. për përmirësimin e izolimit në dritaret dhe dyert në institucionet publike, shtëpive, etj; përdorimin e burimeve të energjisë diellore, si shtesë të energjisë elektrike, përdorimi i dritave me sensor në ndriçimit publik etj) duke iu referuar veprimeve nga fusha e shërbimeve publike në lidhje me ngrohjen qendrore:
- Ndërmarrja e një studimi fizibiliteti për të futur një sistem të ngrohjes qendrore në Junik bazuar në bio-lëndë djegëse

### **STRATEGJIA E3: RUAJTJA E PEISAZHEVE DHE BIODIVERSITETIT:**

#### **Projektet:**

- Hartimi i planit për mbrojtjen e biodiversitetit për komunën e Junikut
- Përkrahja e projekteve të Shoqatave (shoqata e gjuetarëve) dhe OJQ për mbrojtjen e florës dhe faunës (projektet për pasurimin e faunës sidomos drenit të cilit i kanoset rreziku nga zhdukja dhe ushqimi i tyre gjatë dimrit); shtimit të fondit të egërsirave, mbrojtja nga sëmundjet;
- Ndërmarrja e fushatave për sensibilizim opinionit për mbrojtjen e florës dhe faunës dhe monitorimi i shfrytëzimit të boronicës dhe bimëve mjekuese, etj.

### **STRATEGJIA E4: FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL DHE NDËRSHTETËROR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

- Inicimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërshtetëror për politikën ambientale (Projekti Parku i Paqes) dhe veprimet e përbashkëta për mbrojtjen nga fatkeqësitë

## **F: STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR TRASHËGIMINË KULTURORE**

Siç është vënë në pah në pjesën e profilit, Juniku ka vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore me theks të veçantë të trashëgimisë arkitekturale (kullat, shtëpitë e gurit, mullinj), arkeologjike (lokaliteti arkeologjik Gradina) dhe asaj shpirtërore (traditat, zakonet popullore, ritet, festat etj). Përkundër asaj që një pjesë e konsiderueshme e këtyre vlerave është shkatërruar sot ende ekzistojnë vlera të tilla që tentojnë t'i rezistojnë zhvillimeve aktuale. Ndaj dhe sfida kryesore është se si të ruhen, zhvillohen dhe promovohen edhe më tej këto vlera. Deklarata e vizionit, fuqimisht e shpreh këtë aspekt të zhvillimit: *“Juniku, vend i traditës, që ruan, zhvillon dhe promovon vlerat e tij kulturore, historike...dhe me turizëm të zhvilluar;...”* dhe qëllimet/objektivat e përcaktuara poashtu strategjitë dhe veprimet për të arritur qëllimet/objektivat e përcaktuara janë:

### **STRATEGJIA F1: MBROJTJA DHE FUNKSIONALIZIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE**

Për arritjen e objektivave të përcaktuara si: identifikimi (inventarizimi) i gjithë fondit të trashëgimisë kulturore të komunës; vetëdijesimi i popullatës mbi vlerat kulturore-historike të Junikut; Mbrojtja trashëgimisë kulturore nga shkatërrimi; si dhe jetësimi/funksionalizimi i vlerave të trashëgimisë kulturore në favor të zhvillimit të turizmit kulturor,veprimet e propozuara janë:

### **FUNKSIONALIZIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE**

- Ngritja e kapaciteteve komunale për bashkëpunim dhe koordinim me Qendrën Rajonale për Trashëgimi në Pejë, rreth inventarizimit, mbrojtjes së trashëgimisë dhe monitorimit të zbatimit të Ligjit mbi Trashëgiminë Kulturore . Kjo nënkupton që komuna duhet të ketë staf të punësuar për këtë punë
- Pjesëmarrja aktive e Komunës në aktivitetet e autoriteteve qendrore në hartimin e politikave për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitekturale

### **BAZA E TË DHËNAVE DHE INVENTARIZIMI**

- Propozim lista e inventarizimit të trashëgimisë kulturore dhe databazës krijuar nga komuna për nevojat e PZHK-ë të koordinohet me procesin e inventarizimit me Qendrën Rajonale për Trashëgimi në Pejë dhe mirëmbahet rregullisht

### **MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE**

- Dhënia e statusit të objekteve nën mbrojtje të përhershme dhe përkohshme (se cilat objekte mund të kenë këtë status kjo mund të definohet mbasi të jetë bërë kategorizimi së bashku me Qendrën Rajonale për Trashëgimi në Pejë dhe pas konsultimit me Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore)
- Gjetja e formave të partneritetit publiko-privat të cilat do të ofronin mundësi të konservimit, përfshirë mirëmbajtjen e objekteve me vlera kulturore
- Ndërtimi i Muzeut të Qytetit (restaurimi i ndonjë kulle për këtë qëllim)
- Restaurimi, konservimi i kullave dhe vëria në funksion publik (bibliotekë, qendër informative turistike, rinore, objekte hoteliere etj)
- Shenjëzimi i lokaliteteve atraktive të trashëgimisë kulturore-natyrore për vendas dhe turistë

### **PROMOVIMI DHE MARKETINGU**

- Funksionalizimi i Qendrës Turistike të informimit (përfshirë punësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit) si dhe krijimi i mekanizmave propagandues dhe promovues të trashëgimisë junikase (OJQ, asociacione, etj) të cilat do të përfshihen në rrjetet lokale dhe ndërkombëtare turistike
- Manifestimi tradicional i Ditës së Kullave të Junikut i cili do të përfshinte edhe forume debatuese të rregullta me pronarë të kullave dhe pjesëmarrës tjerë për ruajtjen dhe funksionalizimin e kësaj trashëgimie, etj

- Publikimet e ndryshme dhe organizime të aktiviteteve qoftë në formë të ekspozitave, panairove, koncerteve, festave apo tjetër ku mund të prezantohet trashëgimia kulturore përfshirë atë shpirtërore (zakonet, doket, ritet, vallet, muzika, kënga dhe shprehjet artistike-artizanatet, zejjet etj)
- Përkrahja e Projekteve që stimulojnë zhvillimin e veprimtarisë artizanale dhe kultivimin e kuzhinës tradicionale

**Masat:**

- Komuna ndërmerr masa stimuluese për jetësimin e resurseve të trashëgimisë kulturore (lirimi nga tatimi në pronë për objektet e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme apo të përkohshme) /në referencë të Ligjit Neni 5.3/
- Marrja e masave për ruajtjen e zonës së mbrojtur në kuadër të së cilës ndodhen monumentet arkitekturale nën mbrojtje të përhershme apo të përkohshme (nen 6.4)

**G: STRATEGJITË PËR KONSOLIDIMIN E SISTEMIT DHE STRUKTURAVE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOMUNË**

Konsolidimi i një sistemi funksional të planifikimit në komunë, përfshirë ngritjen e kapaciteteve njerëzore me njohuritë dhe praktikat e reja në Planifikim dhe atyre organizative, është sfidë që Plani ka vënë në konsideratë. Juniku është komunë në konsolidim e sipër dhe ka nevojë për funksionalizim të kësaj fushe në mënyrë që ky Plan që po hartohet, të ofrojë mundësi krijimi apo dhe fuqizimi të mekanizmave adekuat për zbatim. Plani mbështet parimin e qeverisjes së mirë ku përgjegjshmëria, transparencja, efektiviteti dhe efikasiteti janë disa norma që duhet aplikuar në procesin e Planifikimit dhe zbatimit të planeve hapësinore dhe atyre urbanistike. Kjo kërkon institucione, resurse njerëzore dhe mekanizma përkatës.

**Strategjia G1: Konsolidimi i sistemit dhe strukturave të planifikimit hapësinor në Komunë**

Zhvillimi i kapaciteteve komunale njerëzore dhe organizative në fushën e planifikimit hapësinor dhe kontrollin e zhvillimeve; Zhvillimi i bazës së të dhënave në planifikim hapësinor; Ndërgjegjësimi i popullsisë për fushën e planifikimit hapësinor si dhe Zhvillimi i metodave që thjeshtojnë procedurat e marrjes së lejeve urbanistike dhe ndërtimit janë objektivat e përcaktuara të kësaj fushe. Veprimet që kjo strategji propozon janë:

- Përkrahja e edukimit të avancuar dhe trajnimet të personelit në fushën e planifikimit hapësinor përfshirë edhe inspektionin
- Themelimi i Njesisë për Planifikim Hapësinor
- Përkrahja dhe fuqizimi i mekanizmave inspektues për monitorim dhe kontroll të zhvillimeve në hapësirë sipas planeve hapësinore dhe urbane të miratuara
- Emërimi i GIS zyrtarit
- Trajnime të avancuara në fushën e përdorimit të Sistemit gjeografik informativ (GIS)
- Krijimi i bazës së të dhënave në GIS dhe harmonizimi me ato të Ministrisë
- Sigurimi i pajisjeve përkatëse softwerike dhe teknike që mundësojnë punën në GIS
- Organizimi i debateve publike me tema ku trajtohen çështjet e zhvillimit hapësinor
- Zhvillimi dhe shpërndarja e Buletinit Komunal ku prezantohen në mes tjerash edhe të arriturat në zbatimin e planeve hapësinore dhe urbane
- Përfshirja e qytetarëve në zhvillimin e projekteve të dala nga Plani
- Hartimi i Broshurës mbi procedurat për marrjen e Lejeve Urbanistike, Ndërtimit dhe Lejes së Përdorimit
- Zhvillimi i mënyrave softwerike për aplikim për leje në formë elektronike

## 5.2. VLERËSIMI I STRATEGJIVE

*Shënim: Siç është cekur më herët, edhe kjo pjesë e Planit është me detajisht e elaboruar në raportin për "Vlerësimin e ndikimeve" (shih aneksin). Strategjitë dhe veprimet/projektet e identifikuar janë testuar dhe vlerësuar duke u bazuar në efektet dhe ndikimet që ato kanë në aspekt të ndryshimeve në demografi, shëndetësi, vendbanim, punësim dhe të ardhura, shërbimet publike për komunitetin. Ndikimet mjedisore të strategjive në përgjithësi vlerësohen në aspekt të ndryshimeve në ajër, ujë, tokë, biodiversitet, trashëgimi natyrore/kulturore, ndryshimi i klimës dhe fatkeqësi natyrore si dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri.*

*Strategjitë e testuara kanë shfaqur rezultate të ndryshme në lidhje me ndikimin e tyre në çështjet socio-ekonomike dhe mjedisore. Edhe pse, ekziston një konsensus i përgjithshëm se shumica e veprimeve të parashikuara do të kenë një ndikim pozitiv, pavarësisht kësaj nga disa veprime të identifikuar kanë potencial të përkeqësojnë gjendjen socio-ekonomike dhe mjedisore për zonën.*

*Në anën tjetër, për veprimet dhe Projektet të cilat kanë shfaqur mundësinë e degradimit të situatës socio-ekonomike dhe të mjedisit, janë nxjerrur rekomandimet për të bërë (ndërmarrë) VNM ose VSM (varësisht se cila aplikohet) para zbatimit të projekteve sidomos atyre infrastrukurore dhe dokumentet rregulluese që ndikojnë drejtpërdrejtë në shfytëzimin e tokës (p.sh. PRRU).*

*Është e rëndësishme të theksohet se veprimet për zbutjen e disa ndikimeve negative apo për rritjen e dobive të një reagimi pozitiv do të kontribuojë në zbutjen e ndikimeve të tjera. Për shembull, propozimi i paraqitur në Strategjinë B për zhvillimin e Eko-Turizmit do të ketë ndikime të shumta pozitive në kritere të ndryshme socio-ekonomike dhe mjedisore që janë diskutuar. Ideja është që vendim-marrësit Komunal duhet të inkurajohen për të vepruar në sigurimin e një situatë më të mirë socio-ekonomike për banorët dhe për të përmirësuar efikasitetin e përdorimit të burimeve natyrore, pavarësisht nga kufizimet financiare me të cilat ballafaqohen. Përmirësimi i standardit jetësor dhe përkujdesja për të mbajtur një mjedis të pastër për brezat që vijnë është me rëndësi kyçe.*

## 5.3. AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE DHE KORNIZA INSTITUCIONALE

Kjo pjesë e Planit ofron pakon e përmbledhur të veprimeve/projekteve apo programeve të propozuara në fushat tematike për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara me Plan. Përcaktimi i afateve kohore, subjekteve të përfshira si dhe implikimet financiare për realizimin e projekteve/veprimeve është rezultat i punëtorisë së zhvilluar me grupin punues dhe përfaqësues të ndryshëm. Më pas, projektet janë analizuar edhe njëherë me Drejtorinë për Financa, për t'i ndërlidhur ato me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës (2011-2013). Projektet për realizim në vitin 2011 kanë të përcaktuar edhe koston financiare përderisa ato të parapara për realizim gjatë viteve në vijim, do të jenë subjekt i harmonizimit me Planin Buxhetor gjatë rishikimit të tij.

#### 5.4. AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE DHE KORNIZA INSTITUCIONALE

FUSHA	KOD I PROJEKTI	VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	SUBJEKTET TJERA TË PËRFSHIRA	PRIORITET	KOHËZGJATJA	IMPLIKIMI FINANCIAR
<b>ZHVILLIM SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE</b>	<b>A 1: PËRMIRËSIMI I GJENDJES SOCIALE DHE EKONOMIKE</b>						
	A1.1	Zhvillimi i programit për punësim përfshirë punësimin sezonal	KOMUNA, DZHE, DAKRS, GPSH	MPMS, UNDP, BE	LARTË	2011-2013	MESËM
	A1.2	Ngritja e shkollave profesionale në fushat bujqësi, turizëm dhe fushat që ndërlidhen me to	Komuna, DZHE, DAKRS, GPSH	MBPZHR, MTI, DONATORË	LARTË	2014-2016	LARTË
	A1.3	Mbajtja trajnimeve dhe kurseve profesionale kualifikuese që mundësojnë ngritje të kapaciteteve humane në fushën e bujqësisë, turizmit dhe fushat që ndërlidhen me to si marketingu, promovim si dhe veprimtaritë shërbyese/hoteliere	KOMUNA	MASHT, MPMS	MESËM	2012-vazhdimesi	MESËM
	A1.4	Përkrahja e projekteve që gjenerojnë të ardhura për gratë	KOMUNA, OJQ	BIZNESET	MESËM	2012-vazhdimesi	ULËT
	<b>A2: PËRMIRËSIMI I KUALITETIT TË JETËS PËRMES NGRITJES SË HAPËSIRAVE DHE OBJEKTEVE PUBLIKE</b>						
	A2.1	Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve	KOMUNA, DASH	MASHT	MESËM	2013	LARTË
	A2.2	Ndërtimi i objekteve kulturore- biblioteka, shtëpia e kulturës, qendra rinore (të shikohet mundësia e sigurimit të shumë përmbajtjeve në një objekt)	KOMUNA, DASH	MKRS, DONATORËT	ULËT	2017-2023+	LARTË
	A2.3	Sigurimi i objekteve dhe përmbajtjeve për sport e rekreacion: • Ndërtimi i sallës së sporteve • Sigurimi i terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura (shfrytëzim max.i terreneve ekzistuese përfshirë terrenet sportive shkollore)	KOMUNA, DASH	MKRS-MA	ULËT	2012-2013	LARTË
	A2.4	Ndërtimi i Muzeut të Qytetit (projekt i njëjtë me F.1.6)	KOMUNA, DASH	MKRS, DONATORËT	ULËT	2012-2013	LARTË
	A2.5	Projekte që promovojnë-masivizojnë aktivitetet kulturo-sportive	KOMUNA, OJQ	BIZNESET, DONATORËT	ULËT	2014-vazhdimësi	ULËT
	A2.6	Formimi i një zyreje/qendre që ofron kujdes ndaj pleqve	KOMUNA	DONATORËT	ULËT	2017-2023+	LARTË
	<b>A3. ZHVILLIMI I SHOQËRISË INFORMATIVE, MË TË ORGANIZUAR DHE PJESËMARRËSE NË VENDIMMARRJE</b>						
	A3.1	Hapja e zyrës publike për informim dhe këshilla për qytetarë përfshirë punësimin e stafit dhe ngritjen e kapaciteteve të kuadrit punues të zyrës	KOMUNA	QEVERIA, DONATORËT	ULËT	2017-2023+	MESËM
	A3.2	Përkrahja e projekteve të shoqatave, organizatave joqeveritare apo komunitare të cilat promovojnë vlera të mirëfillta dhe zhvillim të shoqërisë	KOMUNA, OJQ	DONATORËT	ULËT	2011-vazhdimesi	ULËT
	A3.3	Publikimi i rregullt i Buletinit të Komunës	KOMUNA, ZYR.INORMIMIT	OSBE	LARTË	2011-vazhdimesi	MESËM

Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011-2023

FUSHA	KODI I PROJEKTIT	VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	SUBJEKTET TJERA TË PËRFSHIRA	PRIORITET	KOHËZGJATJA	IMPLIKIMI FINANCIAR
ZHVILLIM I EKONOMIK	<b>B1: ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK NË TË GJITHA SFERAT E NË VECANTI BUJQËSI, TURIZËM, PYLLTARI, ENERGJI ALTERNATIVE</b>						
	<b>BUJQËSIA DHE AGROBIZNESI</b>						
	B1.0	Hartimi i programit për zhvillim të bujqësisë	KOMUNA	DONATORËT	MESËM	2014-2016	ULËT
	B1.1	Hartimi i Planit Rregullues Urban për zonën ekonomike bazuar në zhvillim të bujqësisë dhe agro-biznes	KOMUNA DUKM	DONATORËT	LARTË	2012	LARTË
	B1.2	Ngritja e pemishteve intensive	BIZNESI PRIVAT	KOMUNA, MB-DONATORËT	MESËM	2014-2016	MESËM
	B1.3	Projekti "Qërshiza-Boronica e Junikut"	BIZNESI PRIVAT	KOMUNA, MB-DONATORËT	MESËM	2017-2023+	LARTË
	<b>ZGJERIMI DHE PËRMIRËSIM I SISTEMIT TË UJITJES SË TOKAVE BUJQËSORE</b>						
	B1.4	Ndërtimi i pendës për ujitje te Prita e Katundit	KOMUNA	MBPZHR	LARTË	2012	LARTË
		Riparimi pendave në Jaruha (Gaxherr)					
	B1.5	Ndërtimi i kanaleve primare të ujitjes	KOMUNA, MINISTRIA	MBPZHR	LARTË	2011	LARTË
	<b>QASJE MË E LEHTË NË TOKAT BUJQËSORE</b>						
	B1.6	Hapja e trasesë me zhavor e rrugës së Turbisë	KOMUNA	MBPZHR	MESËM	2012-2013	MESËM
	B1.7	Trasimi/shtrimi me zhavor i rrugës Miroc Uleza	KOMUNA	MBPZHR	MESËM	2011	MESËM
	B1.8	Asfaltimi i rrugës Shafrane- Hybe	KOMUNA	MBPZHR	MESËM	2012-2013	MESËM
	B1.9	Shtrimi me zhavor i rrugës te arave te Prita e Katundit	KOMUNA	MBPZHR	MESËM	2017-2023+	MESËM
	<b>RRITJA E SEKTORIT TË BLEGTORISË</b>						
	B1.10	Zhvillimi i projekteve për shtim të fondit të blegtorisë së imët	KOMUNA	DONATORET	MESËM	2012-vzhdimësi	MESËM
	<b>PROMOVIMI I PRODUKTEVE BUJQËSORE-BLEGTORALE DUKE OFRUAR QASJE NË TREGJET LOKALE DHE REGJIONALE</b>						
	B1.11	Ngritja e tregut për shitjen e produkteve bujqësoro-blegtorale përfshirë edhe aktivitetet e magazinimit dhe përpunimit si një qendër shpërndarëse	KOMUNA	DONATORËT, MBPZHR	LARTË	2012	ULËT
	B1.12	Zhvillimi i programit/aktiviteteve të marketingut "Produktet e Junikut"	KOMUNA, OJQ	DONATORËT ABK-BIZNESET	MESËM	2011-vazhdimësi	ULËT
	<b>NDIKIMI NË ORGANIZIM DHE VETËDIJESIM</b>						
	B1.13	Formimi i shoqatave të bujqve, fermerëve, përpunuesve dhe shitësve të prodhimeve bujqësoro-blegtorale (është formu shoqata "kallavajt"	AFARISTET	KOMUNA, FAO	MESËM	2011	ULËT
	B1.14	Themelimi i njësisë apo drejtorisë së bujqësisë në kuadër të strukturës organizative të komunës	KOMUNA	KOMUNA, FAO	LARTË/ME SËM	2011	ULËT
B1.15	Aktivitete vetëdijesimi i popullsisë sidomos të rinjtë për beneficionet e Bujqësisë(njëjtë me D1.3)	KOMUNA, OJQ	MBPZHR, DONATORËT	LARTË	2014-vazhdimisht	ULËT	
B1.16	Organizimi i trajnimeve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë	KOMUNA	MBPZHR, DONATORËT	MESËM	2012-vazhdimisht	ULËT	
<b>PYLLTARIA</b>							
B1.17	Ngritja kapaciteteve komunale për menaxhim të pylltarisë	KOMUNA, ZYRA E PYLLTARIS	MBPZHR (APK)	LARTË	2011-vazhdimisht	LARTË	
B1.17 (a)	Edukimi i gjeneratave të reja me njohuri elementare për menaxhim të pyjeve	KOMUNA	OJQ, DONATORË	MESËM	vazhdimisht	ULËT	
B1.17 (b)	Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësimi ndaj mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve (projekt i njëjtë me E1.9)	KOMUNA	OJQ, DONATORËT	LARTË	2012-vazhdimësi	MESEM	
B1.18	Hartimi i planit të veprimit për menaxhimin e pyjeve	KOMUNA	MBPZHR (APK)	LARTË	2011	ULËT	
B1.19	Studim fizibiliteti i shfrytëzimit të potencialit pyjor për zhvillim të mundshëm	KOMUNA	DONATORËT. MBPZHR(APK)	MESËM	2014-2016	LARTË	

Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011-2023

	industrial, përpunim final dhe plasim të mëtejshëm (njëjtë me E1.7)					
<b>TURIZMI DHE SHËRBIMET TURISTIKE</b>						
B1.20	Hartimi i PRRU për lokalitetin Moronica dhe Lugina e Erenikut. Plani duhet të parasheh përveç rregullimit të zonës edhe zhvillimin e produktit turistik të lokalitetit, ngritjen e kopshtit zoologjik dhe parkut botanik, dhe mundësinë e zhvillimit të sporteve ujore dhe aktivitete për rekreacion	KOMUNA, DUKM	DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTË
B1.21	Hartimi i Planeve Rregulluese Urbane për Grykën e Erenikut me lokalitetet: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gradinë, Jedovë dhe</li> <li>• Burimi Erenikut, Liqejtë e Gjeravicës dhe Rrasa e Zogut, si zonë ku mund të zhvillohet turizmi rekreativ (sportet ujore, gjuetia, etj), eko-turizmi, turizmi ndërkuftar, alpin.</li> </ul>	KOMUNA, DUKM	DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTË
B1.22	Hartimi i PRRU për Zonën Gryka e Zharres me lokalitet Gjocaj, Jasiq, Zharre me mundësi zhvillimit ekoturizmit, turizmit konferencial, turizmi rural, përfshirë edhe ngritjen e një qendre rekreative-rehabilituese (njëjtë me D2.1)	KOMUNA, DUKM	DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTË
<b>PROMOVIM MARKETING</b>						
B1.23	Ngritja e Qendrës Informuese për Turizëm dhe Marketing (njëjtë me F1.8)	KOMUNA	DONATORËT, MTI-BIZNESET	MESËM	2017-2023+	LARTË
B1.24	Përkrahja e projekteve që stimulimojnë zhvillimin e veprimtarisë artizanale (njëjtë me F1.11)	KOMUNA	OJQ-DONATORËT	ULËT	2014-2016(vazhdimësi)	ULËT
B1.25	Mbështetja e projekteve në kultivimin e gastronomisë tradicionale(njëjtë me F1.11)	KOMUNA	OJQ-DONATORËT	ULËT	2014-2016(vazhdimësi)	ULËT
B1.26	Mbështetja e zhvillimit të resurseve humane në fushën e turizmit	KOMUNA	MTI-DONATORËT	MESËM	2014-2016	ULËT
B1.27	Publikimi i hartave dhe guidave turistike	KOMUNA	OJQ-DONATORËT	MESËM	2014-2016	ULËT
B1.28	Mbështetja për investime me partneritetit publiko-privat në turizëm	KOMUNA, BIZNESET	MTI-DONATORËT	LARTË	2014-2016	LARTË
B1.29	Organizimi i manifestimeve të ndryshme që lidhen me promovimin e vlerave turistike në Junik <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dita e shënimit të Pavarësisë me aktivitetin “Vrapimi për Pavarësi 600 m”</li> <li>• Shënimi i Ditëve të Gjeravicës kombinuar me projektin për sinjalizimin turistik</li> <li>• Dita e Kullave</li> </ul>	KOMUNA, DASH	BIZNESET, MKRS, OJQ	MESËM	2011-vazhdimisht	ULËT
<b>ENERGJIA ALTERNATIVE</b>						
B1.30	Projekti i hidrocentralit të Malit	INVESTITORI	MEM, KOMUNA, DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTË
B1.31	Projekti i hidrocentralit të Erenikut	INVESTITORI	MEM, KOMUNA, DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTË
B1.32	Projekti i hidrocentralit të Jasiqit	INVESTITORI	MEM, KOMUNA, DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTË
B1.33	Mbështetja e studimeve të fizibilitetit për shfrytëzimin e energjisë alternative (projekt i njëjtë me C.3.8)	KOMUNA	MEM, DONATORËT	MESËM	2017-2023+	LARTË
<b>B2: BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL DHE NDËRKUFITAR</b>						
B2.1	Projektit “Parku i Paqes” në kufirin Shqipëri-Kosovë-Mal i Zi	QEVERIA, AZHR	KOMUNA-KE	ULËT	2017-2023+	LARTË
B2.2	Bashkëpunimi me Agjencionin për Zhvillim Regjional (AZHR) të Pejës në hartimin e projekteve të karakterit ndërkomunal-ndërkufitar	KOMUNA, DE	KOMUNA-KE	LARTË	Vazhdimisht	ULËT
B2.3	Bashkëpunimi me komunat fqinje në projektet me interes të përbashkët: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi impiantit për trajtimin e ujërave të zeza</li> <li>• Menaxhimi i mbeturinave/rregullimi i deponisë regjionale</li> <li>• Menaxhimi i ujërave</li> </ul>	KOMUNAT NË REGJION	MMPH, AZHR, KE, MKRS	MESËM	Vazhdimisht	MESËM / LARTË

Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011-2023

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ruajtja e trashëgimisë/inicimi i propozimit për hartimin e Planit Hapësinor për Kullat e Dukagjinit (zonë me interes të vecantë e deklaruar me PHK)</li> <li>Projekte të zhvillimit ekonomik me theks në turizëm, pylltari, energji alternative, bujqësi etj</li> </ul>					
--	--	--	--	--	--	--

FUSHA	KODI I PROJEKTTIT	VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET	INSTITUCIONI PERGJEGJES	SUBJEKTET TJERA TË PËRFSHIRA	PRIORITET	KOHEZGJATJA	IMPLIKIMI FINANCIAR
<b>INFRASTRUKTURA TEKNIKE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET</b>	<b>C1: PËRMIRËSIMI DHE ZGJERIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE SIPAS KUSHTEVE TEKNIKE BASHKËKOHORE NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS DHE MË GJERË</b>						
	C1.1	Ndërtimi i rrugës tranzit në aksin "Bajraktar-Gaxherr"	KOMUNA	KOMUNITETI	LARTË	2011	MESEM
	C1.2	Ndërtimi i segmentit rrugor 'Udha e Kuqe' (qasje në rrugë regjionale)	KOMUNA	BIZNESET	MESËM	2013	MESEM
	C1.3	Asfaltimi i rrugës Junik-Nivokaz	KOM.GJAKOVË-JUNIK	PARTNERITETI NDËRKOMUNAL	MESËM	2012-2013	MESEM
	C1.4	Ndërtimi i rrugës që qon deri në Bjeshkë	KOMUNA	DONATORËT	MESËM	2017-2023+	LARTE
	C1.5	Hartimi i studimit të fizibilitetit për hapje të re të rrugës prej Bjeshkës deri në trekëndëshin Shqipëri-Kosovë-Mal i Zi	KOMUNA	PARTNERITET NDËRSHTETËTOR	MESËM	2017-2023+	MESEM
	C1.6	Në zonën urbane, ndërtimi i rrugëve të përcaktuara me PZHU	KOMUNA	KOMUNITETI	LARTË	2011-2012	ULET
	C1.7	Mirëmbajtje e rregullt e rrugëve në komunë	KOMUNA	/	MESEM	2011-vazhdimisht	MESEM
	<b>C2: PËRMIRËSIMI-SHTRIJA E TRANSPORTIT PUBLIK URBAN DHE NDËRURBAN ME SHËRBIME DHE ELEMENTE PËRCJELLËSE SI DHE INFRASTRUKTURËS ADEKUATE PËR KËMBËSORË</b>						
	C2.1	Ndërtimi i stacionit të autobusëve në lokacionin e paraparë sipas PZHU	KOMUNA	/	LARTË	2012	MESEM
	C2.2	Punimi i planit për mobilitet (qarkullimi i transp. publik, infrast. Këmbësorëve,etj)	KOMUNA/DSHP	/	MESËM	2014-2016	ULET
	C2.3	Rregullimi i infrastrukturës së këmbësorëve në zonën urbane ashtu siç është e përcaktuar me PZHU	KOMUNA	KOMUNITETI	MESËM	2014	ULET
	C2.4	Krijimi i infrastrukturës së këmbësorëve për turistë dhe rekreacion në Bjeshkë * Rregullimi i shtigjeve për ecje dhe ngjitje në bjeshkë, * Rregullimi i shtigjeve për kalërim, * Rregullimi i shtigjeve për zhvillimin e sporteve ekstrem p.sh ngjitjes me motorë, * Shenjëzimi i pikave vrojtuese/soditëse dhe atyre me vlera kulturore * Shenjëzimi i vendeve për kamping	KOMUNA/DREJTORIA PËR SHËRBIMET PUBLIKE(DSHP)	OJQ, DONATORËT, BIZNESET	MESËM	2017-2023+	ULET
	<b>C3: OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE MË CILËSORE PËR BANORËT TË CILAT I KONTRIBUOJNË NGRITJES SË KUALITETIT JETËSOR</b>						
	C3.1	Kompletimi i rrjetit të kanalizimit në zonat ku mungon	KOMUNA/DSHP	DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTE
	C3.2	Ndërtimi i rezervuarit për ujë: Gaxherr-Bajraktar	KOMUNA/DSHP	DONATOR. HIDRODRINI	MESËM	2012-2013	MESEM
	C3.3	Ndërtimi i trafostacionit të ri që do të zvogëlonte ngarkesën në trafot ekzistuese	KOMUNA/KEK	KEK/MEM	LARTË	2012-2013	MESEM
	C3.4	Ndërtimi i 3 hidrocentraleve (njëjtë me projektet B.1.30; B.1.31; B.1.32)	INVESTITOR TË NDRYSHËM	KOMUNA, MEM, DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTE
	C3.5	Themelimi i ndërmarrjes për menaxhimin e mbeturinave (njëjtë me projektin E.1.1)	KOMUNA/DSHP	/	LARTË	2012-2013	MESEM
	C3.6	Hartimi i planit lokal për administrimin e mbeturinave (njëjtë me E1.6)	KOMUNA/DSHP	MMPH/ OJQ	MESËM	2012-2013	ULET
C3.7	Hartimi i programit për trajtimin e ujërave të zeza dhe atyre atmosferik	KOMUNA/DSHP	OJQ	MESËM	2013	ULET	
C3.8	Studim fizibiliteti për shtrirjen e sistemit të ngrohjes qendrore duke shqyrtuar edhe mundësitë e shfrytëzimit të materialeve me ndikim të vogël ekologjik në mjedis (projekt i njëjtë me B.1.33)	KOMUNA/DSHP	KOMPANITË PËRGJEGJËSE/ DONATORËT	MESËM	2017-2023+	LARTE	

FUSHA	KODI PROJ EK.	VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET	INSTITUCIONI PERGJEGJES	SUBJEKTET TJERA TË PËRFSHIRA	PRIORITET	KOHEZGJATJA	IMPLIKIMI FINANCIAR	
SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI	<b>D1: MBROJTJA DHE SHFRYTËZIMI RACIONAL I TOKËS BUJQËSORE</b>							
	D1.1	Krijimin e kadastrit (evidencës) së tokës bujqësore në GIS	KOMUNA, DUKM	AKK, MBZHR, DONATORË	MESËM	2014-2016	ULËT	
	D1.2	Projekti për “Rregullimin e tokës bujqësore” me qëllim të : - krijimit të ngastrave më të mëdha; - përmirësimin e tokës përmes zbatimit të masave agroteknike, agromeloriuese dhe hidromeloriuese; - rregullimin e qasjes në infrastrukturën publike; - krijimin e ngastrave në formë të rregullt gjeometrike; - rregullimin e marrëdhënieve pronëso- juridike; - matjet e reja të tokës; - krijimi i kadastrit të ri	KOMUNA, DUKM, DB	AKK, MBPZHR	MESËM	2017-2023+	LARTË	
	D1.3	Aktivite vetëdijësimi për ruajtjen, zhvillimin e tokës bujqësore (projekt i njëjtë me B.1.15)	KOMUNA, OJQ,	MBPZHR DONATORËT	LARTË	2014-vazhdimisht	ULËT	
	<b>D2: TRAJTIMI VENDBANIMEVE PËRFSHIRË EDHE VENDBANIMIN JOFORMAL</b>							
	D2.1	Hartimi i Planit Rregullues Urban për vendbanimet Jasiq, Gjocaj dhe Zharre. PRRU duhet të bazohet në konceptin e zhvillimit të fshatrave si zona banimi të kompletuara me infrastrukturë fizike dhe sociale por edhe si vendbanime me funksionin e zhvillimit të turizmit rural dhe aktiviteteve bujqësore (projekt i njëjtë me B1.22)	KOMUNA, DUKM	DONATORËT	MESËM	2014-2016	LARTË	
	D2.2	Hartimi i programit për rregullimin e vendbanimit joformal Agim Ramadani, me fokus rregullimin e çështjeve pronëso- juridike, dhe krijimin e mundësive për kthimin e sigurtë të banorëve në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj duke krijuar parakushtet e nevojshme për kthim (deminimi i zonës, ndërtimin e shtëpive të shkatërruara gjatë luftës, ofrimi i infrastrukturës fizike (rrugë, ujësjellës, kanalizim) dhe qasje më të lehtë në infrastrukturën sociale).	KOMUNA	MMPH(AKP), DONATORËT	LARTË	2014-2016	LARTË	
	<b>D3: BANIMI DHE NDËRTIMET</b>							
	D3.1	Trajtimi i hapësirave të reja të banimit dhe ndërtimit në zonën urbane –hartimi i PRRU sipas rekomandimeve të PZHU	KOMUNA(DUKM)			LARTË	2011-2013	ULËT
	D3.2	Hartimi i programit dhe planit të veprimit për banim dhe ndërtim	KOMUNA	MMPH (DBN)		ULËT	2017-2023+	ULËT
D3.3	Hartimi i rregullores dhe programit për rregullimin e ndërtimeve pa leje (në përputhje me dispozitat ligjore)	KOMUNA, (DUKM)	MMPH		LARTË	2014-2016	MESËM	

Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011-2023

FUSHA	KODI PROJEK.	VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET	INSTITUCIONI PERGJEGJES	SUBJEKTET TJERA TË PËRFSHIRA	PRIORITET	KOHEZGJATJA	IMPLIKIMI FINANCIAR
MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA DEGRADIMI DHE FAKEQËSITË	<b>E1: MBROJTJE DHE ZHVILLIM I QËNDRUESHËM MJEDISOR</b>						
	<b>MBROJTJA E MJEDISIT NGA NDOTJA</b>						
	E1.1	Themelimi i ndërmarrjes për menaxhimin e mbeturinave (projekti i njëjtë me C.3.5)	KOMUNA/DSHP	/	LARTË	2012-2013	MESËM
	E1.2	Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për fushën e mjedisit dhe caktimi i zyrtarit për mjedis	KOMUNA	OJQ	MESËM	2011	ULET
	E1.3	Hartimi i planit lokal të veprimit për mbrojtjen e mjedisit	KOMUNA	OJQ	MESËM	2011	ULET
	E1.4	Aktivitetet pastrimi dhe sensibilizim opinionit për mbrojtjen e mjedisit	KOMUNA	OJQ, KOMUNITETI	ULËT	2012-2013-vazhdimësi	ULET
	E1.5	Përkrahja e projekteve të OJQ mjedisore	KOMUNA	DONATORET, BIZNESET, KOMUNITETI	MESËM	2012-vazhdimësi	MESËM
	E1.6	Hartimi i planit lokal për administrim të mbeturinave në harmoni me planin strategjik (MMPH) (i njëjtë me projektin C.3.6)	KOMUNA/SHER BIMET PUBLIKE	MMPH/OJQ	MESËM	2012-2013	ULET
	<b>MBROJTJA E PYJEVE NGA DEGRADIMI</b>						
	E1.7	Hartimi i planit operacional për menaxhimin e pyjeve (projekt i njëjtë me B1.18)	KOMUNA	MBPZH(APK)	LARTË	2011	ULET
	E1.8	Projekte për ripyllëzimin e zonave të zhveshura dhe pyllëzimin e zonave të reja (projekt i njëjtë me E2.3)	KOMUNA	MBPZH(APK)DONATORËT	MESËM	2011-vazhdimësi	MESËM
	E1.9	Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësimiti ndaj mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve (njëjtë me B1.17)	KOMUNA	OJQ, DONATORËT	LARTË	2012-vazhdimësi	MESËM
	E1.10	Hapja e qendrës për pyllëzim/ripyllëzim e cila do të mirret me kultivimin e fidaneve (pëmë gështenja dhe bredh)	KOMUNA	MPBZHR, OJQ, Donatorët	MESËM	2012-2013	MESËM
	<b>E2. MBROJTJA NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE ATO TË SHKAKTUARA NGA NJERIU</b>						
	<b>MBROJTJA NGA ZJARRET</b>						
	E2.1	Hartimi i planit për mbrojtje dhe shpëtim për gjithë komunën	KOMUNA	MPB (DME), MMPH	LARTË	2011	ULET
	E2.2	Fushatë e ndërgjegjësimit (seminare, leksione në shkollë, botimet (broshura, postera), debate televizive për mbrojtjen nga zjarret dhe parandalimin	KOMUNA	MPB(DME), OJQ, DONATORËT	MESËM	2012-vazhdimësi	MESËM
	<b>MBROJTJA NGA EROZIONI</b>						
	E2.3	Projekte për ripyllëzim e zonave të zhveshura dhe pyllëzimin e zonave të reja (projekt i njëjtë me E.1.8)	KOMUNA	MBPZH(APK)DONATORËT, OJQ-te	MESËM	2011-vazhdimësi	MESËM
	E2.4	Vendosja e rrjetave për mbrojtjen nga rrëshqitja e tokës (përgjatë rrugës në vendin Gurthi)	KOMUNA	KOMUNITETI	MESËM	2013	ULET
	<b>MBROJTJA NGA VËRSHIMET</b>						
E2.5	Rregullimi i shtratit të lumit Erenik dhe vendosja e prioriteteve për zonat më të rrezikshme	KOMUNA	MMPH, DONATORËT	LARTË	2012-2013	LARTE	
E2.6	Analiza për trajtimin e çështjes së përmytjeve në lagjen Tofaj dhe Prita e Katundit	KOMUNA	MPB(DME), MPBZHR, DONATORËT	MESËM	2012	MESËM	
E2.7	Riparimi i digës ekzistuese në lumin Trava	KOMUNA	KOMUNITETI, MBPZHR	MESËM	2014-2016	MESËM	
<b>MBROJTJA NGA TËRMETET</b>							
E2.8	Hartimi i planit për mbrojtje dhe shpëtim për komunën (njëjtë me E.2.1)	KOMUNA	MPB(DME), MMPH	LARTË	2011	ULET	
<b>DEMINIMI</b>							
E2.9	Aktivitetet deminimi	KOMUNA, QEVERIA, FSK, KFOR, POLICIA	OJQ, MEDIAT	LARTË	2014-2016	LARTE	

Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011-2023

E2.10	Fushatë ndërgjegjësimi për rreziqet nga minat dhe mënyrën e informimit	KOMUNA	OJQ, FSK, MEDIAT	LARTË	2012-2014	MESEM
<b>NDRYSHIME KLIMATIKE</b>						
E2.11	Projektet me ndikim në ndryshime klimatike të cekura më lartë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtje të mjedisit: E1.8; E1.9; E2.1; E.2.2; E.2.7;</li> <li>Energji alternative : B.1.31; B.1.32; B.1.33; B.1.34</li> </ul>	KOMUNA	DME/ OJQ, DONATORËT	LARTË	Vazhdimësi	MESEM
E2.12	Mbështetje e projekteve për përdorimin e energjisë alternative dhe efikasitetit të energjisë	KOMUNA	OJQ, DONATORËT, AZHR	MESËM	2017-2023+	MESEM
<b>E3: RUAJTJA E VLERAVE NATYRORE DHE BIODIVERSITETIT</b>						
E3.1	Përkrahja e projekteve të Shoqatave dhe OJQ për mbrojtjen e florës dhe faunës (projektet për pasurimin e faunës sidomos drenit të cilit i kanoset rreziku nga zhdukja dhe ushqimi i tyre gjatë dimrit; shtimit të fondit të egërsirave; mbrojtja nga sëmundjet;	KOMUNA	DONATORËT, OJQ-te, QEVERIA MPBZHR	MESËM	2012-vazhdimisht	MESEM
E3.2	Ndërmarrja e fushatave për sensibilizim opinionit për mbrojtjen e florës dhe faunës	KOMUNA	OJQ-te, DONATORËT, MPBZHR, MMPH	MESËM	2012-2013	MESEM
E3.3	Analiza për shfrytëzueshmërinë dhe ruajtjen e produkteve malore (boronica, bimët mjekuese, gështenja)	KOMUNA	KOMUNA, MPBZHR	MESËM	2012-2013	ULET
E3.4	Piketimi/shënjëzimi i peisazheve hidrografike, fushore, maloro-kodrinore dhe mbrojtja e tyre nga degradimi	KOMUNA	OJQ mjedisore, MMPH	ULËT	2017-2023+	MESËM
E3.5	Hartimi i planit të biodiversitetit për mbrojtjen dhe menaxhimin e të mirave të natyres.	KOMUNA	OJQ-te, DONATORËT, MMPH	MESËM	2012-2013	MESEM
<b>E4: FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL DHE NDËRSHTETËROR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT</b>						
E4.1	Marrëveshje bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërshtetëror për politikën ambientale dhe mbrojtjen e mjedisit: <ul style="list-style-type: none"> <li>veprime të përbashkëta për mbrojtje nga fatkeqësitë</li> <li>pjesëmarrje aktive në hartimin e Planit Hapësinor për Parkun Nacional "Bjeshkët e Nemuna"</li> <li>Projekti Parku i Paqes (projekt i njëjtë me B2.1)</li> </ul>	KOMUNA, MMPH, KOMUNAT TJERA KUFITARE	PARNERITET NDËRKOMUNAL	MESËM	2012-vazhdimisht	MESEM


Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011-2023

FJSHA	KODI PROJEKTIT	VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	SUBJEKTET TJERA TË PËRFSHIRA	PRIORITET	KOHËZGJATJA	IMPLIKIMI FINANCIAR	
<b>TRASHËGIMIA KULTURORE</b>	<b>F1: MBROJTJA DHE FUNKSIONALIZIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE</b>							
	<b>NGRITJA E KAPACITETEVE HUMANE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE PËR BASHKËPUNIM</b>							
	F1.1		Ngritja e kapaciteteve humane/organizative për bashkëpunim dhe koordinim me Qendrën Regjionale për Trashëgimi Kulturor në Pejë (QRTP) rreth inventarizimit, mbrojtjes së trashëgimisë, zbatimit të Ligjit mbi Trashëgiminë Kulturorë. Komuna punëson staf dhe trajnime të vazhdueshme	KOMUNA	QRTP / MKRS	MESËM	2011	ULET
	F1.2		Bashkëpunim dhe pjesëmarrje aktive e komunës në aktivitetet e autoriteteve qendrore në hartimin e politikave për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitekturale	KOMUNA	QRTP / MKRS	LARTË	2011-vazhdimisht	ULET
	<b>DATA BAZA DHE INVENTARIZIMI</b>							
	F1.3		Propozim-lista e inventarizimit të trashëgimisë kulturore dhe databazës krijuar nga komuna për nevojat e PZHK të koordinohet me procesin e inventarizimit me QRTP dhe mirëmbajtje e rregullt	KOMUNA	QRTP / MKRS	MESËM	2011	ULET
	<b>MBROJTJA DHE FUNKSIONALIZIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE</b>							
	F1.4		Dhënia e statusit të objekteve nën mbrojtje të përhershme dhe përkohshme (se cilat objekte mund të kenë këtë status kjo mund të definohet mbase të jetë bërë kategorizimi së bashku me QRTP në Pejë dhe mbas konsultimit me Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë)	KOMUNA, INSTITUTI PËRMBROJTJEN E MONUMENTEVE-PEJË	QRTP / MKRS	MESËM	2012-2013	ULET
	F1.5		Gjetja e formave të Partneritetit publiko-privat të cilat do të ofronin mundësi të konservimit, përfshirë mirëmbajtjen e objekteve me vlera kulturore	KOMUNA, INSTITUCIONET	MKRS	MESËM	2017-2023+vazhdimësi	
	F1.6		Ndërtimi i Muzeut të qytetit (restaurimi i ndonjë kulle për këtë qëllim) projekt i njëjtë me A.2.4	KOMUNA, DASH	MKRS, DONATORËT	ULËT	2012-2013	LARTË
	F1.7		Restaurim, konservim i kullave dhe vëria në funksion publik (bibliotekë, qendër informative turistike, rinore)	KOMUNA, DASH	MKRS, DONATORËT	LARTË	2011-vazhdimësi	LARTË
	<b>PROMOVIMI DHE MARKETINGU</b>							
F1.8		Funksionalizimi i qendrës turistike të informimit (përfshirë punësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit) si dhe krijimi i mekanizmave propagandues dhe promovues të trashëgimisë junikase (OJQ, asociacione, etj) të cilat do të përfshihen në rrjetet lokale dhe ndërkombëtare turistike.(B1.23)	KOMUNA	DONATORËT, MTI-BIZNESET	MESËM	2017-2023+	LARTË	
F1.9		Manifestimi tradicional "Ditët e Kullave të Junikut" (përfshin edhe forume debatuuese me pronarë të kullave dhe pjesëmarrës tjerë mbi ruajtjen dhe funksionalizimin e kësaj trashëgimie) etj. (B1.29)	KOMUNA, DASH	BIZNESET, MKRS, OJQ	MESËM	2011-vazhdimësi	ULET	
F1.10		Publikime, organizime në formë ekspozitash, panairesh, koncertesh, festash ku mund të prezantohet trashëgimia kulturore përfshirë atë shpirtërore (zakonet, doket, ritet, vallet, muzika, kënga dhe shprehjet artistike-artizanatet, zejet etj)(pjesërisht ngjashëm me B1.29)	KOMUNA	OJQ-DONATORËT	MESËM	2011-vazhdimësi	ULET	
F1.11		Projekte që stimulojnë zhvillimin e veprimtarisë artizanale <sup>28</sup> dhe kuzhinës tradicionale <sup>19</sup> (B1.24; B1.25)	KOMUNA	OJQ-DONATORËT	ULËT/MESËM	2014-2016-vazhdimësi	ULET	
F1.12		Shenjëzimi i lokaliteteve atraktive të trashëgimisë kulturore-natyrore për vendas dhe turistë (pjesërisht ngjashëm me projektin C2.4)	KOMUNA	OJQ-DONATORËT	MESËM	2017-2023+	ULET	


Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2011-2023

FUSHA	KODI PROJEKTI	VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET	INSTITUCIONI PERGJEGJES	SUBJEKTET TJERA TË PËRFSHIRA	PRIORITET	KOHEZGJATJA	IMPLIKIMI FINANCIAR
NGRITJA E KAPACITETEVE NE PLANIFIKIM HAPËSINOR	<b>G1: KONSOLIDIMI I SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOMUNË</b>						
	ZHVILLIMI I KAPACITETEVE KOMUNALE NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE KONTROLLIN E ZHVILLIMEVE						
	G1.1	Përkrahja e edukimit të avancuar dhe trajnimet të personelit në fushën e planifikimit hapësinor përfshirë edhe inspektionin	DUKM,DSHP	MMPH, SHERBIMET PUBLIKE	LARTË	2012-Vazhdimisht	ULET
	G1.2	Themelimi i njësisë për planifikim hapësinor	DUKM KOMUNA	MMPH	LARTË	2012	ULET
	G1.3	Përkrahja dhe fuqizimi i mekanizmave inspektues për monitorim dhe kontroll të zhvillimeve në hapësirë sipas planeve hapësinore dhe urbane të aprovuara	KOMUNA, DUKM,DSHP	MMPH	LARTË	2012-vazhdimisht	ULET
	ZHVILLIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE NË PLANIFIKIM HAPËSINOR						
	G1.4	Emërimi i GIS zyrtarit dhe trajnime të avancuara në fushën e përdorimit të Sistemit gjeografik informativ (GIS)	KOMUNA	MINISTRITË, DONATORËT	MESËM	2012-vazhdimisht	ULET
	G1.5	Krijimi i bazës së të dhënave në GIS dhe harmonizimi me ato të Ministrisë	KOMUNA	MMPH	MESËM	2017-2023+	ULET
	G1.6	Sigurimi i pajisjeve përkatëse softërike dhe teknike që mundësojnë punën në GIS	KOMUNA	DONATORËT	MESËM	2016	ULET
	NDËRGJEGJËSIMI I POPULLSISË PËR FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR						
	G1.7	Organizimi i debateve publike me tema ku trajtohen çështjet e zhvillimit hapësinor	KOMUNA, DUKM	OJQ-te, MMPH	MESËM	2011-vazhdimisht	ULET
	G1.8	Zhvillimi dhe shpërndarja e buletinit komunal (projekti njejtë me A3.3)	KOMUNA	OSBE	LARTË	2011-vazhdimisht	MESEM
	G1.9	Përfshirja e qytetarëve në zhvillimin e projekteve të dala nga plani	KOMUNA	KOMUNITETI	MESËM	2011-vazhdimisht	ULET
	ZHVILLIMI I METODAVE QË THJESHTOJNË PROCEDURAT E MARRJES SË LEJEVE URBANISTIKE DHE NDËRTIMIT						
	G1.10	Hartimi i broshurës mbi procedurat për marrjen e lejes urbanistike, ndërtimit dhe lejes së përdorimit	KOMUNA	DONATORË, OJQ-te	LARTË	2011	ULET
G1.11	Zhvillimi i mënyrave softwerike për aplikim për leje në formë elektronike	KOMUNA	DONATORË, MMPH	MESËM	2014-2016	MESEM	

Harta 13 : Zhvillimet/veprimet e propozuara jashtë zonës urbane



Harta 14: Zhvillimet e propozuara në zonën urbane sipas PZHK dhe propozime të PZHU



## 6. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Kreu i Dispozitave për Zbatim paraqet dispozitat të cilat janë të nevojshme për të siguruar zbatimin e Planit. Zhvillimi i ardhshëm i Junikut duhet të bazohet në vendime që duhet të ndërmerren nga komuna.

### 6.1. UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PZHK-së GJATË HARTIMIT TË PRRU-ve DHE PLANEVE TJERA

- PZHK bazohet në Projekt Planin Hapësinor të Kosovës dhe duhet të jetë në përputhje me propozimet e dala nga ai; Vendimet për zhvillimet me rëndësi për nivelin e Kosovën të parapara me PHK në territorin e komunës duhet të respektohen;
- PZHK merr parasysh mundësinë e shpalljes së Alpeve Shqiptare Park Nacional. Me shpalljen e tij, dispozitat e dala nga Plani Hapësinor i Zonës së Veçantë (PHZV) të Parkut shfuqizojnë ato dispozita të PZHK nëse ato janë në kundërshtim me ato të PHZV
- PZHK do të jetë bazë për hartimin e PRRU-ve të parapara jashtë Zonës Urbane. Këto Plane nuk duhet të cenojnë dispozitat e PZHK-së.
- PZHK shërben si Udhëzues për të gjithë sektorët tjerë në komunë;
- Çdo propozim apo vendim në lidhje me PRRU-të që janë në konflikt me dispozitat e PZHK-së duhet të kalojnë nëpër procesin e rishikimit dhe shqyrtimit publik (ashtu siq është paraparë me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor) dhe marrin miratimin në Kuvend.
- PZHK duhet të shërbejë për interpretimin e çështjeve të caktuara si ato të pronësisë, Vendbanimeve joformale (VJF), zhvillimeve dhe ndërtimeve të parapara sidomos atyre jashtë zonës urbane etj

### 6.2. KUSHTE TË PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE PËR ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NË KOMUNË

Determinues për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e komunës janë kushtet dhe karakteristikat gjeografike dhe morfologjike, vizioni dhe qëllimet e planit të cilat japin orientimet e ardhshme të zhvillimit. Prandaj, në komunën e Junikut, Plani përcakton këto destinime të sipërfaqeve:

1. Vendbanimet në kuadër të të cilës janë funksionet për banim, infrastruktura sociale, objektet për rini, kulturë, sport, hapësirat publike, biznese e afarizëm. PZHK ka respektuar destinimin e përcaktuar me PZHU.
2. Toka bujqësore, kullosat, livadhe dhe pyjet
3. Zona ekonomike
4. Hapësirat me vlera të trashëgimisë kulturore
5. Hapësirat me potencial të zhvillimit të turizmit jashtë zonës urbane
6. Hapësira për ndërtimin e mini hidrocentraleve
7. Hapësirat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu
8. Infrastruktura fizike jashtë zonës urbane dhe qasja në bjeshkë
9. Infrastruktura e këmbësorëve me theks të veçantë jashtë zonës urbane (qasja e vizitorëve në bjeshkë) etj

#### 6.2.1. Kushtet për rregullimin e hapësirës:

PZHK përmes Kornizës së Zhvillimit Hapësinor përcakton kushtet dhe masat për rregullimin e sipërfaqeve të destinuara: kushtet për rregullimin e vendbanimeve dhe zonës ndërtimore, tokës bujqësore, zonës ekonomike dhe asaj industriale, pyjeve, hapësirave publike, infrastrukturës fizike dhe sociale, hapësirave për sport e rekreacion, hapësirave me rrezikshmëri etj. Në përgjithësi, kushtet për rregullimin e hapësirës bëhen sipas

rregullave të përcaktuara nga korniza e zhvillimit hapësinor të Planit, si dhe rregullave të veçanta të përcaktuara me ligje përkatëse dhe ato të përcaktuara me akte nënligjore (UA për Kushtet e Lokacionit, Dhënie e Përlqimit urbanistik dhe Lejes Urbanistike etj.) me të cilat rregullohen Kushtet e Lokacionit të Objekteve Ndërtimore.

### **6.2.2. Kushtet për rregullimin e vendbanimeve**

- Rregullimi i vendbanimeve do të bëhet përmes kushteve për rregullim të përcaktuara në Kornizën e Zhvillimit Hapësinor të PZHK-së.
- Kushtet e përgjithshme për rregullimin e hapësirës për vendbanimet (Jasiq dhe Gjocaj) që gjenden jashtë zonës urbane bëhen duke respektuar Konceptin e Zhvillimit Hapësinor të paraparë me PZHK për atë zonë. Kushtet e veçanta përcaktohen me PRrU.
- Kushtet për rregullimin e hapësirës brenda Zonës Urbane rregullohen sipas dispozitatave të PZHU-së dhe PZHK-së.
- Zhvillimi i vendbanimeve në zonat e rrezikuara nuk do të lejohet përderisa nuk merren masat e nevojshme për të eliminuar atë: zhvillimit të vendbanimeve Gjocaj dhe Jasiq duhet t'i paraprijnë aktivitetet e deminimit; në lagjet Berishë e Tofaj duhet të ketë një lloj kufizimi në ndërtimet derisa të mos rregullohet shtrati i lumit Erenik për të siguruar mbrojtjen nga vërshimet;
- Gjatë zhvillimit të vendbanimeve, sidomos gjatë hartimit të PRrU-ve, duhet marrë parasysh edhe aspekti sizmik. PZHK ka identifikuar zonat sizmike dhe gjithashtu ka propozuar hartimin e Planit për Mbrojtje dhe Shpëtim për gjithë territorin e komunës
- PZHK nuk parasheh zgjerim të kufirit të Zonës Urbane të përcaktuar me PZHU.
- PZHK ka identifikuar Vendbanimin Joformal "Agim Ramadani" dhe ka propozuar hartimin e Programit për Trajtimin e tij. Kushtet për rregullimin e VJF do të bazohen në udhëzimet e strategjisë së Ministrisë. Deri në trajtimin e VJF, komuna merr masa për parandalimin e zhvillimeve të pakontrolluara në vendbanim.

#### **6.2.2 a. Kushtet e rregullimit për ndërtesat me rëndësi për Kosovën në territorin e Komunës së Junikut**

- Objektet e trashëgimisë kulturore (kullat, mullinj të, shtëpitë e gurit etj.) konsiderohen si ndërtime me rëndësi për Kosovën. Komuna do të bashkëpunojë ngusht me pronarët për ruajtjen e këtyre objekteve. Lirimi nga tatimi në pronë është një masë që komuna ndërmerr për ruajtjen e kësaj trashëgimie. Komuna do të bashkëpunojë me Institucionet qendrore për inventarizimin, restaurimin dhe vënien nën mbrojtje të këtyre objekteve. Komuna merr përgjegjësi përmes inspektionit që të mbaj kontrollin e zhvillimeve rreth këtyre ndërtesave.
- PZHK ka propozuar objekte të reja që mund të kenë interes kombëtar (Hidrocentralet në Junik, qendra për turizëm, sport e rekreacion, rehabilitim etj). Komuna, përmes inspektorëve, do të parandalojë çdo zhvillim të mundshëm në zonën ku janë propozuar ndërtimet e reja.

#### **6.2.2 b. Kushtet për rregullimin e ndërtimeve në zonat ndërtimore për vendbanime;**

- Në zonën ndërtimore urbane, do të respektohen kushtet dhe dispozitat për dendësim dhe plotësim të hapësirave të lira. Jashtë zonës urbane për vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj zona ndërtimore do të përcaktohet saktësisht me PRrU, i cili duhet të respektojë dispozitat e dala nga ky Plan për rregullimin e zonës.
- Ndërtesat do të lejohen vetëm në zonat e përcaktuara me Plan. Infrastruktura fizike dhe sociale do të ofrohet vetëm në zonat e destinuara për ndërtim.
- Në tokën bujqësore kualitative e përcaktuar me Plan, nuk do të lejohen ndërtimet me përjashtim të objekteve të karakterit bujqësor.
- Në hapësira ku lejohet zhvillimi, kushtet e lokacionit, kushtet tekniko-urbanistike dhe ato të ndërtimit përcaktojnë me sa vijon:

##### **i) kushtet e lokacionit- përfshin shënimet mbi lokacionin-**

- Karakteristikat hidrologjike dhe gjeologjike ku parashihen hulumtime gjeomekanike për të përcaktuar përbërjen e tokës/kualitetin e dheut për llojin e caktuar të ndërtimit dhe kultivimit, prania e ujërave tokësore dhe nëntokësore, mënyra natyrore e drenazimit, vegjetacioni dhe fauna, aspekti i rrezikshmërisë ndaj rreziqeve dhe fatkeqësive tjera (vërshimet, erozioni, tërmetet), pjerrtësia e terrenit etj.

- Kushtet makro-mikroklimatike: insolimi gjatë stinëve të ndryshme të vitit, mbizotërimi i erërave në kohë të ndryshme të vitit, vendet e ngrirjes, mundësia e përdorimit të energjisë solare. Gjatë planifikimit të ndërtesave/strukturave të reja në raport me ato ekzistuese është me rëndësi të analizohet struktura dritë/hije në stinë të ndryshme të vitit në ndërtesat përreth si dhe në hapësirat publike.
- Të dhënat për zonën e zhvillimit dhe ngastrën kadastrale: përfshijnë analizën mbi pozitën, orientimin, formën, madhësinë e zonës së zhvillimit, ngastrës ndërtimore, analizën e përshtatshmërisë, shfrytëzimin e tokës në zonat përreth, përgatitja e lokacionit (largimi i ndërtesave dhe rehabilitimi i tokës, etj).
- Shënimet për linjën rregulluese dhe atë ndërtimore

#### **ii) kushtet teknike-urbanistike**

- Shënimet për llojin e objektit, përmbajtjen dhe kapacitetin, pozitën e objektit në ngastrën ndërtimore,
- Rregullat për kyçjen e ndërtesës në rrjetin e infrastrukturës rrugor dhe instalimet tjera (rrugët e mundshme për qasjen në zonë, duke përfshirë konfliktet me sistemin e rrugëve dhe instalimeve ekzistuese).
- kushtet për ofrimin e parkingjeve dhe sipërfaqëve gjelbëruese në kuadër të ngastrës ndërtimore
- kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe mbrojtje civile
- kushtet për mbrojtjen nga fatkeqësitë
- kushtet për mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- kushtet për lëvizjen pa pengesa të personave me nevoja të veçanta

#### **iii) kërkesat e përgjithshme të ndërtimit (referoju më gjerësisht Ligjit të Ndërtimit)**

- Ndërtesat duhet të vendosen, ndërtohen, ndryshohen, rrënohen dhe mirëmbahen në mënyrë që të mos rrezikojnë sigurinë dhe rendin publik, veçanërisht jetën dhe shëndetin e njerëzve, mjedisin, qëndrueshmërinë e objekteve fqinje, instalimeve publike. Ndërtimi duhet të arrijë nivel optimal të qëndrueshmërisë, stabilitetit, mbrojtjes nga zjarri, higjienë sanitare, siguri përdorimi, izolim zhurme dhe temperature.

#### **iv) kërkesat themelore për ndërtim:** Gjatë projektimit të objekteve mirren parasysh këto kërkesa themelore (më gjerësisht referoju Ligjit të Ndërtimit):

- Qëndrueshmëria mekanike dhe stabiliteti
- Mbrojtja nga zjarri
- Mbrojtja e higjienës, shëndetit dhe mjedisit (nenet përkatëse: 3, 5, 6, 7, 8,9)
- Izolimi nga temperatura, zhurma dhe mbrojtja kundër vibrimeve
- Distancat në mes objekteve
- Përdorimi i ndërtesës, siguria dhe qëndrueshmëria
- Përjashtimet- vlejnjë për objektet me vlera historike-kulturore
- Specifikimi me rregulla teknike - vlen sidomos për përcaktimin e kushteve teknike për përdorimin e objekteve ndërtimore nga personat me nevoja të veçanta.
- Komuna lëshon Leje të Ndërtimit për të gjitha ndërtimet, përveç atyre që janë të përcaktuara me nenin 35 të Ligjit të Ndërtimit. Për këto objekte Leja e Ndërtimit lëshohet nga MMPH-ja:
  - Ndërtimet e ndërlidhjeve dhe telekomunikacionit (referoju më detajisht Ligjit)
  - Objektet energjetike; hidroteknike dhe objektet industriale
  - Objekte për qëllime të veçanta
- Objektet/strukturat të cilat nuk kanë nevojë për Leje Ndërtimit janë të përcaktuara me nenin 41 të Ligjit për Ndërtim.

#### **6.2.2 c. Kushtet për rregullimin e strukturave të ndërtuara jashtë vendbanimeve;**

Jashtë zonës ndërtimore mund të ndërtohen këto ndërtesa të parapara me nenin 17.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor për të cilat MMPH lëshon Lejen Urbanistike dhe Ndërtimore:

- Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile
- Ndërtesat për mbrojtje nga zjarri dhe materialet e dëmshme – eksploziv etj
- Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore
- Ndërtesat e infrastrukturës
- Ndërtesat për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksploatuar

- Ndërtesat për rekreacion dhe turizëm rural
- Rregullimi i strukturave të ndërtuara jashtë vendbanimeve duhet të bëhet konform kushteve të përgjithshme: kushteve të lokacionit, kushteve tekniko-urbanistike dhe atyre të ndërtimit sipas Ligjeve në fuqi (shih paragrafin paraprak). Kushtet e veçanta të projektimit dhe ndërtimit do të përcaktohen me Plane Rregulluese Urbane dhe gjithnjë duke respektuar dispozitat e Planit dhe ato ligjore të planifikimit dhe ndërtimit.
- Komuna nuk do të jetë përgjegjëse për ofrimin e infrastrukturës jashtë vendbanimeve përpos asaj të përcaktuar me PZHK.
- Strukturat e ndërtimit në zona turistike, duhet të jenë nga materiale që konsiderohen si materiale miqësore ndaj natyrës (si druri e jo struktura nga betoni, betonarmeja, muret me blloqe, etj)

### ***6.2.3. Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike***

- Komuna do të ofroj infrastrukturën, kushtet dhe hapësirën për stimulimin e investuesve serioz të cilët paraqesin ofertën e përshtatshme për zhvillim ekonomik dhe angazhimin e fuqisë punëtore lokale
  - Komuna do të përkrahë dhe mundësojë ngritjen e kapitalit njerëzor përmes arsimimit dhe trajnimit të fuqisë punëtore sidomos në fushat ekonomike prioritare të përcaktuara me Plan. Në këtë aspekt, komuna do të përkrah hapjen e shkollave profesionale
  - Komuna do të përkrahë punën e Agjencionit për Zhvillim Regjional (AZHR) duke siguruar bashkëpunim të plotë me ta dhe Komunitat fqinje në realizimin e Projekteve me interes të përbashkët të identifikuar me Plan.
- 6.2.3 (a) Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike industriale***
- PZHK ka përcaktuar zonën ekonomike ku do të lejohen veprimtari të caktuara industriale të propozuara me Plan. Shpallja e zonës si zonë ekonomike, duhet të bëhet sipas kriterëve të parapara me ligjin për veprimtaritë ekonomike dhe përfshin: statusin e zonës p.sh zonë ekonomike ose industriale, park industrial ose teknologjik etj, kufijtë e zonës, llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në zonë etj.
    - PZHK ka përcaktuar zonën ekonomike të paraparë për zhvillimin e industrisë së lehtë me agro-biznes. PZHK ka propozuar hartimin e PRrU-së dhe studimin e fizibilitetit të zonës në të cilin mund të parashihet edhe ndërtimi i Parkut të Biznesit me theks të veçantë në agro-biznes. Do të lejohet vetëm ndërtimi i përmbytjeve të pastra për prodhimtari bujqësore dhe industriale, depot për magazinimin e produkteve, shërbimet dhe përmbytje tregtare të cilat nuk kanë ndikim negative në mjedis. Gjatë hartimit të PRrU-ve duhet marrë parasysh kushtet për rregullimin e zonës së përcaktuar sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor si dhe Ligjit për Zonat e Ekonomike si dhe hartimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Kushtet e veçanta për zhvillimin e zonës përcaktohen me detyrën projektuese për PRrU-të.

### ***6.2.3 (b) Kushtet për vendosjen e veprimtarive të bizneseve prodhuese, tregtare dhe komerciale***

- Zonat e destinuar me Plan për biznese tregtare dhe komerciale janë përcaktuar me PZHU. Ato mund të zgjerohen vetëm nëse Komuna e sheh atë veprim si progresiv dhe me interes afatgjatë.
- Do të stimulohen subjektet tregtare-komerciale të cilat ofrojnë programe të qëndrueshme të bizneseve të tyre të cilat do të shfrytëzojnë energjinë elektrike nga burimet e ripërtërishme
- Bizneset prodhuese do të stimulohen dhe lejohen nëse ato janë konform kushteve për shfrytëzim të tokës, dhe dispozitave tjera mbi ruajtjen e mjedisit.
- Në zonën ku është paraparë ndërtimi i tregut të gjelbërt duhet marrë parasysh kushtet e përgjithshme si: qasja (me transport publik, shtigjet këmbësorike, parkingjet), kushtet e lokacionit, kushtet tekniko-urbanistike si dhe rregullat e ndërtimit dhe distancat me ndërtesat në afërsi, masat për siguri, mbrojtja mjedisore, kushtet për mirëmbajtjen e zonës etj. Kushtet më detaje jepen me detyrën projektuese.

### ***6.2.3 (c) Kushtet për ruajtjen dhe vendosjen e veprimtarive të bujqësisë dhe blegtorisë:***

- Korniza e zhvillimit hapësinor, ka përcaktuar tokën bujqësore kualitative e cila duhet të mbrohet nga çdo ndërtim pos atyre që kanë të bëjnë me veprimtari bujqësore. Komuna merr Vendim për mbrojtjen e kësaj toke dhe merr masa për parandalimin e zhvillimeve në të. Komuna, sipas Ligjit për Tokën Bujqësore, harton edhe projektin për Rregullimin e tokës bujqësore, dhe krijimin e kadastrit bujqësor.

- Kushtet për rregullat mbi distancat dhe standartet teknike të objekteve për prodhime blegtorale të cilat jepen sipas dispozitave ligjore.
- Objektet për përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të tij, licencohen nga MBPZHR dhe duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin për Bletarinë;
- Komuna do të stimulojë investuesit e orientuar në grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekuese duke respektuar Ligjet në fuqi (Ligji për Pyjet, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës etj) dhe siguruar lejet nga Ministritë përkatëse.

#### **6.2.3 (d) Kushtet për vendosjen e veprimtarive të turizmit-hotelet, motele, restorantet, etj**

- PZHK ka përcaktuar lokalitetet turistike
- Në hapësirat turistike të përcaktuara si Zona Turistike me Plan do të hartohen PRRU-të. Komuna do të lejojë vetëm ndërtimin e akomodimeve të vogla me maksimum 20 shtretër për turistë, nëse ata në tërësi i respektojnë kushtet mjedisore. Strukturat e ndërtimit në Zona Turistike malore duhet të jenë nga materiale që konsiderohen si materiale miqësore ndaj natyrë dhe material të lokalitetit (si druri e jo struktura nga betoni, betonarmeja, muret me blloqe etj.)
- Komuna do të lejojë ndërtimin e infrastrukturës që përkrah atraksionet turistike dhe aktivitetet e rekreacionit të cilat nuk kanë asnjë ndikim negativ në mjedis
- Komuna do të sigurojë edhe zhvillimin e infrastrukturës dhe lëmive përcjellëse turistike si gastronomia, aktivitetet kulturore, zhvillimi i artizanateve etj. Komuna do të përkrah projektet e OJQ-ve që merren me promovimin e vlerave tradicionale.
- Komuna krijon lehtësira dhe mundësi për investime në turizëm duke aplikuar format e PPP gjithnjë në përputhje me dispozita Ligjore dhe PZHK-në (kjo formë është e përshtatshme për shfrytëzimin e objekteve të trashëgimisë kulturore për nevoja të turizmit: kullat, shtëpitë e gurit, stanet që mund të jepen me qira, etj.)

#### **6.2.4. Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike**

- Veprimtaritë publike do të zhvillohen në zona të parapara me PZHK.
- Nëse gjatë hartimit të PZHK-së nuk është arritur të përcaktohet saktësisht hapësira për veprimtaritë e tilla (për shkak të çështjeve pronësore-juridike në lidhje me tokën komunale apo arsye tjetër), komuna do të kujdeset që gjatë periudhës së zhvillimit të Planit të alokojë tokë për këto veprimtari.
- Gjatë trajtimit të hapësirave publike është me rëndësi të mbahen dhe përdoren elementet e ndërtimi që janë karakteristike për zonën. Arkitektura e lokalitetit duhet të analizohet dhe të tentohet të respektohet. Strukturat historike dhe ato të trashëgimisë duhet të mbrohen duke i modifikuar ato dhe propozuar destinim të ri për shfrytëzimin e atij objekti (adaptimi i kullave për t'u shfrytëzuar për muze, bibliotekë, etj.)
- Duhet të i kushtohet kujdes i veçantë vizurave (pamjet drejt shesheve, ndërtesave të veçanta ose bukurive natyrore siç janë: hapësirat pranë lumejve, etj).

#### **Kriteret e përgjithshme për planifikimin e hapësirave të objekteve të veprimtarive publike:**

##### **6.2.4 (a) Institucione shkollore do të ndërtohen sipas parametrave:**

- institucione parashkollore- sipërfaqe e përgjithshme 20-40 m<sup>2</sup>/fëmijë
- raporti mësimdhënës/ nxënës (sipas UA-18/9 i MASHT) dhe numri i nxënësve në klasë
  - arsimin parashkollor(5-6 vjeç)- raporti 1 mësimdhënës/12 fëmijë
  - shkollimin fillor (prej klasës I-IX)- raporti 1 mësimdhënës/ 21.3 nxënës
  - shkollimin e mesëm (klasa X-XII)- raporti 1 mësimdhënës/ 21.3 nxënës; numri i nxënësve në klasë 32
  - shkollimin i mesëm profesional (X-XIII)- raporti 1 mësimdhënës/ 17.2 nxënës; numri i nxënësve në klasë 17
  - shkollat në vise malore në lartësinë mbidetare mbi 700 m- raporti 1 mësimdhënës/14.3 nxënës
- hapësira e nevojshme për nxënës në kuadër të klasës është 2m<sup>2</sup>/nxënës
- të sigurohet hapësirë e gjelbërimit dhe terrenet e hapura sportive në kuadër të oborrit shkollor

- Komuna duhet të sigurojë që gjatë zhvillimit të hapësirave shkollore të jetë marrë parasysh aspekti i sigurisë së fëmijëve në trafik. Komuna siguron transportin publik deri në shkollë.
- Kushtet e lokacionit, kushtet tekniko-urbanistike përcaktohen detajisht me detyrë projektuese **6.2.4 (b) Objektet për kulturë (muzetë, shtëpia e kulturës, biblioteka etj.):**
- PZHK ka përcaktuar nevojën për sigurimin e objekteve për kulturë
- Me qëllim të shfrytëzimit maksimal të tokës, Komuna merr parasysh adaptimin e ndërtesave ekzistuese (p.sh shfrytëzimi i kullës për muze ) si dhe do të favorizojë ndërtimet multi-funksionale.
- Komuna lidh marrëveshje të PPP për shfrytëzimin e objekteve për qëllime kulturore nëse ato janë në pronësi private (kjo sidomos vlen për ato objekte që kanë vlera të trashëgimisë kulturore)
- Kushtet e lokacionit, kushtet tekniko-urbanistike përcaktohen me detyrë projektuese **6.2.4 (c) Objektet për rini, sport e rekreacion si dhe terrenet e hapura për sport e rekreacion**
- PZHK ka dhënë propozimet për sigurimin e objekteve dhe hapësirave për rini, sport e rekreacion (qendra e të rinjve, halla sportive, terrenet për sport e rekreacion). Planifikimi i këtyre hapësirave do të bëhet sipas standardeve ndërkombëtare
- Komuna do të maksimizojë shfrytëzimin e terreneve sportive shkollore të cilat do të mund të shfrytëzohen edhe për publikun e gjerë
- Komuna përkrah projektet që promovojnë dhe stimulojnë angazhimin e të rinjve në aktivitete sportive
- Kushtet e lokacionit, kushtet tekniko-urbanistike dhe ato të ndërtimit përcaktohen me detyrë projektuese **6.2.4 (d) Sipërfaqet publike të gjelbëruara, hapërisat e lira dhe parqet:**
- PZHK ka identifikuar hapërisat e tilla
- Sipërfaqet publike të gjelbëruara ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrën e cila mundëson ruajtjen dhe avancimin e vlerave natyrore dhe të krijuara
- Nëse për shkak të ndërtimit të objektit, dëmtohet sipërfaqja publike e gjelbëruar, ajo duhet të kompensohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar nga komuna.
- Planifikimi i hapërisave publike me destinim parqe, gjelbërim duhet të bëhet konform dendësisë së banimit.
- Gjatë trajtimit të parkut të qytetit nuk lejohet pllakosje më shumë se 10% e sipërfaqes së përgjithshme të parkut.
- Gjatë trajtimit të parqeve, duhet analizuar me kujdes kushtet makro-mikroklimatike. Lëvizja e ajrit, mbrojtja nga erërat të cilat janë karakteristike për atë rajon, mund të modifikohen me struktura të larta urbane.
- Kushtet më detaje për rregullimin e këtyre hapësirave përcaktohen me detyrë projektuese

### **6.2.5. Kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve, sipërfaqeve komunikuese dhe sistemeve tjera të infrastrukturës**

- Komuna e Junikut obligohet që të iniciojë hartimin e Planit për Mobilitet i cili duhet të trajtojë qasjen në transport publik, sigurinë dhe efikasitetin në trafik, infrastrukturën rrugore dhe atë të këmbësorëve, rregullimin e trafikut, ndikimet në mjedis etj.
- Komuna i drejton disa kërkesa nivelit qendror:
  - Për studimin e fizibilitetit për hapjen e lidhjes rrugore në mes të Junikut dhe Shqipërisë, Bjeshkët e Junikut
  - Përmirësimin e rrugëve kryesore që e lidhin Junikun me qendrat tjera
  - Zbatimin e Ligjit për Rrugët, lidhur me distancën e cila duhet mbajtur e lirë nga ndërtimi, dhe lidhur me qasjet e paorganizuar dhe ilegale në rrugë kryesore
- Dimensionet e rrugëve përcaktohen konform standardeve të rrugëve varësisht prej kategorive që i takojnë
- Rrugët lokale dhe rrugë tjera duhet të rregullohen në mënyre që të sigurohet rrjedhja e sigurtë e trafikut në të gjitha kushtet atmosferike

- Duhet ti kushtohet kujdes dizajnit të udhëkryqeve dhe rreth-rrotullimeve për qarkullim duke konsideruar pamjen prej të gjitha drejtimeve dhe ti jepet prioritet sigurisë dhe komoditetit të këmbësorëve
- Shtigjet për çiklizëm në një drejtim që nuk janë të ndara nga rruga duhet të jenë 1m' të gjëra.

#### **6.2.6. Masat për mbrojtjen e peisazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike**

- Komuna bashkëpunon me Ministrinë përkatëse, institucionet dhe organizatat tjera për përgatitjen e Planit të menaxhimit me të mirat e natyrës, Planit të veprimit lokal për mbrojtjen e mjedisit, Planit operacional për menaxhimin e pyjeve për të siguruar harmonizimin me Planet dhe strategjitë e Qeverisë
- Komuna zhvillon dhe merr pjesë në hartimin e politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me ruajtjen e resurseve natyrore, trashëgimisë kulturo-historike, si dhe në zhvillimin e projekteve të parapara me Plan për mbrojtjen e mjedisit dhe vlerave natyrore e kulturore
- Komuna siguron pjesëmarrjen edhe të publikut, OJQ-ve, organizatave profesionale, komunitetit të biznesit etj në procesin e hartimit të Planeve, programeve e projekteve të lartpërmendura
- Komuna siguron zbatimin e legjislacionit përkatës dhe konform tij mbështet të drejtat pronësore të qytetarëve të saj
- Strukturat e duhura dhe legjislacioni mbështetës gjithashtu do të mbështesin transparencën dhe luftimin e korrupsionit në sektorin e pylltarisë
- Komuna në kuadër të kompetencave të saj ndërmerr këto masa dhe aktivitete:
  - kujdeset për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peisazhore për territorin e vet
  - shpall Zonat e Mbrojtura për të cilat është kompetente dhe merr pjesë në procedurën e shpalljes së Zonave të Mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi;
  - siguron kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e Zonave të Mbrojtura për të cilat është kompetente
  - kujdeset për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe mbështet shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës
  - përcjell gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë, Ministrinë dhe Institutit i paraqesin raport /mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës/
  - informon publikun për gjendjen e natyrës dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e saj
  - Komuna bashkëpunon me komunat fqinje për të siguruar mbrojtjen e peisazheve dhe vlerave natyrore e kulturo-historike. Dy ose më shumë komuna, mund të hartojnë dhe miratojnë së bashku plane ose programe të përbashkëta të veprimit për mbrojtjen e mjedisit për zvogëlimin e efekteve negative në mjedis
  - Komuna do të kërkojë ndihmën e organeve pyjore qendrore, për të patur prioritet në hartimin e Planeve Menaxhuese me përfaqësues të qytetarëve të saj. Administrata lokale dhe komunitetet do të fitojnë ngritje të kapaciteteve për një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve të tyre.

##### **6.2.6(a): Zonat e mbrojtura:**

Komuna me PZHK ka përcaktuar vlerat e natyrës dhe ato kulturore të cilat duhet të mbrohen dhe në të cilat duhet marrë masa për të penguar degradimin:

- Zonë e mbrojtur ndërkufitare
- Zonë e mbrojtur e llojit Park Nacional pritet të bëhet shpallja e Alpeve Shqiptare. Pas miratimit të Ligjit dhe shpalljes nga Kuvendi i Kosovës, MMPH harton Planin Hapësinor për Zonën e Vecantë për Parkun Nacional. Deri në vendosjen e një regjimi institucional të Qeverisë për rregullimin e kësaj hapësire, Komuna e Junikut merr përgjegjësitë e plota për mbajtjen nën kontroll të zhvillimeve për territorin i cili shtrihet në Zonën e Parkut.
- Me PZHK, Komuna ka parapare zhvillime me veprimtari turistike (turizëm alpin, rekreativo-kurativ, eko-turizëm) në lokalitete me potencial turistik të Zonës dhe ka propozuar hartimin e PRRU-ve. Komuna do të bashkëpunojë ngusht me Ministrinë gjatë hartimit të këtyre Planeve për të siguruar që këto zhvillime nuk do të jenë në të ardhmen në kontraditë me ruajtjen e vlerave të Zonës. Në kuadër të kësaj Zone gjenden edhe monumente arkeologjike (Gradina), peisazhe hidrografike (te Burimi i lumit Erenik dhe

Liqejtë e Gjeravicës) dhe peisazhe malore (Maja e Gjeravicës). Me qëllim të ruajtjes së biodiversitetit në këtë Zonë, komuna me Plan ka paraparëhartimin e planeve përkatëse dhe projekte që kanë të bëjnë me pyllëzimin dhe ripyllëzimin e zonave të zhveshura, projekte për kujdesin ndaj kafshëve të egra, projekte ndërgjegjësimi etj.

- Zonë e mbrojtur e llojit Park natyror propozuar me PZHU është Moronica e cila gjendet në kuadër të Zonës Urbane dhe të cilën Kuvendi i Komunës së Junikut e ka shpallur Park Natyror me Vendim (datë 28/08/2008). Në referim të PZHU-së, Komuna harton PRrU për këtë Zonë.

**6.2.6(b): Mbrojtja e ekosistemeve pyjore:**

Me qëllim të mbrojtjes së ekosistemeve pyjore, Komuna ndërmerr aktivitete pyllëzimi dhe ripyllëzimi në zonat e identifikuar me Plan. Pyllëzimi bëhet me llojet vendore të drunjve që shprehin përbërjen natyrore, duke shfrytëzuar metodat e përshtatshme natyrore. Për këto aktivitete Komuna bashkëpunon me Ministrinë përkatëse. Gjatë prerjes së pyjeve, duhet marrë parasysh ruajtjen e larmisë biologjike të pyjeve (Shih më detajisht Ligjin për Pyjet e Kosovës, Nr.2003/3 si dhe Ligjin Nr.2004/29).

**6.2.6(c): Ruajtja e kullosave dhe peisazheve përfshirë peisazhin bujqësor:**

Ruajtja e kullosave bëhet përmes kullotjes së bagëtive, kositjes, përshtatjes së llojit të barit dhe shfrytëzimit të pranueshëm të mjeteve për mbrojtjen e bimëve dhe plehrave minerale. Ruajtja e peisazheve bujqësore të tokave të punueshme bëhet duke ruajtur skajet e vlefshme të vendbanimeve, gardhiqet, trungjet individuale, grup trungjet, skajet e livadheve etj. Komuna merr masa për të siguruar ruajtjen e veçorive karakteristike të peisazheve si dhe mirëmbajtjen e vlerave biologjike, gjeologjike dhe kulturore të cilat e përcaktojnë rëndësinë dhe përjetimin estetik të tij.

**6.2.6(d): Mbrojtja e ujërave (nëntokësor dhe mbitokësor):**

Komuna nuk duhet të lejojë shkarkime të mëtutjeshme të ujërave te zeza në lumejtë përreth, ndërsa shkarkimet ekzistuese duhet të trajtohen përmes impiantit për trajtimin e tyre

**6.2.6(e): Mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit:**

Me PZHK është theksuar një numër i konsiderueshëm i florës dhe faunës që gjenden në Alpet Shqiptare (ku përfshihen edhe Bjeshkët e Junikut), të cilat janë dhe/apo duhet të përfshihen në listat ndërkombëtare për t'u mbrojtur (sipas studimit të fizibilitetit për Shpalljen Park Nacional të Alpeve Shqiptare).

• **Llojet e bimësisë:**

Të propozuara për t'u përfshirë në Librin e Kug të Kosovës i cili do të hartohet janë: *Gështenja, Kërleka, Arneni, Bungbuta, Draba e Korabit, Gentiana Lutea (Sanëza), Zambaku Shqiptar, Cerasti Dinarik, Burgulli Maqedonas* etj.

Në mbrotje rigoroze duhet të jenë: *Arneni, Kërleka, Pafti i Hirkanisë, Bangëbuta, Sanza,*

Në kontroll të shfrytëzimit: Në përgjithësi e gjithë flora dhe vegjetacioni i Alpeve Shqiptare është në rrezik nga shkatërrimi dhe zhdukja, prandaj Komuna duhet të marr masa në parandalimin e dukurive negative të shkaktura nga faktori njeri. Ndaj e prerjes ilegale të pyjeve, parandalimi i djegieve aksidentale, kontrolli i shfrytëzimit të bimësisë dhe vegjetacionit janë disa masa.

• **Llojet e faunës**

Llojet e faunës të cilave iu kanoset rreziku i ekzistencës në territorin e Alpeve Shqiptare (edhe pse nuk ka të dhëna detaje vetëm për Bjeshkët e Junikut) janë:

- *Ariu i Murrme dhe Rrëqebullit (Lynx lynx L)* të cilëve iu kanoset rreziku i ekzistencës (janë të ndieshëm në zhurmën e sharrave, praninë e njeirut, prerja e pyjeve, etj)

- Në zvogëlim e sipër janë *Kaprolli, Dhia e Egër, Macja e egër* etj.

- I regjistruar në Librin e Kug është *Gjeli i egër i madh (Tetra Urogallus)*, që është i rralluar meqë është shumë i ndieshëm ndaj zhurmës dhe pranisë së njeriut. *Bonasa nonasia* në Bjeshkët e Junikut; *Familja Accipitridae*- shpend grabitqar me disa lloje të saj por e veçuar me *Shqiponjën e Malit (llojin Aquila chrysetos)* që jeton në malet e larta dhe shkëmbinj të thepisur në Bjeshkët e Junikut.

- Komuna merr masa përmes të cilave nuk lejohet pa arsye të justifikuar që shtazët e egra të shqetësohen, të kapen, të lëndohen, të zvogëlohet numri i popullacionit të llojeve të tyre, vrasja, mënjanimi, shkatërrimi ose dëmtimi i vendbanimeve të tyre si dhe ndryshimi i kushteve jetësore të tyre në masën në të cilën lloji do të

kërcënohet. Komuna merr masa për të mos lejuar zhdukjen e llojeve të egra vendore. (referoju më gjerësisht Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës).

- Komuna përkrah projektet e OJQ-ve të identifikuara me Plan, për promovimin e këtyre vlerave si dhe të aktiviteteve për ushqimin e kafshëve të egra gjatë sezonit dimëror
- Mbrojtja e bimëve, produkteve bimore, masat mbrojtëse biologjike të bimëve etj. janë të rregulluara me Ligjin për Mbrojtjen e Bimëve Nr.02/L-95 dhe Ligjin Nr.02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve.

#### **6.2.6(f): Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe historike**

##### Dispozita të përgjithshme:

- PZHK ka identifikuar dhe lokalizuar vlerat e trashëgimisë kulturore arkitekturale, arkeologjike, etj.
- Komuna bashkëpunon me Ministrinë e Kulturës dhe institucionet e saj në inventarizimin e vlerave të trashëgimisë, hartimin e listës së trashëgimisë për përfshirjen e vlerave të caktuara në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme, krijimin dhe azhurnimin e bazës së të dhënave mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore, si dhe në realizimin e Projekteve të restaurimit dhe funksionalizimit të trashëgimisë kulturore.
- Në momentin që ndonje vlerë e trashëgimisë kulturore hyn në listën për mbrojtje të përkohshme apo të përhershme (shih në Ligj procedurat për shpalljen e vlerës në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme), ajo regjistrohet në Kadastër. Trashëgimia kulturore nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme lirohet nga tatimi në pronë. Dhënia e Lejes për Ndërtim në objektet nën mbrojtje të përkohshme apo përhershme, mënyra e përdorimit me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor, çështjet e kompensimit, financimit, shitjes, të drejtat pronësore të trashëgimisë kulturore nën kontrollin e shtetit apo pronësisë së trashëgimisë kulturore në pronësi private janë të rregulluara me Ligjin për Mbrojtjen e Trashëgimisë.
- Komuna duhet të marrë parasysh rekomandimet e dala nga Plani i Konservimit dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë.

##### Trashëgimia arkitekturale:

- Monumentet arkitekturale në Junik përfshin: kullat, shtëpitë e gurit, vajavicat, mullinjtë etj.
- Monumenteve arkitekturale në momentin kur ato përfshihen në listën për mbrojtje të përkohshme ose të përhershme iu sigurohet zona e mbrojtjes që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet në Planin e Institucionit kompetent dhe në planet hapësinore relevante në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit për Ndryshimih e Ligjit për Planifikim Hapësinor
- Komuna merr masa për të ndaluar lëvizjen apo zhvendosjen e pjesëve ose komplete të ndonjë pjese të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturale
- Komuna kryen inspektim të rregullt dhe merr masa për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë
- Komuna ndërmerr aktivitete ndërgjegjësimi për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë dhe promovimin e saj në favor të zhvillimit të Komunës
- Komuna në bashkëpunim me komunat fqinje inicioni kërkesën në MMPH për hartimin e Planit Hapësinor për Kullat e Dukagjinit si Zonë me Interes të Veçantë e deklaruar me Projekt Planin Hapësinor të Kosovës.
- Komuna lidh marrëveshje të formës së Partneritetit Publiko-Privat në favor të ruajtjes së trashëgimisë dhe shfrytëzimit të saj.

##### Trashëgimia arkeologjike:

- Të gjitha të gjeturat arkeologjike janë pronë e Kosovës
- PZHK ka identifikuar lokalitetin arkeologjik Gradina. Zona ku ndodhet ky lokalitet ka vlera edhe të trashëgimisë natyrore (peisazhet ujore). PZHK propozon hartimin e PrrU-së për atë lokalitet
- Komuna ndërmerr masa për ruajtjen e kësaj zonë nga degradimi
- Rradiusi (kufiri) i Zonës së Mbrojtur është 100 metra nga perimetri i vendit të trashëgimisë së mbrojtur arkeologjike (nëse kjo zonë pas inventarizimit konsiderohet zonë e mbrojtur)
- Aplikimi për Leje Ndërtimi ose krijimtari tjetër brenda Zonës së mbrojtur të një vendi të trashëgimisë arkeologjike paraqiten për shqyrtim në Institucionin kompetent dhe marrjen e Lejes nga ai.
- Procedurat për gërmim arkeologjik, të drejtat, obligimet si dhe shpronësimet, janë përcaktuar me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

#### Trashëgimia e luajtshme

- Komuna bashkëpunon me Ministrinë në krijimin e regjistrit të kësaj trashëgimie
- Sipas Ligjit, objektet e kësaj trashëgimie më të vjetra se 100 vjet vendosen automatikisht nën mbrojtje.
- Trashëgimia e luajtshme që daton para vitit 1453 është pronë publike e Kosovës. Muzetë publik janë institucione kompetente për menaxhimin e koleksioneve publike të trashëgimisë së luajtshme
- Objektet e luajtshme, pjesët përbërëse të trashëgimisë kulturore, komplekset historike, ndërtesat fetare, janë nën mbrojtje dhe ato nuk mund të lëvizen nga konteksti natyror i vendit ku janë të vendosura pa Leje paraprake
- Masat për konservimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së luajtshme nën mbrojtje, qarkullimi i trashëgimisë, tjetërsimi, etj. janë të rregulluara me Ligjin për Trashëgimi.

#### Trashëgimia kulturore shpirtërore:

- Komuna krijon regjistrin e trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe merr masa për të dokumentuar, ruajtur dhe promovuar atë (në pajtim me Ligjin për Trashëgimi Kulturore, parimet ndërkombëtare, standardet dhe praktikat gjyqësore etj.)
- Komuna përkrah projektet e OJQ-ve dhe shoqatave të ndryshme që promovojnë këto vlera

#### ***6.2.6(g): Obligimet e personave juridik dhe fizik për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore***

- Secili person juridik dhe fizik ka për detyrë që të kujdeset për mbrojtjen e tërësisë së trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar, posedues ose shfrytëzues i saj.
- Cilido person fizik apo juridik që dëmton trashëgiminë kulturore, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre pronësore me të, dënohet ose sanksionohet në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligjit për Kundërvajtje dhe në pajtim me nenin 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Trashëgimisë.

#### ***6.2.6(h): Konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore***

- Ndërhyrjet në tërësinë ose vlerat e trashëgimisë kulturore duhet të kenë Lejen nga Institucioni kompetent. Nuk lejohen punët e paautorizuara në vlerat e trashëgimisë kulturore.
- Veprimet konservuese dhe restauruese, projektet dhe proceset e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese duhet të bëhen nga organe të licencuara nga Ministria për këtë punë, të kenë marrë paraprakisht aprovimin si dhe mbikqyren nga Institucioni kompetent.

#### ***6.2.7. Mënyra e trajtimit të mbeturinave***

##### ***6.2.7(a).Trajtimi i mbeturinave***

- Komuna është përgjegjëse për trajtimin e mbeturinave komunale. Komuna harton Planin Lokal për Administrimin e Mbeturinave konform Planit Strategjik të Kosovës për Administrimin e Mbeturinave i hartuar nga MMPH. Plani lokal për administrimin e mbeturinave përfshin periudhen së paku prej 5 vitesh dhe duhet të marrë aprovimin nga MMPH. Dy apo më shumë komuna, mund të hartojnë Planin e përbashkët. Përmbajtja dhe mënyra e hartimit të Planit duhet të jetë konform dispozitave të parapara të Ligjit për Mbeturina, Nr.02/L-30.
- Komuna rregullon veprimtaritë për menaxhimin e mbeturinave mjedisore dhe organizon menaxhimin brenda territorit të tyre përmes lëshimit të Lejeve për menaxhim mbeturinash. Detyrimet e zotëruesve të mbeturinave, prodhuesve të mbeturinave, transportuesve, operatorëve për trajtimin e mbeturinave si dhe detyrimet e operatorit në deponi janë të rregulluara me Ligj
- Komuna organizon, grumbullon, trajton dhe rregullon organizimin dhe mënyrën e ndarjes së mbeturinave për riciklim sipas dispozitave ligjore (neni28) si dhe në përputhje me Planin Lokal të saj. Mbeturinat e rrezikshme

(eksplozive, oksiduese, shumë të ndezshme dhe ato të ndezshme, toksike, etj) dhe ato speciale grumbullohen dhe transportohen si të veçuara /transporti bëhet me mjete adekuate/

- Meqenëse Juniku është komunë e vogël dhe poashtu edhe me buxhet, PZHK rekomandon ngritjen e deponisë së mbeturinave në marrëveshje me dy apo më shumë komuna fqinje. Në kuadër të territorit të saj, komuna mund të ndërtojë një stacion transferi (objekt për administrim të mbeturinave) nga i cili mbeturinat mund të kompresohen dhe vendosen në traktorë që kanë volume të mëdha për procedim në destinacionin tjetër. Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për administrimin e mbeturinave bëhet konform dispozitave ligjore për trajtim të mbeturinave (neni 22). Mbledhja, magazinimi, vendet ku magazinohen-stacioni transfer duhet të jenë teknikut të përgatitura për ruajtjen e përkohshme (afati për ruajtje të përkohshme nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet), trajtimi, ripërdorimi dhe përpunimi i mbeturinave, bëhet në pajtim me dispozitat ligjore të dhëna nga MMPH. Mbeturinat, pasi të jenë trajtuar dhe shfrytëzuar më parë, deponohen në deponi (objekte të licencuara). Kriteret për zgjedhjen e lokacionit të deponive duhet të jenë konform Udhëzimit administrativ të MMPH-së
- Komuna ndërmerr aktivitete të ndryshme dhe bashkëpunon ngusht me OJQ-të mjedisore, në rritjen e vetëdijës qytetare për mbrojtjen e mjedisit nga mbeturinat
- Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, Komuna merr masa për parandalimin e ndotjes nga hedhurinat

#### **6.2.7 (b) Trajtimi i ujërave të zeza:**

- Komuna merr masa për ndalimin e shkarkimit të ujërave të zeza në lumenj.
- Komuna do të hartojë programin për trajtimin e ujërave të zeza dhe atmosferik i cili duhet të shikohet në tri dimensione:
  - ndërtimin e kolektorit kryesor (impiantit) për trajtimin e ujërave të zeza (që duhet të ketë një qasje regionale dhe bashkëpunim ndërkomunal për përzgjedhjen e lokacionit)
  - rehabilitimin e rrjetit ekzistues të kanalizimit (përgjegjësi e komunës për realizimin e projekteve për mirëmbajtjen e këtij rrjeti)
  - zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në zonat ku mungon (përgjegjësi e komunës për realizimin e projekteve të parapara me Plan).

### **6.2.8. Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis**

#### **6.2.8 (a) Masat për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja**

##### Dispozita të përgjithshme:

PZHK ka identifikuar zonat ku ka ndotje dhe degradim të mjedisit dhe propozon veprimet e përgjithshme si:

- Komuna bashkëpunon me Ministrinë përkatëse, institucionet e organizatat tjera në përgatitjen e Planeve (Planit për Veprim Lokal për Mbrojtje të Mjedisit, Planit Operacional për Menaxhimin e Pyjeve, Planit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga Fatkeqësitë etj.) Programeve dhe Projekteve si dhe Ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.
- Komuna, në kuadër të përgjegjësisë të veta të përcaktuara me Ligj siguron kontroll të vazhdueshëm dhe bën monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit. Monitorimi i mjedisit kryhet përmes matjeve sistematike, hulumtimit dhe vlerësimit të indikatorëve të gjendjes dhe ndotjes së mjedisit të cilat përfshijnë përcjelljen e faktorëve natyror, monitorimit të ajrit, ujit, tokës, pyjeve, llojllojshmërisë biologjike dhe peisazhore, florën dhe faunën, mbështjellësit të ozonit, rrezatimit, zhurmës, mbeturinave; merr parasysh detyrimet dhe përgjegjësitë e marra nga marrëveshjet ndërkombëtare. Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi i gjendjes së mjedisit, përbëjnë informacion publik dhe përfshihen në Sistemin Informativ të Mbrojtjes së Mjedisit. Detyrimet e subjekteve që me aktivitetet e tyre shkaktojnë ndotje në mjedis janë të rregulluara me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.

##### Dispozita të veçanta:

- Komuna ndërmerr këto masa për të parandaluar apo/dhe përmirësuar gjendjen mjedisore:

#### **i) Masat për mbrojtjen e ajrit nga ndotja:**

- Komuna, në bashkëpunim me MMPH-në, duhet të vendos sistemin e monitorimit për të monitoruar cilësinë e ajrit të ndotur nga aktivitetet e ndryshme dhe ndërmerr masa për të zvogëluar atë

**ii) Masat për mbrojtjen e ujit nga ndotja:**

- Komuna merr pjesë dhe bashkëpunon me Ministrinë përkatëse në realizimin e Projekteve dhe përpilimin e Planeve e Programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ujërave
- Komuna merr një sërë masash për mbrojtjen e ujërave:
  - Ndalon shkarkimin e ujërave të zeza në shtretërit e lumenjve. Rrjeti i derdhjes së ujërave të zeza duhet të kompletohet dhe të ketë trajtimin primar në nënstacion. Komuna bashkëpunon me komunat tjera në aktivitetet për mbrojtjen e lumenjve nga ndotja si dhe projekte si: ndërtimi i impiantit për trajtimin sekondar të ujërave të zeza
  - Ndalon hedhjen e substancave dhe mbeturinave të cilat për shkak të vetive fizike, kimike e biologjike mund të rrezikojnë shëndetin publik, organizmat ujor, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë pajisjet ose instalimet ujore. Ndalon hedhjen dhe transportimin e substancave dhe mbeturinave të rrezikshme në ujëra
  - Ndalon ndërtimin e objekteve dhe paisjeve të dedikuara për prodhimin e substancave të rrezikshme në afërsi të resurseve ujore, përderisa nuk është fituar e drejta ujore dhe Lejet tjera sipas Ligjit
  - Komuna në bashkëpunim me Ministrinë ndërmerr masa për rregullimin, shfrytëzimin dhe përdorimin publik të ujërave.

**iii) Masat për mbrojtjen e tokës nga ndotja:**

Mbrojtja e tokës bujqësore dhe kullosave nga ndotja bëhet me masat si:

- Komuna ndërmerr masa për ruajtjen dhe përmirësimin e plleshmërisë së tokës sipas dispozitave të parapara të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit  
Ruajtja e shtresës së plleshme të tokës
- Çdo investues është i obliguar që para fillimit të kryerjes së punëve në tokën bujqësore, të largoj dhe të ruajë shtresën potencialisht të plleshme të tokës për nevoja të rikultivimit të tokës ose për aftësimin e tokës me plleshmëri më të vogël apo të tokës së pa plleshme për prodhimtari bujqësore. Kjo shtresë e cila është hequr para ndërtimit të objektit shfrytëzohet për bujqësi konform metodologjisë unike për aftësim të tokës me plleshmëri më të vogël apo tokës së paplleshme për prodhimtari bujqësore

Mbrojtja e tokave pyjore nga ndotja dhe degradimi:

- Komuna në suaza të kompetencave që ka, merr masa për ndalimin e prerjes ilegale të pyjeve si dhe shfrytëzimin ilegal apo të pakontrolluar të produkteve pyjore
- Komuna ndërmerr aktivitete pyllëzimi dhe ripyllëzimi në zonat pyjore të zhveshura dhe ku ka paraqitje të erozionit. Komuna përkrah aktivitetet e tilla të ndërmarra nga ndonjë subjekt tjetër

***6.2.8 (2) Masat për mbrojtje e parandalim të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera:***

Dispozita të përgjithshme:

- PZHK ka lokalizuar zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë
- Komuna harton Planin për Mbrojtje dhe Shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, i cili duhet të jetë në përputhje me atë të Qeverisë
- Komuna, në rast fatkeqësie natyrore ose tjetër, vepron dhe merr masa në suaza të kompetencave të saj të parapara me Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
- Komuna, gjatë realizimit të detyrave të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera bashkëpunon me komunat tjera dhe mund t'i bashkojë mjetet e shërbimet për realizimin e çështjeve të përbashkëta në mbrojtje nga fatkeqësitë

Dispozita të veçanta:

**i) Masat për mbrojtje nga përmbytja:** PZHK ka përcaktuar zonat e rrezikuara nga përmbytja: Komuna ndërmerr masa për parandalimin e kësaj dukurie si dhe merr pjesë në hartimin e Planit për Administrimin e Përmbytjeve të cilin e harton Ministria. Masat përfshijnë:

- Rregullimi i shtratit të lumit Erenik dhe riparimi i digës në lumin Trava
- Komuna merr Vendim për ndalimin e nxjerrjes së rërës nga lumi te Prita e Katundit - Tofaj

**ii) Masat për mbrojtje nga zjarri:** PZHK ka identifikuar lokalitetet ku ka patur paraqitje më të shpeshtë të zjarreve. Për të parandaluar këtë dukuri ndërmirren masat si vijojnë:

- Asnjë person pa Leje paraprake të paraparë sipas dispozitave Ligjore s'mund të ndezë zjarr të hapur në pyjet ose tokat pyjore (kjo nuk nënkupton zjarret përbrenda një ndërtese ose oxhaku, apo pajisjeve të tjera të dizajnuara për mbajtjen e sigurt të zjarrit).

- Komuna ndërmerr fushatë për ndërgjegjësim për mbrojtje nga zjarri dhe parandalim

**iii) Masat për mbrojtje nga materiet eksplozive dhe materiet e rrezikshme:**

- PZHK ka lokalizuar zonën e rrezikuar nga minat (fshatrat Jasiq dhe Gjocaj).
- Komuna në bashkëpunim me institucionet (FSK dhe KFOR) ndërmerr aktivitete për deminimin e kësaj zone. Administrimi me materie të rrezikshme, planifikimi, organizimi dhe ndërmarrja e masave për parandalim dhe sanim, kryhet në kushte dhe në mënyrën më të cilën sigurohet zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësia eventuale
- Komuna ndërmerr fushatë ndërgjegjësimi për sensibilizimin e kësaj çështjeje dhe rrezikshmërinë e saj

**iv) Masat për mbrojtje nga tërmetet:** PZHK ka identifikuar zonat me aktivitet seizmik dhe propozon masat si vijon:

- Ndërtimet në zonat me intensitet të lartë seizmik nuk lejohen; në rast se kjo është e paevitueshme, atëherë, komuna duhet të aplikojë mikrozonimin (shqyrtimin e ndikimit seizmik) gjatë fazës së projektimit për objektet banesore, publike, komerciale, industriale në këto zona
- Në ndërtesat ekzistuese në fushat me ndikim të lartë seizmik dhe rrëshqitje toke. Komuna ndërmerr veprime për përforsim
- Në ndërtimet e reja komuna aplikon normat e stabilitetit dhe siguron inspektim të rregullt dhe rigoroz në punimet e ndërtimit

**v) Masat për mbrojtje nga erozioni:** PZHK ka identifikuar zonat erozive. Komuna me vendim mund të shpall zonat me erozion të lartë (shih gjerësisht Ligjin për Ujërat) në të cilat komuna merr urgjentisht masa si vijon:

- Kufizon ose ndalon prerjen e drunjve, përveç në rastet kur kjo është masë agroteknike
- Bën kufizimin ose shfrytëzimin e kullotave duke përcaktuar llojin, kohën, numrin e kafshëve që mund të kullosin, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre
- Ndalon lëvrimin e livadheve, kullotave dhe sipërfaqeve të pashfrytëzuara të tokave të pjerrëta për qëllime të shndërrimit të tyre në tokë të lëvrueshme me kultura njëvjëçare
- Detyron mbjelljen e barit të llojit të veçantë në tokat e pjerrëta
- Bën ndalimin e largimit të shtresës humusore ose shtresës së punueshme nga toka bujqësore
- Obligon ndërmarrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga erërat
- Ndalon nxjerrjen e rërës nga lumejtë
- Ndërmerr veprime për rregullimin e shtretërve të lumejve dhe brigjeve të tyre
- Tek Gurthi dhe Oda, vendos rrjetat dhe bën vegjetim për të penguar rrëshqitjen e gurëve
- Komuna ndalon ndërtimet në zonat ku ka erozion të lartë, përderisa aty nuk përmbushen kushtet sipas Nenit 42.4 të Ligjit për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

**Vërejtje:** Shpenzimet e zbatimit të masave kundër erozionit i mbulon pronari apo shfrytëzuesi i tokës. Nëse ndërmarrja e masave kundër erozionit është me interes të përgjithshëm, Qeveria mund të caktojë institucionet publike si pjesëmarrës në shpenzimet për zbatimin e këtyre masave.

**6.2.8 (3) Masat për mbrojtje nga zhurma dhe vibracioni:**

- Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdor pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me Ligj të veçantë.
- Mbrojtja e vendbanimeve nga zhurma bëhet duke ndërtuar pengesa, si dhe përmes brezave gjelbërues

**6.2.8 (4) Mbrojtja nga ndryshimet klimatike:**

- Masat në paragrafët e lartpërmendur ndikojnë në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike
- Komuna do të stimulojë dhe favorizojë ndërtimet të cilat përdorin energjinë alternative
- Komuna do të përkrah projektet që kanë të bëjnë me rritjen e efikasitetit të energjisë si në veprimtaritë publike poashtu edhe private

#### **6.2.8 (5) Masat e rehabilitimit**

- Komuna merr masa për rehabilitimin e dëmeve në mjedis të shkaktuara nga personi juridik ose fizik, autoriteti publik apo ato të shkaktuara nga fatkeqësitë
- Subjektet që shkaktojnë dëme të tilla janë të detyruara ta kthejnë pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut duke respektuar dispozitat Ligjore për Mbrojtjen e Mjedisit
- Personi juridik ose fizik, apo autoriteti publik që merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjell dëm të madh apo kritik mjedisor ose aksident mjedisor, ai ka obligim që në afat të caktuar të ndërmarr masa dhe me aktivitetin e tij në të ardhmen të zvogëloj emisionin dhe cilësinë e mjedisit në nivelin e lejuar si dhe të minimizoj rrezikun për një aksident mjedisor në pajtim me Ligjin

#### **6.2.8(6): Masat për objektet e sigurisë publike:**

- Projektet për ndërtimin e objekteve të përcaktuara me Ligj nga Qeveria të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizimin e qytetarëve, të transportit publik, si dhe deponimin, prodhimin, përdorimin e materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, duhet të përmbajnë elaborate të sigurimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera
- Komuna do të bashkëpunojë me komunat fqinje për të përcaktuar lokacionin për të të ndërtuar strehimore publike të cilat mund të subvencionohen nga Qeveria apo adaptimin e objekteve për strehim sipas normave teknike të përcaktuara me Ligj
- PZHK ka paraparë ndërtimin e Qendrës Emergjente e cila do të mundësojë realizimin e detyrave operative nga fusha e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
- Ndërtimet në zonat erozive lejohen nëse janë përmushur kushtet sipas nenit 42.4 të Ligjit për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

#### **6.2.8(7): Lejet, Pëlqimet Mjedisore dhe Pëlqimet tjera:**

- **Vlerësimi strategjik mjedisor:** Komuna duhet të arrijë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të harmonizojë çështjet mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e Planeve dhe Programeve, duke siguruar se vlerësimi strategjik mjedisor bëhet për Planet dhe Programet të cilat kanë mundësi të kenë ndikim të theksueshëm në mjedis (shih më gjerësisht Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Nr.03/L-230)
- **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis:** Vlerësimi i ndikimit të Projekteve në mjedis bëhet për Projekte të cilat planifikohen të realizohen në hapësirë të caktuar, duke përfshirë edhe ndryshimet e teknologjisë, rekonstruimin, zgjerimin e kapaciteteve ose ndërprerjen e punës, gjë që mund të sjell deri te ndotja e mjedisit ose mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Nr.03/L-024, përcakton projektet të cilat i nënshtrohen VNM-se. Rekomandimet për hartimin e VNM të projekteve të propozuara me Plan, janë dhënë edhe me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit socio-ekonomik-mjedisor të PZHK-së (bashkangjitur si dokument shtesë i Planit).
- Pëlqimi mjedisor për shfrytëzim të resurseve natyrore, Leja Mjedisore për objektet e ndërtuara që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit mjedisor, Leja Mjedisore Komunale, Licencat etj. janë të rregulluara me Ligj. Komuna bashkëpunon me Ministrinë përkatëse për të siguruar zbatimin e Ligjit gjatë ekzekutimit të projekteve që kanë ndikim në mjedis.

#### **6.2.9. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social**

- Për t'iu shmangur ndikimit negativ social, komuna do të sigurojë infrastrukturën e nevojshme sociale sipas projekteve të parapara me Plan (ndërtimi i shkollave, qendrës rinore, muzeut, bibliotekë, shtëpi kulture, zyre për kujdes ndaj pleqve, salla sportive dhe rregullim të hapësirave për sport e rekreacion, etj.) si dhe harton programe dhe ndërmerr aktivitete që gjenerojnë dhe krijojnë kushte për mirëqenie sociale
- Komuna harton Programin për punësim si dhe kujdeset që të ndërmerr aktivitete që gjenerojnë vende të reja pune duke marrë parasysh interesat e grupeve të ndryshme të shoqërisë varësisht nga mosha, gjinia, aftësitë, edukimi, etj.

- Gjatë zhvillimit të projekteve të ndryshme, komuna duhet të favorizojë potencialin lokal (vendor) të Junikut në kryerjen e punëve, normal në kushtet kur ata janë të barabartë me pjesëmarrësit tjerë që aplikojnë për Projekt.
- Komuna në bashkëpunim me OJQ-të, bizneset, donatorët etj. harton projekte dhe ndërmerr aktivitete që masivizojnë aktivitetet kulturo-sportive me qëllimin angazhimin e të rinjve në këto aktivitete duke parandaluar kështu mundësinë e përfshirjes së të rinjve në dukuri negative.
- Komuna përmes projekteve të parapara me Plan, duhet të sigurojë kushte për të ofruar siguri publike. P.sh.
  - Për qarkullim të sigurtë edhe gjatë natës është me rëndësi që projektet e ndërtimit të rrugëve gjithnjë të përcillen me ofrimin e ndriçimit publik
  - Komuna nuk do të lëshojë asnjë Leje Ndërtimi për objektet të cilat nuk kanë marrë parasysh aplikimin e normave të projektimit për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta (rampat në objekte, parkingjet, vendkalimet, trotuare të projektuar në formën që lehtësojnë lëvizjen e lirshme të kësaj kategorie, hyrjet dhe qarkullimin e lehtë në lokale etj). Këto masa do të parandalojnë segregacionin social
- Trajtimit të hapësirave publike duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë. Në zhvillimin e Projekteve të tilla, Komuna duhet të sigurojë pjesëmarrjen e palëve me interes në procesin e dizajnit urban të hapësirës
- Gjatë hartimit të PrrU-ve të propozuara, komuna duhet të sigurojë përfshirjen e banorëve të lagjes për të cilën hartohet Plani në këtë proces dhe merr parasysh kërkesat e tyre. Komuna nuk duhet të lejojë të tilla rregullime të cilat favorizojnë një kategori të caktuar shoqërie dhe krijojnë geto-shoqëri
- Komuna gjatë përpilimit dhe zhvillimit të projekteve të ndryshme të propozuara me Plan, duhet të sigurojë proces transparent ndaj publikut. Do t'i kushtohet rëndësi informimit dhe mënyrës se si bëhet informimi për të eliminuar çdo mundësi eventuale për paraqitjen e pakënaqësive të palëve që kanë interes në atë Projekt.

### **6.2.10. Masat për zbatimin e Planit**

#### **6.2.10.a Detyrimi për hartimin e Planit**

- Komuna siguron kushtet financiare dhe kushtet tjera për Zbatimin e Planit dhe Projekteve të dala nga ai
- Planet Rregulluese Urbane të propozuara me PZHK, nuk guxojnë të mos jenë në përputhshmëri me dispozitat e PZHK.
- Sipas Projekt PHK, për çdo hapësirë që kalon sipërfaqen më shumë se 2 Ha jashtë Zonës Urbane duhet të hartohen PRRU (kjo përfshin hapësirat për parqe biznesi/industriale, hapësirat për zhvillim turizmi, sport e rekreacion etj.)
- Komuna harton këto Plane Rregulluese Urbane jashtë Zonës Urbane:
  - PRRU për vendbanimin Jasiq dhe Gjocaj sipas konceptit të zhvillimit si fshatra turistike dhe eko-turizëm
  - PRRU për Zonën Ekonomike bazuar në zhvillimin e bujqësisë dhe agro-biznesit te cilit i paraprin studimi i fizibilitetit.
  - PRRU për Zonat Turistike të përcaktuara në Planin e Veprimit (B1.20; B1.21; B1.22)
- Lejet Urbanistike dhe Lejet e Ndërtimit për zhvillimet jashtë Zonës Urbane lëshohen sipas rekomandimeve të PZHK-së dhe në bazë të dispozitave të përcaktuara në paragrafët e lartpërmendur të PZHK-së. Komuna merr parasyh dispozitat Ligjore për Lejet Urbanistike dhe Lejet e Ndërtimit për objektet e përcaktuara me UA të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjit për Ndërtim si dhe Ligjeve tjera përkatëse.

#### **6.2.10.b. Aplikimi i masave zhvillimore dhe i masave tjera**

- Pas miratimit të planit, komuna ndërmerr veprime për ndërlidhjen e planit me regjistrin kadastral përfshirë veprimet për krijimin e kadastrit të ri nëse me plan është bërë ndërrimi i destinimit të tokës;
- Zbatimi i riparcelimit dhe eksprojimit mund të jenë të domosdoshme për arritjen e synimeve hapësinore.
- Komuna themelon dhe mirëmban sistemin e të dhënave të planit (në referencë të ligjit për planifikim hapësinor) i cili duhet të jetë në harmoni me atë të Ministrisë
- Në zonat e përcaktuara me interes special dhe atyre të mbrojtura duhet të ndërmirren masa të vecanta për mbrojtjen e tyre (shih paragrafët tek mbrojtja e mjedisit dhe peisazheve)

**6.2.10.c. Rekonstruimi i ndërtesës destinimi i së cilës është në kundërshtim me destinimin e planifikuar**

- PZHK parasheh hartimin e Rregullores Komunale dhe Programit (në përputhshmëri me dispozitat Ligjore) për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje pas miratimit të Ligjit përkatës
- Komuna nuk do të lejojë zgjerimin apo mbindërtimin në ndërtesat ekzistuese që janë në zona me peisazhe të bukura natyrore, nëse me Plan kjo nuk është e lejuar
- Problemet specifike në lidhje me VJF do të zgjidhen në pajtim me veprimet e cekura në PZHK dhe sipas udhëzimeve të MMPH/DPH.
- Komuna merr masa për parandalimin e ndërtimeve në zonat ku ndërtimet nuk janë të lejuara

**6.3. DISPOZITAT LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN**

- Komuna informon, bashkëpunon apo/ arrin marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Ministrinë dhe Agjencitë përkatëse për Projektet e propozuara në PZHK që kërkojnë pjesëmarrjen e këtyre institucioneve
- Komuna informon, bashkëpunon apo/ lidh marrëveshje bashkëfinancimi me Komunat fqinje për Projektet me interes të përbashkët. Komuna bashkëpunon me Agjencionin për Zhvillim Regional në realizimin e Projekteve të tilla
- Komuna informon, bashkëpunon dhe arrin marrëveshje partneriteti me ndërmarrjet publike për shërbimet publike në kompetencat e këtyre ndërmarrjeve (çështjet e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, menaxhimit të mbeturinave, etj.)
- Komuna bashkëpunon dhe krijon marrëveshje partneriteti (PPP) me sektorin privat në Projektet që të dy palët kanë interes të përbashkët
- Komuna krijon marrëdhënie bashkëpunimi ndërkufitar me Komunat e shteteve fqinje, për Projektet me interes të përbashkët
- Komuna bashkëpunon me donatorët e ndryshëm në Projektet e parapara me Plan, realizimi i të cilave mund të ndihmohet nga Programet e ndryshme të donatorëve
- Komuna përkrah dhe bashkëpunon me OJQ-të në një sërë Projektesh të parapara me Plan e sidomos në ato që kanë të bëjnë me fushata ndërgjegjësimi dhe promovimi të vlerave të komunës
- Komuna gjatë hartimit të Planeve tjera që rrjedhin nga PZHK, duhet të sigurojë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e publikut (qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit) qysh në fazat e fillimit dhe gjatë gjithë procesit dhe ndërmerr fushatë informimi ashtu siq është parapa me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor.

**6.4. DISPOZITAT PËR RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E IMPLEMENTIMIT**

Plani Zhvillimor Komunal ka paraparë këto faza të zhvillimit të veprimeve:

- Komuna themelon Njësinë për Planifikim e cila do të mirret me: Përcjelljen e zbatimit të Planit dhe Projekteve të dala nga ai, harton raportet vjetore për monitorim dhe vlerësim të Planit si dhe jep sygjerimet për ndryshimet eventuale(revidimi) etj.
- Komuna (Njësia për Planifikim) harton Programin për Zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal.
- Veprimet/Projektet e propozuara në PZHK janë grupuar në tri faza të zhvillimit:
  - faza I-rë: periudhën 2011-2013 ku kryesisht janë të përfshira projektet /veprimet afatshkurta të cilat edhe janë të ndërlidhura me kornizën afatmesme të planifikimit buxhetor komunal
  - faza II-të: periudhën 2014-2016 dhe i përfshin veprimet/Projektet afatmesme
  - faza III-të: periudhën 2017-2023+ dhe përfshin veprimet/Projektet afatgjata
- Të gjitha investimet në Komunë që kanë karakter hapësinor duhet të jenë në harmoni me propozimet dhe prioritetet e përcaktuara me Planin Zhvillimor Komunal

- Pas miratimit të Planit dhe hyrjes së tij në fuqi, Komuna duhet të analizojë Planin aktual buxhetor (kornizën buxhetore) dhe gjatë rishikimit të saj, komuna inkorporon projektet e parapara në kornizën buxhetore të rishikuar.

## 6.5. ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM

Plani Zhvillimor Komunal ofron një kornizë për zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve në fushat e caktuara:

- Studim fizibiliteti për shfrytëzimin e potencialit pyjor në zhvillimin e industrisë së drurit, përpunim final dhe plasim të mëtejshëm
- studim fizibiliteti për shfrytëzimin e energjisë alternative në përgjithësi por edhe mundësinë e shfrytëzimit të saj për ngrohje qendrore
- studim fizibiliteti për ndërtimin e rrugës prej Bjeshkës deri tek trekëndëshi kufitar Shqipëri-Kosovë-Mal i Zi
- analizë për shfrytëzueshmërinë dhe ruajtjen e produkteve malore (boronica, bimët mjekuese, gështenja etj.)

## 6.6. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

**Hyrja në fuqi:** Ky Plan hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut me datën 29 korik 2011.

**Vlefshmëria:** Ky Plan do të jetë i vlefshëm deri në vitin 2023.

**Vlerësimi dhe Ndryshimet e Planit:** Vlerësimi dhe monitorimi i zbatueshmërisë së Projekteve të Planit bëhet nga Njësia për Planifikim dhe atë në baza të rregullta vjetore.

Rishikimi/revidimi i Planit do të bëhet çdo 5 vjet.

Ndryshimet apo plotësimet e propozuara nga rishikimi, duhet të bëhen sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar për miratimin e tyre fillestar (*Ligji për Planifikim Hapësinor, 2003/14, neni 20*).

Çdo propozim ndryshim, amandamentim apo shfuqizim i Planit duhet të kalojë nëpër procesin e Shqyrtimit Publik i cili zgjat jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë (*Udhëzimi Administrativ për Zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor për Procedurën e Shqyrtimit Publik për Planet Hapësinore dhe Urbanistike UA 54/2005, neni 5.4*).